



100 Vjet Pavarësi

KLSH NË KUVEND 2011



- Raporti vjetor i KLSH 2011
- Prezantimi i Raportit në Komisionin e Ekonomisë
- Diskutime në Kuvend mbi Raportin e KLSH 2011
- Rezoluta e Kuvendit dt.26.04.2012

INTOSAI



Tiranë, 2012

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**KLSH NË KUVEND
2011**

Tiranë, 2012

Titulli :
KLSH NË KUVEND

Seria: Botime KLSH
02/2012

© Mundësohet përdorimi i materialeve të këtij botimi,
kundrejt citimit të burimit, KLSH.

ISBN: 978-9928-159-02-1

Shtypur në shtypshkronjën “Mirgeeralb”
Tiranë, 2012

Hyrie

Edicioni i dytë i kolanës “Botime KLSH” me titull “KLSH në Kuvend” përmban informacion të detajuar për prezantimin e Raportit Vjetor të KLSH 2011 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit dhe në seancën plenare të Kuvendit. Ai i sjell të plota diskutimet e deputetëve në Komision dhe në seancë plenare lidhur me raportin dhe veprimtarinë e institucionit në tërësi.

Detyrimi për të publikuar eksperiencat e fituara, krahas detyrimit kushtetues për KLSH për t'i raportuar Kuvendit dhe publikut, buron dhe nga standardi bazë ISSAI 20 i standardeve të INTOSAI, i cili rendit ndër Parimet themelore të punës së një institucioni të auditimit më të lartë (SAI):” SAI-t komunikojnë në kohë dhe gjerësisht për aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimeve nëpërmjet medias, publikimeve të ndryshme, faqeve në internet dhe mjeteve të tjera të komunikimit masiv” (ISSAI 20, Parimi 8).

Edicioni “Botime KLSH: KLSH në Kuvend” mbyllet me Rezolutën e Kuvendit për KLSH të datës 26 prill 2012, e cila afirmon mbështetjen e plote të organit suprem ligjvënës të vendit për KLSH dhe shtron detyra për të ardhmen.

Bujar LESKAJ



** Në latinisht, “Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë” - Moto e INTOSAI, organizata ndërkombëtare e institucioneve më të larta të auditimit*

Përmbajtja

	<i>Faqe</i>
- Raporti Vjetor i KLSH, dërguar Kuvendit me 02 mars 2012.....	5-152
- Fjala e Kryetarit të KLSH në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit me 20 mars 2012.....	153-179
- Diskutime të deputetëve në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit me 20 mars 2012 (Edmond Spaho, Florion Mima, Erion Braçe, Gjokë Ulledaj, Albert Çaçi, Arben Malaj, Sherefedin Shehu, Mimi Kodheli)	181-207
- Diskutime të deputetëve, në seancën plenare të Kuvendit datë 26 prill 2012 (Mesila Doda, Arta Dade, Sherefedin Shehu, Klodiana Spahiu, Selami Xhepa, Asllan Dogjani, Gjok Ulledaj, Erion Braçe, Edmond Spaho).....	209-250
- Informacion për procesin e votimit të Rezolutës për KLSH.....	251
- Rezoluta e Kuvendit për veprimtarinë e KLSH 2011.....	253

RAPORT “PËR VEPRIMTARINË E KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2011”.

HYRJE

Në zbatim të kërkesave të nenit 164, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 18, të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, ju paraqesim raportin “Për veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2011”.

Duke ju falenderuar për mbështetjen që i keni dhënë institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2011, të shprehur qartazi dhe me intensitet në Rezolutën e Kuvendit datë 2 qershor 2011, ju informoj se ky institucion ka punuar për të realizuar objektivat e Planit të tij Strategjik të Zhvillimit 2009-2012 për vitin ushtrues. Gjatë 2011-ës, KLSH ka kryer 152 kontrolle ku janë konstatuar shkelje financiare me dëm të konsiderueshëm ekonomik, si dhe ka rekomanduar shpërblimin e këtij dëmi ekonomik në nivel të lartë financiar në arkën e Shtetit. Ka rekomanduar gjithashtu, masa korigjuese administrative dhe disiplinore, ndonëse përgjithësisht masat e propozuara kanë qenë të lehta.

Gjatë vitit 2011, KLSH ka propozuar ndryshime apo përmirësime ligjore në dispozitat ligjore në fuqi, si dhe ka kryer kallzim penal pranë organeve të Prokurorisë në 6 raste dhe për 13 persona, shifra këto të pamjaftueshme përballë sfidës për thellimin e luftës kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij.

Bashkëpunimi me organet e Prokurorisë në ndjekjen e kallzimeve penale nuk ka qenë në nivelin e kërkuar, megjithëse KLSH ka një marrëveshje me Prokurorinë të vitit 2005, e cila ende nuk është bërë efektive, si rrjedhojë e punës së dobët të institucionit tonë dhe të nënvleftësimit nga ana e Prokurorisë.

Stafi i institucionit ka punuar të zbatojë Rregulloren e tij të Brendshme, Standardet e Kontrollit të KLSH, Metodikat, Manualët e Auditimit Financiar e të

Performancës dhe Kodin Etik, si dhe është përpjekur, por pa ia arritur, për implementimin e standardeve të përditësuara të INTOSAI. Audituesit në jo pak raste janë mjaftuar me dokumentacionet e ofruara nga subjektet e kontrolluara dhe ka munguar vullneti ose aftësia profesionale në zbulim të mashtrimit financiar dhe të korrupsionit.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të KLSH për shpërblimin e dëmit të konstatuar rezulton në një përqindje mjaft të ulët (vetëm 9.5 përqind). Në vlerë absolute nga 7,027 milionë lekë rekomanduar për shpërblim të dëmit, administrata publike ka nxjerrë urdhërat përkatëse për 667 milionë lekë. Diferenca në mosrealizim lidhet me faktin se mbi 83 përqind e dëmit të rekomanduar për shpërblim është konstatuar në dy shoqëri tregtare si AlbPetrol dhe OST, në të cilat procedurat e shpërblimit të dëmit janë në proces.

Auditimet e performancës të subjekteve nën kontroll, të cilat kanë filluar të praktikohen 2-3 vitet e fundit, gjatë vitit 2011 kanë qenë formale dhe shumë të pakta, duke mos u përgatitur dhe kryer sipas kërkesave të manualit përkatës të KLSH. Dijet e stafit për auditimin e performancës janë ende shumë të kufizuara dhe ka dy vjet që nuk kryhen më trajnime për t'i zgjeruar këto dije.

Koordinimi brënda strukturave të KLSH duhet të ishte më produktiv. Informacioni për kontrollet e kryera dhe rezultatet e marra, ndonëse teknologjia e informacionit ka qenë e pranishme, nuk kanë qarkulluar elektronikisht mes departamenteve. Gjatë 2011-ës kanë munguar kontrollet që përdorin programet e teknologjisë së informacionit, ku më i njohuri dhe që përdoret nga institucionet homologe të kontrollit të lartë është programi "IDEA", të cilin KLSH e disponon, por nuk e ka përdorur gjatë vitit 2011.

Për vitin 2012, KLSH ka një program të qartë dhe po synon të fuqizojë cilësinë e veprimtarisë kontrolluese dhe të përgatitjes së raportimeve, përfshirë rekomandimet për zbatim, duke riorganizuar kontrollin e cilësisë brënda departamenteve të auditimit, si hallkë e parë në ngritjen e cilësisë së punës së

stafit. Brënda muajit mars do të përfundojë riorientimi i rregullores së brendshme të institucionit drejt standardeve të përditësuara të INTOSAI, duke kthyer vëmendjen drejt auditimit të performancës, krahas fuqizimit të auditimit financiar. KLSH gjatë shkurtit 2012 ka krijuar departamentin e ri të Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Kontrollit të Brendshëm. Ka nisur bashkëpunim konkret për një planifikim shkencor të kontrollit financiar dhe të performancës, duke përfunduar një marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi eksperience me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës dhe duke negociuar me përfaqësues të programit SIGMA të BE-së. Kemi kërkuar bashkëpunim me institucione homologe të zhvilluara, si SAI gjerman dhe SAI suedez. Kemi nisur kontaktet e para dhe përgatitur draft-marrëveshje për vendosjen e një bashkëpunimi konkret me Njësinë Qëndrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, për të sinergjizuar punën me audituesit e brendshëm të subjekteve të kontrolluara dhe për të shmangur dublimet në kontrolle. Ka nisur bisedimet me institucionet profesionale të fushës, si IEKA, me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, me Autoritetin e Konkurrencës, me Fakultetin Ekonomik të Universitetit Shtetëror të Tiranës, për bashkëpunim drejt rritjes së performancës së punës audituese të stafit. Në kërkim të rritjes së transparencës me publikun dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile, krahas pjesëmarrjes së medias dhe shoqërisë civile në analizën vjetore 2011 të departamenteve të tij, KLSH ka nisur kontaktet me përfaqësuesit më aktivë të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit, për realizimin e politikave të përbashkëta.

Në tërësi, KLSH po bën përpjekje të kalojë në një vizion më koherent të aktivitetit të tij, mbi bazën e respektimit rigoroz të standardeve ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI.

Vizioni dhe strategjia e tij, duke filluar nga viti 2012 është që të shndërrohet në një institucion publik modern të auditimit të jashtëm, i cili funksionon në

sinkron të plotë me standardet e përditësuara INTOSAI dhe praktikat më të mira evropiane.

I. Përmbledhje e performancës.

Nga shqyrtimi i plotë i produkteve të institucionit gjatë vitit 2011, në raport me objektivat dhe detyrat e përcaktuara në fillim të vitit, në mënyrë të përmbledhur performanca e KLSH paraqitet si vijon:

- Gjatë vitit raportues, është përpjekur të zhvillojë dhe praktikojë, por pa ia arritur plotësisht, një metodologji bazuar në standardet ndërkombëtare për kontrollin dhe në praktikat e mira të kontrollit të vendeve të BE.
- Në funksion të kësaj, KLSH ka përgatitur dhe nxjerrë në Intranet për shfrytëzim nga punonjësit mjaft materiale, përfshirë standardet e kontrollit, rregullat bazë dhe procedurat për kryerjen e kontrolleve nga strukturat respektive në KLSH, manualet e auditimit, materiali udhëzues për sigurimin e cilësisë së kontrollit etj., materiale që pak janë përdorur apo referuar nga audituesit e institucionit në punën e tyre të përditshme.
- KLSH vëren se megjithatë ka, në krahasim me një vit më parë, një ecuri disi pozitive të veprimtarisë kontrolluese, rrjedhojë e përcaktimit të kërkesave për kontrollin e cilësisë, përfshirë zbatimin e rregullave proceduriale për vlerësimin e sistemit të sigurimit të cilësisë, duke përdorur vlerësimin objektiv të 10% të dosjeve të kontrollit të përfunduara e të evaduara. Por, duhet theksuar se procesi dhe procedurat e kontrollit të cilësisë nuk kanë arritur të japin një nivel cilesie të pranueshëm në raport me mundësitë. Kjo ka ulur cilësinë e përmbajtjes së raporteve përfundimtarë të kontrollit.
- KLSH ka realizuar si vëllim detyrat e përcaktuara për veprimtarinë kontrolluese. Nga 150 kontrolle gjithsej të programuara janë realizuar 152, ose 2 kontrolle më shumë. Ndërkohë, vlerësimi i materialitetit dhe i riskut ka çaluar dhe jo të gjitha kontrollet e kryera kanë mbartur efiçencën e pritur.

- Po ashtu KLSH ka mosrealizim të dukshëm në vëllim në auditimet financiare të tij. Nga 13 të programuara, janë kryer vetëm 9 auditime të tilla, edhe pse veprimtaria audituese e kontrollorit është mbështetur në manualin e auditimit financiar të KLSH, përfshirë vlerësimin dhe përcaktimin e materialitetit dhe të riskut.

- Në auditimet e performancës, rezultatet kanë qenë edhe më të dobëta. Nga 5 auditime të programuara është realizuar vetëm 1 auditim, ndërsa 1 tjetër është në proces. Shumë pak për një vit, gjë që tregon se ka munguar vëmëndja e duhur nga institucioni, për këtë lloj auditimi.

- Kontributi i dhënë nga KLSH nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese për ndërgjegjësimin e punonjësve që administrojnë pronën dhe fondet publike, ka pasur deri diku impakt pozitiv në formësimin e administratës publike për të zbatuar më me rigorozitet kërkesat e përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi në fushën e administrimit dhe përdorimit të pronës dhe fondeve publike.

- Veprimtaria për kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe evidentimin e hapësirave apo mospërputhjeve që mund të ekzistojnë, është shoqëruar me rritje të cilësisë së përgatitjes të propozimeve për ndryshime dhe përmirësime të dispozitave ligjore. Më konkretisht, gjatë vitit 2011, janë përgatitur dhe dërguar në organet respektive 45 propozime për ndryshime dhe përmirësime ligjore, nga të cilat 22 prej tyre janë zbatuar, ndërkohë që 13 propozime të tjera janë në proces zbatimi.

- Impakti i kontrollit *rezulton në shumën totale 7,027,566 mijë lekë* dhe përfaqëson vlerën totale të zbulimeve të dëmit ekonomik të konstatuar, evidentuar dhe të raportuar në përfundim të kontrolleve të kryera nga data 1 janar 2011 deri më 31 dhjetor 2011. Edhe pse shuma paraqitet e konsiderueshme, raporti i shpërndarjes së saj në subjektet e kontrolluara

ndryshon shumë, ngaqë dëmi ekonomik i konstatuar në vetëm dy prej tyre (AlbPetrol dhe OST) përbën 83,90 përqind të shumës. Kjo shumë e dëmit ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit është rekomanduar të shpërblehet në masën një qind për qind.

Nga vlera e sipërcituar, nga strukturat e kontrolluara dhe ato përgjegjëse janë nxjerrë aktet respektive për arkëtimin e shumës prej 667,495 mijë lekë, ose në masën 9.5% të vlerës totale të dëmeve, shumë për të cilën janë nxjerrë urdhërat përkatës, ka filluar dhe vazhdon arkëtimi i saj. Në këtë nivel tejet të ulët realizimi, ka ndikuar puna e pamjaftueshme e kryer nga strukturat përgjegjëse në KLSH për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të tyre, si dhe përgjegjshmëria e pakët a stafit drejtues apo e bordeve të subjekteve të kontrolluar, ku janë adresuar rekomandimet për shpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar.

- Raporti ndërmjet vlerës së dëmeve ekonomike të konstatuar dhe evidentuar gjatë vitit kalendarik 2011 (si dhe të kërkuar për shpërblimin e dëmit në shumën 7,027,566 mijë lekë) dhe vlerës të raportuar me situacionin përfundimtar të shpenzimeve të KLSH^{së} për këtë vit në shumën 253,117 mijë lekë; tregon shkallën e efektivitetit të veprimtarisë kontrolluese të KLSH^{së}. Për çdo lek të investuar në KLSH gjatë vitit 2011, institucioni ka kërkuar për t'ju kthyer arkës së Shtetit 27.76 lekë.

- Tregues tjetër i veprimtarisë kontrolluese të KLSH^{së} është vlera e shkeljeve financiare me pasojë dëm ekonomik të zbuluar mesatarisht në vitin 2011 nga një i punësuar në KLSH, në raport me vlerën që harxhon Shteti për punonjës të institucionit, përkatësisht 45.048 mijë lekë/për punonjës (7,027,566 mijë lekë:156 punonjës në organikë), nga 1,622 mijë lekë të harxhuar mesatarisht gjatë vitit 2011 për çdo punonjës në organikë (253,117 mijë lekë : 156 punonjës në organikë).

- Kurse kosto e një kontrolli të kryer nga KLSH rezulton në shumën 1,665 mijë lekë, dhe del nga raporti ndërmjet situacionit përfundimtar të

shpenzimeve për vitin 2011, me numrin prej 152 kontrolle të evaduar këtë vit (253,117 mijë lekë : 152 kontrolle).

- Niveli i zbatimit të masave të rekomanduara nga ana e KLSH gjatë vitit 2011 paraqitet relativisht mirë. Kjo, dhe në varësi të faktit që masat e propozuara kanë qenë relativisht të lehta. Më konkretisht:

a) Masat organizative janë realizuar në masën 69% (në këtë nivel realizimi përfshihen dhe masat e realizuar pjesërisht, gjithsej 15);

b) Masat administrative 83.2%; dhe

c) Masat disiplinore 72.6%.

Megjithatë, niveli i zbatimit të masave të rekomanduara në vitin raportues, kundrejt vitit 2010 *rezulton me ulje* (më hollësisht trajtohet në kapitullin e zbatimit të rekomandimeve).

- Shpenzimet buxhetore të KLSH^{se} për vitin raportues, janë kryer në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, duke respektuar me rigozitetet kuotat e planifikuara të zërave të buxhetit, përfshirë pakësimet e bëra me ligj, respektivisht në shpenzimet operative 3 milionë lekë dhe në investime 7 milionë lekë, gjithsej 10 milionë lekë.

- Përsa i përket trajnimit të punonjësve të institucionit, janë realizuar 224 ditë/njerëz të trajnuar, kryesisht punonjës të veprimtarisë kontrolluese, ndërkohë që sipas praktikave të institucioneve homologe parashikohet minimumi 5 ditë trajnim në vit për çdo punonjës ose e barabartë me 720 ditë/njerëz për KLSH. Pra, shumë pak, rreth 4 herë më pak, për një institucion si KLSH që tek shtimi i kapaciteteve të audituesve ka investimin parësor për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë kontrolluese.

- Marrëdhëniet e bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë të kontrollit, si me INTOSAI, EUROSAI dhe me Gjykatën e Llogarive të BE kanë qenë të vakta, thjesht duke iu përgjigjur ftesave apo kërkesave për informacion prej tyre. Nga ana e institucionit kanë munguar nismat për

intensifikimin e këtyre marrëdhënieve dhe për vitin 2011(sikurse edhe për një vit më parë), sidomos me institucionet homologe dhe këto e kanë ndihmuar pak institucionin.

- Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë, me Institucionin e Presidentit, me Kryeministrinë, ministrinë dhe institucionet qendrore, kanë qenë institucionale dhe të fokusuara në zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore në fushën e administrimit të vlerave materiale dhe monetare.

- Kontaktet me organet e drejtësisë nuk kanë qenë frutdhënëse, sidomos me organin e Prokurorisë. Marrëveshja e lidhur ndërmjet Kryetarit të KLSH dhe Prokurorit të Përgjithshëm më 6 maj 2005 nuk ka funksionuar, duke prodhuar një nënvleftësim gati tërësor të institucionit të Prokurorisë ndaj kallzimeve të KLSH. Numri i kallzimeve në Prokurori është shumë i ulët , çka tregon qartë punën e dobët të KLSH.

- Në fushën e komunikimit me median, me grupet e interesit në shoqërinë civile dhe me publikun e gjerë, marrëdhënia e KLSH ka qenë sporadike, duke u mjaftuar me disa njoftime për shtyp dhe kontakte jo institucionale. Këtij raporti i ka munguar transparenca dhe bashkëpunimi i sigurtë në emër të interesave të përbashkëta publike.

II.1 Statusi ligjor

Baza legjislative për KLSH^{në} janë *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Organik i KLSH*, respektivisht, pjesa e katërmbëdhjetë e Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 162-165, dhe Ligji nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000.

KLSH është një institucion kushtetues i pavarur dhe institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në Shqipëri, i cili në ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e detyrimeve të tij për arritjen e objektivave, i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

Në dispozitat kushtetuese, krahas rregullimit të sferës së veprimtarisë kontrolluese të KLSH^{së}, është përcaktuar edhe statusi i Kryetarit të institucionit lidhur me emërimin dhe shkarkimin e tij, si dhe raportet e informacionet që KLSH duhet t'i paraqesë Kuvendit. Ndërsa, në Ligjin Organik të KLSH^{së} përcaktohen objektivat, detyrat dhe të drejtat, organizimi, struktura, kompetencat, mandati i Kryetarit, procesi i veprimtarisë kontrolluese, e drejta e disponimit të dokumenteve dhe informacionit, detyrimi i paraqitjes së raporteve të kontrollit, ruajtja e sekretit, statusi i punonjësve dhe masat disiplinore etj. Krahas Kushtetutës, Ligjit Organik të KLSH dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe ndonjë akt ligjor tjetër i veçantë, KLSH e zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në standardet ndërkombëtare të kontrollit dhe në kërkesat e parashikuara në aktet e mëposhtme:

- Rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të KLSH;
- Standardet e kontrollit të KLSH;
- Kodi Etik i KLSH;
- Dokumente dhe formularë standard të kontrollit;
- Metodika dhe manualët e kontrollit financiar e të performancës;
- Plani i Zhvillimit Strategjik për periudhën 2009–2012;
- Urdhëra dhe vendime të ndryshme të nxjerra nga Kryetari i KLSH.

Theksojmë se KLSH në ushtrimin e veprimtarisë së tij, i është përmbajtur dhe i përmbahet me rigorozitet përcaktimeve të cilësuara në aktet ligjore dhe nënligjore të sipërcituar.

Nga pikëpamja ligjore, KLSH ka themele të qëndrueshme. Ndërkohë, vlen të pasqyrohet se puna për studimin dhe përgatitjen e amendamenteve që duhen bërë në Ligjin Organik të KLSH^{së} duhej të përfundonte brenda vitit 2011. Për përgatitjen e këtyre amendamenteve, krahas tërheqjes së propozimeve nga i gjithë stafi i KLSH^{së} dhe specialistë të ndryshëm të fushës së kontrollit,

përfshirë dhe akademikë; ndihmesë të çmuar kanë dhënë specialistët e Gjykatës së Auditimit të Holandës, të cilët kanë qenë prezent në përgatitjen e këtyre amendimeve. Ndërkohë, amendimet i janë dërguar disa organizmave ndërkombëtarë të kontrollit dhe të BE^{-së}, si SIGMA, presidencës së EUROSAI^t (NIK-Poloni) dhe organizmave të interesuara të BE^{-së} në Tiranë dhe Bruksel, të cilët kanë dhënë opinionet e tyre, opinione të cilat janë vlerësuar dhe po pasqyrohen në draftin final.

Ritmet e punës së KLSH në përgatitjen e draftit final të amendimeve në Ligjin “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” nuk kanë qenë ato të duhurat, por edhe klima politike për gati dy vjet nuk ka qenë e përshtatshme për të kaluar në Kuvend një ligj që kërkon shumicë të cilësuar prej 3/5. Gjithsesi, kjo nuk na justifikon ne si KLSH.

Brënda muajit prill 2012, KLSH do të paraqesë draftin final në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Kuvendit të Shqipërisë.

II.2 Detyrat dhe të drejtat

Detyrat në fushën e kontrollit janë parashikuar në nenin 7 të Ligjit Organik të KLSH, ku përcaktohet që në përputhje me kompetencat e tij, KLSH kontrollon:

- Veprimtarinë ekonomike e financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë.
- Përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qëndror dhe vendor.
- Veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilën shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve apo të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.
- Përdorimin e fondeve që u janë dhënë nga buxheti i shtetit partive politike dhe shoqatave.
- Mbikëqyrjen e veprimtarisë së strukturave të auditimit brendshëm shtetëror.

□ Subjekte të tjera të përcaktuara me ligje të veçanta.

Ndërsa, në nenin 9 të Ligjit Organik të KLSH^{së} është përcaktuar që, KLSH mund të japë rekomandime përsa i përket kontrollit të drejtimit dhe të kontroll revizionit të brendshëm. Gjithashtu, jep opinionet e tij dhe bën propozime përsa i përket përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit në fushat brenda detyrave të tij. Nëse, KLSH gjatë kontrollit konstaton akte ligjore ose nënligjore në kundërshtim me ligjet bazë, atëhere mund të kërkojë ndryshimin ose shfuqizimin e tyre nga organet që i kanë nxjerrë. Nëse ky i fundit nuk e ndryshon ose e shfuqizon aktin ligjor ose nënligjor brenda 2 muajve nga data e kërkuar, atëhere KLSH duhet t'u drejtohet organeve kompetente të përcaktuara me ligj.

Gjithashtu, në Ligjin Organik të KLSH^{së} janë përcaktuar:

- Detyra për botimin e një buletini të rregullt, duke cilësuar edhe përmbajtjen e tij.
- Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryetarit e të institucionit.
- E drejta për të kërkuar nga subjektet objekt kontrolli, marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e gjëndjes, në përputhje me rekomandimet e kontrollit.
- E drejta për të kërkuar nga subjektet e kontrolluar ose autoritetet më të larta shtetërore, marrjen e masave të zhdëmtimit dhe disiplinore në përputhje me ligjet përkatëse ndaj personave që kanë shkaktuar dëme direkte ose indirekte.
- Marrja e masave në përputhje me rregullat për prokurimet publike, kur janë shkelur rregullat dhe procedurat e prokurimeve.
- Informimi nga subjektet e kontrolluar lidhur me marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.
- E drejta e disponimit të dokumenteve dhe të informacionit.
- E drejta për të bërë padi në gjyq etj.

II.3 Juridiksioni kontrollues

Bazuar në Kushtetutë, Ligjin Organik të KLSH^{-së}, në dispozitat ligjore për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, si dhe në dispozita të tjera ligjore të fushës ekonomike dhe financiare, veprimtaria kontrolluese e KLSH^{-së} shtrihet në pushtetin legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor, pushtetin vendor, njësi të ndryshme ekonomike e financiare dhe në persona juridikë, ku shteti zotëron më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Përsa i përket fushave dhe sektorëve objekt kontrolli, referuar dispozitave ligjore në fuqi, KLSH nuk ka ndonjë kufizim. Ajo ka të drejtë të kontrollojë grumbullimin e të ardhurave buxhetore dhe përdorimin e të gjitha fondeve të parashikuara me ligjin vjetor të buxhetit të shtetit, po kështu edhe fondet në kompanitë publike ku fondet shtetërore zenë mbi gjysmën e tyre. Nuk bëjnë përjashtim fondet për shëndetin, punësimin dhe pensionet, fondet e akorduara organizatave apo kompanive private nga buxheti i shtetit, po kështu dhe fondet e dhëna nga donatorët e huaj etj.

Kompetencat e KLSH^{-së} shtrihen dhe në qeverisjen vendore, ku kontrollojnë të ardhurat dhe shpenzimet e këtij pushteti, përfshirë përdorimin e transfertave të shtetit për këto subjekte etj.

Renditur sipas subjekteve, KLSH mbulon me kontroll:

- Administratën e Presidentit e të Kuvendit.
- Kryeministrinë, ministritë dhe institucione të tjera qendrore shtetërore.
- Agjencitë dhe entet e ndryshme shtetërore.
- Bankën e Shqipërisë dhe institucione të tjera financiare shtetërore.
- Njësitë e pushtetit vendor si: prefektura, këshilla qarku, bashki dhe komuna.
- Njësitë që administrojnë ndihma shtetërore, hua e kredi, detyrimet e të cilëve garantohen nga shteti.

- Personat juridikë në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve apo të aksioneve.
- Njësitë e auditimit dhe kontrollit të brendshëm shtetëror.
- Subjekte që menaxhojnë fonde publike jashtë buxhetit të shtetit dhe subjekte të tjerë të përcaktuara me ligje të veçanta.

Cilësojmë se, për zbatimin e programit të veprimtarisë kontrolluese të vitit 2011, KLSH është mbështetur në: burimet materiale, monetare dhe njerëzore të miratuar për të, për këtë vit, gjithashtu, në standardet e kontrollit lidhur me periodicitetin e ushtrimit të kontrolleve. Shtojmë se, me burimet në dispozicion, në rradhë të parë, është synuar përmbushja e objektivave dhe detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të KLSH^{se} në ushtrimin e veprimtarisë vjetore kontrolluese, në shkallën sa më të mirë të mundshme.

II.4 Raportimi

Në nenin 164 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenin 18 të Ligjit Organik të KLSH^{se}, është parashikuar detyrimi ligjor i institucionit për të raportuar para Kuvendit. Me konkretisht KLSH paraqet në Kuvend:

- Raportin për zbatimin e buxhetit faktik të shtetit, duke përfshirë konkluzionet e kontrollit me opinionin e vet.
- Mendime për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar, para se të miratohet në Kuvend.
- Raportin vjetor të veprimtarisë së KLSH.
- Informacion për rezultatet e kontrollit sa herë kërkohet nga Kuvendi.

Gjithashtu, Kryetari i KLSH, mund t'i kërkojë Kuvendit që të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme.

Në zbatim të dispozitës kushtetuese dhe ligjore të sipërcituar, KLSH ka përgatitur dhe paraqitur në afat për shqyrtim në Kuvend raportet “Mbi veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2010” dhe “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2010

Duhet pasqyruar se, praktika raportuese gjatë vitit 2011 u fuqizua më tej, lidhur me mënyrën e paraqitjes së rezultateve të kontroleve dhe përmbajtjes së materialeve të kontrollit, në veçanti të raporteve përfundimtarë të kontrollit. Gjithashtu, duhet evidentuar fakti që, materialet e kontrollit dhe raportet e KLSH^{së} paraqitur Kuvendit dhe Komisioneve të tij, janë vlerësuar pozitivisht për problematikën e trajtuar, për konstatimet dhe përfundimet e nxjerra, opinionet e parashtruara, masat e rekomanduara, si dhe nivelin e realizimit të tyre.

II.5 Misioni, vizioni dhe objektivat.

Misioni i KLSH^{së} – është kontrolli i subjekteve dhe programeve publike në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontrollit të përshtatura nga KLSH dhe praktikat më të mira evropiane, për t'i siguruar Kuvendit, grupeve të interesit, dhe publikut të gjerë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike.

Për këtë, KLSH raporton për rregullshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve financiare të Qeverisë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë proceseve të kontrollit të cilësisë dhe ndërkohë i jep siguri Kuvendit, taksapaguesve dhe publikut të gjerë që, burimet e sektorit publik janë përdorur sipas ligjit dhe me efektivitet.

Vizioni i KLSH^{së} – është që, si organ i pavarur kontrolli të përdorë burimet e tij me efektivitet, në mënyrë që t'i ofrojë këshilla dhe mbështetje të paanshme sa më cilësore Kuvendit.

Përpjekjet e KLSH^{së}, për ndërtimin e reputacionit si një institucion i pavarur, i cili prodhon kontrole objektive, të sigurtë e të besueshëm për Kuvendin, ekzekutivin, median dhe publikun e gjerë, dhe njëkohësisht rekomandon masa të dobishme për organet ekzekutive dhe legjislative, janë të vazhdueshme dhe kërkojmë më shumë integritet, profesionalizëm e moral të fortë.

Lidhur me *objektivat e përcaktuara në fushën e kontrollit*, KLSH ka objektiv prioritar:

□ Kontrollin e përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve publike, zhvillimin e mirëadministrimit financiar, si dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike dhe financiare. Gjithashtu, komunikimin dhe dhënien e informacioneve autoriteteve publike dhe publikut në përgjithësi, nëpërmjet publikimit periodik të raporteve të paanshme.

Ndërmjet *objektivave të programuar nga KLSH për vitin raportues*, paraqesim:

□ Konstatimin dhe evidentimin me objektivet të punës së bërë nga subjektet e kontrolluar, në raport me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe standardet e pranura të kontrollit.

□ Konstatimin dhe evidentimin e punës së kryer për zbatimin e buxhetit të shtetit, përkundrejt kërkesave dhe përcaktimeve në legjislacionin përkatës, veçanërisht të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të urdhrave apo udhëzimeve dalë në zbatim të tij.

□ Evidentimin e shmangieje apo shkeljeve të rregullave të kontabilitetit dhe të administrimit financiar, duke vlerësuar dokumentacionin e vënë në dispozicion nga subjektet e kontrolluar, asetet ekzistuese dhe pasqyrat financiare të këtyre subjekteve për vërtetësinë dhe ndershmërinë e të dhënave të raportuara.

□ Rritjen e përgjegjshmërinë të administratës shtetërore për kryerjen e shpenzimeve publike brenda kuadrit ligjor të miratuar dhe për raportimin me korrektësi të detyrave të marra përsipër.

□ Vlerësimin e veprimtarisë së strukturave të auditimit të brendshëm dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë të kontrollit të brendshëm, si dhe harmonizimin e funksioneve të auditimit të jashtëm me auditimin e brendshëm.

□ Formulimin e masave rekomanduese dhe kontrollin e zbatimit të masave të programuara nga subjektet e kontrolluar, lidhur me bërjen e propozimeve për ndryshimin dhe përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, kompensimin e vlerave të dëmtuara apo të humbura dhe parandalimin e shkeljeve, etj.

III. Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë të KLSH për vitin 2010 dhe kërkesat për vitin 2011.

Për vitin 2011, për stafin drejtues dhe kontrollues të KLSH^{së}, inkurajuese, por në të njëjtën kohë detyrim dhe përgjegjësi për rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të punës kontrolluese, kanë qenë konkluzionet e shprehura në **Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë** e datës 2 qershor 2011 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2010”. Konstatimet dhe detyrat e parashtruara në këtë Rezolutë, kanë kërkuar rishikimin e objektivave të programuara nga KLSH për vitin raportues, me qëllim plotësimin e tyre. Më konkretisht, në këtë Rezolutë përcaktohet që:

▪ Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke u nisur nga misioni i KLSH për ushtrimin e kontrollit në subjektet dhe programet publike, për t'i siguruar Kuvendit, grupeve të interesit dhe publikut të gjerë informacion mbi përdorimin e fondeve publike;
- Duke njohur vizionin e këtij institucioni për ushtrimin e kontrollit të pavarur, objektiv, të sigurt e të besueshëm mbi subjektet që përdorin fonde publike;
- Duke u mbështetur në detyrimet kushtetuese e ligjore, si dhe në objektivat afatmesëm e ata vjetorë të institucionit;

Konstaton se gjatë vitit 2010 Kontrolli i Lartë i Shtetit:

- Ka realizuar objektivat e veprimtarisë kontrolluese, duke e shtrirë atë në një numër më të madh subjektesh dhe veprimtarish;
- Ka rritur cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë kontrolluese, duke zbatuar me korrektësi rregullat ligjore e nënligjore për kontrollin e cilësisë dhe sistemin e sigurimit të cilësisë;
- Në kontrollet e ushtruara, ka zbatuar dhe zhvilluar një metodologji bashkëkohore, bazuar në standardet ndërkombëtare të kontrollit, standardet e nxjerra nga institucioni në zbatim të tyre dhe praktikat më të mira të vëndeve të tjera;

- Në auditimet financiare i ka dhënë përparësi vlerësimit dhe përcaktimit të riskut, kurse në auditimet e performancës u ka dhënë përparësi subjekteve e problematikave që lidhen me sektorë të ndryshëm të ekonomisë;
- Ka përmirësuar ndjeshëm veprimtarinë për kontrollin e zbatimit të legjislacionit, evidentimin e hapësirave apo mospërputhjeve të mundshme, duke rritur cilësinë e propozimeve për ndryshime e përmirësime të dispozitave ligjore;
- Ka rekomanduar arkëtimin në Buxhetin e Shtetit të dëmit ekonomik të konstatuar gjatë kontrolleve;
- Ka rritur dobinë e kontrolleve dhe cilësinë e rekomandimeve ndaj personave e subjekteve që kanë kryer shkelje ligjore, duke sjellë rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve për masa organizative, administrative dhe disiplinore;
- Ka përdorur fondet buxhetore, në përputhje me kuotat e planifikuara, sipas zërave të buxhetit;
- Ka kryer rregullisht trajnimin e punonjësve të institucionit;
- Ka mbajtur marrëdhënie bashkëpunimi institucionale e rezultative me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, ka rritur transparencën e komunikimit ndaj Kuvendit, medias dhe gjithë opinionit publik.

Në vijim, Kuvendi kërkon që, për vitin 2011, KLSH të thellojë më tej përvojën në këto drejtime:

1. Përdorimin më gjerësisht të metodologjisë bashkëkohore të kontrollit, mbështetur në standardet ndërkombëtare e praktikat më të mira të vëndeve të tjera.

Lidhur me përdorimin gjerësisht të metodologjisë bashkëkohore në auditim, në përputhje me standardet dhe praktikat e mira evropiane, eksperiencia e fituar nga zbatimi gjatë viteve 2008-2009 i Projektit të Binjakëzimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Britanisë së Madhe dhe me Gjykatën e Auditimit të Hollandës ka prodhuar materiale udhëzuese të vlefshme dhe dy manuale, një i

auditimit financiar dhe një i auditimit të performances, por që janë përdorur dhe referuar pak nga audituesit e KLSH gjatë kontrolleve të vitit 2011. Megjithatë, KLSH është përpjekur dhe ka provuar të implementojë auditime pilot financiare dhe të performancës, bazuar në materialet udhëzuese të NAO^s së Britanisë së Madhe dhe Gjykatës së Auditimit të Holandës, arritjet e deritanishme janë të dobta. Krahas këtyre manualeve dhe dokumenteve, KLSH ka kërkuar të zhvillojë metodologjinë e auditimit duke :

- Rishikuar udhëzimet dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të miratuara nga INTOSAI; dhe
- Rishikuar dhe përmirësuar draft/dokumentin për auditimin e çertifikimit të pasqyrave financiare dhe hartimin e formularëve standard për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për institucionet buxhetore etj.

Gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011 KLSH ka kryer respektivisht 15, 20 dhe 11 audime të tilla (financiare, performance dhe çertifikim të llogarive), ndërkohë që mesatarisht çdo vit janë kryer dhe evaduar 130-140 kontrolle të llojeve të tjera, kryesisht të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë.

KLSH me vështirësi po orientohet drejt auditimeve sipas praktikave bashkëkohore, pasi është kërkesë e kohës shtimi i ritmit dhe përmirësimi cilësor i kryerjes së këtyre lloj auditimesh, veçanërisht auditimeve të performancës, duke patur parasysh që në vitin 2011 u realizua vetëm një i tillë. Kryerja me cilësi e auditimeve të performancës kërkon rritjen e kualifikimeve profesionale të stafit dhe për vitin 2012 KLSH ka nxjerrë një urdhër të brendshëm ku përcakton një limit të poshtëm prej 10 ditësh trajnimi për punonjës e tij në vit (ose rreth 8 herë më shumë se treguesi i sotëm), por po has shumë vështirësi në gjetjen e trajnuesve të përshtatshëm dhe thithjen e ekspertizës jashtë institucionit, ngaqë mungon fondi për pagesat e ekspertëve të jashtëm për vitin 2012. Kur diskutohej buxheti i vitit 2012 në muajt tetor-nendor 2011, KLSH nuk u paraqit në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe nuk kërkoi që ky fond minimalisht të ishte sa vitet e kaluara.

Kjo mungesë po ndikon negativisht në punën tonë të këtij viti. Shpresojmë që duke e shpjeguar më gjerë këtë në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, të gjejmë dashamirësinë e tij dhe të qeverisë për vendosjen e këtij fondi.

2. Zhvillimin e burimeve njerëzore, me synim rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, veçanërisht të atij kontrollues.

Përsa i përket këtij objekti, KLSH në Planin e Zhvillimit Strategjik 2009-2012 dhe në programin e veprimtarisë të vitit 2011 ka patur përcaktuar drejtimet dhe aktivitetet. Programi është njëra anë dhe ka rëndësinë e tij, por kryesorja dhe më e vështira është ndjekja e zbatimit të aktiviteteve të programuara, shkalla dhe cilësia e zbatimit të tij, të cilat kanë lënë për të dëshiruar.

Në kualifikimin e programuar nga çdo departament dhe drejtori në KLSH, në vitet 2008-2009 dukshëm në zhvillimin profesional të punonjësve të institucionit ka ndikuar trajnimi i realizuar nga ekspertët e huaj në kuadër të Projektit të sipërpërmendur të Binjakëzimit. Aplikimi i produkteve të përfutuara nga ky projekt dhe trajnimi e kualifikimi i punonjësve të cilët nuk kanë marrë pjesë të drejtëdrejtë në këtë projekt është konsideruar prioritar, megjithatë në praktikë, në vitet 2010-2011 ka munguar asistencë konkrete e huaj dhe për vitin 2011 treguesi i trajnimit dhe kualifikimit të personelit prej 2.1 ditë trajnim në vit për punonjës është shumë i ulët. Ndërkohë, edhe pse e kufizuar, duhet nënvizuar pjesmarrja e punonjësve të KLSH për shkëmbimin e përvojave dhe përfitim të njohurive në trajnimet e zhvilluar nga ITAPⁱ, nga Agjencia e Prokurimit Publik, nga institucione si përfaqësia e BB në Tiranë, nga organizmat ndërkombëtarë të kontrollit në programet e trajnimit në distancë (IDI, INTOSAI) dhe nga institucionet homologe. Eksperienca e përfutur nga këta punonjës të kufizuar të trajnuar mund të shfrytëzohet dhe këta punonjës të kthehen në trajnerë për pjesën e gjerë të stafit të KLSH që nuk ka marrë kualifikim.

3. Rritjen e cilësisë në kontrollin e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, fondeve të projekteve të financuara nga BE dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Në funksion të realizimit të kësaj detyre (rritja e cilësisë në kontroll), theksojmë se, krahas arsimimit profesional dhe vetë punës kualifikuese individuale që kryejnë kontrollorët dhe stafi drejtues i tyre, kanë shërbyer dhe trajnimet në seminarët, konferencat apo workshop^{-et} e ndryshme të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, si dhe kontrollet paralele të kryera me institucionet homologe të kontrollit. Puna individuale dhe trajnimet e vazhdueshme kanë rritur nivelin e veprimtarisë kontrolluese, edhe pse jo në nivelin e pritshmërive të planifikuara. Nga ana tjetër, KLSH ka punuar për njohjen dhe përditësimin në vijimësi të kontrollorëve me dispozitat ligjore e nënligjore, si kusht i domosdoshëm për njohjen dhe vlerësimin e veprimtarisë së subjekteve të audituara, argumentimin e zbulimeve, nxjerrjen e konkluzioneve, përgjegjësi dhe rekomandimeve përkatëse. Krahas sigurimit të legjislacionit nëpërmjet fletoreve zyrtare, shfrytëzimit të internetit dhe sistemit kompjuterik të institucionit, Drejtoria Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë e KLSH ka bërë përditësim të paketës me dispozitat ligjore e nënligjore më kryesore. Megjithatë, rezulton se njohja e audituesve me të rejat e dispozitave ligjore e nënligjore më kryesore ende lë për të dëshëruar.

Kontrollet mbi çështjet e rregullshmërisë, të administrimit financiar dhe vlerësues, të realizuara gjatë vitit 2011, kanë bërë të mundur mbulimin e një pjese të veprimtarisë ekonomiko-financiare të institucioneve qendrore dhe atyre në nivel vendor që administrojnë dhe përdorin fonde publike, po ashtu edhe të subjekteve të tjerë publikë, përfshirë shoqëritë anonime, projektet apo investimet me financime të huaja etj. Këto kontrolle janë kryer në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e KLSH dhe të subjekteve objekt kontrolli, si dhe pjesërisht me standardet ndërkombëtare të kontrollit dhe ato të KLSH.

Përsa i përket kontrollit të përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, ky është detyrim kushtetues për KLSH^{në}. Siç dihet, çdo vit KLSH përgatit dhe dërgon në Kuvend raportin mbi zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit të mëparshëm dhe jep mendime për raportin e KM për shpenzimet e vitit të kaluar financiar. Kontrolli për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2010 është ushtruar në 94 subjekte si ministri dhe institucione qendrore, njësi të pushtetit vendor, agjenci apo projekte që operojnë me fonde buxhetore.

Gjatë vitit 2011 janë kontrolluar 9 projekte me fonde të huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare si Banka Botërore, Banka Evropiane e Investimeve, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Gjermane (KfW) etj., në fusha të ndryshme si infrastrukturën rrugore, në energjitikë, në arsim dhe shëndetësi dhe në sektorin e ujësjellës kanalizimeve.

Në kontrollet e ushtruar, përgjithësisht është konstatuar se konsumohet një kohë e gjatë për procesin e negociatave, për hartimin e nënshkrimit e marrëveshjeve dhe bërjen efektive të tyre, duke sjellë jo vetëm pasoja në rritjen e kostos së projekteve, por edhe mangësi në plotësimin e objektivave. Për t'u përmendur, mangësitë në studimet dhe projektimet e investimeve me financime të huaja, të cilat shoqërohen me ndryshime gjatë zbatimit të projektit duke rritur koston e tyre; mosngritja e kapaciteve të nevojshme për sektorin e prokurimeve dhe menaxhimit financiar të projektit; vonesat në shpronësimet me pasojë mosrealizimin në kohë dhe me sukses të programeve investuese si, rruga Lushnjë-Levan dhe Levan-Tepelenë; mosndjekja dhe mosndëshkimi nga Njësitë e Menaxhimit të Projekteve të përgjegjësve për realizimin jashtë afateve të punimeve apo punime të pakryera, por të situacionuara e të likuiduara si Spitali Kavajë; mosaplikimi i penalteteve për vonesa; në disa raste moskryerja e testimeve për të garantuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të parashikuara në kontratë; mosregjistrimi në kontabilitet i investimeve të kryera në ujësjellësa dhe energjitikë etj.

Gjatë ushtrimit të kontrolleve KLSH ka konstatuar edhe dëme ekonomike, të evidentuara kryesisht në fushën e pagave, shpërblimeve dhe prokurimeve në vlerën 64,689 mijë lekë, si në Projektin “Ndërtimi i rrugës Lushnjë-Fier, vlera e dëmit 28,832 mijë lekë” dhe “Menaxhimi i burimeve ujore, 24,724 mijë lekë.

Kohët e fundit, kapitali dhe fondet e huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare janë kontrolluar dhe në këndvështrimin e vlerësimit të prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare, ku sipas situatës konkrete përgatiten dhe dërgohen për zbatim rekomandimet përkatëse.

4. Zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe intensifikimin e trajnimit të punonjësve.

Megjithë masat e marra, kryesisht në blerjen e pajisjeve kompjuterike, gjatë viteve të fundit KLSH nuk ka njohur progres, si rezultat i zhvillimit me hope dhe jo harmonik të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit.

Ambienti në të cilin zhvillohet kjo teknologji informacioni, për mungesë totale të hapësirave të punës, ndrydh dhe deformon edhe ato investime që janë kryer vite më pare. Pasja e një rrjeti kompjuterik të amortizuar fizikisht edhe moralisht (i para 10 vitesh) dhe pa parametrat e standardet e përcaktuara nga AKSHI përbëjnë një pengesë të pa kompesueshme nga ndikimi pozitiv i faktorëve të tjerë. Mungesa e një godine të re për KLSH na detyron që dhe investimi në sistemin e TI të mos jetë i duhuri.

Në takimin e dobishë dhe frytdhënës të datës 19 janar 2012 me Kryetarin e KLSH, Kryeministri Berisha premtoi t'i jepte një zgjidhje sa më të shpejtë dhe të përshtatshme sistemimit të KLSH me ambiente zyrash që mund të hapin rrugë për investimet dhe përmirësimet e nevojshme në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit. Kjo çështje, siç përmendet më tej në këtë raport, është një kërkesë e kahershme dhe e ekipeve të SIGMA[®], e cila që nga viti 2008 e ka evidentuar në raportet e saj të vlerësimit që adreson për ekonominë, qeverinë dhe institucionet shqiptare.

Nga analiza e bërë në Departament, rezultoi se zhvillimi i burimeve njerëzore në KLSH në fushën e IT gjatë vitit 2011 lë mjaft për të dëshiruar. Sasia e trajnimeve për stafin IT ka qenë e pakët, dhe ato pak trajnime që janë organizuar nga institucionet homologe dhe ato të përfituara nga suporti i dhënë nga qeveria në kontekstin e e-gov nuk janë shfrytëzuar si dhe sa duhet. Ndonëse, duhet evidentuar se stafi i IT, edhe pse i vogël në numër, ka gjetur mundësinë për të zhvilluar pjesën më të madhe të trajnimeve të brendshme të kryera gjatë vitit 2011.

Për futjen e teknologjisë së informacionit në kontroll nëpërmjet programit të auditimit IDEA, janë shpenzuar vlera jo të pakta financiare dhe njerëzore, por gjatë gjithë vitit 2011 praktikisht ky program nuk është përdorur, për shkak të moskoordinimit të strukturave përkatëse në KLSH.

Duke patur parasysh faktin se auditimi kërkon aftësi speciale, kur subjektet që do të auditohen veprojnë në një mjedis të kompjuterizuar, është e domosdoshme për kontrollorët që të fitojnë vazhdimisht njohuri të reja mbi sistemet e përdorura nga subjektet e audituara. KLSH ka programuar trajnime të posaçme për të fituar e zhvilluar këto aftësi, siç janë trajnimet për njohjen me teknologjinë e informacionit, programin IDEA, si dhe programet “Financa 5”, “Alpha” dhe “Oracle”, por këto programe nuk u realizuan gjatë vitit 2011. Ne patjetër do t'i realizojmë këtë vit.

5. Harmonizimin e veprimtarisë audituese të kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm dhe rritjen e rolit mbikëqyrës ndaj strukturave të auditimit të brendshëm.

Krahas Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, KLSH ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi dhe me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MF^{ve}, Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MB^{me}, kohët e fundit me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik etj. Megjithëse këto

marrëdhënie janë vendosur, shkëmbimi i informacionit mes palëve nuk ka njohur vijimësi dhe rreziku i mbivendosjes në kontrole ngelet sërisht i lartë.

Drejtim tjetër i veprimtarisë së KLSH për vitin 2011 ka qenë vlerësimi i funksionimit të auditimit të brendshëm, parë edhe në kontekstin e zbatimit të detyrimit ligjor dhe të standarteve të auditimit.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga neni 7 i Ligjit Organik të KLSH, gjatë vitit analizues KLSH ka ushtruar:

- *Mbikëqyrjen e funksionimit të auditimit të brendshëm në 17 subjekte në nivel qëndror si: ministri, universitete shtetërore, drejtori të Përgjithshme, institute etj.,*

- *Vlerësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm në 7 institucione qëndrore,*

- *Mbikëqyrjen e organizimit dhe funksionimit të njësisve të auditimit në qeverisjen vendore, në 18 bashki, një komunë dhe një ndërmarrje; dhe Mbikëqyrjen e funksionimit të auditimit të brendshëm në 14 ndërmarrje dhe shoqëri tregtare (me kapital shtetëror).*

Ky proces vlerësimesh dhe mbikëqyrje, arritjet dhe dobësitë apo shkeljet ligjore të vërejtura në organizimin dhe funksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm publik, janë pasqyruar në Raportet Përfundimtare të Kontrollit që u janë përcjellë së bashku me rekomandimet përmirësuese përkatëse subjekteve të audituara.

Në kuadrin e opinioneve që KLSH jep për saktësinë e Raporteve që Ministri i Financave paraqet në Kuvend për zbatimin e buxhetit përmbledhës, në zbatim të ligjit Organik të Buxhetit dhe të Ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pjesë e raportimeve është dhe raporti *“Mbi gjendjen e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit”*. Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2010 dhe nga MF janë hartuar një sërë aktesh rregullative për implementimin e koncepteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik.

E parë në këtë këndvështrim, kjo reformë është në hapat e para dhe në proces konsolidimi të mëtejshëm.

KLSH, si stukturë e auditimit të jashtëm në sektorin publik ka një rol të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit dhe forcimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet e kontrollit. Për vitin 2012, gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese që në fazën e programimit të kontrollit, KLSH ka parashikuar të përfshijë në programin e kontrollit një drejtim të veçantë kontrolli *“Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit”*, i detajuar në nënpika në drejtim të vlerësimit të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë vitit 2011, në bashkëpunim me MF, KLSH ka filluar trajnimin teorik dhe praktik të komponentëve për ushtrimin e këtij lloji kontrolli. Në vitin 2012, në kuadër të bashkëpunimit me Njësinë Qendrore të Harmonizimit, do të ndërmarim një cikël trajnimesh të kontrollorëve në përgjithësi dhe në veçanti, të audituesve që do të kryejnë kontrolle dhe specializohen për këtë fushë auditimi.

Është kërkesë e re e kohës dhe e zhvillimeve në fushën e menaxhimit financiar publik që KLSH të përfshijë si objekt të punës së tij vlerësimin e veprimtarisë së MF për zbatimin e letër politikave 2010-2014 për kontrollin e brendshëm financiar publik. KLSH ka bërë pak për përgatitjen e kapaciteteve të veta për këtë aktivitet monitorues. Në këtë drejtim, kemi vendosur si prioritet trajnimin e kontrollorëve në këtë fushë, duke u asistuar dhe financuar edhe nga organizmat ndërkombëtare.

6. Konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit.

Bashkëpunimi i KLSH me institucionet e sipërcituara ka qenë i rregullt dhe gjithëvjeter dhe nga viti në vit është konsoliduar, por përmasa e tij për thellimin

e luftës dhe për parandalimin e korrupsionit nuk ka qenë e zhvilluar në nivel të pritshmërive të publikut.

Lidhur me përmirësimin e Ligjit Organik të KLSH, amendimet që KLSH ka përgatitur janë të një rëndësie të veçantë. Ato janë bërë në përputhje me përcaktimet në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe drafti i përgatitur në konsultim me ekspertët e Gjykatës së Auditimit të Holandës dhe NAO të Britanisë së Madhe, u është shpërndarë për konsultim institucioneve ndërkombëtare të kontrollit dhe të Evropës, përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të BE dhe SIGMA. Ditët e fundit kemi marrë dhe komentet e SIGMA dhe aktualisht jemi në procesin e draftit final dhe mendojmë që brënda muajit prill 2012 ta paraqesim në Kuvend për shqyrtim. Në bashkëpunimin me Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave, KLSH ka dhënë kontribut real në diskutimin dhe përgatitjen e projekt-akteve të ndryshme ligjore si: për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, për prokurimin publik, për menaxhimin financiar dhe kontrollin, inspektimin financiar publik, etj. Më konkretisht, në vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011, KLSH ka hartuar dhe dërguar në institucionet objekt kontrolli dhe në strukturat drejtuese të tyre, përfshirë KM respektivisht 32, 62, 47 dhe 45 propozime. Sipas konfirmimeve të subjekteve ku i kemi adresuar këto propozime dhe verifikimeve të kryera nga ana e jonë, numri i propozimeve të zbatuara ka rezultuar respektivisht 14, 32, 33 dhe 22 propozime. Në tërësi, propozimet për ndryshim apo përmirësim të dispozitave ligjore në fuqi i përkasin fushës së ruajtjes dhe administrimit të mjeteve monetare dhe monetare, si dhe mbrojtjes së pronës publike.

Vlen të theksohet se, në drejtim të rritjes së nivelit të zbatimit të masave përmirësuese të rekomanduara nga KLSH, ka ndikuar ndjeshëm Urdhëri i Kryeministrit nr. 70, datë 18.4.2006 “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ e Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit e të Ministrive”. Qëllimi

kryesor i këtij Urdhëri është rritja e shkallës së zbatimit të ligjit. Niveli i zbatimit të këtij Urdhëri është gjithashtu tregues për mënyrën e reagimit të institucioneve të kontrolluara ndaj rekomandimeve dhe masave të propozuara. Megjithatë, niveli i zbatimit të masave rekomanduese në vitin 2011, krahasuar me një vit më parë, rezulton me ulje. Kjo dëshmon mosvëmëndjen e duhur të KLSH ndaj ndjekjes dhe kontrollit të zbatimit të masave të propozuara prej tij. Më konkretisht, masat organizative në vitin 2011 janë realizuar në masën 68% nga 82.3% rezultuar një vit më parë; masat administrative 67.9% nga 85.9% dhe masat disiplinore 77% nga 78% në vitin 2010. Shkaqet e rënies së nivelit të realizimit të rekomandimeve janë nga më të ndryshmet, por ndër kryesoret paraqitet rënia e kërkesës së llogarisë dhe përgjegjshmërisë në punë të punonjësve të aktivitetit kryesor (kontrollues) dhe drejtuesve të departamenteve.

7. Rritjen e bashkëpunimit me organet e drejtësisë për shyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.

Marrëdhëniet e bashkëpunimit dypalësh me organet e prokurorisë gjatë vitit raportues 2011 kanë munguar. Ato kanë ekzistuar formale në ndjekjen dhe plotësimin e angazhimeve të përcaktuara në Memorandumin e Bashkëpunimit për ngritjen e njësive të përbashkëta të hetimit rajonal, të nënshkruar në kuadër të Programit të USAID dhe Departamentit të Drejtësisë të SHBA, Pragu i Mijëvjecarit II^{-të}, më datë 6 maj 2009, nga 6 (gjashtë) institucione të vendit, si Prokuroria e Përgjithshme, MB, MF, SHISH, KLSH dhe ILKDP.

Me nënshkrimin e këtij Memorandumi, pas Tiranës u ngritën edhe gjashtë zyra të reja të Task-Forcës për hetimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit në rrethet si:

Fier, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë, Korçë dhe Durrës. Kompetenca lëndore e këtyre njësive përfshin shumë vepra penale, si ato në tatime, dogana, shoqëritë tregtare, të falimentit, falsifikimet e ndryshme, mashtrimet, abuzimet me detyrën dhe veprat penale në fushën e korrupsionit.

Aktiviteti kontrollues i KLSH^{se} në vitin 2011, ka evidentuar si fusha me rrezikshmëri më të lartë për shfaqjen e krimit ekonomik dhe korrupsionit; - investimet publike, përfshirë prokurimet dhe zbatimin e projekteve me fonde publike; konçesionet dhe administrimin e investimeve me financime të huaja, mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore; rregullimin e territorit, regjistrimin e pronës etj. Këtë e dëshmon fakti se ato pak kallëzime që KLSH ka depozituar vitet e fundit në Prokurori, janë bërë për zbulime të shkeljeve me pasojë dëm ekonomik, pikërisht në këto fusha dhe kryesisht për konsumim të veprave penale si “Shpërdorimi i detyrës”, “Shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera e ankande publike”, “Vepra penale në fushën e tatimeve” dhe “Falsifikimi i dokumentave”.

Gjatë vitit 2011, janë bërë 6 kallëzime penale për 13 persona për një vlerë dëmi prej 367,657 mijë lekë. Pak, shumë pak për një institucion si KLSH.

Krahas kallëzimeve penale për keqpërdorimin e pronës dhe fondeve publike, KLSH ka përcjellë në organet e Prokurorisë dhe raste të zbulimeve dhe konstatimeve të kontrollit që mendohet se mbartin elementë të veprave penale.

Një element i rëndësishëm i shkeljeve për të cilat bëhen kallëzime në Prokurori, është edhe efekti i tyre pasuror. Për rekuperimin e vlerave monetare të dëmtuara buxhetit të shtetit, KLSH duhet t'i kushtojë më shumë rëndësi ndërveprimit me institucione si Avokatura e Shtetit, me qëllim ndjekjen proceseve gjyqësore civile, në të cilat subjektet e kontrolluara kërkojnë kthimin e shumave nga subjektet që kanë përfituar në dëm të buxhetit të shtetit.


Megjithë përpjekjet, jemi të vetëdijshëm se *marrëdhëniet me organet e drejtësisë, veçanërisht me organin e Prokurorisë kanë qenë thjesht të karakterit rutinë pune dhe kanë konsistuar kryesisht në shkëmbimin e informacioneve dhe marrjen e masave për plotësimin e rregullt të materialeve kallëzuese* (masat e parashikuara për vitin 2012 dhe në vijimësi trajtohen në kapitujt që vijojnë).

IV.1 Organizimi i institucionit

Sipas nenit 12, gërma a, të Ligjit Organik të KLSH, Kryetari vendos për strukturën, organikën dhe emërtimin e funksioneve të institucionit.

Me qëllim përmbushjen në nivelin dhe cilësinë e dëshiruar të detyrimeve dhe detyrave të programuara për vitin 2011, Kryetari i KLSH duke marrë në konsideratë edhe mendimin e drejtuesve të departamenteve e të drejtorive, ka rishikuar dhe miratuar strukturën dhe organikën e përmirësuar të institucionit, njëkohësisht edhe emërtimin e funksioneve për vitin raportues.

Më konkretisht, struktura organizative e KLSH për vitin 2011, paraqitet si më poshtë:



Detyrat për çdo departament, drejtori dhe sektor në KLSH, janë përcaktuar në mënyrë të detajuar në Rregulloren e Brëndshme të Organizimit dhe Funksionimit të KLSH, me ndryshimet e bëra.

IV.2 Burimet njerëzore

Zhvillimi i burimeve njerëzore ka qenë dhe është një komponent i rëndësishëm që ka ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin cilësor të ushtrimit të veprimtarisë të punonjësve të KLSH, veçanërisht të asaj kontrolluese. Vitet e fundit, burimet njerëzore në KLSH janë zhvilluar, por ka vend për shumë më tepër, për t'ju përshtatur kërkesave dhe nevojave të shumta që shtrohen për auditimin e jashtëm.

Megjithatë, për vitin 2011, KLSH^{se} i është miratuar në organikë gjithsej 156 punonjës, nga 160 punonjës që kishte 2 vjet më parë.

Sipas organikës së miratuar, *numri i punonjësve në fund të vitit 2011, për secilin departament dhe drejtori* ka qenë:

- Departamenti i Kontrollit të Buxhetit Qëndror, të Institucioneve të Administratës së Lartë Publike dhe Mbikëqyrjes së Auditimit të Brendshëm 32 punonjës.
- Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Publike 39 punonjës.
- Departamenti i Kontrollit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit 26 punonjës.
- Departamenti i Kontrollit të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit 17 punonjës.
- Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, me Publikun dhe Teknologjinë e Informacionit 8 punonjës.
- Drejtorja Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë 7 punonjës.
- Drejtorja Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë 6 punonjës.
- Drejtorja Ekonomike 16 punonjës, përfshirë Sekretaren e Kryetarit.
- Njësia e Auditimit të Brendshëm 2 punonjës.

Së bashku me Kryetarin dhe Drejtorin e Përgjithshëm, numri i punonjësve të punësuar në fund të vitit 2011 ka rezultuar 155, nga të cilët 22 punonjës kanë qenë me kontratë dhe të emëruar pandjekur procedurat e parashikuara në ligjin për statusin e nëpunësit civil. Në testin “kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm që zhvilluam më 28 dhjetor 2011, 15 nga këta punonjës rezultuan shumë dobët. Nëse do t'i vlerësonim me nota nga 1 në 10, nuk morën dot as notën 5, as notën 4, por notën 2.

Përbërja e punonjësve sipas funksioneve dhe detyrave të kryera ka qenë:

- Personel drejtues gjithsej 10 (ku përfshihen Kryetari, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve e të Drejtorive).
- Kontrollorë 106, përfshirë 2 audituesit e brendshëm.
- Kryekontrollorë 7.
- Juristë dhe specialistë të Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë 6.
- Specialistë të Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë, me Publikun dhe Teknologjisë së Informacionit 7.
- Specialistë të burimeve njerëzore dhe Metodologjisë 3.
- Punonjës të aktivitetit ndihmës 16, nga të cilët 1 përgjegjëse sektori, 5 specialistë dhe 1 sekretare.

Numri i kontrollorëve, kryekontrollorëve dhe audituesve të brendshëm, gjithsej *113 punonjës, zë rreth 73% të numrit total të punonjësve.*

Struktura e punonjësve ka ndryshuar në favor të stafit kontrollorë me arsim të lartë, por niveli i përgjithshëm i përgatitjes dhe kompetencave të tyre për kontroll ende lë shumë për të deshëruar.

Klasifikuar sipas arsimit, në strukturën organike punonjësit me arsim të lartë zenë 141 punonjës, ose në masën rreth 90.1% kundrejt numrit total të punonjësve. Punonjësit me arsim të mesëm e të ulët gjithsej 14, janë të punësuar vetëm në detyra shërbimi.

Nga punonjësit me arsim të lartë, pjesën dërmuese e përbëjnë ekonomistët (përfshihen kontabilistët dhe financierët), të cilët zenë rreth 67% të numrit total

të tyre (94:141), juristët rreth 12% (17:141), inxhinierët 15% (21:141) dhe të diplomuar në degë të tjera 6% (9:141).

Mosha mesatare në KLSH në janar 2012 është 50 vjeç, vjetërsia në punë është rreth 9.1 vjet për person, kurse raporti femra/meshkuj 33.5% me 66.5% nga 31% me 69% që ishte një vit më parë. Mosha mesatare e lartë është problem për ne. Të moshës 57-65 vjeç janë 52 punonjës.

Puna në fushën e burimeve njerëzore ka konsistuar në:

□ Plotësimin e dokumentacionit të parashikuar në legjislacionin në fuqi, për rastet e pranimit, lëvizjes, ngritjes në detyrë, transferimit dhe largimit të punonjësve që statusi i tyre rregullohet me ligjin për statusin e nëpunësit civil.

□ Regjistrimin e të dhënave të punonjësve në regjistër të veçantë dhe në formë elektronike, me synim pasqyrimin e lëvizjeve të punonjësve të institucionit, si dhe plotësimin e dosjeve individuale të punës të tyre.

□ Hartimin e një udhëzuesi metodik me afate dhe struktura përgjegjëse, në të cilin në mënyrë të përmbledhur përfshihen: përdorimi dhe plotësimi i një pyetësoi për nevojat e trajnimit, i bazuar te stafi, vendosja e prioriteteve duke kombinuar nevojat strategjike me ato individuale, trajnimi i stafit të ri me të gjitha trajnimet e nevojshme fillestare etj.

Krahas hartimit të programit të trajnimeve (kualifikimit profesional) të brendshëm, KLSH është përpjekur të koordinojë edhe me institucionet trajnuese jashtë dhe brenda vendit, kryesisht me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike.

□ Ndjekjen dhe zbatimin e kërkesave lidhur me hartimin, shpërndarjen, plotësimin dhe dorëzimin në afat, konform legjislacionit në fuqi, të formularëve për vlerësimin e arritjeve të punonjësve në punë. Këta formularë kanë pasqyruar edhe kërkesat e parashikuara në materialin udhëzues për *“Sistemin e vlerësimit të stafit”*, të përgatitur në bashkëpunim me ekspertët e NAO të Britanisë së Madhe.

Sistemi i ri i vlerësimit të stafit, në qoftë se do të aplikohet seriozisht, do të përmirësonte procesin e vendosjes së objektivave, përdorimin më të mirë të kriterëve matës të performancës, si dhe adaptimin e një procesi më të përshtatshëm për të identifikuar nevojat e trajnimit, të dala nga vlerësimet. Megjithatë, procesi i përmirësimit të sistemit të vlerësimit vijon dhe *përbën një nga detyrat për shqyrtim vitin 2012.*

□ Zbatimin e detyrës për plotësimin dhe dorëzimin brënda afateve të caktuara në ligjin përkatës, të formularëve të deklarimit të pasurisë nga punonjësit e ngarkuar nga ligji. Mendojmë dhe do të kërkojmë ndryshime ligjore që kontrollorët e KLSH, pa përjashtim të deklarojnë pasurinë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

□ Është përpjekur të qarkullohen dora dorës kontrollorët me rezultate jo të mira në veprimtarinë kontrolluese të realizuar, me kontrollorë të tjerë me vlera profesionale dhe etike. Ndërkohë që, punonjësve të rinj të rekrutuar u duhet kushtuar më shumë kujdes që t'u krijohet mjedisi që u ofron mundësi teknike dhe nxitëse për të zhvilluar mjeshtëritë e tyre profesionale, veçanërisht përvetësimin e metodologjisë, të metodikave dhe të manualeve bashkëkohore të kontrollit, si dhe të sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Për vitin në vazhdim, KLSH do të realizojë:

□ Mbajtjen e regjistrit të aftësive profesionale, ku të përshkruhet për çdo kontrollor arsimimi, kategoritë, detyrat e kryera, kualifikimet dhe trajnimet, sektorët në të cilët kanë eksperiencë pune, etj.

□ Vlerësimin/monitorimin e stafit të KLSH pas trajnimit mbi aftësitë e fituara gjatë temave të ndryshme që janë kryer në KLSH.

□ Testimin vlerësues për kryekontrollorët dhe kontrollorëve të lartë për vlerësimin e përputhshmërisë së gradave të tyre me kapacitetet reale. Nga studimi i dosjeve të punës rezulton se ka grada të pamerituara.

IV.3 Trajnimi i punonjësve

Trajnimi i punonjësve, veçanërisht i stafit kontrollorë, ka qenë një ndër objektivat prioritarë të KLSH^{-së}, por për shumë arsye për vitin 2011 ka qenë i mangët. Si në vitin 2010 dhe gjatë vitit 2011, institucioni nuk ka mundur të përfitojë nga një asistencë e huaj e organizuar, por ka marrë vetë çfarë i kanë ofruar në mënyrë sporadike.


Çdo fillim viti, KLSH harton strategjinë e trajnimit për vitin në vazhdim, përkatësisht, trajnimin e punonjësve brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë 2011-ës, trajnimi brenda vendit, është realizuar bazuar në programin e hartuar nga vetë institucioni, si dhe nëpërmjet institucioneve të tjera shtetërore, apo institucione rezidente në vendin tonë. Nga stafi trajnues i KLSH^{-së} janë realizuar 11 tema trajnimi nga 16 të programuara e të miratuara në fillim të vitit 2011; nga APP janë zhvilluar gjithsej 4 tema dhe nga MF në kuadër të trajnimit të kontrollorëve është zhvilluar tema “Mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm”.

Trajnimi jashtë vendit, është realizuar nëpërmjet organizmave ndërkombëtarë të kontrollit të tilla si INTOSAI, EUROSAI, SIGMA, Gjykata e Llogarive e BE dhe nga institucionet homologe të kontrollit, ku KLSH ka qenë pjesëmarrës në 2 workshop^e dhe 1 projekt trans-rajonat të organizuar nga IDI.

Gjatë vitit 2011, mesatarisht për çdo ditë pune është trajnuar 1 punonjës i KLSH (në këtë përlogaritje përfshihen ditët e shpenzuara për trajnim brenda dhe jashtë vendit). Shprehur në ditë trajnimi për punonjës të KLSH, treguesi është 2.1 ditë në vit, ndoshta më i ulti në rajon. Nëpërmjet trajnimeve nga vetë KLSH në total janë realizuar 187 ditë/njerëz të trajnuar, ndërsa nëpërmjet trajnimeve të kryera jashtë vendit rezultojnë 37 ditë/njerëz, pra gjithsej 224 ditë/njerëz.

Struktura e trajnimeve të realizuara në vitin 2011 paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Ndër temat më kryesore të trajnimit të zhvilluara brenda vendit gjatë vitit 2011, janë:

- Standardet e kontrollit dhe kodi etik i KLSH.
- Auditimin financiar; njohja me subjektin e auditimit, hartimi i programit të auditimit, përcaktimi i riskut, hartimi i pyetësorëve, lista e verifikimeve, mbajtja e kohëshënuesit, shqyrtimi i observacioneve, hartimi i projektraportit dhe raportit përfundimtar të auditimit.
- Auditimi i performancës; njohja me subjektin, hartimi i programit të auditimit, tre “E”-të (ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti), ndryshimi midis auditimit financiar dhe atij të performancës, shqyrtimi i observacioneve, hartimi i projektraportit dhe raportit përfundimtar të auditimit.
- Materialiteti dhe risku.
- Sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm; ku ndër të tjera janë trajtuar letër politikat për kontrollin e brendshëm financiar publik; ligji dhe manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin; ligjet për auditimin e brendshëm i ndryshuar dhe për inspektimin financiar publik etj.
- Kontabiliteti publik.
- Njohja me teknologjinë e informacionit dhe programi IDEA.

□ Prokurimi publik – zhvillimi i procedurave të prokurimit me mjete elektronike (konçensionet për shërbimet dhe punët, marrëveshja kuadër, kriteret e dhënies së kontratës me theks të veçantë mbi tenderin ekonomikisht më të favorshëm).

Për mungesë burimesh financiare nuk u realizuan trajnimet për programet “Financa 5”, “Alpha”, “Oracle”, si dhe për programe të Doganave, pasi ishin programuar për t’u realizuar me ekspert të jashtëm me pagesë.

Struktura e trajnimeve sipas temave të zhvilluara në ditë/njerëz në KLSH paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Përpjekjet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë kanë qenë në drejtim të organizimit dhe ofrimit të shërbimeve të trajnimit për stafin e KLSH, por kontributet e Departamenteve të Kontrollit nuk kanë qenë në të njëjtin nivel, duke filluar që nga analizat e nevojave specifike për trajnim, përzgjedhja e kontrollorëve pjesëmarrës në trajnime sipas kriterëve objektive, apo edhe mungesa e një sistemi të vlerësimit të kontrollorëve për njohuritë e përftuara nga trajnimet.

Ndër aktivitetet e zhvilluara jashtë shtetit për trajnim dhe shkëmbim eksperience në fushën e auditimit, punonjës të KLSH kanë marrë pjesë:

□ Në zbatim të projektit Trans-rajonat të IDI në bashkëpunim me grupin e punës të INTOSAI, pjesmarrja në takim në temë mbi “Mbi auditimin e menaxhimit të borxhit publik”, të zhvilluar në Lusaka, Zambia, në muajin mars 2011. Theksojmë se ky projekt ka filluar nga implementimi në vitin 2009 dhe kishte për qëllim jo vetëm ngritjen e kapaciteteve në menaxhimin e borxhit publik dhe trajnimin e tyre online, por edhe ushtrimin e auditimeve në këtë fushë, dhënien e mbështetjes dhe asistencës gjatë proceseve të kryerjes së auditimit, si dhe shkëmbimin e eksperiencave dhe të rezultateve të auditimit.

Në përfundim të këtij projekti, organizatorët shpërndanë diploma duke dokumentuar punën e mirë, përkushtimin dhe angazhimin e dy përfaqësuesve të KLSH për përmbushjen në afat dhe sipas programit të detyrës për menaxhimin e auditimit të borxhit publik.

□ Pjesmarrjen në seminarin e zhvilluar në Varshavë, Poloni në muajin maj 2011 me temë “Komunikimi i SAI^t me publikun dhe median”. Në këtë aktivitet u diskutuan çështje lidhur me përmirësimin e komunikimit ndërmjet SAI^t, publikut dhe medias, si dhe u shkëmbyen eksperiencat ndërmjet vetë SAI^{ve} pjesmarrëse dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, me synim informimin në vijimësi të publikut me rezultatet e auditimeve.

□ Pjesmarrjen në seminarin e zhvilluar në Oslo, Norvegji në muajin maj 2011 me temë “Mbi auditimin e menaxhimit të mbetjeve”, ku u diskutua dhe u trajtuan njohuritë, eksperiencat dhe praktikat më të mira lidhur me këtë çështje, si dhe mënyrat për përmirësimin e veprimtarisë audituese të SAI^{ve}.

□ Takimin vjetor të bordit ndërkombëtar të audituesve të NATO^s të zhvilluar në Bruksel, Belgjikë, në muajin maj 2011.

KLSH ka punuar shumë dobët për të siguruar, seleksionuar, përkthyer dhe shpërndarë materiale të siguruar në seminarët, konferencat, takimet dhe trajnimet e ndryshme, nga punonjësit e institucionit; dhe për rrjedhojë ka munguar shkalla e përvetësimit të tyre nga stafi i gjerë auditues. Edhe pse është bërë praktikë pune hedhja në rrjetin e brendshëm “Intranet”, e një pjesë

të mirë të materialeve të siguruara gjatë trajnimeve të realizuara (ndonëse duhen pasqyruar mangësitë apo cilësia e dobët e shërbimit Internet dhe Intranet në institucion) këto materiale kanë gjetur një përdorim shumë të kufizuar të stafit.

Nevojat për trajnim janë shumë të mëdha, duke parë mungesat ekzistuese, prandaj KLSH parashikon për vitin 2012:

- Rritjen domethënëse në mbi 10 ditë në vit, ose rreth 5 herë më shumë se treguesi aktual. Për punonjësit e rinj të rekrutuar do të ofrohet trajnim 25 ditë në vit.
- Koordinimin me MF, DPT dhe DPD për trajnimin e kontrollorëve për të genë të aftë të kryejnë kontroll me të dhënat e siguruara nga sistemet si:
 - Asycuda World për sistemin doganor;
 - SIT për tatimet;
 - AMoFTS për sistemin e thesarit;
 - DMFAST për menaxhimin e borxhit publik.
- Vendosjen e kontakteve dhe nënshkrimin e marrëveshjeve për bashkëpunim me institucione të tilla si MF, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti Juridik në Universitetin e Tiranës, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike etj., për realizimin e disa temave të trajnimit.
- Mbështetjen e Zyrës së Përfaqësisë së BE në Tiranë dhe të SIGMA për dhënien e ndihmës për trajnimin e punonjësve të KLSH që këtë vit, nëpërmjet seminareve apo workshop^{eve}.
- Hartimin e një plani strategjik afatgjatë për trajnimet, ku të përcaktohen objektivat e trajnimeve, nevojat për trajnim, vendosja e përparësive të trajnimeve sipas institucionit dhe më pas sipas personelit, mënyra e dhënies së trajnimeve, bashkëpunimi me departamentet e kontroleve për pjesëmarrjen e stafit që do trajnohet dhe vlerësimi i efektivitetit të trajnuarve pas trajnimit.

- Hartimin e pyetësorëve për vlerësimin e trajnuesve që do të plotësohet në fund të çdo trajnimi nga personat e trajnuar dhe specialisti i kualifikimeve dhe trajnimeve etj.

VII.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të KLSH

Gjatë procesit të planifikimit dhe realizimit të buxhetit të vitit 2011, KLSH ka ndjekur dhe zbatuar me përpikmëri kërkesat e ligjit organik të KLSH^{së}; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; ligjit nr. 10355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, i ndryshuar; dhe udhëzimit të MF nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”.

Në zbatim të kriterëve të parashikuara në legjislacionin e mësipërm dhe bazuar në objektivat, politikat e zhvillimit social dhe programin buxhetor afatmesëm 2010-2012, KLSH ka hartuar dhe plotësuar formularët standard për projektbuxhetin e vitit 2011, të cilët i ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim brenda afatit të përcaktuar në udhëzimin plotësues nr. 7/2, datë 9.7.2010 “Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondeve speciale”. Referuar tavanit të shpenzimeve të përcaktuar për KLSH në vendimin e KM nr. 521, datë 20.07.2011 dhe shkresën e MF nr. 15409, datë 01.08.2011, është përgatitur dhe bërë detajimi i zërave të shpenzimeve të KLSH për vitin 2012.

Përsa i përket kontabilitetit, ai është organizuar dhe mbajtur konformë kërkesave të ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993 “Për kontabilitetin” dhe planin e përgjithshëm, përfshirë ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si evidenca kontabël, pasqyrat financiare, anekset dhe informacionet plotësuese.

Theksojmë se, gjatë vitit 2011, është ndjekur me përparësi zbatimi i afateve të parashikuara për zbatimin e detyrave lidhur me përdorimin me efektivitet të buxhetit të këtij viti, duke respektuar kërkesat ligjore financiare.

Këtij qëllimi i ka shërbyer tërë puna dhe përpjekjet për bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet departamenteve, drejtorive, sektorëve dhe specialistëve të shërbimeve me sektorin e financës, njësinë e prokurimit dhe komisionin e blerjeve me vlera të vogla, të ngritur me urdhër të brendshëm të Kryetarit të KLSH.

Nga Sektori i Financës, veprimet janë regjistruar në mënyrë kronologjike në librat e kontabilitetit mbështetur në dokumente justifikues dhe kontabël. Në llogaritë përkatëse janë paraqitur të gjitha transaksionet financiare që i përkasin periudhës ushtrimore 2011. Ky Sektor ka kryer me rigorozitet veprimet që kanë të bëjnë me përpilimin e dokumentacionit të bankës, arkës e të magazinës. Të gjitha pagesat e punonjësve si paga, dieta, paradhënie dhe shërbime të tjera me arkën janë kryer brenda rregullave. Gjithashtu, është kryer në mënyrë periodike kontrolli i shpenzimeve ditore për rastet e prokurimeve të drejtpërdrejta, si dhe të gjitha llojet e shpenzimeve të kryera me bankë dhe arkë.

Në kontrollet sistematike të kryer në arkë nuk janë konstatuar diferenca.

Shërbimet jashtë vendit janë mbyllur brenda afatit dhe në fund të çdo muaji, situacioni i shpenzimeve të valutës jo tregtare është dërguar në Drejtorinë e Thesarit pranë MF.

Veprimet ekonomike që janë kryer në Institucion janë pasqyruar gjithmonë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi. Dokumentet vërtetuese si faturat, fletëhyrjet, fletëdaljet, mandat-arkëtimet, mandat-pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi, janë kryer në mënyrë kronologjike.

Gjatë vitit raportues, janë kryer në kohë dhe me cilësi riparimet dhe shërbimet e pajisjeve dhe orendive në institucion për krijimin e kushteve optimale për zhvillimin normal të punës. Po kështu, menaxhimi i aktiveve në institucion është kryer në çdo rast konform akteve ligjore të miratuara.

Dokumentet autorizuese si urdhërat e blerjeve, kontratat, urdhërat për krijimin e komisioneve, urdhërat për nxjerrje jashtë përdorimit janë përpiluar rast past rasti, si dhe është bërë kontrolli i tyre me qëllim që dokumentacioni të tregojë me vërtetësi veprimin e kryer.

Gjithashtu, janë kryer rregullisht çdo muaj rakordimet e situacioneve të shpenzimeve me Degën e Thesarit lidhur me realizimin e shpenzimeve të buxhetit dhe janë bërë aktrakordimet për çeljen dhe lëvizjen e fondeve buxhetore me Drejtorinë e Buxhetit në MF^{-ve}.

Sipas buxhetit të vitit 2011, financimi i shpenzimeve ka qenë parashikuar dhe është mbuluar tërësisht nga buxheti i shtetit. Buxheti i këtij viti i KLSH është realizuar në masën 95.1%. Situacioni i zbatimit të buxhetit për 12-mujorin 2011 për KLSH, i krahasuar me planin 12-mujor (strukturës së miratuar) dhe sipas aktrakordimit me DTHT, paraqitet si më poshtë:

Njësia në Lekë

Art	Emërtimi	Plani vjetor	Realizimi vjetor	Rakordimi me thesarin	Në %
600	Pagat	191,068,000	186,911,030	186,911,030	97.9
601	Sigurime shoqërore	25,500,000	25,500,500	25,500,000	100.0
602	Shpenzime operative	46,156,000	38,271,911	38,271,911	82.9
605	Kuotë anëtarësie	131,000	125,554	125,554	95.8
606	Ndihmë për sëmundje	276,000	276,000	276,000	100.0
231	Investime	3,000,000	2,032,400	2,032,400	67.7
T O T A L I:		266,131,000	253,116,895	253,116,895	95.1

Nga shqyrtimi i strukturës së shpenzimeve, rezulton se zërat “Sigurime shoqërore” dhe “Ndhimë për sëmundje” janë realizuar në masën qind për qind, kurse zërat e tjerë rezultojnë me mosrealizim. Për zërin “Shpenzime operative”, i cili rezulton me mosrealizim të theksuar, raportojmë se, si institucion në kuadër të kursimit të këtyre shpenzimeve kemi përcaktuar dhe ndjekur zbatimin e një sërë masave që në procesin e ndarjes së tyre në nënzëra, duke përcaktuar normativa të shpenzimit të tyre për çdo nënzë, si

për përdorimin dhe pagesën e energjisë elektrike, të ujit, telefonisë fikse dhe celulare, të karburantit, pjesëve të këmbimit, blerjeve të kancelarive, riparimeve të ndryshme, shpenzimeve për dieta brënda dhe jashtë vendit etj. Madje, për shpenzimet e parashikuara për telefoninë fikse, për karburantin, gomat, për artikujt e kancelarisë dhe letrën, janë parashikuar normativa konsumi për zyrë, departament apo drejtori. Gjithashtu, për shpenzimet për dieta brenda vendit janë caktuar kuota 3/mujore orientuese për çdo departament dhe drejtori të detajuar në muaj.

Shpenzimet e kryera dhe likujtimi i tyre është ndjekur dita ditës, ndërsa çdo 15-ditor dhe në fund të çdo muaji janë nxjerrë të dhënat faktike të konsumit apo shpenzimit sipas zërave dhe nënzërave, të cilat ballafaqohen me nivelet e përcaktuara për konsum, dhe për çdo tejkalim punonjësit përgjegjës detyrohen të shpërblejnë vlerën e tejkaluar mbi normativë apo kuota.

Theksojmë se, si institucion kemi likujduar në kohë të gjitha detyrimet ndaj të tretëve, si për blerjet ashtu dhe për shërbimet e parashikuara me fondet e planifikuara për vitin 2011. Gjithashtu, për zërin “Kuotë anëtarësie”, i cili rezulton me mosrealizim, KLSH ka shlyer tërësisht detyrimet që ka pasur për vitin 2011; ndërsa mosrealizimi në fondin e pagave ka rezultuar si pasojë e mospërdorimit të fondit të veçantë dhe mungesës së një punonjësi në organikë.

Pavarësisht se i takon vitit 2012, mendojmë të paraqesim një problem mjaft serioz me të cilin jemi ndeshur aktualisht dhe ka të bëjë me cilësinë si dhe efektivitetin e veprimtarisë kontrolluese të KLSH. Më konkretisht, me shifrat e buxhetit të vitit 2012, referuar ligjit nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, KLSH^{se} i është pakësuar fondi i shpenzimeve për këtë vit respektivisht 10,758 mijë lekë më pak se sa tavanin i miratuar ose 11,258 mijë lekë më pak se sa kërkesa e KLSH; dhe ky pakësim është bërë tërësisht në zërin “paga”. Kështu, nga 193,000 mijë lekë parashikuar në tavanin përfundimtar të shpenzimeve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm

2012-2014, miratuar me VKM nr. 521, datë 20.7.2011 dhe po kaq kërkesa e KLSH dërguar me shkresën nr. 297/2, datë 31.8.2011 Komisionit të Ekonomisë e Financave dhe nr. 297/1, datë 31.8.2011 MF, me ligjin e sipërcituar për buxhetin e vitit 2012, KLSH^{-së} i janë miratuar 182,242 mijë lekë. Me këtë fond page, për vitin në vazhdim, përballohen vetëm nevojat për paga për numrin e punonjësve të miratuar, gjithsej 156 punonjës, ndërkohë që institucioni ka shumë nevojë për punën këshillimore dhe kontrolluese të ekspertëve të jashtëm, praktikë e cila është zbatuar në vijimësi, mbështetur në nenin 15 të ligjit organik të KLSH ku përcaktohet: “Kontrolli i Lartë i Shtetit kontraktin ekspertë të përkohshëm. Ekspertët që janë kontraktuar kanë të njëjta të drejta dhe përgjegjësi, si edhe kontrollorët e KLSH”. Gjithashtu, vlen të cilësohet se, institucioni i KLSH nuk ka kërkuar dhe nuk është ftuar për të marrë pjesë në seancat dëgjimore për shifrat e parashikuara për buxhetin e vitit 2012 për KLSH^{-në}.

Zëri “Shpenzime udhëtimi dhe dieta”, i cili zë peshën më të madhe në shpenzimet operative, për vitin 2011, kundrejt totalit të këtyre shpenzimeve është realizuar në masën rreth 71% të tij, si më poshtë:

Emërtimi	Viti 2011 (në 000/lek)	Realizuar në % në raport me shpenzimet operative
Dieta gjithsej	27,142	71%
Nga këto:		
Brenda vendit	24,104	63%
Jashtë vendit	3,038	8%

Lidhur me shpenzimet për shërbimet jashtë vendit, ato janë mbyllur brenda afatit dhe në fund të çdo muaji. Situacioni i shpenzimeve të valutës jotregtare është dërguar në Drejtorinë e Thesarit, pranë MF^{-ve}.

Shpenzimet e kryera për ujë, energji elektrike, telefoni fikse dhe celularë, krahasuar me totalin e shpenzimeve operative 12-mujore, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Shërbime nga të tretë	12- mujori 2011 në 000/lek	Realizuar në % në raport me shpenzimet operative
1.	Ujë	29	0.07%
2.	Energji elektrike	807	2,1%
3.	Telefoni	353	0.9%
4.	Celular	862	2,3%
5.	Posta	87	0.2%
	Totali:	2,138	5,6%

Për shpenzimet e kryera gjatë 12-mujorit 2011, për energjinë elektrike, telefoninë dhe ujë, kujdesi ka qenë i veçantë, madje me impakt në uljen e shpenzimeve. Më konkretisht, nga krahasimi i shifrave të shpenzimeve për këto zëra të realizuar në vitin 2010 kundrejt atyre të vitit 2011, rezulton se në zërin “Shërbime nga të tretë”, për vitin 2011 ka një ulje ndaj vitit 2010 prej 2,805 mijë lekë, dhe konkretisht:

Nr.	Shërbime nga të tretë	Viti 2010 në 000/lek	Viti 2011 në 000/lekë	Shpenzuar më pak në 000/lekë
1.	Ujë	637	29	608
2.	Energji elektrike	1,743	807	936
3.	Telefoni	619	353	266
4.	Celular	1,695	862	833
5.	Posta	249	87	162
	Totali:	4,943	2,138	2,805

Gjatë 12-mujorit të vitit 2011, kujdes është treguar dhe për plotësimin e nevojave me artikuj kancelarie, për mirëmbajtjen e mjedisit, për riparimin e

pajisjeve etj. Realizimi në përqindje i këtyre zërave kundrejt totalit të shpenzimeve operative, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	12-mujori / 2011 në 000/lek	Realizimi në % në raport me shpenzimet operative
1.	Materiale zyre e të përgjithshme	877	2,3%
2.	Shërbime nga të tretet	359	0,9%
3.	Mirëmbajtje të zakonshme	1,772	4,6%
4.	Shpenzime të tjera operative	439	1,2%
	Totali:	3,447	9%

Nga krahasimi i shifrave të realizimit të vitit 2010 me ato të vitit 2011, rezulton se në zërin “Materiale të përgjithshme zyre”, në vitin 2011 janë shpenzuar më pak 1,155 mijë lekë, dhe konkretisht këto shifra paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr	Shpenzime	Viti 2010 në 000/lek	Viti 2011 në 000/lekë	Shpenzuar më pak në 000/lekë
1.	Materiale zyre e të përgjithshme	2,032	877	1,155

Me fillimin e vitit 2012, është dërguar brenda afatit të përcaktuar rregjistri i realizimit të prokurimeve publike për vitin 2011 dhe rregjistri i parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2012.

Vëmëndje e veçantë gjatë vitit raportues 2011, i është kushtuar zbatimit të kërkesave ligjore në fushën e prokurimit publik, duke filluar nga përgatitja e dokumentacionit përkatës, përcaktimi i fondit limit dhe deri në realizimin e detyrimeve kontraktore të përcaktuara. Për vitin 2011, në KLSH është kryer vetëm një prokurim me vlerë të lartë (tender 3,531,700 lekë me t.v.sh.) për

blerje karburanti dhe në këtë rast është përgatitur dokumentacioni i nevojshem sipas listës së proceseve të punës për prokurimet me vlerë të lartë. Kurse, në çdo rast të prokurimeve të drejtpërdrejta, dokumentacioni përkatës është përpiluar konform listës së proceseve të punës për prokurimet me vlerë të vogël.

Në fushën e transportit, gjatë vitit 2011, është punuar duke zbatuar me rigorozitet urdhërat e brendshëm të Kryetarit të KLSH “Për përdorimin, administrimin dhe furnizimin me karburante të automjeteve të KLSH”.

Krahas punës për mbajtjen në gatishmëri të mirë teknike të automjeteve, duke respektuar afatet e kryerjes së shërbimeve, është bërë përgatitja e të dhënave dhe pajisja në kohë me taksa fikse plus siguracionin e të gjithë autovecurave. Të gjitha shpenzimet e kryera në fushën e transportit, si konsumi i karburantit, kryerja e shërbimit të mirëmbajtjes të automjeteve, taksat dhe siguracionet janë evidentuar për çdo muaj dhe për çdo mjet në veçanti.

Më konkretisht shpenzimet për blerje dhe shërbime në fushën e transportit paraqiten si më poshtë:

<i>Nr</i>	Emërtimi	12- mujori 2011 (në /000 lekë)	Realizuar në % në raport me shpenzimet operative
1.	Karburant	3,531	9,2%
2.	Lubrikante	165	0,4%
3.	Pjese këmbimi	837	2,3%
4.	Goma	125	0,3%
5.	Siguracione dhe taksa fikse	519	1,3%
6.	Shpenzime te tjera e servis	368	0,9%
	Totali:	5,545	14,4 %

Përsa i përket shpenzimeve faktike në fushën e transportit, referuar daljeve nga magazina, situacioni paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	12- mujori 2011 (në/000 lekë)
1.	Karburant (25 980 litra)	4,050
2.	Lubrifikante	183
3.	Pjesë këmbimi	847
4.	Goma	140
	Totali:	5,220

Nga krahasimi i sasisë së karburantit të tërhequr me atë që justifikohet me fletë-udhëtimet për 12-mujorin e vitit 2011, rezulton se nuk ka diferenca.

VII.2 Auditimi i brendshëm i KLSH^{së}

Është shumë e rëndësishme që, duke qenë KLSH institucioni që kontrollon të gjithë administratën publike, duke vlerësuar edhe përgjegjshmërinë dhe transparencën e saj, duhet së pari që këto vlera dhe detyrime ligjore t'i kërkojë tek vetja. Në rrethanat kur Kuvendi që nga viti 2001 nuk ka realizuar kontrollin e llogarive të KLSH, e konsiderojmë të nevojshme të përpiqemi ta mbushim në një farë mënyre këtë boshllëk, duke paraqitur rezultatet e auditimit të brendshëm të institucionit. Nga ana tjetër, me shkresën nr.208 datë 02.02.2012 i kemi kërkuar Kryesisë së Kuvendit të realizohet detyrimi ligjor për auditimin sa më parë të llogarive të KLSH për periudhën 2002-2011.

Në zbatim të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010, dy kontrollorët e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në KLSH, nga data 17.1.2012 deri më datën 17.2.2012, sipas drejtimeve të përcaktuara në Programin e Auditimit nr. 63/1, datë 16.1.2012, të miratuar nga Kryetari i KLSH, ushtruan auditim me objekt “Mbi vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe aktivitetit ekonomiko-financiar të KLSH”, për periudhën 01.01.2011 deri më 31.12.2011. Në përfundim të kontrollit të kryer, duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje të vënë në dispozicion, NJAB paraqiti Raportin Përfundimtar të Kontrollit, në të cilin në mënyrë të përmbledhur parashtrohet:

- **Mjedisi i kontrollit**

KLSH është institucion kushtetues që funksionon në pajtim me Kushtetutën e RSH, nenet 162-165, dhe me Ligjin Organik nr. 8270, datë 23.12.1997, i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, si dhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007. Institucioni është me drejtim monokratik drejtohet nga Kryetari, i cili është autoriteti i vetëm drejtues dhe vendimmarrës në institucion.

KLSH ka hartuar dhe miratuar Deklaratën e Misionit me vendimin nr. 13, datë 01.2.2006 të Kryetarit të KLSH, në përputhje me legjislacionin shqiptar, standardet ndërkombëtare të INTOSAI dhe standardet e KLSH, kërkesë kjo e përcaktuar dhe në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH".

Për plotësimin e misionit të saj, KLSH ka hartuar Planin Strategjik të Zhvillimit 2009-2012, i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet afatshkurtra, iniciativat ligjore, aktivitetet zbatuese dhe planet e veprimit.

Për realizimin e këtij plani janë përcaktuar dhe kuadri i përgjegjësive të burimeve njerëzore.

Për realizimin e "Programit të veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2011" është miratuar shpërndarja e fondeve për shpenzime operative dhe janë përcaktuar detyrat për çdo strukturë për ndjekjen dhe kontrollin e tyre.

- **Etika personale dhe profesionale.**

Në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues, për rregullimin e marrëdhënieve në fushën e etikës, konfliktit të interesit, përdorimit dhe përhapjes së informacionit, marrëdhëniet në aktivitetin me të tjerët etj., KLSH ka Kodin Etik të vetin.

Punonjësit që shkelin parimet dhe dispozitat e këtij Kodi ndëshkohen me masa disiplinore sipas parashikimeve të ligjit për statusin e nëpunësit civil dhe kodit të punës. Vetëm në fund të vitit 2011 janë dhënë disa masa të para për shkelje të normave të etikës.

- **Struktura organizative**

Për vitin 2011, KLSH ka funksionuar sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kryetari i KLSH me vendimin nr. 159, datë 29.12.2010 “Për strukturën e renditjes së punëve, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave në KLSH për vitin 2011”, i ndryshuar, ku përfshihen miratimi i strukturës analitike, linjat për kontrollin e brendshëm dhe lehtësimin e qarkullimit të informacionit.

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për specifikat e KLSH, me urdhër të titullarit të saj “Nëpunës autorizues” ka qenë caktuar Drejtorja e Departamentit Ekonomik dhe Burimeve Njerëzore, kurse “Nëpunëse zbatuese” Përgjegjësjë e Sektorit të Financave dhe Shërbimeve. Për vitin 2012, me shkresën e Kryetarit të KLSH me nr. 1/1, datë 5.1.2012 dërguar Ministrit të Financave, është caktuar “Nëpunës Autorizues” Drejtori i Përgjithshëm i KLSH dhe “Nëpunës Zbatues” Drejtore e Drejtorisë Ekonomike.

- **Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.**

Me vendimin nr. 13, datë 01.02.2006 të Kryetarit të KLSH është miratuar “Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të KLSH”, e cila përmban në mënyrë të hollësishme përcaktimin e strukturave, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të KLSH, mënyrën e organizimit të procesit të kontrollit, raportimin dhe publikimin e raporteve të kontrollit.

Gjatë kontrollit është konstatuar se, pas nxjerrjes së kësaj rregulloreje, nga Titullari i KLSH janë marrë disa vendime, të cilat kanë sjellë ndryshime në emërtesat, detyrat dhe funksionet e departamenteve, janë krijuar departamente dhe drejtori të reja, janë shkruar Zyrat Rajonale, është krijuar një kategori e re kontrollorësh (Kontrollor i Lartë), *ndryshime këto, që nuk janë përfshirë rast pas rasti në rregulloren ekzistuese të funksionimit të KLSH. Për sa më sipër, janë ndërthurur funksionet dhe detyrat e strukturave të ndryshme,*

të cilat nuk gjejnë pasqyrim të saktë e të qartë në këtë rregullore, pasi ky dokument nuk është azhornuar me të gjitha ndryshimet e bëra.

1. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e sipërcituar ka përshkrime pune për çdo pozicion, në të cilat përfshihen detyrat individuale që duhen kryer dhe linjat e raportimit, por në strukturën analitike të vitit 2011, ka pozicione pune të tilla, që nuk janë të përfshira brenda kësaj rregulloreje, si “Drejtori i Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë, me Publikun dhe Teknologjisë e Informacionit”, “Drejtoresha Ekonomike”, “Drejtoresha e Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë”, “Njësia e Auditimit të Brendshëm”, etj. Kategoria e “Kontrollorëve të Lartë” që ekziston si kategori më vete në strukturë, nuk përfshihet në rregullore, ndaj nuk është qartësisht i përcaktuar roli apo detyra që duhet të kryejnë si pjesë e departamenteve përkatëse.

Përsa më sipër rezulton, se gjatë vitit 2011, ka munguar verifikimi dhe rishikimi periodik i përshkrimeve të punës dhe si rrjedhim nuk është kryer përditësimi me strukturën ekzistuese për eliminimin e mospërputhjeve të rregullores me këtë strukturë.

Në KLSH, nga Drejtori i Departamentit apo i Drejtorisë përkatëse, është kryer vlerësimi vjetor i punonjësve, i cili mbështetet në plotësimin e objektivave vjetore dhe kërkesat e përpunuara nga institucioni, në lidhje me detyrat që kryejnë. Konstatohet se procesi i vlerësimit, megjithëse bëhet sipas procedurës dhe kriterëve të përcaktuara, *ka vend për përmirësim në drejtim të dokumentimit dhe argumentimit të shkallës së vlerësimit, pasi për të mbështetur opinionin e pavarur për notën e vënë, eprori direkt, duhet të ketë evidencën e fakteve të mjaftueshme, të mbledhura nga puna e gjithë vitit, për çdo kontrollor.* Meqenëse në këtë proces, raporti midis objektivitetit dhe subjektivitetit është shumë i ndjeshëm dhe delikat, evidenca e punës së kryer dhe rezultatet e arritura në çdo kontroll, do të shtonin objektivitetin e këtij vlerësimi. *Kjo arrihet me plotësimin e letrave të punës nga çdo kontrollor, si*

dhe shqyrtimin e tyre, evidentimin e zbulimeve dhe rekomandimeve të ndara për çdo kontrollor brenda një programi kontrolli etj.

2. Vlerësimi i menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit, monitorimit dhe informimit.

a) Në vitin 2011, mbas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 21, KLSH nuk ka të formalizuar dhe dokumentuar ndonjë procedurë për *menaxhimin e riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve* që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit, të përcaktuara gjatë planifikimit afatmesëm dhe vjetor.

Struktura që realizon operacionet financiare të KLSH është “Drejtoria Ekonomike”, e cila në vitin 2011 ka pasur në përbërjen e saj si Nëpunësin Autorizues dhe atë Zbatues, gjithashtu, një specialiste finance, dy specialistë shërbimesh dhe një magazinier. Detyrat janë të ndara qartësisht dhe Nëpunësi Autorizues nënshkruan të gjitha angazhimet e institucionit në përputhje me ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe nenin 9 të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

b) Informimi dhe Komunikimi.

Në KLSH, komunikimi është thelbësor për zbatimin e të gjithë objektivave të institucionit në tërësi dhe të departamenteve në veçanti. Ka një paketë të formularëve dhe dokumentave standarde të KLSH, në të cilat strukturat dhe personat përgjegjës duhet të lenë gjurmët e veprimit të tyre me qëllim që Kryetari, të ketë informacion të qartë e të saktë, që do ta ndihmojë në vendimmarrjen e tij. KLSH në janar të 2012-ës ka filluar rishikimin e këtyre dokumentave, për t’i dhënë ngjyrën e kohës, duke synuar rritjen e cilësisë dhe eficiencës në komunikimin dhe informimin.

Përsa i përket informimit të stafit, për veprimtarinë e KLSH, përveç informimeve periodike për proceset e zbatimit të detyrave për çdo kontrollor e punonjës, janë kryer mbledhje për informim dhe analiza 3/mujore dhe vjetore

mbi bazë Departamenti, Drejtorie dhe në nivel Stafi Drejtues. Në vitet e mëparshme, nuk është bërë ndonjë analizë me të gjithë stafin e KLSH, ku të paraqitet raporti i veprimtarisë së Institucionit. Për herë të parë, një gjë e tillë u bë e mundur në “Analizën vjetore të veprimtarisë të KLSH për vitin 2011”, zhvilluar në datën 20 Janar 2012.

Në funksion të komunikimit dhe informimit, Sistemi i Teknologjisë së Informacionit, gjatë këtij viti nuk ka funksionuar në nivelin që e kërkon zbatimi i ligjit për MFK dhe standartet e KLSH dhe ato ndërkombëtare. *Intraneti nuk ka funksionuar rregullisht gjatë gjithë vitit, faqja zyrtare ka qenë e paazhurnuar me njoftime, plotësime aktesh ligjore, urdhra të brendshëm etj.* Praktikisht, shumica e informacionit qarkullon dorazi me fletë të printuara, duke rritur kohen dhe koston e komunikimit dhe vështirësuar shpërndarjen e informacionit në kohë dhe tek të gjithë.

3. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit

Nga auditimi u konstatua se, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH"; igjit nr. 10355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011"; udhëzimit të MF nr. 4, datë 27.01.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011" dhe shkresave të ndryshme të MF, Departamenti përkatës ka përgatitur, detajuar dhe paraqitur për shqyrtim në Kuvend projektbuxhetin për vitin 2011.

Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve operative është miratuar urdhri i brendshëm i Kryetarit të KLSH nr. 36, datë 29.12.2010 "Për ndjekjen dhe kontrollin e përdorimit të fondeve të miratuara për shpenzime operative për vitin 2011", ku ndër të tjera në pikën 4 të këtij urdhri përcaktohen kuotat për shpenzimet për udhëtim e dieta për çdo Departament dhe Drejtori, pasi ky zë pjesën më të madhe rreth 63% të shpenzimeve operative.

Me urdhër të brendshëm të Kryetarit të KLSH nr. 386/1 datë 27.07.2010 "Për hartimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011" janë ngritur grupet e punës (komisionet) për hartimin e buxhetit. Pas përgatitjes dhe miratimit nga Kryetari

i KLSH, projektbuxheti i vitit 2011 i është dërguar Kuvendit të Shqipërisë (Komisionit të Ekonomisë dhe Financave) dhe MF.

Megjithë punën e bërë dhe korrespondencën e shkëmbyer nga KLSH kryesisht me MF, buxheti fillesatar për vitin 2011 ka qenë 276,131 mijë lekë, kurse buxheti i ndryshuar përfundimtar 266,131 mijë lekë, ose 10,000 mijë lekë më pak. Sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit dhe raportit të monitorimit të KLSH, dërguar me shkresën nr. 62, datë 27.01.2011, plani përfundimtar i rishikuar i buxhetit dhe realizimi i shpenzimeve të detajuara për periudhën e kontrollit (viti 2011), paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në mijë/lekë

Artikulli	Emërtimi	Plani	Realizimi	Në %
		Vjetor	12-mujor	
600	Paga	191,068	186,911	98
601	Sigurime shoqërore	25,500	25,500	100
602	Shpenzime operative	46,156	38,272	83
605	Kuotë anëtarësie	131	126	96
606	Ndihmë sëmundje	276	276	100
231	Investime	3,000	2,032	68
	Totali:	266,131	253,117	95

Nga të dhënat e mësipërme rezulton që buxheti faktik për vitin 2011 nuk paraqitet me tejkalim në asnjë të tij, përkundrazi rezulton me mosrealizim. Buxheti është miratuar i balancuar me nivel të njëjtë të ardhurash dhe shpenzimesh. Pasqyra e shpenzimeve (situacioni) është detajuar për çdo zë shpenzimesh.

Nga shqyrtimi i pasqyrave përkatëse të shpenzimeve sipas zërave dhe nëzërave dhe situacionit të shpenzimeve rezulton që, veprimet janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", shkresën e MF nr. 13379/157, datë 05.01.2011 "Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve operative", si dhe udhëzimin e MF për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011.

4. Sistemi i pagave

a) Mbi miratimin dhe zbatimin e organikës dhe legjislacionit të pagave.

Nga kontrolli i ushtruar mbi marrëdhëniet e punës dhe të pagave për periudhën objekt kontrolli në Drejtorinë Ekonomike dhe atë të Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë në KLSH, u konstatua se:

Në zbatim të Ligjit Organik të KLSH, me vendimet nr. 159 datë 29.12.2010 dhe nr. 102, datë 31.08.2011, Kryetari i KLSH ka miratuar strukturën organike dhe nivelin e pagave sipas klasave dhe grupeve për nëpunësit civil. Nga kontrolli i ushtruar për muajin mars, korrik, nëntor dhe dhjetor 2011, u konstatua se në pasqyrat e pagave kishte përputhje të vendeve të punës të miratuara në strukturat organizative respektive dhe të kufijve të pagave të përcaktuara dhe ndryshimet përkatëse.

Për vitin 2011, struktura organizative e KLSH përbëhet nga 5 Departamente dhe 3 Drejtori, gjithsej 156 punonjës, realizuar në fakt 154+1 punonjës.

Gjatë kontrollit me zgjedhje, u krahasuan përmbledhëset e listëpagesave me shumat e urdhërpagesave dhe listat e pagave neto të derdhura në llogaritë bankare personale dhe rezultuan të njëjta. Listëpagesat për punonjësit e KLSH hartoheshin për çdo muaj mbi bazën e listëprezencave. Për punë jashtë kohës normale pagesat bëheshin në bazë të urdhrit të titullarit.

Në listëpagesat e çdo muaji, për çdo punonjës ishin evidentuar pagat bazë, shtesat për funksionet, vjetërsia, gjithashtu janë llogaritur dhe ndaluar detyrimet fiskale si tatimi mbi të ardhurat personale, përqindja e kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe çdo ndalesë tjetër deri në pagën neto. Gjithashtu, janë hapur librat e pagave dhe janë bërë përditësimet përkatëse për çdo punonjës me pagat mujore të përfituara, për vitin 2010 dhe vitin 2011.

Krahas pagave për punën e kryer, punonjësit kanë marrë shpërblime nga fondi i veçantë i cili është llogaritur në masën 5% të fondit të planifikuar të pagave, konformë vendimit të KM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe

përdorimin e fondit të veçantë”. Në mbështetje të nenit 12, të Ligjit Organik të KLSH dhe Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 03.05.2007, Kryetari i KLSH ka kompetencë që t’i miratojë vetë pagat dhe shpërblimet. Mbështetur në këto dispozita ligjore me urdhër-shpenzimin nr. 7, datë 12.01.2011, është shpërndarë shuma neto gjithsej 2,417,193 lekë, e cila përfaqëson nga 1 pagë mujore për 31 punonjës.

Në përdorimin e fondit të veçantë nuk u konstatua tejkalim nga fondi i planifikuar.

b) Mbi kontrollin e zbatimit të marrëdhënieve juridike të punës dhe plotësimin e Regjistrimit Themeltar të punonjësve.

Nga kontrolli rezultoi se nga 155 punonjës në fakt që rezultoi në vitin 2011 administrata e KLSH, marrëdhëniet juridike të punës janë rregulluar si më poshtë:

Numri i Punonjësve	Viti 2010		Viti 2011	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt
	156	154	156	155
Punonjës me kontratë provizore	15		16	
Punonjës me Status Nëpunësi Civil	113		113	
Punonjës të emëruar	16		16	
Punonjës me Kodin e Punës	9		9	

Nga kontrolli rezultoi se për punonjësit, të cilët trajtohen me Kodin e Punës dhe ata me statusin e nëpunësit civil, janë lidhur kontrata individuale të punës dhe në kontratë janë parashikuar llojet e masave disiplinore, konformë kërkesave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Për Kodin e Punës", me ndryshime dhe ligjin për statusin e nëpunësit civil.

Nga kontrolli rezultoi se është hapur dhe azhurnuar periodikisht Regjistri themeltar i punonjësve që nga viti i krijimit të KLSH, siç është parashikuar në nenin 95 "Regjistri" të ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar. Të gjithë punonjësit e punësuar në KLSH, janë të pajisur me

libreza punë, diplomë dhe çertifikatë notash, si dhe dokumente të tjera, të përcaktuar në Aneksin I dhe II të vendimit të KM nr. 355 datë 07.07.2000 "Për organizimin e dosjes dhe Regjistrin të Personelit".

c) Mbi pagesat për orët jashtë kohës normale të punës.

Për vitin 2011, u janë paguar punonjësve të administratës 90 orë jashtë kohës normale të punës ose 58,965 lekë dhe punonjësve mbështetës 640 orë pune baraz me 230,518 lekë. Nga kontrolli i dokumentacionit për pagesën jashtë kohës normale të punës rezulton se pagesa është bërë bazuar në urdhrat e titullarit dhe listëprezencën e hartuar dhe nënshkruar nga përgjegjësi i personelit, ku janë shënuar vetëm sasia e orëve.

5. Sistemi i kontabilitetit dhe raportimi financiar

Nga ana e Sektorit të financës është bërë ndarje e detyrave me shkrim për punonjësit që ka ky sektor, gjë që sjell kontrollimin dhe kryerjen e detyrave në afat dhe përcaktimin e përgjegjësisë individuale për moskryerjen e detyrave, konform ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

a) Veprimet me arkën në lekë dhe valute

Nga kontrolli me të zgjedhur i veprimeve me arkën për periudhën 2011, u konstatua se është zbatuar disiplina financiare dhe dokumentacioni është mbajtur në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në ditarin e arkës regjistrimet janë bërë në mënyrë kronologjike, veprim për veprim, duke përfshirë çdo të dhënë të dokumentit justifikues ku mbështetet ky regjistrim. Çdo muaj është kuadruar ditari dhe gjendja kontabël që është e barabartë me gjendjen në librin e arkës. Debiti i llogarisë 580 "Xhirime të Brendshme" e arkës është e barabartë me kredinë e kësaj llogarie në ditarin e bankës.

Në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 21.11.2006 "Për prokurimin publik" dhe vendimin e KM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", janë nxjerrë urdhrat e brendshëm për ngritjen e komisionit të blerjeve

me vlera të vogla dhe pagesat janë bërë në bazë të dokumenteve bazë dhe justifikues, të cilat janë në përputhje me legjislacionin e cituar më sipër.

Nga kontrolli rezultoi se nga ana e Sektorit të Financës janë kryer në vazhdimësi inventarë fizikë mujorë të arkës, për çdo fund muaji janë përpiluar procesverbalet e arkës të cilët janë bashkalidhur dokumentave duke u krahasuar me inventarin kontabël i cili kryhet me mbylljen mujore. Drejtuesi dhe përgjegjësi i financës ose personat e ngarkuar prej tyre, kanë bërë kontroll të gjendjes së arkës jo më pak se njëherë në muaj.

Nga kontrolli i arkës në valutë, llogaritja e dietave është bërë konform vendimit të KM nr. 304, datë 08.05.2003 dhe udhëzimit të MF nr. 16, datë 24.07.2003 “Për zbatimin e vendimit KM nr. 304, datë 08.05.2003”, tashmë të shfuqizuar me VKM nr. 870, datë 14.12.2011. Libri i arkës në valutë është i kuadruar dhe i kontabilizuar në mënyrë korrekte. Për veprimet e arkës në valutë, u kontrollua dokumentacioni në mënyrë të njëpasnjëshme dhe rezultoi se, të gjitha pagesat ishin kryer bazuar në urdhrin e titullarit, në të cilat janë përcaktuar data e nisjes dhe e kthimit nga shërbimi, shpenzimet që përfiton nga institucioni, si dhe ato shpenzime që merr përsipër pala pritëse. Për aktivitete jashtë vendit për vitin 2011 rezultojnë gjithsej 9 urdhra të brendshëm dhe ftesat e institucioneve homologe, bashkëngjitur dokumentet e tjera shoqëruese.

b) Veprimet e kryera nëpërmjet bankës dhe blerjet me vlera të vogla.

Nga kontrolli i njëpasnjëshëm i dokumentacionit të bankës për periudhën objekt kontrolli, rezultoi se dokumentacioni dhe veprimet kontabile janë kryer në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Të gjitha tërheqjet me çek nga banka në lekë dhe valutë, janë bërë hyrje në arkë dhe kontabilizimi i tyre në ditarin e bankës dhe të arkës është bërë në llogarinë 580 “Xhirimi i vlerave monetare”, llogari e cila në fund të periudhës paraqitet e mbyllur.

Pagesat e kryera me urdhër xhirimi, janë të shoqëruara me dokumente të rregullta justifikuese. Është bërë regjistrimi dhe kontabilizimi i rregullt në ditar dhe në fund të çdo muaji, shuma e pagesave të bankës është e barabartë me ekstraktin e saj.

Kontabilizimi i lëvizjeve të disponibiliteteve në ditarin e shpenzimeve korrente është i saktë. Dokumentet justifikuese që i janë bashkangjitur urdhrave të pagesave janë të rregullta dhe të firmosura nga titullarët. Faturat e blerjes janë tatimore dhe hyrjet në magazinë për mallrat e blera janë kryer brenda datës.

Blerjet e mallrave, materialet dhe shërbimet janë kryer në përputhje me vendimin e KM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Dokumentet justifikuese për çdo blerje ose shërbim të prokuruar, tregojnë se, është bërë studimi i tregut dhe janë mbledhur ofertat të cilat i janë bashkangjitur procesverbalit të miratimit të çmimit.

Por, nga auditimi i njëpasnjeshëm i dokumenteve të bankës u konstatuan disa shkelje e mangësi, në drejtim të copëzimit të fondeve.

Mbi zbatimin e limiteve të përcaktuara për telefoninë celulare.

Nga kontrolli rezulton se, për vitin 2011, në zbatim të vendimit të KM nr. 864, datë 23.07.2010 për pajisjen me numër telefoni celulare të personave juridik, publik; Kryetari i KLSH ka nxjerrë urdhrat e brendshëm nr. 26, datë 21.07.2010 “Për caktimin e normave mujore në shpenzimet e telefonisë fikse në zyrat e KLSH” dhe nr. 33, datë 3.11.2010 “Për pajisjen me numër celulari të punonjësve të KLSH”, në të cilët janë përcaktuar shpenzimet për telefoninë celulare gjithsej 10 punonjës me një vlerë totale prej 81,000 lekë në muaj, duke respektuar tavanin prej 2% të totalit të shpenzimeve operative; kurse për telefoninë fikse janë përcaktuar limite shpenzime tepër minimale. Në fakt, në vitin 2011 janë shpenzuar 862 mijë lekë ose 2.3% të shpenzimeve operative të faktit, ndërsa me planin është nën 2%.

c) Inventarizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese.

Në bazë të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 dhe udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, është kryer procesi i inventarizimit të vlerave materiale në institucion. Në bazë të urdhrit të titullarit nr. 5, datë 11.01.2012 është ngritur komisioni i inventarizimit i cili ka kryer inventarizimin e gjendjes fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në magazinë. Inventarizimi i aktiveve gjëndje në magazinë filloj më datë 11.01.2012 deri më 13.01.2012. Gjendja fizike është krahasuar me gjendjen kontabël për çdo artikull dhe nuk ka rezultuar diferenca. Çdo fletë inventari është firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në fund të inventarizimit, komisioni ka bërë vlerësimin e aktiveve të qëndrueshme në magazinë dhe Sektori i Financës ka bërë përmbledhësen e artikujve në vlerën 15,145,410.6 lekë.

d) Saktësia dhe rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet magazinës dhe kontabilizimi i tyre.

Nga kontrolli u konstatua se dokumentacioni i magazinës është i rregullt. Për çdo lëvizje malli pritët fletë-hyrje dhe fletë-dalje, të cilat plotësoheshin me të gjitha ekstremitetet dhe pa korrigjime.

Kontabiliteti mbahet me ditarët e magazinës ku bëhej regjistrimi kronologjik veprim për veprim dhe kontabilizimi i tyre. Në bazë të dokumenteve bazë të magazinës janë përpiluar për gjithë periudhën ushtrimore kartelat dyfishe, ku për çdo muaj magazinierja ka rakorduar me ekonomisten e magazinave në bazë të tyre, duke lënë gjurmë në këtë dokumentacion.

Fletë-daljet e materialeve, janë shoqëruar me urdhër dorëzime, janë hapur kartela personale për secilin punonjës për gjithë inventarin ekonomik dhe inventarin e imët të tërhequr nga magazina, në mënyrë që Sektori i Financës të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

6. Zbatimi i rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare.

Veprimet e kryera nëpërmjet bankës dhe arkës për vitet 2010-2011 janë kontabilizuar saktë sipas funksionit që ato kryejnë në klasat përkatëse dhe sipas kategorive ekonomike sipas të cilit janë organizuar ato. Si të ardhurat dhe shpenzimet janë kontabilizuar sipas natyrës. Rregjistrimet e këtyre veprimeve janë bërë në mënyrë kronologjike në ditarët e bankës dhe arkës. Krahas ditarëve janë hapur dhe mbajtur partitarët analitikë për llogari të veçanta në të cilat është bërë azhurnimi i veprimeve dhe kuadruar me ditarët. Gjithashtu është mbajtur libri i madh në të cilat janë pasqyruar efektet e veprimeve ekonomike të klasifikuara sipas llogarive të prekura nga azhurnimi në ditarë nëpërmjet mbartjes së shumave nga ditarë në fund të periudhës ushtrimore.

Në bazë të udhëzimit të MF nr. 26, datë 27.12.2007, Sektori i Financës ka përfunduar procesin e përgatitjes të pasqyrave financiare për vitin 2011. Përsa i përket cilësisë së informacionit kontabël të pasqyruar në këto pasqyra financiare, nga kontrolli u konstatua se:

- Është plotësuar bilanci dhe pasqyrat anekse të tij. Kalimet e llogarive analitike në ato sintetike dhe më tej në bilanc janë bërë të sakta dhe të kuadruara, si ndërtesa, pajisje, inventar ekonomik, mjete transporti etj.
- Debi-kreditë nuk paraqesin probleme, përjashtuar llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” për gjendjen e saj në fillim dhe në fund të vitit 2011, ku qëndrojnë formalisht 2,536,652 lekë që janë vjedhje materiale dhe pajisje qysh në vitin 1998. Sipas Organit të Prokurorisë Tiranë, çështja është në proces ndjekjeje.
- Gjendja e llogarisë të të ardhurave, përkatësisht nga qiraja për ndërtesë rezulton në vlerën 159,360 lekë.
- Përsa i përket anës formale të plotësimit të pasqyrave financiare, rezulton se në përgjithësi ato janë në përputhje me udhëzimin dhe gjendjet në llogaritë e pasqyrave anekse dhe kuadrojnë me gjendjet në llogaritë e bilancit.

Në përgjithësi dokumentacioni i arkës, bankës dhe magazinës (me përjashtime të pakta), është plotësuar pastër, pa korrigjime dhe është i sigluar nga personat e ngarkuar për kryerjen e veprimeve, si dhe të gjitha veprimet janë pasqyruar në librin e arkës, bankës e magazinës. Gjithashtu, mandatpagesat dhe urdhërpagesat janë plotësuar me dokumentacionin justifikues të shpenzimeve. Lëvizja e vlerave monetare të kryera nëpërmjet arkës dokumentohej për çdo ditë si për hyrjet ashtu edhe për daljet, duke plotësuar rregullisht librin e arkës.

a) Liqshmëria e lëvizjes së vlerave monetare, dokumentimi dhe regjistrimi.

Nga kontrolli me zgjedhje i veprimeve me arkën, si të librit të lëvizjes së arkës, mandatarkëtimet, mandatpagesat dhe dokumenteve të tjera justifikuese për arkëtimet dhe pagesat e kryera, u konstatua se, veprimet janë kryer konform ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 dhe udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011. Për veprimet e arkës mbahen llogari kontabile të arkës nga Sektori i Financës dhe libër arke nga punonjësi i caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare. Dokumentet e arkës shqyrtohen, kontrollohen dhe nënshkruhen nga personat përkatës të ngarkuar me ligj. Lëvizja e mjeteve monetare nga arka në bankë është dokumentuar me mandatpagesa, të cilat për çdo rast kanë të bashkëngjitur arkëtimin e bankës.

Nga kontrolli i dokumenteve të arkës rezultoi që për blerjet e bëra ekziston dokumentacioni përkatës si: urdhër prokurimet e titullarit të entit prokurores; procesverbalet e komisionit; fletëdaljet apo faturat e shitësit të nënshkruara edhe nga 2 anëtarët e komisionit të ngarkuar për realizimin e blerjes; fletëhyrjet e magazinës për materialet e blera. *Gjatë auditimit u vërejtën edhe mangësi, veçanërisht në lidhje me mungesën e relacionit për domosdoshmërinë e blerjeve, dhe mungesën e evidentimit të veprimtarisë së Komisionit dhe të grupit të anëtarëve të ngarkuar për realizimin e blerjeve, kjo vetëm për veprimet me arkën.*

7. Nxjerrja e llogarisë vjetore (bilanci kontabël) dhe inventarizimi i llogarive dhe pasurisë publike.

Për vitin 2011 është nxjerrë Bilanci Kontabël me të gjithë formularët dhe anekset dhe do të paraqitet brenda afateve pranë Degës së Thesarit.

U kontrolluan postet e bilancit për saktësinë e paraqitjes të llogarive 401-408 "Personeli llogari të lidhura me to", llogaria 435-436 "Sigurime Shoqërore e Shëndetësore" dhe 431 "Shteti Tatim Taksa" dhe rezultoi se, në bilancin e datës 31.12.2011 llogaria 421-428 "Personeli llogari të lidhura me to" është e barabartë me shumën e mandatpagesës për pagimin e pagave. Llogaria 435-436 "Sigurime Shoqërore e Shëndetësore" është e barabartë me shumën e xhiruar Degës të Sigurimeve Shoqërore. Llogaria 431 "Shteti Tatim Taksa", sipas bilancit datë 31.12.2011 paraqitet me një gjendje prej 2,019,165 lekë dhe është derdhur pranë Degës të Tatim Taksave.

Gjendja e llogarive të Bilancit në fund dhe fillim të vitit 2011 paraqitet në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij raporti.

Duhet pasqyruar se, totali i aktivitetit është i barabartë me totalin e pasivitetit, si për ushtrimin e mbyllur, ashtu edhe për ushtrimin paraardhës, respektivisht në fund të vitit 2011 në shumën 103,682,762.2 dhe 93,340,030.2 lekë.

8. Drejtimet e auditimit për sistemin e prokurimeve

Auditimi për prokurimet me fonde publike të kryera në KLSH, u krye në zbatim të kërkesave të ligjit për prokurimin publik, i ndryshuar, dhe vendimit të KM nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Për vitin 2011, kërkesat për prokurim, KLSH i ka bazuar në parashikimet e regjistruara në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik, i cili me shkresën nr. 88, datë 14.2.2011 i është dërguar APP dhe është botuar në faqen e buletinit. Gjatë periudhës 1.01.2011–31.12.2011, sipas regjistrimit të parashikimeve të prokurimit publik, janë parashikuar për t'u zhvilluar 2

procedura prokurimi “Kërkesë për propozim” me fond limit 9,600 mijë lekë, objekti i të cilëve ka qenë “Blerja e karburantit” me fond limit 3,500,000 lekë dhe “Blerje kompjutera” me fond limit 6,000,000 lekë. Pjesa tjetër e fondit prej 17,500,000 lekë, është parashikuar për t’u prokuruar me procedurën “Prokurim me vlerë të vogël” e ndarë në 4,000,000 për investime dhe 13,500,000 blerje mallrash dhe shërbime për nevojat e KLSH gjatë vitit 2011.

Në hartimin e regjistrit të parashikimeve, janë konstatuar këto shkelje:

a) Vlera prej 1,600,000 lekë për blerje “Paisje zyrash” është copëzuar dhe është parashikuar për prokurim me vlerë të vogël, duke shmangur procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, veprim ky që bie në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu II, pika c, dhe udhëzimin e APP “Mbi mënyrën e përzgjedhjes së llojit të procedurës sipas kufirit monetar”, pika 2/2.

b) Vlera prej 1,865,000 lekë për “Riparim automjeteve” është copëzuar dhe është shmangur një nga procedurat e prokurimit të përcaktuara në nenin 32 dhe 33 të ligjit për prokurimin publik, veprim ky që bie në kundërshtim edhe me udhëzimin e APP “Mbi mënyrën e përzgjedhjes së llojit të procedurës sipas kufirit monetar” pika 2/2.

Nga shqyrtimi i regjistrit të realizimit të prokurimeve për vitin 2011, rezulton se është realizuar vetëm 1 procedurë prokurimi për blerje karburanti në vlerën 3,531,469 lekë, ndërsa tenderi i planifikuar për blerjen kompjuterësh me fond limit 6,000 mijë lekë, nuk është realizuar. Nuk është realizuar gjithashtu blerja e pajisjeve të zyrës si mokat, karrige, rafte tavolina të parashikuara për blerje më procedurë prokurim me vlerë të vogël.

Për llogaritjen e sasisë së karburantit janë marrë në referencë 12 automjete në dispozicion të KLSH. Ky numër bie në kundërshtim me VKM nr. 1139, datë 24.11.2009 “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të Ministrive dhe të Institucioneve Qendrore”, në të cilën është përcaktuar se “numri i automjeteve në dispozicion të KLSH-së është 9”, pra për 3 automjete më tepër. Ky veprim ka sjellë si rezultat shtimin e sasisë së

karburantit me rreth 5000 litra, si rjedhim dhe shtesën e fondit limit me afërsisht 900,000 lekë.

- Kontroll mbi mbajtjen e fletë udhëtimeve dhe ndjekja e harxhimit të karburantit.

Për vitet 2010 dhe 2011, KLSH ka pasur në inventar 16 mjete të tipeve të ndryshme, nga të cilat 4 i janë nënshtruar procedurave të shitjes në vitin 2010. Aktualisht janë në punë 5 mjete dhe 7 mjete të tjera në gjendje pune, por qëndrojnë të parkuar. Institucioni aplikon normativa për harxhimin e karburantit, të përcaktuara në manualin e mjetit të blerë.

Nga kontrolli për harxhimin e karburantit rezultoi se, fletët e udhëtimit plotësoheshin nga drejtuesi i mjetit, ndërkohë kontrolloheshin dhe lihej gjurmë në fletë udhëtimi, nga punonjësi i caktuar për kontrollin e tyre ,

Për vitin 2011, janë konsumuar 15350 litra benzol me vlerë 2,431,447 lekë, 10630 litra gazoil me vlerë 1,619,324 lekë, në total 25980 litra me vlerë 4,050,772 lekë, shumë e cila përkon me pasqyrat e realizimit të buxhetit të trajtuara në problemet e buxhetit të institucionit dhe të rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë

Konstatohet se, km e përshkuara edhe sasia e konsumit të karburantit ka ardhur në ulje, kështu në vitin 2011 krahasuar me vitin 2008 janë harxhuar 13335 litra më pak, kurse në krahasim me vitin 2009 dhe 2010 janë harxhuar respektivisht 11536 litra dhe 1142 litra më pak.

* Pavarësisht sa më sipër, paraqitet urgjente nevoja për auditimin e llogarive të KLSH nga ekspertë të jashtëm të caktuar nga Kuvendi. Auditimi i fundit i llogarive të KLSH nga ekspertë të tillë është kryer në vitin 2001, ndërkohë që sipas ligjit organik të KLSH, neni 3 përcaktohet se llogaritë vjetore të KLSH përgatiten në përputhje me Ligjin për Buxhetin dhe kontrollohen nga një organizëm i pavarur, i caktuar nga Kuvendi dhe që raporton tek ai.

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit me Nr. 1250 datë 05.05.2010 “Për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH për vitin 2009”, ku përcaktohet

realizimi i detyrimit ligjor për auditimin dhe kontrollin e veprimtarisë financiare dhe administrative të KLSH, i jemi drejtuar Kuvendit për të vepruar në përmbushjen e këtij detyrimi ligjor.

VIII.1 Teknologjia e informacionit

Duke vlerësuar rëndësinë dhe rolin e teknologjisë së informacionit (IT) në veprimtarinë e përditshme të punonjësve të institucionit, duke vënë theksin në përdorimin gjerësisht të kësaj teknologjie sidomos nga stafi kontrollorë, çdo vit KLSH për zhvillimin e IT, ka parashikuar masa konkrete që rrjedhin nga Plani Strategjik i Zhvillimit të KLSH^{së} dhe gjejnë pasqyrim në programet vjetore të veprimtarisë së departamentit përkatës dhe atë në nivel institucioni. Përgjithësisht këto masa, përfshijnë plotësimin e kërkesave më të nevojshme të institucionit me teknika dhe pajisje kompjuterike bashkëkohore, ashtu dhe detyra për mbajtjen në gatishmëri të pajisjeve gjëndje, të rjetit të brendshëm informatik dhe të faqes së internetit.

Ndër masat e parashikuara në strategjinë e zhvillimit të IT^{së} për vitin 2011 dhe në programin e veprimtarisë së KLSH^{së} dhe të realizuara këtë vit, paraqesim:

- Mirëmbajtjen e pajisjeve dhe programeve kompjuterike në institucion, si dhe asistencë teknike për stafin.
- Mirëmbajtjen dhe rifreskimin e informacionit të faqes së intranetit dhe internetit të KLSH.
- Trajnimin e stafit auditues gjatë muajit mars 2011 mbi përdorimin e programit IDEA në kontroll.
- Përpunimin dhe hedhjen e materialeve dhe aktiviteteve të ndryshme në intranet dhe internet etj.

Pavarësisht sa më sipër, duhet pasqyruar me realizëm gjëndja dhe progresi i pakët në teknologjinë e informacionit, ku ndër faktorët që kanë ndikuar përmendim:

- Mungesa e hapësirave të nevojshme,

- Amortizimi fizik dhe moral i rrjetit kompjuterik (i para 10 viteve),
- Sasia e pakët e trajnimeve, sidomos mungesa e trajnimeve përmbi 3 vjet nga institucionet homologe të auditimit,
- Mosshfrytëzimi si dhe sa duhet i mundësive trajnuese të e-gov.

Vlerësojmë me ndikim negativ mosstabilitetin e organizimit të strukturave IT, të ndërtuar para shumë vitesh, strukturë e cila gradualisht është tkurrur në dy specialistë.

Ndonëse, janë shpenzuar vlera jo të pakta financiare e njerëzore për futjen e teknologjisë së informacionit në kontroll nëpërmjet programit të auditimit IDEA, por deri më sot shkalla e përdorimit në praktikë ngelet e limituar, kjo dhe si rezultat i moskoordinimit e mosfunksionimit si dhe sa duhet të strukturave përkatëse.

Shkalla e përdorimit të faqes së internetit të KLSH gjatë vitit 2011 ka qenë e ulët dhe botimi i materialeve në të është kryer pa dinamizëm.

Si institucion, kemi vendosmërinë dhe prokupacionin për të ndryshuar gjendjen dhe të përdorim teknologjinë e informacionit si një nga mjetet me të dobishme për rritjen e transparencës, efijencës e performacës së institucionit, veçanërisht në drejtim të aktivitetit kryesor atë të kontrollit, pa lënë mënjanë ndikimin e IT në drejtim të informimit të faktorëve kryesore, në veçanti publikut. Intensifikimi i përdorimit të metodave bashkëkohore të teknologjisë së informacionit do të jetë një nga instrumentet bazë të rritjes së performancës së punës së KLSH dhe do të lehtësojë kontrollet e kryqëzuara të transaksioneve financiare.

KLSH ka nevojë të fitojë akses në publik dhe për këtë i duhet:

a) Të transformojë rrënjësisht faqen e saj në internet, duke siguruar një ndryshim rrënjësor në drejtim të transparencës dhe furnizimin periodik me informacion të rrjeteve të mediave elektronike dhe të shtypit të përditshëm, të interesuara për mirëmenaxhimin e pronës publike.

b) Të rrisë aksesin e buletinit periodik të KLSH në aktorët kryesorë të opinionit publik, si mediat, opinionistët dhe OJF^{-të} e angazhuara kundër korrupsionit dhe/ose të interesuara për bashkëpunim.

c) Një investim të plotë në kuptimin e gjerë, ndonëse kjo është e kondicionuar me sigurimin e ambienteve të përshtatshme për zyra për një punë normale.

Mungesa e ambienteve të punës dhe pamundësia e kryerjes së investimeve në fushën e IT është trajtuar dhe nga SIGMA, agjencia e ngarkuar nga Komisioni European për të vlerësuar progresin e administratave publike të vendeve kandidate dhe aspirante për në BE. Në raportet e saj të vlerësimit të përvitshëm të ecurisë së veprimtarisë së KLSH është theksuar në vijimësi nevoja urgjente e KLSH për ambiente të reja, si kusht jetik për zhvillimin e infrastrukturës së TI të tij. Në vlerësimin e SIGMA të vitit 2011 thuhet: "...KLSH vijon të vuajë mungesën e ambienteve të përshtatshme të punës, mungesë që, ndër të tjera, pengon edhe investimet e domosdoshme në infrastrukturën e TI". Ky shqetësim u ritheksua në konstatimet e misionit të radhës të SIGMA gjatë muajit shkurt 2012.

Së fundi, për zhvillimin e IT do të përgatisim një strategji komunikimi 2012-2015, që të synojë rritjen e aksesit dhe kuptimin e plotë në publik të misionit dhe rolit të KLSH si parandalues i korrupsionit dhe i abuzimeve me pronën shtetërore, si dhe të rolit të tij orientues dhe ndreqës në performancën e institucioneve publike që kontrollon. Një strategji e tillë do të pajiset me një plan konkret veprimi 2012-2015, duke mundësuar tryeza të rumbullakëta informacioni dhe konsultimi me OJF^{-të} që luftojnë korrupsionin dhe/ose të interesuara për bashkëpunim, si dhe me media.

IX.1 Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet brënda vendit

1. *Marrëdhëniet me Kuvendin* burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Organik i KLSH^{-së}. Relatojmë se, këto marrëdhënie nga njëri vit në tjetrin janë fuqizuar dhe konsoliduar më tej. Madje, duhet evidentuar se, Kuvendi me Komisionet e tij, në veçanti Komisioni i Ekonomisë

dhe Financës, në vijimësi kanë mbështetur dhe inkurajuar veprimtarinë e KLSH^{së}. Në këtë kontekst, përmendim kontaktet apo shkëmbimin e opinioneve për kontrollet më të rëndësishme dhe rezolutat e viteve të fundit për veprimtarinë e KLSH^{së}.

KLSH është përpjekur për të përmbushur në kohë detyrimet kushtetuese, si nëpërmjet informimit dhe raportimit në vijimësi për rezultatet e kontrolleve, ashtu dhe për përgatitjen dhe dërgimin në kohë në Kuvend të raporteve të parashikuara në Kushtetutë dhe në Ligjin Organik të KLSH^{së}.

Krahas dy raporteve të cilësuar në kapitullin “Për raportimin”, përkatësisht raportit për veprimtarinë vjetore të KLSH^{së} dhe për zbatimin e buxhetit faktik të shtetit, të cilët në përgjithësi janë vlerësuar për problematikën e trajtuar, zbulimet dhe përfundimet e nxjerra, madje dhe për shkallën e zbatimit të rekomandimeve; KLSH gjatë vitit 2011, ka dërguar rregullisht në Kuvend dhe në Komisionin e Ekonomisë dhe Financës buletin 3-mujor për rezultatet e kontrolleve të ushtruara për periudhën respektive dhe një numër materialesh të ndryshëm, me interes në fushën e veprimtarisë kontrolluese.

Sipas kërkesës apo me iniciativë, për rezultatet e kontrolleve më kryesore, KLSH ka dërguar raporte kontrolli kryesisht në Komisionin e Ekonomisë dhe Financës.

Raportet e kontrollit të KLSH^{së} dërguar Kuvendit, krahas informacionit për gjendjen e konstatuar dhe masat e propozuara për përmirësimin e gjëndjes, kanë shërbyer edhe si një burim për të vlerësuar punën e kryer nga ekzekutivi.

2. Me institucionin e lartë të Presidentit të Republikës është komunikuar në vijimësi dhe me korrektesë. Krahas korrespondencës shkresore, nga ana e KLSH^{së} janë dërguar rregullisht në Presidencë buletinet për rezultatet e veprimtarisë kontrolluese të institucionit gjatë vitit 2011. Janë dërguar në kohë raportet “Mbi veprimtarinë e KLSH^{së} për vitin 2010” dhe “Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2010 dhe mendimet për raportin e KM për shpenzimet

e vitit të kaluar financiar”, gjithashtu raportohet për problemet e ecursisë së institucionit në takimet zyrtare me Presidentin.

3. Përsa i përket marrëdhënieve me Kryeministrinë dhe me organet ekzekutive në nivel qëndror, ato kanë qenë të rregullta, duke respektuar pozicionin kushtetues dhe ligjor të njëri tjetrit. Gjatë vitit raportues 2011, KLSH ka dërguar periodikisht në Kryeministri dhe në të gjitha ministrinë buletin 3-mujor për rezultatet e kontroleve të ushtruara për periudhën respektive dhe një numër materialesh të ndryshëm, me interes në fushën e veprimtarisë kontrolluese. Madje, në Kryeministri, krahas buletineve janë dërguar herë pas here raporte përfundimtarë të kontrollit, të gjykuar problematikë dhe me rëndësi. Urdhëri i Kryeministrit Nr. 70, datë 18.04.2006 “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave në institucionet në vartësi të Kryeministrit e të Ministrive” është tepër i vlefshëm dhe i dobishëm për vlerësimin e punës sonë.

Ndër marrëdhëniet e bashkëpunimit, duhen pasqyruar ato me *Ministrinë e Integritit, në kuadër të realizimit të detyrimeve të përcaktuara për auditimin e jashtëm në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit*. Me këtë ministri, janë mbajtur kontakte periodike dhe është raportuar rregullisht në lidhje me hartimin, ndjekjen dhe zbatimin e masave të parashikuara në Planin Kombëtar për zbatimin e MSA^{-së}. KLSH ka qenë pjesëmarrëse dhe periodikisht ka dërguar informacione sipas kërkesave të parashtruara dhe brenda afateve kohore të përcaktuara nga Ministria e Integritit. Si pjesë e këtij procesi, gjatë vitit 2011, në të gjitha takimet e mbajtura, për çështje të ndryshme pranë zyrave të kësaj ministrie, KLSH ka pasur përfaqësues të saj. Gjithashtu, KLSH ka marrë pjesë aktive si në grupet e punës të përbashkëta Shqipëri–BE, për çështjet ekonomike, të kontrollit financiar dhe statistikave, ashtu edhe në përditësimin e angazhimeve të Shqipërisë në raport me MSA^{-në}.

Duke konsideruar rezultatet e deritanishme në përpjekjet dhe luftën antikorruption, KLSH, ka ende shumë punë për të bërë për të arritur nivele të kënaqshme të kontributit të vet në përpjekjet antikorruption, dhe kjo duke analizuar me realizëm marrëdhëniet e bashkëpunimet me agjenci dhe organizmat e ngarkuara me luftën kundër fenomeneve të mashtrimit dhe korrupsionit.


Kemi filluar gjatë këtij viti të punojmë për një bashkëpunim intensiv dhe bashkërendim të veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të kësaj fushe, të cilët luftojnë korrupsionin dhe mashtrimin financiar, si me Departamentin AntiKorrupsion pranë Kryeministrisë, me Njësinë Qëndrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave, pse jo, edhe me Shërbimin Informativ Shtetëror dhe me Drejtorinë kundër Krimit Financiar në Policinë e Shtetit për të shfrytëzuar në këtë mënyrë mundësitë e mëdha për burim informacioni që ofron bashkëpunimi me ta, por gjithnjë duke ruajtur pavarësinë e KLSH si organi më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar.

Motoja jonë e punës është kontroll cilësor, zbulim, evidentim dhe denoncim i mashtrimit financiar dhe korrupsionin kudo dhe në çdo kohë që ai ushtrohet dhe konstatohet, në institucione qëndrore, agjenci buxhetore apo në njësi vendore.

4. Marrëdhëniet me organet e drejtësisë.

Një pjesë e rëndësishme e misionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në rolin e tij si mbikëqyrës i përdorimit të fondeve publike dhe miradministrimit të pronës publike është edhe përcjellja në organet e Prokurorisë e të gjitha zbulimeve që mendohet se mbartin elemente të veprave penale. Këtij procesi i duhet dhënë një rëndësi e veçantë nga ana e KLSH, pasi në këtë mënyrë krijohen hapësira që për shkeljet e konstatuara në përdorimin dhe administrimin e fondeve e pronës publike të ndërhyjnë dhe të sigurojnë zbatimin e ligjit organet e akuzës

dhe sistemi i drejtësisë, duke mbyllur kështu ciklin jo vetëm me ndëshkimin e personave përgjegjës, por edhe duke rritur forcën parandaluese të ligjit. Ka patur gjatë vitit 2011 një përgjumjeje të KLSH në drejtim të ndërveprimit me organet e prokurorisë. Në fund të vitit 2011, u bë një studim për nivelin sasior të kallëzimeve penale që KLSH ka depozituar në organet e prokurorisë për periudhën 2000–2011. Rezultatet statistikore të kësaj analize përfshihen në grafikun e të dhënave në vijim:



Përsa i përket ecurisë së kallëzimeve penale, duhet thënë se raporti i kallëzimeve të depozituara, me ato për të cilat është marrë vendim mosfillimi është rreth 5% e numrit total të kallëzimeve të depozituara nga KLSH gjatë viteve 2000–2011.

Nga ana tjetër, numri i rasteve për të cilat pasi vendoset regjistrimi i procedimit dhe në përfundim të hetimeve prokuroria ka vendosur pushimin e çështjes, ka qenë relativisht i madh. Vetëm në rreth 10% të rasteve gjatë kësaj periudhe, Prokuroria ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim.

Disa përfundime të rëndësishme që formulohen menjëherë nga analizimi i këtyre të dhënave janë:

- Numri i kallëzimeve, që ka arritur maksimumin e vet në vitet 2005-2006, ka ardhur në rënie duke përfunduar në vitet 2010 -2011 në një rënie drastike në nivel minimal. Konstatohet se ky është një numër shumë i vogël kallëzimesh, po të kihet parasysh se niveli i zbulimeve të KLSH në terma financiarë, nuk ka pësuar një rënie të ngjashme. Kjo tregon se përpjekjet e KLSH nuk kanë qenë

të mjaftueshme në drejtim të dhënies rrugë për hetime të mëtejshme nga organet e Prokurorisë për zbulimet e kontrollit që shoqërohen me efekte të mëdha financiare të fondeve dhe pasurisë publike.

- Shkëmbimet e ndërsjella mes KLSH dhe organeve të Prokurorisë kanë qenë të vakëta dhe të kufizuara vetëm në komunikime formale në kufijtë e kërkesave minimale të ligjit. Kjo tregon se ka një rënie të cilësisë së ndërveprimit mes institucioneve dhe shkaqet për rënien e këtij niveli të ndërveprimit, nga ana jonë duhen kërkuar fillimisht tek mungesa e vullnetit dhe mangësitë në performancën e KLSH.

Megjithëse mes KLSH dhe Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, ekziston një Marrëveshje Bashkëpunimi e datës 6 Maj 2005, konstatojmë se kjo Marrëveshje, për fat të keq, ka mbetur vetëm në letër dhe ka arritur të funksionojë vetëm në disa prej drejtimeve të saj kryesore si p.sh. sigurimi i ndihmës së ndërsjelltë, shkëmbimi i informacioneve dhe marrja e masave për plotësimin e rregullt të materialeve kallëzuese.

KLSH gjatë vitit 2012, për të maksimizuar efektivitetin e punës së vet në drejtim të përpjekjeve antikorrupsion, do t'i orientojë burimet dhe kapacitetet e veta në drejtimet e mëposhtme:

Së pari, nëpërmjet angazhimit në kontrollet me risk të lartë, të një stafi që posedon ekspertizën e nevojshme profesionale. Kontrollorët, në ushtrimin e detyrave të tyre, tashmë gëzojnë pavarësi nga ndërhyrje të çfarëdolloji, prej cilitdo individ, apo institucion tjetër. Nëpërmjet aktivitetit kontrollues, që kryhet në mënyrë të vazhdueshme për fondet dhe pronën publike, KLSH do të jetë një nga sinjalizuesit kryesorë të rasteve që mbartin elementë të krimit ekonomik dhe korrupsionit në administrimin e pasurisë publike.

Së dyti, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve ekonomiko-financiarë, të rregullshmërisë, apo edhe vlerësues, KLSH ka të gjitha mundësitë të shkojë deri tek rrënjët e krimit ekonomik dhe korrupsionit. Këto analiza mundësojnë

institucionit, të rekomandojë zgjidhjet më të mira organizative dhe ligjore, me qëllim kufizimin, apo mënjanimin e faktorëve që favorizojnë këto dukuri.

Së treti, edhe pse KLSH nuk ushtron funksione ekzekutive, do të shfrytëzojë të gjitha hapësirat në dispozicion, që nëpërmjet rekomandimeve të veta të ndikojë tek ekzekutivi, që ky i fundit të ketë një qasje sa më efektive në frenimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit.

Së katërti, në bazë të rezultateve të kontrollit, KLSH i rekomandon Kuvendit dhe subjekteve që mund të ushtrojnë inisiativën legjislative nxjerrjen apo ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim eliminimin e boshllëqeve në legjislacion që favorizojnë shfaqjen e krimit ekonomik dhe korrupsionit në sektorin publik.

Së pesti, kur rezultojnë kushtet dhe rrethanat përkatëse, KLSH do t'i përcjellë organeve të Prokurorisë materiale të kontrolleve, konkluzionet e të cilave sinjalizojnë për ekzistencën e veprave penale në sektorin publik.

Së gjashti, një element i rëndësishëm i shkeljeve për të cilat bëhen kallëzime në Prokurori, është edhe efekti i tyre pasuror. Kjo merr rëndësi të veçantë, pasi kemi të bëjmë me para të taksapaguesve dhe qytetarët kanë nevojë jo vetëm që personat shpërdorues të ndëshkohen, por edhe që paratë e tyre të shkojnë në destinacionin për të cilin janë mbledhur. Në këtë mënyrë, duke pasur parasysh kuadrin rregullator të krijuar nga ligji “Për Avokaturën e Shtetit”, rezulton se Avokatura e Shtetit mbart një rol mjaft të rëndësishëm si institucioni që duhet të mbrojë interesat e shtetit kur dyshohet se janë cenuar interesat pasurore të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë, publikë, pasi është ky institucion që duhet të marrë masat për ngritjen e padisë civile në procesin penal, për kërkimin e pasurisë ose shpërblimin e dëmit, që u është shkaktuar interesave të shtetit nga kryerja e veprës penale.

KLSH ka punuar në drejtim të ndjekjes dhe plotësimit të angazhimeve të përcaktuara në *Memorandumin e Bashkëpunimit* për ngritjen e njësive të përbashkëta të hetimit rajonal, të nënshkruar në kuadër të Programit të USAID

dhe Departamentit të Drejtësisë të SHBA, Pragu i Mijëvjeçarit II^{të}, më datë 6 maj 2009, nga 6 (gjashtë) institucione të vendit tonë si, Prokuroria e Përgjithshme, MB, MF, SHISH, KLSH dhe ILKDP. Me nënshkrimin e këtij Memorandumi, pas Tiranës u ngritën edhe gjashtë zyra të reja të Task-Forcës për hetimin e krimit ekonomik dhe korrupsionit në rrethet si: Fier, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë, Korçë dhe Durrës. Kompetenca e këtyre njësive përfshin shumë vepra penale, si ato në tatime, dogana, shoqëritë tregtare, të falimentit, falsifikimet e ndryshme, mashtrimet, abuzimet me detyrën dhe veprat penale në fushën e korrupsionit. KLSH përfaqësohet në të gjitha takimet e përmuajshme të Komitetit të Koordinimit të punës për zbatimin e këtij Memorandumi, nga punonjës me eksperiencë, të cilët kanë ofruar ekspertizën e vet në aspektet ekonomiko-financiare të çështjeve në proces hetimi nga Njësitë “Task Forcë”. Por, edhe në këtë drejtim ka shumë për të bërë.

Në përfundim, theksojmë se, për t’ju përgjigjur me punë konkrete dhe produktive kërkesave të kohës për parandalimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit në administratën publike, kemi filluar nga puna për harmonizimin e politikave dhe strategjitë e KLSH me institucionet e tjera që luajnë rol në përpjekjet për parandalimin e këtyre fenomeneve. Një kërkesë e tillë është përcaktuar edhe nga Strategjia Kombëtare Anti-Korrupsion 2008-2013, në të cilën kërkohet një bashkëpunim më i ngushtë i institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara dhe pikërisht: “Shkëmbimin e informacionit, jo vetëm ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili synon shkëmbimin e informacionit jo si pjesë e detyrimit e përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë”. Hapi i parë në këtë drejtim është hedhur pikërisht këto ditë, ku sapo nëshkruam një marrëveshje bashkëpunimi me ILDKP.

IX.2 Marrëdhëniet me jashtë

Drejtim tjetër i rëndësishëm dhe i dobishëm në mbështetje të veprimtarisë kontrolluese të KLSH^{së} janë marrëdhëniet me jashtë dhe procesi i integritetit evropian të institucionit. Gjatë vitit 2011 janë realizuar disa aktivitete në nivel bilateral dhe më gjerë, ndër të cilat pasqyrojmë pjesëmarrjen në vizita zyrtare dhe takime të rëndësishme ndërkombëtare si:

- Vizita zyrtare e delegacionit të KLSH-së në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, Prishtinë në muajin janar 2011.

Kjo vizitë mbeti në planin e një kontakti formal dhe nuk u vijua me bashkëpunim konkret mes të dy institucioneve.

- Takimi i Kryetarëve të Rrjetit të SAI^{ve} të Vendeve Kandidate dhe Kandidate të Mundshme për në BE, organizuar nga SIGMA dhe Gjykata e Llogarive të Turqisë dhe zhvilluar në muajin mars 2011 në Stamboll, Turqi.

Delegacioni i KLSH-së luajti një rol aktiv në diskutimet e zhvilluara lidhur me temat e përcaktuara, të cilat u konsideruan të një rëndësie të veçantë për ecurinë e punës së një SAI. Në këto tema trajtoheshin çështjet lidhur me “Marrëdhëniet me Parlamentin”, “Pavarësinë e SAI-t” si edhe “Kontrollin e Cilësisë”. Gjithashtu, në takim u shkëmbyen mendime dhe ide për zhvillimin e punës së rrjetit në të ardhmen, si dhe u konsideruan mundësitë e bashkëpunimit në nivelet e larta drejtuese, duke përfshirë edhe përfaqësues të grupeve të interesit. Në përfundim të punimeve, nga pjesëmarrësit *u miratua unanimisht Marrëveshja e Stambollit* dhe plani i punës së aktiviteteve për të ardhmen.

- Vizita zyrtare e Këshilltarit të Lartë të SIGMA^s për Auditimin dhe Kontrollin Financiar Z. Joop Vrolijk dhe Jan Pieter Lingen Drejtues Kabineti në Gjykatën Evropiane të Audituesve, të realizuar në muajin prill të vitit 2011, në kuadër të vlerësimit dhe përpilimit të raportit vjetor të funksionimit të kontrollin të jashtëm në Shqipëri nga KE, të cilët mbi bazën e një programi organizuan dhe

zhvilluan një sërë takimesh, si me drejtuesit e institucionit, me drejtorë departamentesh e drejtorish dhe me punonjës të stafit.

Punonjësit e KLSH^{së} të cilët gjatë vitit 2011 kanë qenë pjesëmarrës në aktivitetet e zhvilluara jashtë shtetit nga organizmat ndërkombëtarë, si INTOSAI, EUROSAI, Gjykata e Llogarive e BE, institucionet homologe etj., kanë prezantuar materiale të ndryshme në këto aktivitete (trajtuar në kapitullin “Trajnimet”).

Megjithë sa sipër, niveli i marrëdhënieve me jashtë nuk ka qenë në nivelin e kërkesave të kohës. Ndonëse formalisht ka pasur një program të departamentit për këto marrëdhënie, në të nuk ka pasur të specifikuar tematika ku duhej të konsistonin dhe çfarë përfitime me interes reciprok do të përfitoheshin në takimet dhe vizitat e ndërsjellta. Mangësitë e konstatuara në marrëdhëniet me jashtë argumentojnë dhe mangësitë në trajnimin e punonjësve me përvojën e mirë të vendeve të BE, pasi KLSH ka mbi 3 vjet që nuk ka përfutur ndonjë projekt trajnimi në kuadër të programit IPA apo me fonde të tjera të BE, si dhe donatorëve të tjerë. Edhe për këtë vit nuk arrijmë dot të përfitojmë nga këto programe, për shkak të mungesës së aplikimeve tona gjatë vitit 2011.

Sfida jonë për vitet në vijim do të jetë partneriteti me Delegacionin e BE në Tiranë, Gjykatën Evropiane të Audituesve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të KE në Bruksel. Do të synojmë të marrim pjesë në programet e kontrollit të Gjykatës Evropiane të Audituesve për vendet që aspirojnë për në BE dhe që përfitojnë nga programet e asistencës së BE^{së}, përfshirë vendin tonë. Për thellimin e dijeve në auditimin e performancës, do të vazhdojmë partneritetin me institucione homologe që na kanë ndihmuar në të kaluarën, si Zyra Kombetare e Auditimit e Britanisë së Madhe apo Gjykata Hollandeze e Auditimit, por njëkohësisht duke kërkuar partneritet edhe nga institucioni homolog gjerman, suedez apo i vendeve të tjera të fuqishme të EUROSAI.

Ne do t'i kushtojmë gjatë këtij viti e më tej rëndësinë e duhur bashkëpunimit me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, me të cilin nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi në shkurt 2012. Kjo marrëveshje parashikon vizita të ndërsjellta dhe trajnime, ku KLSH mund të përfitojë nga kontributi cilësor që kjo Zyrë e Kosovës ka marrë nga drejtimi i saj prej një autoriteti të njohur të komunitetit ndërkombëtar të auditimit të jashtëm publik. Të dyja institucionet e kontrollit të lartë kanë vendosur të unifikojnë terminologjinë e auditimit në gjuhën shqipe.

Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet marrëdhënieve të bashkëpunimit me SIGMA, në mënyrë që të asistohemi nga kjo organizatë për të siguruar trajnimet aq shumë të nevojshme për stafin e KLSH që këtë vit.

X.1 Marrëdhëniet me publikun dhe median.

Në zbatim të objektivave kushtetuese dhe ligjore, si dhe misionit të tij, KLSH gjatë vitit 2011 ka punuar për komunikimin me median dhe publikun, por ka munguar përparësia dhe transparenca me këta partnerë të natyrshëm të KLSH.

Në media dhe në dijet e publikut kanë mbizotëruar njoftimet e KLSH për abuzime, vjedhje dhe dëm hipotetik, duke dëmtuar në shumë raste imazhin e institucionit tonë dhe të institucioneve të tjera qendrore dhe vendore.

a) Marrëdhëniet me publikun.

Shërbimi ndaj qytetarëve, për punonjësit e KLSH është detyrim ligjor dhe përgjegjësi tepër e madhe në procesin e komunikimit institucional me taksapaguesit. Gjatë vitit 2011, janë zhvilluar dhe pritur në takime në ambientet e KLSH një numër qytetarësh nga rrethe të ndryshme të vendit, ku një pjesë e tyre ka paraqitur dhe me shkrim ankesat apo kërkesat e tyre për problematika të ndryshme, të cilat në raste shumë shumë të pakta janë zgjidhur.

Gjatë analizimit të ankesave apo kërkesave nga publiku, drejtuar KLSH^{-së}, janë evidentuar një gamë e gjerë çështjesh të ngritura, ndër të cilat kryesore

kanë qenë ato që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronës, regjistrimin e pasurive të paluajtshme, administrimin financiar, sistemin fiskal etj.

Për t'i dhënë një impuls, përmbajtje dhe formë krejtësisht të re këtyre marrëdhënieve, KLSH po përfundon brenda programit të 100 ditëve të lidërshiptit të ri *hartimin e një udhëzuesi të veçantë për mënyrën e komunikimit me publikun, sidomos për administrimin e kërkesë/ankesave të publikut*, që nga momenti i mbërritjes së tyre dhe deri në dhënien e zgjidhjeve të mundshme dhe brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe burimeve njerëzore që disponon KLSH.

b) Marrëdhëniet me median.

KLSH gjatë vitit 2011 ka informuar nëpërmjet medias së shkruar dhe audiovizive publikun e gjerë dhe institucionet e shtetit me rezultatet e veprimtarisë së tij kontrolluese. Rol të rëndësishëm në këtë informim ka dhe faqja zyrtare e institucionit, e cila ka qenë pak interaktive dhe e miqësore për lexuesin. Media e shkruar nga fillimi i muajit janar 2011 deri në fund të muajit dhjetor 2011 ka prodhuar në faqet e saj 280 artikuj, editoriale, si dhe komente analitike, nga të cilat vetëm 37 prej tyre ishin nga mesi i muajit Nëntor deri në fund të Dhjetorit, çka përkon përkon me procesin e zgjedhjes së Kryetarit të Ri. Janë pasqyruar buletinet e kontrolleve të institucionit, në lidhje me rezultatet e kontrolleve të ndryshme.

Medias audiovizive gjatë vitit 2011 ka transmetuar 100 sekuenca filmike, edicione informative, apo kronika të ndryshme televizive.

Për vitin 2012, ndër objektivat kryesore të KLSH në marrëdhënien me publikun renditet rritja e impaktit në komunikim, njoftime tërësisht transparente, shpërndarja më e gjerë e raporteve të veprimtarisë kontrolluese, si dhe forcimi i kontakteve me të gjithë aktorët dhe faktorët mediatike të vendit tone, si analistë të njohur, OJF të angazhuara në luftën kundër korrupsionit, etj. *Synimi është përcjellja sa më e shpejtë dhe me vërtetësi e të gjithë veprimtarisë*

kontrolluese të KLSH tek publiku i gjerë, duke shërbyer si një mjet efikas denoncimi dhe parandalimi të korrupsionit.

V.1 Metodologjia dhe standardet e kontrollit

Qëllimi i metodologjisë së kontrollit është përpunimi dhe përgatitja e udhëzimeve dhe metodikave për ushtrimin e kontrolleve, bazuar në rekomandimet dhe udhëzuesit zbatues të standardeve të auditimit, të hartuar nga INTOSAI. Ndërkohë që, njohja dhe zbatimi i standardeve të kontrollit dhe përditësimi i tyre, si element thelbësor i teknikës profesionale, edhe pse ka qenë një kërkesë e stafit drejtues të KLSH^{SE}, nuk është plotësuar gjatë vitit 2011

KLSH për vitin 2012 ka përcaktuar objektivat për metodologjinë, të cilat përmbliidhen në:

Përditësimin e standardeve të auditimit dhe formularëve standard.

Në këtë drejtim, janë përkthyer dhe shpërndarë, si dhe janë në procesin e vlerësimit materialet e mëposhtme:

- Deklarata e Limës;
- Parimet themelore në auditimin e njësive publike;
- Standardet e përgjithshme të auditimit shtetëror;
- Standardet e fushës të auditimit shtetëror;
- Standardet e raportimit të auditimit shtetëror.

Gjatë vitit 2011, KLSH ka hartuar formularë standard për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për institucionet buxhetore. Për të konfirmuar nëse këta formularë janë praktikisht të zbatueshëm nga kontrollorët dhe nëse mbulojnë të gjithë proceset e veprimtarisë audituese, do të duhet të kryhen disa auditime pilot dhe më pas këta formularë të përfshihen në manualin e auditimit financiar.

Njohja dhe përpunimi i udhëzuesve dhe metodikave për ushtrimin e kontrolleve.

Plotësimi dhe përmirësimi i metodologjisë së aktivitetit kontrollues ka si qëllim që, manualët e auditimit të pasurohen duke reflektuar në to praktikat e mira që kontrollorët kanë kryer në subjekte, po kështu praktikat e mira apo standardet më të fundit, të dërguar nga institucionet ndërkombëtare dhe homologe të kontrollit. Në këto manuale, synohet që të paraqiten në mënyrë sa më të kuptueshme llojet më të përshtatshëm të kontrollit të realizuar, të cilët të shërbejnë si materiale bazë në ndihmë të kontrollorëve për plotësimin sa më të mirë të kërkesave e të standardeve gjatë kontrolleve që ata do të kryejnë. Gjithashtu, është synuar që në to, të jepen shpjegime sa më të sakta, për një kuptim më të plotë dhe të aplikueshëm të materialitetit e të riskut, si dhe ku duhet të përqëndrohet më tepër kontrollori gjatë kryerjes së punës së tij audituese.

Evidentimi i nevojave për kualifikim profesional të kontrollorëve dhe plotësimi i tyre me anë të realizimit të trajnimeve sipas kërkesave përkatëse të evidentuara, sipas një procedure të miratuar.

Për këtë, struktura përkatëse e metodologjisë së kontrollit ka ndjekur procesin e hartimit dhe shpërndarjes së pyetësorëve për fushat dhe tematikat e trajnimit, si dhe plotësimin e tyre nga secili punonjës i institucionit. Mbi bazën e përgjigjeve të dhëna në këta pyetësorë, u hartua “Programi i trajnimit të punonjësve për vitin 2011”. Në vitin 2011 u hartua dhe programi i trajnimit të punonjësve të rinj në KLSH. Me punonjësit e rinj janë zhvilluar tema si, njohja e institucionit të KLSH, proceset e punës, standardet e kontrollit të KLSH, dokumentet dhe formularët standard të KLSH, llojet e auditimit, si dhe risku dhe materialiteti. Rezultatet e dobta të këtyre punonjësve të rinj në testin e fund-dhjetorit 2011 tregojnë se kjo punë ka qenë e dobët dhe e pamjaftueshme.

Për të pasur auditime sa më të mira dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, specialisti i metodologjisë ka shqyrtuar të gjithë auditimet financiare dhe të performances, duke kryer procesin e shqyrtimit,

analizën dhe dhënien e mendimeve, mbi këto auditime. Me anë të këtij procesi pune, është synuar rritja e cilësisë së raportimit, nëpërmjet dhënies së mendimeve mbi projektvendimet dhe raportet përfundimtare për auditimet financiare e të performancës. Gjithashtu, nëpërmjet ushtrimit të këtij procesi u është rekomanduar grupeve të auditimit se çfarë duhet të përmirësojnë, në kryerjen e procesit të auditimit, në mënyrën e raportimit dhe arritjen e standardeve të auditimit.

Nga analizimi i punës së deritanishme, krahas rezultateve, janë evidentuar dhe të meta dhe mangësi (disa trajtuar në kapitullin e trajnimeve) për të cilat kemi programuar masa përmirësuese. Ndër to, paraqesim:

Vlerësimin dhe redaktimin e standardeve të përkthyer gjatë vitit 2011 dhe konkretisht për:

a) Dhënien e opinioneve të pasqyrave financiare për institucionet buxhetore, dhe nëse ato janë të zbatueshme do të paraqiten për miratim te Kryetari, më pas do të përfshihen në manualin e auditimit financiar.

b) Hartimin dhe sigurimin e strukturës së raportimit me anë të dokumenteve dhe formularëve standard të nxjerra nga INTOSAI dhe EUROSAI.

Rishikimin e efikasitetit dhe efektivitetit të standardeve të brendshme dhe procedurave të KLSH.

V.2 Kontrolli i cilësisë dhe sigurimi i cilësisë në procesin kontrollues

Kontrolli i sigurimit të cilësisë, garanton zbatimin e standardeve profesionale dhe proceduriale të institucionit, evidenton dhe pasqyron praktikat më të mira të auditimit, synon të garantojë një përmirësim të vazhdueshëm të punës audituese, gjë që lë të kuptosh dhe të konfirmosh faktin se institucioni në procesin auditues zbaton standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare të auditimit. Pikërisht për këto arsye, sigurimi i cilësisë ka qenë dhe mbetet në vazhdimësi objektiv kryesor i veprimtarisë, i pasqyruar në Planin Strategjik të Zhvillimit 2009-2012 dhe në Programet afatmesme e vjetore të aktivitetit të KLSH.

▪ Konstatime të përgjithshme.

Për realizimin e objektivit kryesor të KLSH, kryerjen e auditimeve të një cilësie sa më të lartë, është thelbësore ekzistenca e një sistemi të menaxhimit të plotë të cilësisë, i cili të mbulojë të gjitha drejtimet e veprimtarisë së institucionit.

Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, si koncept i përgjithshëm përfshin:

- A.** Menaxhimin e cilësisë në nivel institucional;
- B.** Sistemin dhe procedurat e kontrollit të cilësisë (shqyrtime të “nxehta”);
- C.** Proçesin e sigurimit të cilësisë (shqyrtime të “ftohta”).

Niveli i ndjekjes dhe zbatimit nga hallkat përkatëse të institucionit të elementeve të mësipërm përbërës ka patur një ndikim të rëndësishëm në nivelin e realizuar në fakt të cilësisë të punës audituese, në zbatim të detyrimeve kushtetuese e ligjore të KLSH dhe standarteve përkatëse.

A. Menaxhimi i Cilësisë në nivel institucional

Duke patur parasysh elementët përbërës kryesorë të menaxhimit të cilësisë në nivel institucional (politika dhe strategjia e cilësisë, përkushtimi i drejtuesve, metodologjia, mbështetja me IT, menaxhimi i burimeve njerëzore, marrëdhëniet jashtë institucionale, etj.), KLSH i ka kushtuar vemendje këtyre elementëve, megjithatë, ekziston vazhdimisht nevoja për përpjekje më të mëdha në këtë drejtim dhe përsosjen e politikave, objektivave dhe instrumentave zbatues. Më konkretisht:

a) Edhe pse tashmë rregullat, manualët e udhëzimet, në mbështetje të proçesit të auditimit janë të hartuara, miratuara dhe në përdorim, duhet pasur parasysh që pjesa më e madhe e tyre i përkasin vitit 2005, dhe vetëm manualët e auditimit financiar e të performancës vitit 2009. *Pra, koha e konsiderueshme që ka kaluar dhe ndryshimet e politikave, ato ligjore dhe rregullatore në fushën e administrimit publik, tregojnë për tejkalim të vlerës dhe efektivitetit të këtyre dokumentave dhe manualeve. Edhe pse gjatë vitit 2011*

nuk ishte ende momenti që të ndërhyhej në këto dokumenta për shkak të pritjes së bërjes së ndryshimeve në Ligjin Organik të KLSH, gjithsesi mund të ishte filluar puna me analizën dhe studimin e nevojave. Sidoqoftë, kjo punë tashmë ka filluar, duke u shoqëruar edhe me plane konkrete veprimi, të pasqyruara në Programin e Veprimtarisë së KLSH për vitin 2012. Në fund të marsit do të përfundojë rishikimi i Rregullores së institucionit me një orientim të plotë drejt zbatimit të standardeve të përditësuara të INTOSAI.

b) Duke vlerësuar e konsideruar si faktor të rëndësishëm menaxhimin e drejtë dhe racional të burimeve njerëzore për sigurimin e cilësisë së punës audituese, si dhe duke patur parasysh faktin që politikat për burimet njerëzore, duhet të mbështesin mbajtjen dhe zhvillimin e një stafi të kualifikuar dhe kompetent, të aftë për të zbatuar planet e auditimit në mënyrë sa më të efektshme, nga ana e institucionit kërkohet që të ndiqen politika jo vetëm korrekte, por edhe efektive në drejtim të rekrutimit të personelit me kualifikim arsimor të duhur e në përgjithësi me eksperiencë, për të siguruar një staf të kualifikuar e cilësor, të disponueshëm në kohën e vendin e duhur, me aftësi të specializuara, me objektivin e vetëm kryerjen me cilësi e kompetencë të detyrës audituese.

Gjatë vitit 2011, në KLSH nuk janë bërë rekrutime me shpallje, me procedura konkurimi, por kanë qenë të punësuar 22 punonjës me kontrata të përkohshme pune pa afat ose me afat deri në 31.12.2011. Të gjithë këta punonjës, më datë 28.12.2011, iu nënshtruan një testimi të aftësisve profesionale, për të vlerësuar përshtatshmërinë ose jo të tyre për të vijuar marrëdhëniet e punës me KLSH. Testimi rezultoi në vlerësime të dobëta për 15 prej tyre. Ky fakt flet qartë se, rekrutimi jo mbi baza transparence dhe konkurrence, prodhon staf cilësisht të dobët, për pasojë dëmton në tërësi punën e institucionit, pasi duke qenë natyra e punës audituese, punë në ekip, mangësitë e këtij stafi rrezikojnë të kompromentojnë edhe cilësinë e punës së stafit ekzistues. Duke filluar nga 1 Janari 2012, procedurat për plotësimin e

vendeve të lira, kanë filluar të shpallen rregullisht dhe rekrutimi të realizohet nëpërmjet konkurimit me anë të testimit të njohurive dhe përzgjedhjes mbi kritere objektive.

c) Evidentimi i aftësive profesionale për çdo kontrollor nga ana e Departamenteve të Kontrollit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë, i cili realizohet çdo fund viti, i shërben programimit të nevojave për trajnim të kontrollorëve brenda institucionit, gjë që është parashikuar edhe si objektiv i rëndësishëm në Planin Strategjik të Zhvillimit të KLSH për periudhën 2009 - 2012, mbi bazën e të cilit është hartuar e zbatuar edhe programi i trajnimeve për vitin 2011.

Edhe pse që në vitin 2007, me Urdhër të Kryetarit të KLSH, Drejtorët e Departamenteve të Kontrollit, janë urdhëruar që për çdo dosje kontrolli të plotësojnë formularin e cilësisë ku të evidentohen në detaje për çdo kontrollor vlerësimet përkatëse, rezulton se ky formular nuk plotësohet. Në këtë mënyrë, *vlerësimi në fund të vitit për çdo kontrollor nuk mbështetet në vlerësimet individuale për çdo punë të realizuar.*

d) Në vazhdimësi dhe gjatë vitit 2011, KLSH është përballur me një situatë ku nevojat për auditime që duhet të kryejë tejkalojnë mundësitë (që kanë të bëjnë me burimet njerëzore e materiale që ka në dispozicion). Duke marrë në konsideratë këtë fakt, për të arritur një nivel sa më të lartë të sigurimit të cilësisë, i është kushtuar rëndësi shfrytëzimit racional të burimeve në dispozicion, duke programuar e kryer auditime në subjekte të prioritetit më të lartë. Në hartimin e programit të auditimit për vitin 2011, janë patur parasysh realizimi i objektivave të vendosura në Planin Strategjik të Zhvillimit të KLSH për vitet 2009-2012, për auditimin e subjekteve dhe programeve publike në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të përshtatura nga KLSH dhe praktikat e mira Europiane, për t'i siguruar Kuvendit, grupeve të interesit dhe publikut të gjërë informacion sa më të plotë mbi përdorimin e fondeve publike. Ne mendojmë që stafi i KLSH duhet të shtohet dhe për këtë do t'i

paraqesim shumë shpejt Komisionit për Ekonominë dhe Financat një studim të plotë për kërkesat dhe nevojat tona.

Në kuadrin e menaxhimit institucional, rëndësi i duhet kushtuar zhvillimit të marrëdhënieve ndër-institucionale të KLSH, si me Kuvendin dhe Komisionet e tij, me publikun dhe median etj. Vlen të theksohet se, në këtë drejtim, *ka vend për më shumë ndërveprim, sidomos mes KLSH dhe Kuvendit e Komisioneve të tij.*

B. Sistemi dhe procedurat e Kontrollit të Cilësisë (shqyrtime të “nxehta”).

KLSH ka vendosur politika, sisteme dhe procedura që inkurarojnë veprime të cilat çojnë në një cilësi më të lartë auditimi dhe parandalojnë veprimet që mund të çenojnë cilësinë.

Këtij qëllimi i ka shërbyer përcaktimi në rregulloret dhe manualët e hartuara, të detyrave e përgjegjësive të hallkave përkatëse, në të cilat kalojnë për shqyrtim, vlerësim e mendim materialet e auditimit, duke filluar nga kontrollorët, përgjegjësat e grupeve, kryekontrollorët, drejtorët e departamenteve të kontrollit, Drejtoria Juridike dhe e Kontrollit të Cilësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm, përpara se të merret vendimi përkatës nga Kryetari për miratimin e raportit dhe rekomandimeve përkatëse për subjektin e audituar. Tërë kjo procedurë është e dokumentuar në të gjitha fazat e auditimit dhe është pjesë përbërëse e dokumenteve të auditimit në dosjen përkatëse.

Ka ardhur koha që skema, procedurat dhe hallkat e përfshira në kontrollin e cilësisë të rishikohen, të pasurohen dhe të përshtaten me dinamikën e institucionit, pasi skemat dhe procedurat aktuale datojnë që nga viti 2005 dhe një rishikim i skemës do prodhonte cilësi të shtuar.

C. Proçesi i Sigurimit të Cilësisë (shqyrtime të “ftohta”).

Ky është një proçes që kryhet brënda institucionit për t’u siguruar që: janë kryer auditimet e nevojshme, që ato janë zhvilluar siç duhet, janë përcaktuar rrugët e mundshme të fuqizimit të auditimit, si dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e punës në të ardhmen. Për këtë qëllim KLSH ka adoptuar

politika dhe procedura, për të rishikuar efikasitetin dhe efektivitetin e standardeve dhe procedurave të brendshme të kontrollit të cilësisë.

Kjo procedurë e kryer nga struktura e veçantë brenda institucionit e ngritur për këtë qëllim, pas evadimit e arkivimit të dosjeve të auditimeve, në zbatim të urdhërave të brendshme, standardeve të kontrollit të KLSH dhe rekomandimeve të SIGMA^s, ka shqyrtuar realizimin e sigurimit të cilësisë të një numri të caktuar të auditimeve, për të verifikuar nëse ato politika, strategji e rregulla të përcaktuara në rregulloret e brendshme, standardet e manualit e auditimit janë zbatuar me rigorozitet në të gjitha fazat që kanë të bëjnë me programimin, zbatimin dhe raportimin e punës audituese.

Puna për shqyrtimin e auditimeve përsa i përket sigurimit të cilësisë, bëhet sipas urdhërit të brendshëm të Kryetarit të KLSH-së, bazuar në kërkesat e formularit tip të miratuar për këtë qëllim.

Veç kërkesave të përcaktuara në formularin e miratuar nga Kryetari i KLSH, gjatë shqyrtimit të auditimeve për sigurimin e cilësisë, grupi i është referuar kërkesave të përcaktuara në manualin dhe formularët e hartuar në bashkëpunim me specialistet e projektit të binjakëzimit.

Për auditimet financiare të cilat gjejnë pasqyrim në Manualin e Auditimit Financiar të vitit 2009, shqyrtimi i tyre për sigurimin e cilësisë u bë duke koordinuar kërkesat e formularit të miratuar me urdhërin e brendshëm të Kryetarit të KLSH nr. 6, datë 15.01.2007 dhe ato të listës verifikuese për rishikimin e cilësisë (shtojca A) të hartuar në bashkëpunim me specialistët e projektit dhe të miratuar me shkresën nr.702 datë 21.11.2008. Lista verifikuese përmban disa elementë të rinj për rishikimin e cilësisë, të parashikuar këto edhe në Manualin e Auditimit Financiar për të gjitha fazat e auditimit (programim, zbatim dhe raportim të punës audituese) që kanë të bëjnë kryesisht me:

- Vlerësimin e riskut dhe përcaktimin e materialitetit.
- Identifikimin e sistemeve dhe testimin e kontrolleve kyçe.

- Dokumentimin e punës dhe rishikimin e letrave të punës.
- Dokumentimi i kontakteve kyçe me subjektin.
- Vlerësimin e auditimit të brendshëm, marrjen në konsideratë të rezultateve të tij.
- Rishikimin e sistemeve të kontabilitetit.
- Adresimin e çështjeve të dala nga auditimi i mëparshëm.
- Kontrollin e pasqyrave financiare.
- Krahasimin e gabimeve me nivelin e materialitetit të llogaritur.
- Dokumentimin e gjithë takimeve të grupit me subjektin gjatë gjithë auditimit etj.

▪ Zbulimet e konkluzionet e shqyrtimit (“të ftohtë”).

Shqyrtimi për sigurimin e cilësisë për vitin 2011, si çdo vit, u krye në zbatim të urdhërit të brendshëm të Kryetarit nr.10, datë 23.01.2012, ku u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme 16 dosje auditimi, rreth 10% e auditimeve të kryera gjatë këtij viti (të evaduara dhe të arkivuara) nga të gjithë departamentet e kontrollit.

Në ndryshim nga praktika e viteve të kaluara, ku shqyrtimi për sigurimin e cilësisë kryhej nga një specialist i vetëm i Drejtorisë, këtë vit sipas urdhërit të brendshëm u angazhua grup specialistësh nga çdo departament, nën mbikëqyrjen e specialistit përkatës të Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë. Secili nga specialistët e grupit shqyrtoi dosje që nuk i përkasin departamentit të tyre, në mënyrë që të jepej një opinion sa më i pavarur dhe objektiv.

Referuar konstatimeve të dala nga shqyrtimi i dosjeve të auditimit, të cilat paraprakisht janë diskutuar me përgjegjësat e grupeve dhe drejtorët e departamenteve përkatëse, rezulton se krahas punës së bërë dhe rezultateve të arritura në drejtim të sigurimit të cilësisë, në procesin e programimit, zbatimit dhe raportimit të përfundimeve të auditimeve, u konstatuan edhe disa

të meta e mangësi në zbatim të kërkesave të përcaktuara në rregulloren e brëndshme, standardet e kontrollit dhe manualet e auditimit, ndaj të cilave kërkohet të reflektohet me masa konkrete tekniko-administrative të qëndrueshme, mbasi influencojnë në arritjen e një niveli më të lartë të sigurimit të cilësisë në të gjithë veprimtarinë e KLSH.

Në mënyrë të përmbledhur konkluzionet e shqyrtimit janë:

1. Duke patur parasysh kërkesat për auditim dhe mundësitë që ka KLSH përsa i përket burimeve njerëzore e materiale, duhet të ishte treguar një kujdes më i madh në përzgjedhjen e auditimeve të prioritetit më të lartë, duke përdorur për këtë qëllim argumente më të plota, kërkesë kjo e parashikuar në nenin 19.1.1 të rregullores së brendshme dhe pikave 2.1.3 dhe 3.1 të standardeve të kontrollit. Mangësi kjo e konstatuar në 4 auditime, si Ndërtimi i Spitalit Kavajë, DPT, Dega e Doganës Durrës dhe Drejtoria e Tarifave e Taksave në Bashkinë Durrës.

2. Shkurtimi i afatit të auditimit dhe përdorimi sa më racional i burimeve njerëzore e materiale. Në nenin 19.2.3 të rregullores së brendshme është parashikuar njoftimi i subjektit 2 javë para fillimit të kontrollit, që ka për qëllim vënien në dispozicion të dokumentacionit për marrjen e informacionit paraprak, sigurimin e ambienteve e paisjeve për një punë normale të kontrollorëve, si dhe kërkesa të tjera në vartësi të specifikave dhe natyrës së auditimit apo subjektit. Në 12 nga 16 dosje të shqyrtuara rezulton se kjo kërkesë nuk është zbatuar, pasi data e njoftimit përputhet me datën e programit të paraqitur në subjekt për fillim auditimi.

3. Shmangia e konfliktit të interesit dhe rritja e efektivitetit të punës të ekspertëve të jashtëm të aktivizuar me kontratë. Në zbatim të pikës 3.2.1. dhe 3.5 të standardeve të kontrollit, me urdhërin e brendshëm nr. 16, datë 23.04.2008, është miratuar dokumenti 2.1, i cili duhet të plotësohet para fillimit të auditimit nga grupi i kontrollorve dhe ekspertëve të jashtëm të aktivizuar në auditim. Gjatë shqyrtimit të dosjeve rezultoi se ky dokument nuk është

plotësuar për 5 nga 16 auditimet e shqyrtuara, respektivisht DPT, Dega e Doganës Durrës, Drejtoria e Tarifave e Taksave në Bashkinë Durrës, Dega e Doganës Lezhë dhe Bashkia Pogradec.

4. Në zgjedhjen e teknikave për grumbullimin e provave dhe evidencës së auditimit, kontrollorët janë përqëndruar kryesisht në dokumente si procesverbale dhe aktverifikime, duke mos përdorur teknika të tjera si: inspektimi, vëzhgimi, intervista dhe konfirmimi etj., të parashikuara në pikën 3.9.14 të standardeve të kontrollit. Vërejtje të kësaj natyre u konstatuan në 7 auditime nga 16 të shqyrtuara si Posta Sqiptare Sh.a., Ndertimi i Spitalit Kavajë, Albpetrol Sh.a, Bashkia Fier, Komuna Prezë, Bashkia Pogradec dhe Dega e Doganës Lezhë.

5. Drejtuesit e departamenteve gjatë shqyrtimit të auditimeve në të gjitha fazat e zhvillimit të tyre, duhet të kërkojnë me rigorozitet zbatimin e afateve, pasi respektimi i tyre gjatë kryerjes së auditimeve sipas programeve të miratuara dhe çdo ndryshim i tyre bëhet me miratim të Kryetarit si një detyrim ligjor institucional i përcaktuar në nenin 19.1 të rregullores së brendshme dhe pikës 3.5 të standardeve të kontrollit. Drejtuesit e departamenteve të kontrollit mbajnë përgjegjësi për zbatimin e afateve të programuara dhe çdo ndryshim në afatin e kryerjes së auditimit duhet të shoqërohet me kërkesë me shkrim dhe miratim nga Kryetari. Në 10 auditime nga 16 të shqyrtuara u konstatuan tejkalime afatesh në procedurat e evadimit, të përgatitjes së projektraportit dhe raportit përfundimtar, për të cilët në dosje nuk jepen sqarime apo kërkesë për shtyrje afati të evadimit. Ndër to veçojmë, tejkalimin e afateve në auditimin e subjekteve; Bashkia Fier me rreth 4 muaj vonesë; Dega e Doganës Durrës afro 8 muaj (jashtë çdo lloj parashikimi), dhe Drejtoria e Tarifave e Taksave Vendore në Bashkinë Durrës ku auditimi ka zgjatur rreth 5 muaj.

6. Konstatohet një praktikë pune që ka të bëjë me dorëzimin e procesverbeleve e aktverifikimeve të hartuara, në zyrat e protokollit të subjekteve në 2-3 ditët e fundit të përfundimit të afatit të qëndrimit në subjekt

të kontrollorëve, apo pas përfundimit të afatit të përcaktuar në program, dhe jo dora dorës gjatë periudhës së auditimit, për t'i dhënë mundësi personave të atakuar dhe që janë në marrëdhënie pune për t'u ballafaquar dhe shprehur objeksionet gjatë periudhës së auditimit. Nga aplikimi i kësaj praktike, përgjithësisht në dosjet e auditimit këto dokumente arkivohen vetëm me shënimet e numrave të protokollit dhe firmat e kontrollorëve, por pa firmat e personave të atakuar, ku jo të gjithë bëjnë observacione. Madje, në shumicën e rasteve nuk ka një konfirmim nga zyrat e protokollit për dorëzimin e këtyre dokumenteve ose vënien në dijeni të personave përkatës, për të shmangur ndonjë pretendim për mosmarrje dijeni për përmbajtjen e këtyre dokumenteve dhe shmangie ndaj përgjegjësisë të personave të atakuar.

Mangësi të kësaj natyre, në kundërshtim me rregulloren e brendshme u konstatuan në 12 auditime nga 16 të shqyrtuara, dhe ndër to veçojmë auditimet e kryera në subjektet: Dega e Doganës Durrës, Drejtoria e Tarifave e Taksave Durrës dhe Dega e Doganës Lezhë, ku rezulton se procesverbalet e aktverifikimet janë dorëzuar në zyrat e protokollit të subjekteve një muaj pas përfundimit të auditimit në subjekt.

7. Krahas punës së bërë nga grupet e kontrollit, përsëri vërehen të meta e mangësi në trajtimin e problemeve që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe vlerësimin e observacioneve, shpjegimeve të subjektit, dokumentimin e rezultateve të takimeve ballafaquese me subjektin e kontrollit dhe pasqyrimin e tyre në raportin përfundimtar, kërkesa këto të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 6 të ligjit organik të KLSH, nenet 20.2.c.8 dhe 20.2.d.1,4 të rregullores së brendshme dhe në pikën 4.2.2 të standardeve të kontrollit.

Në dosjet e shqyrtuara, në raportet përfundimtare të auditimit nuk jepen sqarimet e plota për observacionet e bëra, dhe ndonëse nga kontrollorët e drejtuesit e departamenteve pretendohet se takimet ballafaquese janë bërë, nuk rezulton të jenë dokumentuar në dosje këto ballafaqime me subjektin për problemet e trajtuara në raport, gjë që do të rriste sigurinë e besueshmërinë e

konkluzioneve dhe rekomandimeve të kontrollit, si dhe eliminimin e observacioneve të panevojshme pas dërgimit të raportit përfundimtar në subjekt.

Për t'i dhënë siguri subjektit të audituar se, observacionet e tij janë shqyrtuar konformë procedurave të KLSH, nuk mjafton përgjigja standarde që ndeshet shpesh në raportet përfundimtar të kontrollit të llojit *“observacionet nuk kanë bazë ligjore dhe si të tilla nuk merren në konsideratë”*, por kontrollorët duhet të përshkruajnë shkurt thelbin e përmbajtjes së observacionit dhe të argumentojnë me dispozita ligjore pse nuk merren në konsideratë, gjë që do të përforconte konkluzionin e kontrollorëve për shkeljet e konstatuara.

Rëndësia dhe domosdoshmëria e ballafaqimit është parashikuar dhe në nenin 19.3, pika 4, të rregullores së brendshme, ku grupi i kontrollit gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese për parregullsitë e shkeljet ligjore është i detyruar të bëjë ballafaqimin me të gjithë personat përgjegjës të subjektit të kontrolluar. Por, një gjë e tillë rezultoi e pazbatuar në 9 praktika nga 16 të shqyrtuara.

8. Menaxhimi racional kërkon që burimet njerëzore të vlerësohen në mënyrë të atillë që, në kontroll krahas numrit të përshtatshëm të caktohet edhe stafi me aftësitë e arsimit dhe me eksperiencë, në mënyrë që cilësia e aftësive të grupit t'i përgjigjet kompleksitetit të kontrollit, kërkesa këto të përcaktuara në pikat 2.1.1, 2.2.3 dhe 2.2.4.1 të standardeve të kontrollit. Në 4 auditime nga 16 të shqyrtuara këto kërkesa nuk janë vlerësuar me kujdesin e duhur, kështu: në Albpetrol sha. në përbërjen e grupit kishte një kontrollor me eksperiencë dhe dy me kontratë; në MPJ kishte numër të pakët në krahasim me problematiken dhe riskun që mbart; në Gjykatën Kushtetuese dhe në Kuvendin e Shqipërisë, numër të shumtë në krahasim me nivelin e materialitetit dhe volumin e veprimtarisë.

9. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve e parashikuar në nenin 20.2.h të rregullores së brendshme, kërkon që ky proces të bëhet në mënyrë të pandërprerë gjatë gjithë vitit nga departamentet e kontrollit, pavarësisht se

kontrolli i zbatimit të rekomandimeve organizohet në fund të vitit. Në dy auditime të shqyrtuara që i përkasin Komunës Prezë dhe Bashkisë Pogradec rezulton se, subjektet nuk janë përgjigjur për zbatimin e rekomandimeve edhe pse kanë kaluar afatet e përcaktuara në nenin 16, paragrafi 3 të ligjit organik të KLSH dhe nenin 20.2.h.2 të rregullores së brendshme. Në këto kushte nga ana e departamenteve duhet të ishte përsëritur kërkesa, deri në marrjen e përgjigjes.

10. Kërkesat e përcaktuara në nenin 16, paragrafi 3 të Ligjit Organik të KLSH dhe nenit 20.2.a.4 e 20.2.a.11 të rregullores së brendshme, nuk janë vlerësuar në shkallën e duhur nga kontrollorët dhe drejtuesit e departamentit për rastet e konstatimit të shkeljeve dhe përcaktimit të masës së shpërblimit të dëmit dhe të përgjegjësisë të personave përkatës. Nga shqyrtimi i dosjeve të kontrollit në Degën e Doganës Durrës dhe Degën e Doganës Lezhë, rezulton se, duke krahasuar shkallën e gjetjeve për shkelje të ligjit, si dhe masën e shpërblimit të dëmit lënë subjektit të kontrolluar, në projektvendim dhe në vendim nuk janë propozuar masat e duhura ndaj personave shkaktarë përgjegjës.

▪ **Rekomandime për përmirësim.**

Duke vlerësuar performancën e arritur në drejtim të përmirësimit të sigurimit të cilësisë së punës audituese dhe duke reflektuar ndaj të metave e mangësive të vërejtura gjatë shqyrtimit të dosjeve të auditimit për kontrollin e sigurimit të cilësisë, për përmirësimin e punës kemi përcaktuar këto detyra:

1. Konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të sigurimit të cilësisë drejtuesit e departamenteve të kontrollit t'i trajtojnë në analizat periodike të punës së departamenteve dhe të mbahen parasysh në vlerësimin e kontrollorëve.
2. Kontrolli për sigurimin e cilësisë të mos përqëndrohet në një numër të kufizuar dosjesh kontrolli në fund të vitit, por të jetë një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit për dosjet e evaduar dhe të arkivuara, ku të shqyrtohen sa më shumë dosje, duke marrë në konsideratë dhe kontrollet që kanë të bëjnë me zbatimin e rekomandimeve të kontrollit, pasi nëpërmjet këtyre verifikohet

drejtësia e konkluzioneve dhe rekomandimeve të kontrollit, tregues këto të cilësisë dhe efektivitetit të punës kontrolluese.

3. Të rishikohen, të pasurohen dhe të përshtaten me dinamikën e institucionit, skema, procedurat dhe hallkat e përfshira në kontrollin e cilësisë, pasi ato datojnë që nga viti 2005. Gjithashtu, fuqizimi i disa hallkave të kontrollit të cilësisë, veçanërisht brenda Departamenteve të Kontrollit.

4. Për tipet e auditimeve që do të kryejë KLSH, të hartohet një politikë e posaçme për trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të kontrollorëve ekzistues, brenda apo jashtë institucionit dhe në varësi të mundësive, gjithashtu, për marrjen e kontrollorëve të rinj në punë me aftësitë e duhura profesionale. Prioritet, dhe brënda mundësive financiare të institucionit, të jetë programimi dhe realizimi i trajnimeve me ekspert të jashtëm për programet “Financa 5”, “Alpha”, programe të doganave, të tatimeve, të thesarit etj.

Prioritare mbetet detyra për trajnimin e kontrollorëve për përvetësimin dhe zbatimin në praktikë të kërkesave të manualeve të auditimit financiar e të performancës, përfshirë materialet për auditimin dhe dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare. Në këto trajnime të tërhiqen edhe mendime që kanë të bëjnë me përmirësimet e mundëshme që i duhet bërë dokumentacionit dhe praktikave të punës në të gjitha fazat e auditimit.

6. Për të shmangur çdo lloj hamendësimi apo pretendimi për qëndrime subjektive, apo shfaqjen e ndonjë konflikti të interesit, si dhe vështirësitë që mund t'i lindin një kontrollori të vetëm në ballafaqim me shumë persona njëherësh të atakuar në procesverbalet apo aktverifikimet e hartuara, në kuadër të rishikimit të rregullores së brendshme të institucionit, të përcaktohet numri minimal i kontrollorëve pjesëmarrës në hartimin e dokumenteve bazë të auditimit, të cilët janë përcaktues në trajtimin e shkeljeve, nxjerrjen e konkluzioneve, përgatitjen e raportit dhe të rekomandimeve.

7. Njëkohësisht me zbatimin rigoroz të kërkesave të rregullores për mbajtjen dhe hartimin e procesverbaleve dhe aktverifikimeve, në varësi të rrethanave të

përdoren dhe letra të tjera pune, siç mund të jenë: protokolle takimesh, intervista, pyetësorë, vëzhgime fizike të zbardhura në fotografi etj., gjë që do të dëshmonte dhe për larmi të metodave e teknikave të përdorura gjatë kryerjes së auditimeve.

8. Kujdes i veçantë nga punonjësit e veprimtarisë kontrolluese t'i kushtohet trajtimit të observacioneve, sidomos nga përgjegjësat e grupeve të kontrollit të cilët detyrimisht në raportin përfundimtar të kontrollit duhet të përfshijnë observacionet dhe qëndrimin e mbajtur ndaj tyre.

9. Kontrollorët për çdo veprim dhe aktivitet të tyre gjatë procesit të kontrollit, krahas dokumentimit të zbulimeve, rëndësi t'i kushtojnë inventarizimit të të gjitha praktikave dokumentare që verifikohen, si dhe zbardhjes dokumentare të takimit prezantues, takimit përmbyllës, apo çdo takimi tjetër për ballafaqimin e zbulimeve me subjektin.

10. Për të përmirësuar cilësinë e kontrolleve, impaktet e punës kontrolluese dhe rritjen e reputacionit të KLSH, të bëhet praktikë pune dërgimi i pyetësorëve drejtuesve të subjekteve të kontrolluara, ku të tërheqim pikëpamjet e tyre lidhur me punën dhe qëndrimin e grupeve të kontrollit, profesionalizmin e tyre, çështjet thelbësore etj.

VI.1 Programimi i kontrolleve dhe realizimi i tij

Për vitin 2011, veprimtaria kontrolluese e KLSH^{së} është bazuar në planifikimin strategjik të kontrolleve të përcaktuara për këtë vit. Krahas tyre, objekt kontrolli kanë qenë edhe subjekte të tjerë jashtë këtij planifikimi, por të përzgjedhur nga lista e subjekteve fakultativë të parashikuar për vitin 2011, apo duke marrë shkas dhe bazuar në të dhënat apo informacionet e ndryshme të dërguar nga institucionet më të larta të shtetit, subjekte të ndryshëm juridikë, shtetërore apo private, si dhe artikujt problemor të botuar në shtypin e përditshëm apo të pasqyruar në median elektronike.

Në planifikimin e subjekteve objekt kontrolli dhe parashikimin e tematikave të kontrollit, çdo fund viti, gjatë procesit të studimit dhe përgatitjes së programit të

kontrollit, KLSH i ka dhënë prioritet ushtrimit të kontrollit në ato subjekte për të cilët ka detyrim kushtetues dhe ligjor dhe që përdorin fonde të buxhetit të shtetit në vlera të mëdha, apo subjekte që kanë shkallë të lartë materialiteti dhe që rrit riskun.

Strategjia e planifikimit të kontrolleve, përfshin një set dokumentesh, në të cilat përfshihen dhe një sërë kriteresh, ndër të cilët pasqyrojmë:

- Rëndësinë që kanë subjektet dhe çështjet që duhen kontrolluar.
- Analizën dhe vlerësimin e materialitetit e të riskut.
- Rezultatet përfundimtarë të kontrolleve të ushtruar më parë.
- Rekomandimet e dërguara subjekteve të kontrolluar dhe nivelin e zbatimit të tyre.
- Mjetet financiare, bazën materiale dhe burimet njerëzore.
- Faktorë të tjerë, përfshirë informacione dhe të dhëna që sigurohen nga jashtë KLSH^{së} etj.

Lidhur me tematikën e kontrolleve, secili grup kontrolli, për çdo subjekt kontrolli, pas grumbullimit të të gjitha të dhënave dhe informacioneve për subjektin respektiv objekt kontrolli, bën shqyrtimin e hollësishëm të tyre dhe në përfundim harton programin e kontrollit, duke parashikuar në të, të gjitha kërkesat e përcaktuara në aktet e nxjerra nga Kryetari i KLSH^{së} për hartimin e tij, më konkretisht: - standardet e kontrollit të KLSH^{së}, rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH^{së}, dokumentet dhe formularët standard të kontrollit dhe ndonjë tjetër.

Në ushtrimin e veprimtarisë kontrolluese, *proces i zhvillimit të kontrollit* ka rëndësi parësore. Në këtë proces, vëmendja dhe përgjegjëshmëria e kontrollorëve përqëndrohet në kryerjen e kontrollit me cilësi të lartë, në rrugë ekonomike dhe efektive, si dhe në kohën e duhur sipas përcaktimit në programin e kontrollit.

Gjatë zhvillimit të kontrollit, ndër çështjet e programuara, rëndësi të veçantë merr puna që duhet bërë nga kontrollorët e KLSH^{së}, për kryerjen e

veprimtarisë për periudhën objekt kontrolli nga subjekti i kontrolluar dhe ballafaqimin e kësaj veprimtarie me dispozitat ligjore, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi. Për këtë, kontrollorët caktojnë hapat dhe procedurat e kontrollit, për të patur sigurinë e pranueshme në zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimeve të paligjshme, të cilat mund të kenë efekte direkte, madje dhe materiale mbi treguesit financiarë ose rezultatet përfundimtare.

Megjithë përpjekjet e stafit për të realizuar planin e auditimeve dhe detyrat e marra përsipër në sasi, jemi të ndërgjegjshëm se cilësia e punës ka lënë për të dëshiruar. Audituesit në jo pak raste janë mjaftuar me dokumentacionet e ofruara nga subjektet e kontrolluara dhe ka munguar vullneti ose aftësia profesionale në zbulim të mashtrimit financiar dhe korrupsionit. Kontrollat më tepër janë kryer formale dhe sa për të plotësuar numrin. Kjo është dhe arsyeja kryesore e një numri shumë të ulët të kallzimeve penale për vitin e kaluar, numër i cili duhet theksuar se në vijimësi ka qenë i ulët gjatë viteve të fundit.

VI.2 Llojet e kontrolleve dhe struktura e subjekteve të kontrolluar

Detyrat e programuara të kontrollit për vitin 2011 në numër, janë realizuar dhe tejkaluar. Nga 150 kontrole të planifikuara për evadim, janë përfunduar dhe evaduar gjithsej 152 kontrole, nga të cilat:

1.	Kontrolle të ligjshmërisë, rregullshmërisë e vlerësues	74
2.	Kontrolle të ligjshmërinë dhe rregullshmërinë	58
3.	Auditime financiare	9
4.	Auditim pilot, çertifikim të llogarive	1
5.	Auditime performance	1
6.	Kontrolle vlerësues	4
7.	Kontrolle tematikë	5

Gjithashtu, ndonëse në numër, kontrollet janë realizuar dhe tejkaluar, në strukturë ato nuk janë realizuar sipas programit të veprimtarisë të miratuar në fillim të vitit 2011. Më konkretisht, auditimet financiare nga 15 të programuar, nga të cilat 2 kontrole për çertifikimin e llogarive, janë realizuar 10; po kështu auditimet e performancës nga 5 të programuar është realizuar vetëm 1. Vlen të theksohet se, mosrealizimi i detyrave të programuara për auditimet financiare dhe të performancës është njëra anë, ana tjetër dhe më e rëndësishmja është cilësia e përgatitjes së tyre, konformë kërkesave të përcaktuara në manualet e këtyre dy auditimeve. Duhet pasqyruar se, veçarërisht auditimet e performancës nuk janë ushtruar dhe përgatitur sipas kërkesave të Manualit përkatës.

Sipas natyrës së subjekteve të kontrolluar rezulton:

1.	Ministri dhe institucione qendrore	39
2.	Institucione të administratës së qeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	62
3.	Drejtori dhe degë të tatimtaksave e të doganave	17
4.	Institucione financiare dhe shoqëri anonime	15
5.	Njësi dhe projekte me financime të huaja	9
6.	Subjekte të mbrojtjes së mjedisit	5
7.	Subjekte të administrimit dhe regjistrimit të pronës	5

Struktura e kontrolleve të evaduar gjatë vitit 2011, sipas subjekteve të kontrolluar, paraqitet në aneksin nr. 2, bashkëlidhur këtij raporti.

VI.3 Gjetjet kryesore sipas fushave apo sektorëve dhe departamenteve të kontrollit.

Në përfundim të kontrolleve të ushtruar gjatë vitit 2011, kontrollorët kanë zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm efektiv të përgjithshëm në shumën totale prej 7,027,566 mijë lekë. Nga kjo vlerë dëmi ekonomik e evidentuar, KLSH ka rekomanduar shpërblimin e tij në masën 100%.

Ky dëm efektiv i përket veprimtarisë ekonomiko-financiare të ushtruar në periudhën kohore 2008-2011, periudhë e cila është cilësuar në programet respektive të kontrollit të çdo subjekti të kontrolluar.

A. Sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar dhe evidentuar dëmet ekonomike, rezulton:

Në mijë/lekë

A.1	Në fushën e shitjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore	352,232
A.2	Në fushën e prokurimeve publike	210,324
A.3	Në sektorin doganor	184,104
A.4	Në fushën e shpërblimeve	149,359
A.5	Në fushën e urbanistikës	87,663
A.6	Në sektorin e tatimtaksave	49,052
A.7	Në fushën e sistemit të pagave	36,614
A.8	Në fushën e shpenzimeve operative	25,087
A.9	Mungesë materiale	55
A.10	Në fusha dhe sektorë të tjerë	5,933,076

Në vlerën totale të dëmit ekonomik, peshën dërmuese me *rreth 83.4%* e zenë dëmet e evidentuara në dy shoqëri anonime, përkatësisht *Albpetrol sh.a. Fier në vlerën 3,936,800 mijë lekë* (shkaktuar nga moslikujdimi i detyrimeve prej 3,578,690 mijë lekë të rrjedhura nga furnizimi me naftë bruto, gaz natyror dhe hollues deri më datë 31.12.2010 nga kompania ARMO sh.a (ARMO Oil) dhe 358,110 mijë lekë nga moslikujdimi në afat i faturave të shitjes së naftës po nga kjo kompani) dhe *Operatori i Sistemit të Trasmetimit të Energjisë Tiranë në vlerën 1,924,209 mijë lekë* (moslikujdim i shërbimit të kryer për transmetimin e energjisë elektrike për periudhën nga privatizimi i OSSH deri më 15.12.2010), ***gjithsej 5,861,009 mijë lekë.***

Në mënyrë të detajuar, sipas emërimit të subjektit ku janë evidentuar dëmet ekonomike, zërave të tyre (në të ardhurat dhe shpenzimet), si dhe vlerave respektive për çdo zë dhe subjekt paraqiten në aneksin nr. 3, bashkëlidhur këtij raporti.

B. Sipas departamenteve të kontrollit, vlera e shkeljeve financiare me dëm ekonomik paraqitet, si më poshtë:

Në mijë/lekë

B.1	Departamenti i Kontrollit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike e Mbrojtjes së Mjedisit	6,094,587
B.2	Departamenti i Kontrollit të Buxhetit Qëndror, të Institucioneve të Administratës së Lartë Publike dhe Mbikëqyrjes së Auditimit të Brendshëm	420,478
B.3	Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Publike	327,227
B.4	Departamenti i Kontrollit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit	185,274

B.1 *Departamenti i Kontrollit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Mbrojtjes së Mjedisit.*

Gjatë vitit 2011, ky Departament ka kryer, përfunduar dhe evaduar 29 kontrolle nga 31 të programuara, nga të ciat:

- 9 në Projektet me financime të huaja të zbatuara në fushën e ndërtimit, të shëndetësisë dhe arsimit, furnizimit me ujë e të kanalizimeve, në fushën e energjitikës, të shërbimeve sociale e bujqësore etj.
- 15 kontrolle në shoqëritë publike;
- 5 kontrolle në entet që operojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Klasifikuar sipas *Ilojit të kontrolleve*, 26 kanë qenë të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare; 1 auditim performance sipas praktikës së auditimit të Gjykatës së Auditimit të Holandës, 1 auditim për çertifikimin e llogarive (pasqrave financiare) sipas praktikës së auditimit të NAO të Britanisë së Madhe dhe 1 kontroll tematik.

Auditimi i performancës është kryer në Ministrinë e Shëndetësisë “Për performancën në menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve spitalore në sistemin e

shëndetësisë”, ku në përfundim të auditimit ka rezultuar, një kuadër ligjor jo i plotë për menaxhimin e mbetjeve spitalore; mungesë e strukturave përkatëse për menaxhimin e mbetjeve dhe e Planit të Administrimit të tyre; mungesë e pjesshme e bashkëveprimit ndër/institucional ndërmjet MSH dhe MMPAU me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit; moshartimi nga MSH i strategjisë, planeve operative vjetore dhe rregullores tip për administrimin e mbetjeve spitalore sipas tipologjisë së gjenerimit të mbetjeve; mungesë e të dhënave për subjekte të sektorit privat shëndetësor si klinikat mjekësore, farmacitë e klinikat dentare, si dhe për subjekte jashtë sistemit shëndetësor, të cilat prodhojnë mbetje spitalore; moszbatimi dhe mosrespektimi i kërkesave të rregullores nr. 6, datë 30.11.2007 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”; kontratat e shërbimit nga institucionet shëndetësore të audituar në përgjithësi ishin lidhur me subjekte të palicencuar për trajtimin e mbetjeve spitalore; për impiantet e djegies së mbetjeve spitalore në shfrytëzim nuk kishte studime mbi ndikimin e tyre në mjedis, madje nuk ishin të miratuara për shfrytëzim nga MMPAU. Përgjithësisht, mbetjet spitalore trajtohen njësoj si mbetjet urbane dhe në fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit nuk ka zë të veçantë për trajtimin e tyre. Gjithashtu, në institucionet e audituar u konstatua se mungonte analiza e kostos për trajtimin e mbetjeve spitalore deri në asgjësimin e tyre dhe nga MSH nuk është marrë asnjëherë në analizë menaxhimi i tyre.

Kurse, auditimi për çertifikimin e llogarive (mbi vlerësimin e parimeve të përdorura për kontabilitetin dhe çmuarjet e bëra nga menaxhimi, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare) realizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetës Kanalizimeve, Tiranë në projektin me financim të huaj: “*Menaxhimi i Integruar i Ujërave dhe Ekosistemit*”, sipas opinionit të kontrollorëve të KLSH, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Projektit, të fondeve të marra dhe të shpenzimeve të paguara nga Projekti, në përputhje me faturat në kesh dhe

mbi bazën e disbursimeve në periudhat përkatëse, shoqëruar me problematika të veçanta.

Në përfundim të kontrolleve të evaduar në vitin 2011, si pasojë e parregullsive dhe veprimeve të kundërligjshme të ndërmarrë nga punonjësit e subjekteve të kontrolluar, sidomos nga drejtuesit e lartë, në 15 prej tyre nga 29 gjithsej, **arkës së shtetit i është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 6,094,587 mijë lekë.**

Sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar këto dëme ekonomike, rezulton:

	<i>Në mijë/lekë</i>
1. Në fushën e shpërblimeve	145,090
2. Në fushën e shitjes dhe dhënies me qira të pronës publike	6,413
3. Në fushën e shpenzimeve operative	5,226
4. Në sistemin e pagave	2,498
5. Në sektorin e tatimtaksave	1,909
6. Në fushën e prokurimit publik	713
7. Në sektorin e doganave	688
8. Në fusha të tjera	5,932,050

Ndër problemet më kryesore të konstatuar dhe evidentuar në kontrollet e evaduar gjatë vitit 2011 nga ky Departament, paraqesim:

a) Në investimet dhe projektet me financime të huaja:

a.1 Në ndërtimin e infrastrukturës rrugore (*rruga Lushnjë-Fier dhe Levan-Tepelenë*) ka rezultuar se Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk ka realizuar në kohë shpronësimet për realizimin me sukses të programeve investuese; nuk kish hartuar një program masash të shoqëruara me koston financiare për sigurimin e niveleve të larta të sigurisë; studimet dhe projektimet e investimeve me financime të huaja nuk ishin të thelluara, për pasojë ato janë shoqëruar me ndryshime gjatë zbatimit duke rritur koston e tyre; si dhe nuk ka bërë inventarizimin e plotë fizik dhe financiar të segmenteve rrugore për secilin

projekt. Gjithashtu, Njësitë e Menaxhimit të Projekteve nuk kanë ndjekur dhe nuk kanë ndëshkuar përgjegjësit për realizimin jashtë afateve të punimeve, madje për vonesat e shkaktuara, nuk janë bërë njoftimet përkatëse për fillimin e aplikimit të penalteteve për vonesa dhe nuk janë realizuar testimet për të garantuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të parashikuara në kontratë.

a.2 Në fushën e arsimit (*projekti “Cilësi dhe barazi në arsim”*), MASH, mund të kishtë analizuar më mirë ecurinë e projektit, duke shkmangur vonesat me pasojë rritjen e shpenzimeve dhe të kostos së kredive.

a.3 Në fushën e ujësjellës-kanalizimeve (*PIU Hidrik, Tiranë dhe furnizimi me ujë dhe sanitetet në qytetin e Korçës*), rezultoi se, nuk janë riparuar defektet në rrjetin e tubacioneve, nuk ka studim për gjendjen e veprave të artit të ndërтуara për sigurinë e Impiantit të Trajtit të Ujërave Bovillë nga rrëshqitjet, rishikimin e zbatimit të punimeve për plotësimin në afat të kontratave; ndërsa Sh.a. Ujësjellës Kanalizime Korçë, nuk ka analizuar ecurinë e projektit, ka lidhur amendamentin e kontratës pa u siguruar financimi i saj, ka bërë ndryshime të strukturës së huasë, nuk ka bërë inventarizim të dokumentacionit të projektit dhe nuk ka aplikuar penaltete për vonesa në zbatimin e kontratës.

a.4 Në fushën e shërbimit shëndetësor (*Spitali Kavajë*), MSH, nuk ka plotësuar me stafin e specializuar mjekësor repartet e shërbimit të kirurgjisë së përgjithshme, sallës së operacionit të maternitetit dhe shërbimit të reanimacionit; Njësia e Zbatimit të Projektit nuk ka bërë inventarizimin e plotë të pajisjeve mjekësore dhe elektronike, si dhe regjistrimin kontabël e evidentimin në llogaritë e bilancit; gjithashtu, kjo Njësi nuk ka marrë masa për ndjekjen e realizimit të punimeve të pakryera, por të situacionuara dhe të likuiduara për zërin “Matja e tymrave” etj.

a.5 Në fushën e energjisë elektrike (*“Transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike Vau Dejës”*), për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar për integrimin në sistemin e Ballkanit, fuqizimi i aftësive të

transmetimit dhe përmirësimit të kontrollit); KESH sh.a. nuk ka bërë të mundur vënien në punë të komponentit të projektit “Ndërtimi i rrjetit shpërndarës 20 kw të qytetit të Koplikut”; nuk ka regjistruar në kontabilitet investimet e kryera; nuk ka zbatuar penalitete për vonesat; si dhe nuk ka marrë masa për mbajtjen e materialeve të pa dorëzuar nga kontraktori. Gjithashtu, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe PIU/OST, në bashkëpunim dhe me METE dhe PMU/METE, nuk kanë përfunduar në kohë projektin; PIU/OST nuk ka raportuar mbi ecurinë e projektit në MF dhe nuk ka hartuar raporte të plota dhe reale, për realizimin e secilit komponent të projektit; planifikimi i disbursimeve nuk ka qenë i saktë; nuk janë kryer misione të përbashkëta monitorimi mbi ecurinë e projektit; si dhe nuk është inventarizuar dhe arkivuar dosja e prokurimit.

a.6 Në fushën e bujqësisë (*Projekti i menaxhimit të burimeve ujore*), MBUMK dhe Bordet e Kullimit në rrethe, nuk kanë marrë masa për një paraqitje reale të veprimeve kontabël për kontratat e përfunduara.

Zbatimi i kontratave në projektet me financime të huaja është shoqëruar me mangësi, duke shkaktuar dëme nga shpërblimet e përfituara padrejtësisht prej shoqërive mbikëqyrëse. Kontraktori për rimbursimet e taksës doganore dhe për punime të pakryera, ka kryer pagesa të pajustificuara në zërin “sigurime” dhe për punime jashtë parametrave teknikë të parashikuar në kontratat përkatëse, pagesa këto që duhen mbajtur nga shuma e garancisë, ose në të kundërt të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik të përfutur padrejtësisht nga pagesa e taksës doganore dhe t.v.sh. për mallin e furnizuar jo sipas kushteve të kontratës.

b) Në shoqëritë publike:

b.1 Moshartimi në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, të dokumentacionit ligjor të shoqërive publike si statut, rregullore e brëndshme, kontrata kolektive dhe individuale të punës, si dhe dokumente të regjistrimit.

b.2 Mospërbërja e Këshillave Mbikëqyrëse dhe/ose Bordet Drejtuese në përputhje me udhëzimet përkatëse; miratimi prej tyre shpesh herë i vendimeve të nxituara e të pabazuara ligjërisht, madje të shoqëruara me efekte financiare në dëm të personit juridik publik; mosanalizimi periodikisht i veprimtarisë të shoqërive apo moszbatimi me rigorozitet i detyrimit statutor për raportimin në institucionet përkatëse.

b.3 Moshartimi nga drejtuesit e shoqërive dhe/ose drejtoritë, në përmbajtjen e kërkuar (siç duhet) të programeve ekonomiko-financiare të shoqërisë, marrja e vendimeve duke anashkaluar Këshillat Mbikëqyrëse. Gjithashtu, mosevidentimi dhe mosndjekja sistematike e detyrimeve debitoare, si dhe mosnxjerrja e përgjegjësisë për mosrealizimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë apo menaxhim jo të mirë të shoqërisë.

b.4 Në fushën e menaxhimit financiar, abuzime në shpenzimet për personelin; mungesë të dokumentacionit justifikues në kryerjen e pagesave me arkë dhe bankë; dhënie të sponsorizimeve të pambështetura ligjërisht; shpenzime për telefonat celular në kundërshtim me legjislacionin; abuzime në përdorimin e kursit të këmbimit të valutës dhe shitjen e produkteve të tyre; dhënie pa kriter të paradhënies; mosshlyerje në afat të detyrimeve të ndryshme; dhënie shpërblimesh në fund të vitit për punonjësit e shoqërisë edhe në rastet kur shoqëria ka rezultuar me humbje; planifikimi dhe përdorimi i të ardhurave nga subvencioni jo sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimet përkatëse; mangësi në dokumentet justifikues për pagesat për shpenzimet e karburantit dhe për udhëtim e dieta etj.

Mangësi janë konstatuar dhe në dhënien me qira të objekteve pronë e shoqërive, duke favorizuar subjekte private dhe duke cënuar interesat e shoqërisë publike.

b.5 Në fushën e prokurimit publik, shkelje të dispozitave ligjore e nënligjore dhe të detyrimeve kontraktore si: mangësi në përcaktimin e fondit limit; po kështu në dokumentacionin e tenderit; mosrespektim të afateve ligjor për

shqyrtimin e ankesave; pagesa të kundërligjshme në formën e shtesës së kontratës; si dhe moszbatim të afatit e të përcaktimeve kontraktuale; çka kanë ulur përdorimin efektiv të fondeve publike.

c) Në institucionet dhe entet që veprojnë në fushën e mjedisit, është konstatuar:

- Moshartimi nga MMPAU të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit dhe të metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis; moshapja e regjistrave të lejeve mjedisore dhe mospasqyrimi në mënyrë të detajuar të këtyre lejeve, për pasojë moskryerja e monitorimit të treguesve mjedisorë; moskoordinimi i punëve ndërmjet departamenteve brënda Ministrisë dhe kësaj të fundit me institucionet e tjera, sidomos në drejtim të ndjekjes së kundërvajtësve dhe arkëtimit të gjobave.

- Mosfunksionimi i Drejtorive të Shërbimit Pyjor në bazë Qarku; moshartimi i planeve të mbarështimit, të trajtimit dhe të shfrytëzimit të fondit pyjor e të kullotave; mungesë e dokumentacionit në kontrata për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe mosndjekja sa dhe si duhet e vjeljes së qirasë dhe gjobave.

- Mosdisponimi nga ARM^{të} të lejeve mjedisore të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në zonën e tyre; mospërcaktimi i masave dhe afateve për rehabilitimin e gjendjes së mjedisit të dëmtuar nga subjektet qiramarrës dhe mosvendosja nga inspektorët e mbrojtjes së mjedisit në rastet e konstatuara të sanksioneve ligjore; diferencime në caktimin e masës gjobës; mangësi në përgatitjen e dosjes për autorizim dhe pëlqim mjedisor etj.

B.2 Departamenti i Kontrollit të Zbatimit të Buxhetit Qëndror, të Institucioneve të Administratës së Lartë Publike dhe Mbikëqyrjes së Auditimit të Brendshëm.

Ky Departament ka ushtruar dhe evaduar gjithsej 39 kontrole, nga 38 të planifikuara. Nga kontrollet e evaduar, 19 kanë qenë të kombinuar, 7 ligjshmërie dhe rregullshmërie, 8 auditime financiare sipas praktikës së auditimit të NAO të Britanisë së Madhe, 4 kontrole për vlerësimin e

veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe derdhjen e dividendit dhe 1 kontroll tematik.

Nga totali i kontrolleve të ushtruar, në 22 prej tyre janë konstatuar dhe evidentuar *shkelje me dëm ekonomik* **në vlerën 420,478 mijë lekë.**

Sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar këto shkelje, rezulton:

	<i>Në mijë/lekë</i>
a. Në fushën e të ardhurave në vlerën	343,722
Nga të cilat:	
1. Nga dhënia e objekteve me qira	978
2. Nga tatimtaksat	743
3. Nga shfrytëzimi i pasurive kombëtare	342,001
b. Në fushën e shpenzimeve	76,756
Nga të cilat:	
1. Në fushën e prokurimeve publike	65,159
2. Në shpenzimet operative	11,154
3. Në fushën e pagave në vlerën	440
5. Mungesë mjete materiale e monetare	6

Të analizuara sipas subjekteve, shkeljet e konstatuara me dëm ekonomik në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës financiare, paraqiten;

a) Në fushën e të ardhurave

a.1 Në *Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektoratit Shtetëror të Punës*, janë konstatuar shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën totale *187 mijë lekë*; në *MBUMK* në vlerën *158 mijë lekë*; *QSU “Nënë Tereza” Tiranë* *978 mijë lekë*; dhe në *Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Pyjeve dhe Kullotave në MMPAU* *342,001 mijë lekë*. Për këto vlera dëmi, *KLSH* ka rekomanduar shpërblimin e tyre në masën 100% dhe nga verifikimi ka rezultuar se ato janë zbatuar plotësisht.

a.2 Ndërsa, në *MPÇSSH*; për shkeljet e disiplinës financiare me dëm ekonomik në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën *398 mijë lekë*, kishin

filluar procedurat për zbatimin e rekomandimit të KLSH për shpërblimin e vlerës së dëmit në masën 100%.

b) Në fushën e shpenzimeve:

b.1 Në MTKRS janë konstatuar shkelje financiare me dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit në vlerën 23,239 mijë lekë dhe për të është kërkuar shpërblimi në masën 100%. Nga kjo Ministri, nga 16 rekomandime, janë pranuar dhe zbatuar 13 prej tyre për vlerën 21,037 mijë lekë dhe nuk janë zbatuar 3 në vlerën 2,202 lekë.

b.2 Në Administratën e Kuvendit janë konstatuar shkelje financiare me dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit në vlerën 3,874 mijë lekë; në Aparatin e Kryeministrit në vlerën 618 mijë lekë; MSH 183 mijë lekë; MM 1,204 mijë lekë; MPJ 202 mijë lekë; MBUMK 884 mijë lekë; Drejtorinë Arsimore Rajonale, Qarku Tiranë 293 mijë lekë; QSU "Nënë Tereza" Tiranë 13,154 mijë lekë; Drejtorinë e Menaxhimit të Tokave dhe Ujërave në MBUMK 6,168 mijë lekë; Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve 3,585 mijë lekë; dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit 259 mijë lekë. Për këto vlera dëmi, KLSH ka rekomanduar shpërblimin e tyre në masën 100% dhe nga verifikimi ka rezultuar se ato janë zbatuar plotësisht.

b.3 Në DPUK, janë konstatuar shkelje financiare me dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit në vlerën 6,119 mijë lekë, për të cilat është kërkuar shpërblimi i tyre në masën 100%. Nga verifikimi rezultoi se ky rekomandim është realizuar pjesërisht dhe pjesa tjetër në proces. Po kështu, në MPÇSSHB, Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës, ku janë konstatuar shkelje financiare me pasojë dëm ekonomik përkatësisht në vlerën 1,644 mijë lekë, 67 mijë lekë dhe 7,713 mijë lekë, rekomandimet e KLSH janë zbatuar pjesërisht. Kurse, në Fondin e Zhvillimit Shqiptar, vlera e shkeljeve financiare me pasojë dëm ekonomik në vlerën 7,550 mijë lekë, rezultoi në proces zbatimi.

o Përsa i përket, dëmeve ekonomike të konstatuara dhe evidentuar në fushën e prokurimit pubik, ato janë kryesisht rrjedhojë e moszbatimit të procedurave të prokurimit me fonde publike dhe zbatimit të kontratave. KLSH, në të gjitha kontrollet e ushtruar në vitin 2011, ndër drejtimet e kontrollit ka programuar dhe ka kryer kontroll për zbatimin e dispozitave ligjore, duke filluar nga forma e komunikimit me ofertuesit, në llogaritjen e vlerës limit të kontratës, në respektimin e kufijve monetarë, në përgatitjen e dokumenteve të tenderit, në paraqitjen e pranimin e ofertave, në shqyrtimin, vlerësimin dhe kualifikimin e ofertuesve, në shqyrtimin e ankesave, si dhe në lidhjen e zbatimit e kontratave për punë, mallra e shërbime. Gjithashtu, është ushtruar kontroll për zbatimin e kontrateve të lidhura.

Nga rezultatet e kontrolleve të subjekteve të evaduar rezulton se, nga 850 *procedura prokurimi të zhvilluara, me një vlerë prej 28,360,372 mijë lekë, janë kontrolluar 689 prej tyre, me një vlerë prej 24,497,203 mijë lekë ose 82% e numrit dhe 86% e vlerës së fondeve të prokuruar. Në prokurimet e zhvilluara nga institucionet e kontrolluara, procedurat e hapura zënë rreth 33% të numrit dhe 81% në vlerë, ndërsa procedurat me negociim pa shpallje paraprake të kontratës zënë 51% të numrit dhe 9% të vlerës.*

Për 689 tenderat e kontrolluar rezulton se, kanë shprehur interesin dhe kanë tërhequr dokumentet e tenderit 2165 ofertues, kanë paraqitur ofertat 2079 prej tyre; kanë konkurruar 2051 ofertues ose mesatarisht 3 konkurrent për një tender, janë skualifikuar 305 ofertues ose 1.5% e tyre; janë kualifikuar 1746 ofertues, janë shpallur fitues dhe kanë lidhur kontratat 745 operatorë ekonomik me një vlerë totale të kontraktuar prej 21,166,109 mijë lekë. Duhet cilësuar se, si rrjedhojë e konkurrencës, është ulur vlera monetare e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike në shumën 3,331,094 mijë lekë ose në masën rreth 13.5%.

Nga 689 procedura prokurimi të kontrolluara, në 497 prej tyre u konstatuan 1045 shkelje të dispozitave ligjore të cilat paraqiten:

- Në llogaritjen e vlerës së kontratës në 97 raste.
- Në respektimin e kufijve monetar në 23 raste.
- Në komunikimin dhe informimin me ofertuesit në 16 raste.
- Në përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe veçanërisht të specifikimeve teknike e të kriterëve të vlerësimit në 387 raste.
- Në paraqitjen dhe pranimin e ofertave nga ofertuesit në 23 raste.
- Në hapjen dhe shqyrtimin e ofertave të paraqitura në 32 raste.
- Në vlerësimin dhe kualifikimin e ofertuesve 367 raste.
- Në s'kualifikimin e ofertuesve 5 raste.
- Në sigurimin e vlefshmërisë së ofertës 8 raste.
- Në njoftimin e fituesit 3 raste.
- Në shqyrtimin administrativ dhe zgjidhjen e ankesave 9 raste.
- Në lidhjen e kontratave dhe marrëdhëniet me nënkontraktorët 42 raste, duke vepruar në kundërshtim me kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratave.
- Në zbatimin e kontratave nga kontraktorët dhe nënkontraktorët, në përputhje me kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratave të lidhura 24 raste të shkeljes së dispozitave ligjore.
- Në arkivimin e dosjeve për tenderat e zhvilluar 9 raste.

B.3 Departamenti i Kontrollit të Zbatimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Publike.

Gjatë vitit 2011, ky Departament ka evaduar 67 kontrolle të ushtruara në bashki, prefektura, këshilla qarqesh, komuna, agjenci qendrore dhe zyra rajonale të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe njësi të ndryshme buxhetore, nga të cilat 53 të kombinuar dhe 10 rregullshmërie dhe ligjshmërie. Nga totali i kontrolleve, në 54 prej tyre janë konstatuar dhe evidentuar *shkelje me pasojë dëm ekonomik* **në vlerën prej 327,227 mijë lekë**, vlerë e cila është rekomanduar të dëmshpërblehet në masën 100%.

Sipas *fushave dhe sektorëve* ku janë konstatuar shkeljet me dëm ekonomik, ka rezultuar:

1) Në sektorin e tatim taksave, në vlerën 44,542 mijë lekë, shkaktuar si pasojë e mosarkëtimit të detyrimeve tatimore, kryesisht mosmbajtje të tatimit në burim, tatimit mbi të ardhurat, mosarkëtim të taksave dhe tarifave vendore nga më të ndryshmet; konstatuar në 12 bashki, në njësitë bashkiake nr. 3 dhe 10 Tiranë, Këshillin e Qarkut Lezhë, Komunën Vllahinë Vlorë dhe Universitetin “Ismail Qemal” Vlorë, mosarkëtim të taksës së regjistrimit në Universitet.

2) Në sistemin e pagave dhe në fushën e shpërblimeve, në vlerën 38,259 mijë lekë, shkaktuar si pasojë e shkeljes së dispozitave ligjore në fuqi, më konkretisht; përfitim page të pambështetur në dispozitat ligjore; paguar jashtë kriterëve për statusin e shërbimit civil; përfitim më tepër pagë për pozicion pune të pamerituar; shtesë në pagë për master dhe tituj shkencor në kundërshtim me ligjin; dhënie shpërblimi për orë shtesë jashtë kohës normale të punës; përfitim të padrejtë shpërblim për udhëtime e dieta; përfitim të pajustificuar për pjesëmarrje në mbledhje e borde; shpërblim të padrejtë si anëtar këshilli; shpërblim të paligjshëm nga fondi i veçantë me rastin e festave; shpenzime të pambështetura ligjërisht për biseda telefonike etj.; konstatuar në 11 bashki, 4 njësi bashkiake të Tiranës, 2 këshilla qarqesh, 4 komuna dhe 1 universitet.

3) Pagesa të kundërligjshme në shpenzimet operative, në vlerën 8,393 mijë lekë, dhe konkretisht: pagesa të papërfshira në preventiv punimesh e shërbimesh dhe të pa argumentuara; pagesa për blerje karburanti, ndërkohë që është përfituar bonusi; pagesa të shpenzimeve për karta telefoni në kundërshtim me ligjin dhe për aktivitete sociale për anëtarët e këshillit; përfitim më tepër në kundërshtim me kontratat e nënshkuara; pagesa shpenzimesh të tepërta për pjesë këmbimi; pagesa të padrejta për bursa dhe udhëtime; dhënie ndihmë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi etj.; konstatuar në 9 bashki, 3

njësi bashkiake të Tiranës, 6 komuna dhe Drejtoria Nr. 1 e Punëtorëve, Bashkia Tiranë.

4) Për dhënien me qira të pasurisë, në vlerën 2,840 mijë lekë, dhe konkretisht: mosarkëtim të qirave dhe të kamatëvonesave; vonesa në arkëtimin e qirasë; mospagesë të qirasë së tokë; mosarkëtim të diferencave të qirasë së tokës dhënë operatorëve celularë me qira etj.; konstatuar në 4 bashki, 2 komuna, Drejtoria Nr. 1 e Punëtorëve, Bashkia Tiranë dhe Spitali Rajonal Durrës

5) Në fushën e prokurimeve publike dhe zbatim kontratash publike, në vlerën 144,455 mijë lekë, shkaktuar kryesisht si pasojë e shkeljes së procedurave të prokurimit publik dhe mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale. Në kontrollat e ushtruar në 45 subjekte, përkatësisht 21 bashki, 3 njësi bashkiake, 2 këshilla qarqesh, 18 komuna dhe 1 njësi tjetër prokuruese, ka rezultuar se janë zhvilluar gjithsej 1212 procedura prokurimi me vlerë 19,579,905 mijë lekë. Nga këto, grupet e kontrollit kanë audituar 595 prej tyre me vlerë 12,579,905 mijë lekë, ose 49% e numrit gjithsej të procedurave dhe 64% të vlefës së prokuruar, nga të cilat në 469 procedura prokurimi janë konstatuar shkelje nga me të ndryshmet me pasojë dëm ekonomik në vlerën e sipërcituar. Më konkretisht shkeljet janë konstatuar:

- Në llogaritjen e vlerës së kontratës në 236 procedura prokurimi;
- Në hartimin dhe përgatitjen e dokumenteve standarde në 358 procedura;
- Në vlerësimin e ofertave në 138 procedura prokurimi; dhe
- Në lidhjen dhe zbatimin e kontratave në 156 procedura prokurimi.

Sipas natyrës së shkeljeve, konstatuar në 45 subjekte të kontrolluar, paraqesim: llogaritje gabim të fondit limit; shpallje të kufirit monetar me vlerë më të lartë se fondi i miratuar; diferenca të zërave të punimeve të pakryera, moskryerje të punimeve sipas kontratave publike të nënshkruara; pagesa më tepër në situacionet e ndërtimeve; përfitim të padrejtë të fondit rezervë në investime; moskryerje punimesh në afat dhe vonesa në dorëzimin e punimeve;

mosllogaritje dhe mosarkëtim të sanksioneve të kontratës për vonesa në zbatimin e saj; shkelje të procedurave në blerjet me vlera të vogla etj.

6) Në fushën e urbanistikës, në vlerën 87,663 mijë lekë, shkaktuar nga mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe taksës 1% të vlerës së investimit; llogaritje të gabuar të kostos mesatare të ndërtimit; mosarkëtimi i taksës së studimeve urbanistike; mosarkëtimi i detyrimit për leje ndërtimi dhe pagesa më pak e detyrimit për leje ndërtimi; mospagesa e detyrimeve për leje shfrytëzimi; aplikimi i gabuar i kostos mesatare të ndërtimit; mosarkëtimi i gjobave për ndërtime pa leje etj., konstatuar në 13 bashki dhe 4 komuna.

7) Të tjera, në vlerën 1,075 mijë lekë, konstatuar në:

- Bashkinë Ballsh shuma 49 mijë lekë, e cila përfaqëson mungesë inventari ekonomik; Komunën Prezë Tiranë 668 mijë lekë, llogaritje t.v.sh. mbi vlerën e makinerive dhe pajisjeve të ujësjellësit dhe jo në përputhje me strukturën e kostos të punimeve të ndërtimit; dhe Komunën Vllahinë Vlorë 358 mijë lekë, përfitim të padrejtë të ndihmës ekonomike.

B.4 Departamenti i Kontrollit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit

Për vitin 2011, ky Departament ka përfunduar dhe evaduar 17 kontrolle, nga 22 të programuara, nga të cilat 11 kontrolle në degët doganore dhe DPD dhe 6 kontrolle në subjektet e tatimtaksave, nga të cilat 2 kontrolle në drejtoritë e tarifave dhe taksave vendore, Tiranë dhe Durrës.

Në këto kontrolle, objektivi kryesor ka qenë shqyrtimi i gjëndjes, konstatimi dhe evidentimi i parregullsive dhe shkeljeve të legjisllacionit tatimor dhe doganor, nga punonjësit e administratës tatimore dhe doganore, si dhe përcaktimi i masave për parandalimin e tyre në të ardhmen.

Në përfundim të kontrolleve të ushtruar, informacionet dhe aktet e kontrollit të mbajtura, përfshirë zbatimin e rekomandimeve, janë azhurnuar periodikisht me të dhënat në regjistrin elektronik të departamentit dhe në mbyllje të periudhës është bërë përpunimi dhe nxjerrja e të dhënave statistikore, të cilat dhe janë raportuar. Në këtë kontekst, janë konstatuar dhe evidentuar parregullsi dhe

shkelje të legjislacionit fiskal në fuqi, me efekte negative në arkëtimin e të ardhurave tatimore nga sistemi tatimor dhe doganor për llogari të Buxhetit të Shtetit të vitit 2011, **në shumën 185,274 mijë lekë**, nga të cilat 183,416 mijë lekë në sistemin doganor.

Renditur sipas llojit të shkeljeve të legjislacionit, rezulton:

A. Në organet tatimore dhe drejtoritë e tatimtaksave vendore, janë konstatuar shkelje në shumën 1,858 mijë lekë; dhe konkretisht:

- Mosvendosje të penalteteve për dorëzim jashtë afateve ligjore të pasqyrave financiare (bilanceve) me vlerë 400 mijë lekë; dhe
- Detyrime tatimore dhe taksë pasurie me vlerë 1,458 mijë lekë.

B. Në organet doganore, janë konstatuar shkelje në vlerë totale prej 183,416 mijë lekë, të cilat sipas llojeve dhe vlerave paraqiten si më poshtë:

- Detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e artikujve të ndryshëm të importuar, me vlerë 157,000 mijë lekë.
- Detyrime dhe penaltete të pavendosura për subjekte që operojnë me Regjimin e Përpunimit Aktiv, me vlerë 13,071 mijë lekë.
- Detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e autoveturave dhe motoçikletave me vlerë 5,657 mijë lekë.
- Detyrime doganore të papaguara për diferencë në peshë me atë të deklaratës doganore me vlerë 6,767 mijë lekë.
- Penaltete të pavendosura për mospagim të t.v.sh. me vlerë 300 mijë lekë, si dhe detyrime e penaltete të tjera me vlerë 612 mijë lekë.

Sipas llojit, vlerave dhe subjekteve ku ato janë konstatuar dhe evidentuar, efektet negative në grumbullimin e të ardhurave tatimore, rezultojnë:

- *Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan* në vlerën 400 mijë lekë, e cila përfaqëson mosvendosje të penalteteve për dorëzim jashtë afateve ligjore të bilanceve financiarë.
- *Drejtoria Tatim Taksave Vendore, Bashkia Durrës* 1,458 mijë lekë, detyrime tatimore e taksë pasurie të paderdhur.

- *Dega e Doganes Kapshticë* 1,263 mijë lekë, përkatësisht:
- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm 479 mijë lekë; dhe detyrime dhe penalitete të pavendosura për subjekte që operojnë me Regjimin e Përpunimit Aktiv 784 mijë lekë.

- *Dega e Doganës Elbasan* 1,978 mijë lekë, përkatësisht detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm.

5. Dega e Doganës Qafë Thanë 11,131 mijë lekë, përkatësisht:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm 2,698 mijë lekë.

- Detyrime dhe penalitete të pavendosura për subjekte që operojnë me Regjimin e Përpunimit Aktiv 1,561 mijë lekë.

- Detyrime doganore të papaguara për diferenca në peshë me atë të deklaratës doganore 6,767 mijë lekë.

- Penalitete të pavendosura për mospagim të t.v.sh. 105 mijë lekë.

6. Dega e Doganës Kakavijë 8,918 mijë lekë, përkatësisht:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm 4,192 mijë lekë; dhe detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e autovecurave dhe motoçikletave në vlerën 4,726 mijë lekë.

7. Dega e Doganës Durrës 142,811 mijë lekë, respektivisht:

- Detyrime doganore të pallogaritura për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importin e mallrave 141,817 mijë lekë.

- Detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e autovecurave dhe motoçikletave 799 mijë lekë.

- Kamatëvonesa të pallogaritura në skemën e shlyerjes së t.v.sh. në vlerën 195 mijë lekë.

8. Dega e Doganës Vlorë 5,872 mijë lekë, përkatësisht:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm 1,067 mijë lekë; dhe detyrime e penalitete të pavendosura për subjekte që operojnë me Regjimin e Përpunimit Aktiv 4,552 mijë lekë dhe detyrime te tjera 253 mijë lekë.

9. Dega e Doganës Shkodër 7,967,000 lekë, ndarë:

- Detyrime doganore të pallogaritura për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importin e mallrave 3,542 mijë lekë.

- Detyrime dhe penalitete të pa vendosura për subjekte që operojnë me Regjimin e Përpunimit Aktiv 4,066 mijë lekë.

- Kamatëvonesa të pallogaritura në likuidimin e detyrimeve jashtë afatit ligjor në vlerën 359 mijë lekë.

10. Dega e Doganes Lezhë 481 mijë lekë, përkatësisht:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve në importin e disa artikujve të ndryshëm 349 mijë lekë; dhe detyrime doganore të papaguara ne zhdoganimin e automjeteve 132 mijë lekë.

11. Dega e Doganes Korçë 2,995 mijë lekë, respektivisht:

- Detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve në importin e disa artikujve të ndryshëm 887 mijë lekë; dhe detyrime e penalitete të pavendosura për subjekte që operojnë me Regjimin e Përpunimit Aktiv 2,108 mijë lekë.

Po provojmë të bisedojmë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për problematikën e krijuar edhe gjatë vitit 2011 lidhur me aksesin në të dhënat e këtij institucioni. Përpjekjet tona pranë Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë nuk kanë dhënë rezultat.

VI.4 Rekomandimet e bëra dhe zbatimi i tyre.

Bazuar në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, KLSH, për të gjitha të metat, parregullsitë dhe shkeljet e ndryshme të ligjshmërisë dhe ato financiare me pasojë dëm ekonomik, të konstatuara gjatë vitit 2011 dhe të pasqyruara në raportet respektive të kontrolleve të këtij viti, u ka dërguar zyrtarisht subjekteve të kontrolluar raportet përfundimtarë të kontrolleve së bashku me rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. Njëkohësisht me to, janë njoftuar edhe institucionet qendrore eprore, në disa raste edhe organet më të larta shtetërore.

Krahas sigurimit të cilësisë në procesin kontrollues dhe përmirësimit cilësor të përmbajtjes të materialeve të kontrollit, objektivi prioritar i KLSH^{së} është *ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara*. Shkalla e realizimit të masave të rekomanduara tregon për drejtësinë, vërtetësinë dhe profesionalizmin në kryerjen e veprimtarisë kontrolluese nga ana e punonjësve të KLSH^{së}, ndërkohë dhe për përgjegjshmërinë e strukturave drejtuese të subjekteve të kontrolluar dhe të atyre eprore në ushtrimin e detyrave të marra përsipër.

Për të përmbushur objektivin e parashikuar për vitin 2011 në drejtim të realizimit të masave të rekomanduara, KLSH ka parashikuar dhe zbatuar një sërë masash, duke filluar nga rritja e kërkesës së llogarisë ndaj punonjësve të ngarkuar me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të tyre dhe deri në rikontrollin e zbatimit të detyrave të lëna në kontrollin e mëparshëm në vetë subjektet e kontrolluar.

Krahas detyrimit ligjor të vetë subjekteve të kontrolluar për kthimin e përgjigjeve për

masat e marra brenda 20 ditëve nga marrja e rekomandimeve, KLSH në të gjitha programet e kontrollit ka parashikuar pikë të veçantë **“rikontrollin e detyrave të lëna”**. Përveç kësaj, brenda numrit të kontrolleve të përvitshme, është përcaktuar që në fillim dhe në fund të çdo viti, të gjithë departamentet e

kontrollit me programe pune të veçanta të ushtrojnë kontrolle për zbatimin e detyrave të lëna.

Vlen të theksohet se, në drejtim të rritjes së nivelit të zbatimit të masave përmirësuese të rekomanduara nga KLSH, ka ndikuar ndjeshëm Urdhëri i Kryeministrit Nr.70, datë 18.4.2006 “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ e Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit e të Ministrive”. Pasqyrojmë se, gjatë vitit 2011 është konstatuar se, për lloje të ndryshme rekomandimesh, niveli i zbatimit të këtij Urdhëri ka qenë i ndryshëm.

Me këtë urdhër, gjatë dy dekadave të fundit Kryeministri Berisha dallohet si autoriteti me i larte i qeverisjes që ka mbështetur më fuqishëm KLSH në veprimtarinë e vet kushtetuese.

Nga 147 kontrolle (152 gjithsej minus 5 kontrolle tematikë për zbatimin e rekomandimeve), të evaduar gjatë vitit 2011, është ushtruar kontroll me objekt verifikimin e zbatimit të masave të rekomanduara në 136 prej tyre, ose në masën mbi 92.5%.

Më konkretisht, niveli i realizimit të masave të rekomanduara për vitin 2011, sipas llojit të masave të rekomanduara, paraqitet:


1. Masat me karakter organizativ:

Nga 1605 masa të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar plotësisht 1093 prej tyre, pjesërisht 15, në proces 184 dhe nuk janë zbatuar 278 masa, ndërkohë që 35 nuk janë verifikuar nga KLSH, pra përqindja e realizimit rezulton në masën 69% (1108:1605).

Në krahasim me një vit më parë, ndonëse numri i masave të rekomanduara është rritur me 80 rekomandime (1605-1525), niveli i realizimit të tyre ka pësuar rënie. Kështu, nga 82.3% niveli i realizimit të rezultuar në vitin 2010, në vitin analizues 2011 ky nivel ka rezultuar në masën 69%, pra me një diferencë në ulje prej 13.3 pikë përqindje.

Institucionet për të cilat aplikohet Urdhëri i Kryeministrit nr. 70, datë 18.4.2006 dhe që kanë nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë: MTKRS me 4 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 8 të rekomanduara, Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit me 8 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 14, MBUMK me 3 masa organizative të pazbatuara nga 11, MF me 2 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 4, dhe QSU “Nënë Tereza” Tiranë me 2 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 11 të rekomanduara.

Në mënyrë grafike, tendenca e zbatimit të masave organizative nga subjektet e kontrolluar për periudhën 2007-2011, paraqiten si më poshtë:



2. Masat për shpërblimin e dëmit ekonomik:


Nga vlera e përgjithshme e dëmit ekonomik prej 7,027 milionë lekë rekomanduar për shpërblimin e dëmit të evidentuar, *deri në fund të vitit 2011 janë nxjerrë urdhërat përkatës për shpërblimin e dëmit dhe janë në proces arkëtimi rreth 667 milionë lekë, ose në masën 9.5% të vlerës gjithsej të rekomanduar për shpërblim dëmi.*

Sikurse e përmendim më lart, treguesi shumë i ulët i arkëtimit të shpërblimit të dëmit dëshmon për një përqëndrim të pakët të vëmendjes dhe punës së KLSH në këtë drejtim. Peshën kryesore në mosarkëtimin e vlerës së dëmit ekonomik të shkaktuar e zenë Albpetrol sh.a me një dëm të konstatuar në

vlërën 3,937 milionë lekë dhe OST Energji Tiranë me 1,924 milionë lekë, në total 5,861 milionë lekë, gjë që dëshmon për vështirësitë që ndeshin këto dy shoqëri në arkëtimin e demit efektiv.

Nga krahasimi i vlerave absolute të raportuara për shpërblimin e demit në vitin 2010 përkatësisht 787 milionë lekë, kundrejt 667 milionë lekë në vitin 2011, rezulton se në vitin 2011 janë dëmshpërblyer 120 milionë lekë më pak.

Në mënyrë grafike, niveli i realizimit të shpërblimit të demit të arkëtuar dhe në proces arkëtimi në përqindje, në periudhën kohore 2007-2011, paraqitet si më poshtë:




3. Masat administrative dhe disiplinore:

Bazuar në përcaktimet në Ligjin Organik të KLSH i ndryshuar, ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, në “Kodin e punës”, ligjin për prokurimin publik, për urbanistikën, për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, për kontabilitetin etj., për parregullsitë dhe shkeljet e ndryshme të konstatuara me apo pa dëm ekonomik, KLSH, u ka rekomanduar subjekteve të kontrolluar dhe organeve respektive të emërtesës, shqyrtimin dhe marrjen e masave administrative dhe disiplinore ndaj punonjësve shkaktarë përgjegjës. Nga 720 masa të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar 536 prej tyre, ose në masën 74.4%. Duhet theksuar që masat e rekomanduara nga KLSH për vitin 2011 në përgjithësi janë të lehta.


Në krahasim me një vit më parë, numri i masave të rekomanduara është ulur me 127 masa rekomanduese (720-847), gjithashtu niveli i realizimit ka pësuar rënie. Kështu, nga 80.8% niveli i realizimit të rezultuar në vitin 2010, në vitin analizues 2011 ky nivel ka rezultuar në masën 74.4%, pra me një diferencë në ulje prej 6.4 pikë përqindje.

3.a Masat administrative, nga 206 të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar 140 prej tyre ose në masën 67.9%, ndërkohë që rezultojnë të pazbatuara 66 masa të rekomanduara. Më poshtë në mënyrë grafike paraqitet tendenca e zbatimit të masave administrative në përqindje, për periudhën kohore 2007-2011:



3.b Masat disiplinore, nga 514 të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar 396 prej tyre ose në masën rreth 77%, ndërkohë që janë pa përgjigje (të pazbatuara) 118 masa të rekomanduara.

Niveli i realizimit të masave disiplinore të rekomanduara për periudhën kohore 2007-2011 luhetet nga 75% deri në 79%, gjë që pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm:



Institucionet për të cilat aplikohet Urdhëri i Kryeministrit nr.70, datë 18.04.2006 dhe që kanë nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë: MTKRS me 4 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 13 të rekomanduara, Fondi Shqiptar i Zhvillimit 0 të zbatuara nga 17 të rekomanduara, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan 0 nga 10, Dega e Doganës Qafë Thanë 0 nga 10, Dega e Doganës Durrës 0 nga 9 etj.

Krahas sa më sipër, vlen të cilësohet se, për vitin 2011, numri i masave të rekomanduara nuk i përgjigjet nivelit të konstatimeve dhe shkallës së përgjegjësisë të punonjësve shkaktarë përgjegjës. Më konkretisht, janë shumë pak masat për largimin nga puna të personave shkaktarë përgjegjës të dëmeve të konstatuara. Konstatimet dhe masat e propozuara nga KLSH duhet të jenë të efektshme dhe të ndihen në publik. Duhet të heqim dorë nga zbulimi i vjedhjeve hipotetike, që s'ekzistojnë, për faktin se këto "zbulime" i shërbejnë mbulimit të korrupsionit të vërtetë. Një libër gri për nëpunësit abuzues do ta dorëzojmë çdo vit pranë Departamentit të Administratës Publike, institucioneve qendrore dhe më gjerë.


4. Propozimet për ndryshime apo përmirësime ligjore

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese në vitin 2011, KLSH ka përgatitur dhe dërguar në strukturat respektive 45 propozime për ndryshim apo përmirësim të dispozitave ligjore në fuqi. Nga totali i propozimeve të

rekomanduara, janë zbatuar plotësisht 22 prej tyre, 13 janë në proces zbatimi, 9 rezultojnë të pazbatuara, kurse 1 propozim nuk është verifikuar.

Institucionet që rezultojnë me nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë: MTKRS me 3 rekomandime të pazbatuara dhe Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit me 2, ndërkohë që MF, DPRMSH, DPT dhe KESH Sh.a. rezultojnë me nga 1 rekomandim të pazbatuar.

Në mënyrë grafike, niveli i zbatimit të propozimeve për ndryshime dhe përmirësime ligjore për periudhën kohore 2007-2011, paraqitet si vijon:



Propozimet për ndryshime dhe përmirësime ligjore, institucionet e ngarkuar me përgatitjen dhe paraqitjen e tyre, si dhe ecuria e zbatimit të tyre, renditur sipas strukturës hierarkike dhe rëndësisë problemore, paraqiten në aneksin nr. 3, bashkëlidhur këtij raporti.

Në mbyllje të kapitullit për zbatimin e rekomandimeve, theksojmë se, krahas përgjegjësisë të strukturave drejtuese të institucioneve të kontrolluar për mosangazhimin dhe moszbatimin e rekomandimeve të KLSH të cituar si më sipër, përgjegjësi kanë edhe punonjësit e institucionit, në veçanti ata të departamenteve të kontrollit, të cilët nuk kanë ndjekur me përgjegjshmëri dhe këmba këmbës zbatimin e rekomandimeve dërguar subjekteve të kontrolluar. Tashmë, është fakt se mangësitë e punës në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dërguar nga KLSH, lidhen me gjendjen e pasivitetit dhe të

pritsmërisë të pjesës dërmuese të punonjësve të KLSH përfshirë stafin drejtues, me mbarimin e mandatit të ish Kryetarit të KLSH në fund të muajit tetor 2011.

VI.5 Mbikëqyrja e veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit.

A. Mbi mbikëqyrjen e veprimtarisë së auditimit të brendshëm publik.

Drejtim tjetër mjaft i rëndësishëm i veprimtarisë kontrolluese të KLSH ka qenë dhe mbetet vlerësimi dhe mbikëqyrja e auditimit të brendshëm, në funksion të detyrimeve që burojnë nga:

- Seksioni 3, pika 3, e Deklaratës së Limës të miratuar në tetor 1977 në Kongresin e IX të INTOSAI (Lima, Peru), shpreh se:

“Si auditues i jashtëm, Institucioni Suprem i Auditimit ka për detyrë shqyrtimin e efektivitetit të auditimit të brendshëm. Nëse auditimi i brendshëm është gjykuar të jetë efektiv, do të bëhen përpjekje, pa cënuar të drejtën e Institucionit Suprem të Auditimit për të kryer kontrole të përgjithshëm, për të arritur ndarje më të përshtatshme apo caktim të detyrave dhe bashkëpunimit në mes Institucionit Suprem të Auditimit dhe auditimit të brendshëm”;

- Standardi Atributiv nr. 1312 “Vlerësimet e jashtme” i Institutit të Audituesve të Brendshëm (Florida, SHBA), përcakton se:

“Vlerësimet e jashtme duhet të kryhen ... nga rishikues të kualifikuar e të pavarur, ose nga një grup rishikimi jashtë njësisë”; dhe

- Neni 7, i Ligjit Organik të KLSH nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me Ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000);

Drejtim tjetër mjaft i rëndësishëm i veprimtarisë kontrolluese të KLSH ka qenë dhe mbetet vlerësimi dhe mbikëqyrja e auditimit të brendshëm.

Për këtë, gjatë vitit 2011 është programuar dhe mbikëqyruar funksionimi i auditimit të brendshëm në 51 subjekte publike me periudhë kontrolli vitet 2009-2011, si dhe është vlerësuar mjedisi i kontrollit të brendshëm në 7 institucione qëndrore, sipas aneksit nr. 4, bashkëlidhur këtij raport.

Për kryerjen e vlerësimit, mbikëqyrjen dhe nxjerrjen e përfundimeve sa më të sakta dhe objektive, KLSH është mbështetur dhe ka marrë për referencë kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9720 datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010 dhe manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 69, datë 29.09.2010 të Ministrit të Financave.

Ky proces vlerësimesh dhe mbikëqyrjesh, arritjet dhe dobësitë apo shkeljet ligjore të vërejtura në organizimin dhe funksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm publik, janë pasqyruar në Raportet Përfundimtare të Kontrollit, të cilat u janë përcjellë me rekomandimet përkatëse përmirësuese subjekteve të audituara.

Ndër arritjet dhe progresin në auditimin e brendshëm publik, KLSH ka vlerësuar:

- Harmonizimin e kuadrit ligjor me praktikat më të mira dhe standartet profesionale të Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA Florida), e reflektuar kjo në:

- a)** Bashkërendimin e përgjithshëm të veprimtarisë së auditimit të brendshëm;
- b)** Ngritjen dhe zbatimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik;
- c)** Miratimin e politikave, manualeve, metodave, procedurave, udhëzimeve, të tilla si:

- Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 10138, datë 16.9.2010.

- Vendimet e KM nr. 640, datë 11.06.2009 “Për miratimin e Letër Politikave të KBFP dhe planit të veprimit” dhe nr. 806, datë 6.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së auditimit financiar”.

- Manuali i auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 69, datë 29.09.2010 të Ministrit të Financave.

- Trajnimin e vijueshëm dhe edukimin e përditësuar të njohurive.

Megjithatë, KLSH mbi bazën e analizës së veçantë të auditimit të brendshëm për çdo subjekt të kontrolluar, ka evidentuar problematikën e kësaj fushe, duke dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e veprimtarisë së tyre në të ardhmen.

Në terma të përgjithshëm, në kontrollet e sipërcituar ka rezultuar:

1. Organizimi strukturave audituese, kapaciteti auditues i tyre, përbërja dhe eksperiencat profesionale të punonjësve të auditimit.

Sipas të dhënave të administruara, evidentohen gjithsej 132 njësi auditimi të organizuara, nga të cilat: 21 subjekte publike janë organizuar në nivel specialisti; 1 në nivel dege; 24 në nivel zyre; 46 në nivel sektorial; 39 në nivel drejtorie; dhe 1 subjekt publik në nivel departamenti. Këto struktura janë ngritur dhe funksionojnë respektivisht; 54 në nivele të qeverisjes qendrore (në të gjitha ministritë e linjës, me përjashtim të Ministrisë së Integritimit) dhe strukturat e tyre të vartësisë; 8 në institucionet e pavarura; 15 në institucionet e Prefektit ose Nënprefektit; 49 në njësitë shpenzuese të qeverisjes vendore si bashki e komuna; dhe 6 struktura në këshillat e qarqeve.

Më konkretisht, shpërndarja e strukturave të auditimit të brendshëm të sektorit publik në kuadër të qeverisjes së përgjithshme, paraqitet si vijon:

(Të dhënat në shkallë sistemi publik, viti 2010)

Numri i strukturave në:		Institucione të pavarura	Prefektura	Pushteti Vendor	Këshilla Qarqesh	Totali
Ministri dhe Institucione Qendrore	14	8	15	49	6	92
Struktura Vartëse	40	x	x	x	X	40
Totali:	54	8	15	49	6	132

Nga analiza krahasuese dhe e detajuar e të dhënave të krijimit të strukturave audituese, vërejmë se ecuria e procesit në subjektet publike për tre vitet e fundit ka pësuar këto transformime:

(Të dhënat në shkallë sistemi publik, viti 2010)

Strukturat	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
Ministri dhe Institucione Qendrore	13	14	14
Institucione te Varesise	37	51	55
Institucione te Pavarura	2	4	8
Pushteti Vendor	36	50	55
Gjithsej:	88	119	132

Nga krahasimi i të dhënave të vitit 2010, me ato të vitit 2009, rezulton se, numri i subjekteve publike që kanë krijuar strukturat e auditimit të brendshëm, ka pësuar një rritje në përqindje në masën 9.85% dhe në numër 13 struktura auditimi më tepër, kurse në krahasim me gjendjen në vitin 2008 rritja rezulton në masën 50% dhe numerike 44 subjekte më tepër.

Kjo tendencë shpreh vlerësimin dhe prokupacionin e ekzekutivit për zhvillimin e sistemit të auditimit publik në vend.

Pavarësisht sa sipër, nga kontrollet e kryera janë konstatuar dhe *mangësi, të meta dhe shkelje në rregullimin dhe efçencën e shërbimit të auditimit të brendshëm publik*, të cilat janë evidentuar në Raportet Përfundimtare të Kontrollit të KLSH. Në këtë kontekst duhet pasqyruar se:

1.a Në disa subjekte publike nuk janë ngritur njësitë e auditimit, në disa të tjera nuk janë plotësuar kapacitetet profesionale për të përballuar ngarkesën e punës së këtij shërbimi të sigurisë publike, ose mungon informacioni i plotë mbi ekzistencën e tyre. Për këtë, *KLSH i ka rekomanduar MF* që: *“Të përcaktohen me një akt të veçantë ligjor kriteret e detyrueshme për themelimin e strukturave audituese në entitetet e sektorit publik”*. Në zbatim të këtij rekomandimi, MF ka përgatitur dhe dërguar në KM projektvendimin “Për

përcaktimin e kritereve për ngritjen e strukturave të auditimit të brendshëm në subjektet e sektorit publik”, dhe kjo çështje është në proces shqyrtimi.

Mbikëqyrja e KLSH ka konstatuar se, *në shkallë sistemi publik, nga 416 punonjës të planifikuar gjithsej në organikë, gjatë vitit 2010 strukturat e auditimit të brendshëm rezultojnë të plotësuara me 406 auditues, ose në masën 97,6%, duke mbetur pa u plotësuar 10 pozicione pune. Me mungesa në plotësimin e kapaciteteve audituese paraqitet sistemi i MF dhe MD nga 2 punonjës secili, sistemi i METE, MM dhe MB me nga 1 punonjës secili etj.*

Përsa i përket strukturave të auditimit pranë *organeve të pushtetit vendor*, Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm deri në vitin 2010 ka administruar informacione të pjesshme, *pasi këto struktura nuk kanë raportuar periodikisht pranë kësaj njësie mbi nivelin, cilësinë, gjetjet, rekomandimet etj.* Prefekturat dhe disa bashki të vogla, kanë raportuar nëpërmjet MB, kurse disa të tjera kanë dërguar vetëm planet vjetorë dhe strategjikë.

- Nga verifikimi i të dhënave të personelit të regjistruar, u konstatuan disa raste të personave të regjistruar që punojnë si auditues, por që nuk janë të përfshirë në database e kësaj Njësie, si në Këshillin e Qarkut Elbasan; AKKP Tiranë; Qendrën e Trajtitimit të Studentëve Vlorë; Komunën Dajt Tiranë etj. Në ISHP u konstatua se Sektori i Auditimit të Brendshëm është përcaktuar në nivel sektori me një auditues, i cili varet tek Inspektori i Përgjithshëm dhe ka detyrimin ligjor për auditimin e 16 objekteve të varësisë direkte (Zyrat Rajonale). Duke krahasuar numrin e objekteve të detyrueshme për auditim dhe frekuencën e auditimit të institucionit (një herë në vit), kapaciteti auditues i kësaj strukture për mbulimin me auditim të plotë është i pamjaftueshem. Në DPRMSH u konstatua se për vitin 2010 struktura e auditimit të brendshëm është organizuar me 1 punonjës në organikë nga 3 të tillë që kishte një vit më parë. Bazuar në numrin e objekteve të varësisë që mbartin detyrimin ligjor për auditim dhe vlerën e madhe të mallrave rezervë shtetërore që administron ky

institucion, si dhe veprimtarinë që kryhet për depozitimin, administrimin dhe shitjen e mallrave të sekuestruara nga strukturat e tjera të shtetit, kapaciteti auditues e kësaj strukture duhet rishikuar.

- Në institucionet e qeverisjes vendore, ka rezultuar se:

- Në Bashkinë Patos janë emëruar dhe larguar nga Drejtoria e Auditimit gjatë një viti 8 punonjës, gjë që ka krijuar shqetësime në përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në ligj; në Komunën Rrashbull Durrës, Zyra e Auditimit funksiononte me 3 punonjës, në një kohë që Komuna nuk ka objekte në vartësi dhe kur efektivisht sipas ngarkesës me vështirësi mbulohej me punë një auditues. Po kështu, në Bashkinë Durrës, janë emëruar 5 auditues, që vlerësuar me numrin e objekteve që kanë në vartësi dhe punën e kryer deri tani, nuk justifikojnë mbulimin e tyre me punë.

- Në shoqëritë tregtare, në mjaft subjekte nuk janë ngritur akoma njësitë e auditimit të brendshëm, si në Sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Mallakastër apo në Drejtorinë e Shërbimit Trupit Diplomatik ku procesin e auditimit e kryen MPJ; gjithashtu disa njesi të auditimit të ngritura nuk janë plotësuar me organikën e nevojshme si p.sh. në filialet e shoqërisë Posta Shqiptare. Madje, janë konstatuar raste të lëvizjeve të shpeshta të drejtuesve dhe punonjësve të auditimit, si në KESH sh.a, të cilat kanë ndikuar negativisht në realizimin e programeve të auditimit dhe në cilësinë e tyre.

1.b Në kontrollet e kryera gjatë viteve 2010 dhe 2011, në disa *institucione qendrore dhe organe të qeverisjes vendore*, janë konstatuar probleme dhe mangësi të shprehura si në organizimin dhe emërtimin e strukturës, ashtu dhe në varësinë e tyre (emërtesa administrative dhe e raportimit) në kuadër të entitetit publik. Nuk janë të pakta rastet kur njësitë e auditimit veprojnë ende si struktura të kontroll-revizionit dhe ushtrojnë funksionin e inspektimit financiar, si në bashkitë Sukth, Ersekë, Kuçovë dhe Bilisht, ku strukturat e auditimit në periudhën kur është ushtruar kontrolli, ruanin ende emërtimin Kontroll-Revizion. Në disa raste, organizimi i strukturave nuk ka qenë në pajtueshmëri

të plotë më kuadrin ligjor e procedural që rregullojnë auditimin e brendshëm, përderisa audituesit ishin atashuar pranë Departamentit Ekonomik, duke humbur sensin e pavarësisë funksionale.

Në QSU “Nënë Tereza”, u konstatua se, në vitet 2009 e 2010, struktura e auditimit brendshëm (SAB) ishte organizuar në nivel sektori në varësi të Titullarit dhe jo në varësi të Këshillit Administrativ, në kundërshtim me nenin 17, të ligjit për ABSP dhe me rekomandimin e lënë nga KLSH në kontrollin e mëparshëm. Madje, në këtë institucion nga 5 punonjës që ka SAB, 2 prej tyre ose 40% janë të pa çertifikuar.

Në Universitetin Politeknik Tiranë, u konstatua se për vitet 2008, 2009 dhe 9 mujorin e vitit 2010, SAB është organizuar me 1 auditues në varësi të Degës së Financës, në kundërshtim me nenin 17 të ligjit dhe nenin 40 të statutit të UPT^{së}. Kurse, në Bashkinë Lushnjë, zyra e auditimit të brendshëm është organizuar me dy punonjës në varësi të Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Në një numër të kufizuar rastesh, evidentohet dukuria e përfshirjes së punonjësve me arsim të mesëm në strukturat e auditimit, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e nenit 19 pika 2 të ligjit 9720, datë 23.4.2007, i ndryshuar, që përcakton shprehimisht se punësimi i audituesve bëhet sipas parimeve dhe rregullave të shërbimit civil dhe kandidatët për rekrutim në këtë funksion duhet të *kenë përfunduar studimet e larta universitare për ekonomi, finance etj.* Kontrolli ka konstatuar ekzistencën e një rasti në Ndërmarrjet e varësisë së Bashkisë së Tiranës dhe një rast në Komunën Shëngjin, ku janë punësuar persona që nuk kanë kryer arsimin e lartë, për të cilën kërkohet ndërhyrje e menjëhershme.

1.c Kontrollat e kryera kanë evidentuar një mungesë standardizimi të pozicioneve të auditimit në organet e qeverisjes vendore, pasi nuk ka asnjë kriter orientues për ngritjen e tyre. Kjo mungesë standardizimi në konturimin e njësive të auditimit, nuk është shoqëruar me një politikë aktive nga MF, siç

përcaktohet në Nenin 17 të Ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007, i ndryshuar. Më konkretisht:

- Në 7 struktura të qeverisjes vendore, njësia e auditimit është organizuar me 1 punonjës, dhe është kompozuar në nivel specialisti, si në Këshillin e Qarkut Tiranë, Gjirokastrë, Vlorë dhe Berat, Komunën Qendër Skrapar, bashkitë Rrëshen dhe Krujë.
- Në 19 struktura të tjera të qeverisjes vendore, njësia e auditimit është organizuar me 1 punonjës, dhe është kompozuar në nivel zyre, si në bashkitë Lushnjë, Përmet, Tepelenë, Vorë, Mamurras, Fushë-Krujë, Ballsh, Delvinë, Sukth, Burrel, Këshilli i Qarkut Dibër e Lezhë; komunat Prezë, Kashar, Nikël, Vertop, Shëngjin, Dermenas dhe Paskuqan.
- Në 5 bashki njësia e auditimit është organizuar me 1 punonjës, dhe është kompozuar në nivel sektori, si në bashkitë Lezhë, Krujë, Peshkopi, Bulqizë dhe Gjirokastrë.
- Në 4 organe të qeverisjes vendore, njësia e auditimit është organizuar me 2 punonjës, dhe është kompozuar në nivel sektori, si në bashkitë Korçë, Kamëz, Kavajë dhe Këshillin e Qarkut Durrës.
- Në 3 bashki, njësia e auditimit është organizuar me 2 punonjës, dhe është kompozuar në nivel Drejtorie, si në bashkitë Patos, Sarandë dhe Berat.
- Në 3 bashki, njësia e auditimit është organizuar me 1 punonjës dhe është kompozuar në nivel Drejtorie, si në bashkitë Pogradec, Ura Vajgurore dhe Kuçovë.
- Në Albpetrol Sh.a. audituesit janë emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm, në kundërshtim me kërkesat e nenit 2 dhe 17 të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, i ndryshuar.

1.d. Çertifikimi i audituesve publikë.

Kontrolli ka konstatuar se nuk ka gjetur zbatim të plotë detyrimi i përcaktuar në nenin 19 të Ligjit nr. 9270, datë 23.4.2007, ku shprehimisht cilësohet se: *“Audituesit, jo më vonë se 2 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, (d.m.th pas*

shtatorit 2009) duhet të jenë të pajisur me çertifikatën “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

Nga kontrolli i të dhënave të evidencës vjetore të vitit 2010 vërehet se, nga 406 persona që punojnë në auditim në shkallë sistemi, janë çertifikuar 277 punonjës, ose 68,2% e tyre.

Nga analiza e plotësisë dhe përbërjes së strukturave audituese konstatohet se 129 auditues të punësuar në njësitë e auditimit të brendshëm publik nuk janë kualifikuar dhe çertifikuar si të tillë, por duhet konsideruar fakti se 58 prej tyre janë në proces kualifikimi. Një situatë më e përgjithshme rreth shpërndarjes së audituesve sipas strukturave, si dhe statusi i tyre lidhur me çertifikimin si “Auditues të Brendshëm në Sektorin Publik” paraqitet në tabelën e mëposhtme:

(Të dhënat në shkallë sistemi publik, viti 2010)

EMERTIMI	Numri strukturave	Punonjës Fakt	Të çertifikuar	Në proces	Të pa çertifikuar
Institucione Qëndrore	14	106	92	11	2
Institucione të Varësisë	55	186	128	25	34
Institucione të Pavarura	8	29	20	8	1
Pushteti Vendor	55	85	37	14	34
Shuma:	132	406	277	58	71

Më shqetësuese kjo gjendje për vitin 2010 paraqitet në disa entitete publike, që kanë treguesit më të lartë të audituesve të punësuar që nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të çertifikimit, sipas kërkesave të nenit 19, pika 3, të ligjit nr. 9720, datë 23.4.2007, i ndryshuar.

Gjendja e çertifikimeve për disa entitete publike me rëndësi, në kohën e kryerjes së kontrolleve, paraqitet si më poshtë:

o Sistemi i MPPT ka 7 të pa çertifikuar nga 28 të punësuar; sistemi i METE 11 të pa çertifikuar nga 26 të punësuar; sistemi i MSH 5 të pa çertifikuar nga 12 të punësuar; DPD 4 të pa çertifikuar nga 10 të punësuar; DPT 3 të pa çertifikuar nga 7 të punësuar; ISSH 3 auditues të pa çertifikuar; QSUT “Nënë Tereza” 2 të pa çertifikuar; Bashkia Tiranë 3 të paçertifikuar nga 13 gjithsej (shkresa nr. 725, datë 25.1.2011); Bashkia Berat nga 2 auditues, asnjë i çertifikuar; Bashkia Vlorë nga 3 auditues, vetëm 1 i çertifikuar (shkresa nr. 194, datë 17.1.2011); Bashkia Elbasan nga 3 auditues, asnjë i çertifikuar; Bashkia Fier nga 3 auditues, asnjë i çertifikuar (shkresa nr. 2, datë 10.1.2011); Komuna Rrashbull nga 2 auditues, asnjë i çertifikuar; Komuna Vërtop 1 auditues, i paçertifikuar (shkresa nr.26, datë 13.1.2011); etj.

Gjithashtu, në shoqëritë tregtare si Albpetrol Sh.a., KESH Sh.a. dhe Posta Shqiptare, punonjësit e auditimit nuk zotërojnë çertifikatën e nevojshme “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

Kjo gjendje ka vazhduar edhe për 9-mujorin e vitit 2011, ku rezultoi se nga 406 auditues të punësuar në sektorin publik, 74 prej tyre janë të paçertifikuar ose në masën 19%. Nga këta, 15 persona janë në procesin e ndjekjes së trajnimeve dhe kualifikimeve për efekt çertifikimi, kurse 59 të tjerët nuk ndjekin trajnimin dhe kualifikimin respektiv.

2. Frekuencat e auditimit.

Nga verifikimi i pasqyrave të evidencës statistikore dhe raportimeve vjetore 2010, rezultoi se 86 subjekte që përbëjnë 4.4% e numrit të përgjithshëm, janë objekte që nuk janë audituar dhe rezultojnë me tejkallim të afatit 2 vjeçar, duke mospërbushur kriteret e pikës 9, seksioni I, të manualit të auditimit të brendshëm të sektorit publik, miratuar me VKM nr. 345, datë 01.06.2004. Kontrolli vëren se një numër të konsiderueshëm në këtë kuadër e zënë 5 entitete publike me 72 subjekte ose 83% të kësaj prapambetje, të tillë si 27 subjekte të sistemit të MM, 15 subjekte të sistemit të MSH, 18 të MPJ, 5 të INSTAT, 3 të Bashkisë Tiranë etj.

3. Planifikimi i angazhimeve dhe misioneve të auditimit.

Për këtë çështje, kontrolli i ushtruar ka konstatuar:

- Në institucionet e qeverisjes vendore, në përgjithësi ka një përmirësim në cilësinë e hartimeve të programeve të auditimit, por në disa raste nuk është përcaktuar kuadri ligjor i nevojshëm, ditët efektive të punës, kostoja e auditimit për secilin objekt, siç përcaktohet në Seksionin III/3, të manualit të auditimit, e vërejtur kjo në bashkitë Elbasan, Patos, Koplík, Fushë-Krujë, etj. Gjithashtu, në këto njësi, strukturat e auditimit nuk kanë parashikuar kontrolle për fondet e shpenzuara nga aparatet e bashkive apo komunave, kontrolle mbi funksionimin e strukturave të ndryshme brenda bashkisë, si funksionimi i zyrës së taksave dhe tatimeve, urbanistikës, inspektoriatit ndërtimor, kontrolle për rregullshmërinë financiare etj. Në ndonjë rast zbulimet e pasqyruara në raportimet e auditimit kanë pasaktësi, si në Bashkisë Patos, e cila ka raportuar në MF mosrealizimin e taksave në vlerën 17,350 mijë lekë si zbulim, me pretendimin se ky mosrealizim përbën evazion fiskal.

- Në shoqëritë tregtare, planet e auditimit të brendshëm nuk ndahen në muaj dhe tremujor sipas subjekteve përkatëse, si dhe ka një numër të kufizuar kontrollesh të programuar, krahasuar me kapacitetet kontrolluese, si psh në Autoritetin e

Aviacionit Civil. Veç kësaj, konstatohet se struktura të ndryshme auditimi, nuk arrijnë të realizojnë programet e tyre vjetore si në Albpétrol Sh.a., KESH Sh.a. dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë.

4. Në përgatitjen e letrave të punës dhe ndjekjen e stadeve të raportimit, mangësitë kryesore përmbidhen:

- Në institucionet qendrore; si në ISHP u konstatua se dosjet e auditimit të brendshëm të objekteve të audituara për vitin 2009 janë të inventarizuara dhe përmbajnë të gjithë informacionin e duhur, por nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit sipas rregullave të përcaktuara për arkivimin e dokumentacionit zyrtar.

- Në *MBUMK* për vitin 2010 u konstatua se, inventarët e brendshëm të dosjeve të auditimeve të evaduar janë hartuar me shumë mangësi, pasi dokumentet e përfshira në inventar nuk mbajnë numrin dhe datën e protokollit kur janë plotësuar, nuk mbajnë numrin rendor inventarial rritës dhe nuk kanë të shënuar numrin e fletëve, çka i bëjnë këta inventare formal e të pabesueshëm, duke lënë hapësirë për abuzime. Të gjitha dosjet e auditimeve të vitit 2010 janë të pa arkivuara në arkivin e institucionit, sipas rregullave të përcaktuara për arkivimin e dokumentacionit zyrtar, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2006 “Për Arkivat” dhe me Seksionin VII “Letrat e punës të auditimit të brendshëm” miratuar me VKM nr. 345, datë 01.06.2004.

- Në *MM* u konstatua se, për vitin 2010, dosjet e auditimeve të kryera nuk kanë të numëruar gjithë sistemin e informacionit të tyre, nuk kanë akt-mbyllje e akt-arkivimi dhe nuk janë dorëzuar në arkivën e institucionit me procesverbal të veçantë.

o Në *organet e qeverisjes vendore*; në *hartimin e procesverbaleve*, në disa raste nuk është vendosur dispozita e ligjit të shkelur, në kundërshtim me Kapitullin II “Dokumentet e auditimit dhe procedurat për administrimin”, pika 5 “Procesverbali” të manualit të auditimit; kjo më e dallueshme në auditimet e kryera nga bashkitë Durrës, Fier, Elbasan dhe Patos. Në Bashkinë Sarandë, audituesit për shkeljet e konstatuara nuk kanë mbajtur asnjë procesverbal apo akt-konstatim.

- Në përfundim të çdo kontrolli hartohet *Memorandumi* (informacion mbi përfundimet e kontrollit), por në shumë raste ai është identik me Raportin Final të Auditimit, si nga numri i fletëve dhe problematika, është shumë i detajuar, pra nuk është i qartë e konçiz, nga i cili, si drejtuesi i Institucionit dhe mbikqyrësi i auditimit (KLSH), të mund të nxjerrin përfundime”; si në bashkitë Fier, Sarandë, Elbasan, Korçë dhe Lezhë.

- Në disa raste gjetjet nga auditimi trajtohen vetëm në procesverbalet, apo akt-verifikime dhe nuk trajtohen në mënyrë të përmbledhur në Raportin Final,

duke i vështirësuar titullarit marrjen e informacionit dhe vendimmarrjen, ku përmendim: bashkitë Tiranë, Fier, Patos, Fushë-Krujë etj.

- Masat disiplinore që propozohen ndaj personave përgjegjës, nuk janë shoqëruar me motivacionin përkatës dhe shkeljet nuk janë trajtuar në mënyrë të përmbledhur, por vetëm duke përmendur disa dispozita ligjore (të cilat shpesh nuk kanë lidhje me shkeljet e konstatuara). Për pasojë nuk është zbatuar VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, pika 8; si në bashkitë Vlorë, Durrës, Lushnjë dhe Patos. Auditimi i Bashkisë Fier për vitin 2010 ka propozuar vetëm 1 masë disiplinore dhe ai i Bashkisë Gjirokastër vetëm 2 masa. Kurse, njësitë e auditimit në bashkitë Shkodër, Lushnjë, Durrës dhe Fushë-Krujë, nuk kanë propozuar asnjë masë. Në disa bashki, si bazë ligjore për dhënien e masave disiplinore, është referuar ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit Civil”, Kreu VII, neni 25, pika 3 “Llojet e masave disiplinore”, ndërkohë që punonjësit e bashkisë nuk e kanë fituar statusin e nëpunësit civil.

- Në disa bashki, nuk janë kryer auditime tematike të veçanta për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna. Verifikimi i tyre është trajtuar si pjesë e auditimeve të radhës, si në bashkitë Patos, Durrës, Sarandë, Korçë etj.

- Dosjet e auditimit, në përgjithësi nuk janë plotësuar me materialin administrativ të domosdoshëm, që duhet të inventarizohet në dosjen e përherëshme të auditimit, pasi mungonin kopjet e shkresave për masat disiplinore drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, nuk janë administruar përgjigjet zyrtare të subjekteve të audituara, nuk janë mbajtur akt-verifikimet mbi zbatimin e rekomandimeve, si në Bashkinë Patos, Komunën Rrashbull Durrës, etj.

- *Në shoqëritë tregtare*; u konstatuan mangësi të karakterit procedural, që kryesisht kanë të bëjnë me strukturën e raporteve dhe mungesën e plotësimit të zbulimeve, me mangësi dhe pasaktësi të referencave ligjore. Në procedurat e auditimit nuk bëhet trajtimi i observacioneve (Albpetrol Sh.a.), nuk ka

shënime të mbajtura në dosjet e auditimit për të pasqyruar punën përgatitore për hartimin e tyre (Enti Kombëtar i Banesave), si dhe nuk protokollohet një pjesë e dokumentacionit të auditimit si takimi pajtues, observacionet e të audituarve, memorandumit (Sh.a. Porti Detar Vlorë).

- Në përgjithësi mungojnë programet vjetore të kontrollit mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve për kontrollet e evaduar, duke u mjaftuar me një çështje të veçantë që vendoset në auditimet e radhës për këto subjekte (Albpetrol Sh.a., KESH Sh.a., ANTA).

- Raportimi në NJQHAB është bërë pa cilësi dhe jo i rregullt, për t'u përmendur KESH Sh.a. dhe Sh.a. Porti Detar Vlorë. Gjithashtu nga këta dy subjekte, nuk tregohet kujdesi i duhur në arkivimin në kohë të dosjeve të auditimit.

- Referuar përcaktimeve llogjore, veprimtaria e auditimit të brendshëm nuk është marrë rregullisht në analizë nga këshillat mbikëqyrëse, duke u mjaftuar dhe kufizuar me raportimet e thjeshta të njësive të auditimit para bordeve, si në Albpetrol Sh.a., OST etj.

5. Në mjaft raste është vërejtur tendenca që njësitë e auditimit të brendshëm funksionojnë si njësi inspektimi, dhe jo si shërbime të dhënies së sigurisë,

sikundër përcaktojnë dhe standardet e auditimit dhe praktikat profesionale të Institutit të Audituesve të Brendshëm të SHBA. Nga analiza dhe studimi i të dhënave vërtetojmë se:

- Për gjithë sektorin publik ka një rënie të ndjeshme të numrit të objekteve të programuara për auditim, krahasuar me periudhat e mëparshme. Kështu, nga 2813 objekte të planifikuara në vitin 2007, në 2034 në vitin 2008, në 2294 në vitin 2009 dhe vetëm 1961 objekte të programuara për vitin 2010, pra në vitin 2010 janë programuar 333 objekte më pak se sa viti paraardhës.

- Në aktivitetin e auditimit publik gjatë vitit 2010, njësitë e auditimit të brendshëm të sektorit publik janë fokusuar nga auditimet tematike dhe

mbikëqyrjet. Më konkretisht, në shkallë *sistemi publik*, niveli i treguesve të planifikimit dhe realizimit të misioneve të auditimit, paraqiten si vijon:

(Në nivel Sektori Publik, viti 2010)

Auditime sipas llojit	Të planifikuara	Të realizuara	Realizimi në %
Auditime të Plota	1207	987	84.7
Auditime Tematike	614	1170	190
Verifikime, Investigime dhe Mbikëqyrje	140	220	157
Totali:	1961	2377	121

Nga analiza e të dhënave të mësipërme, rezulton se, angazhimet e auditimit përfshijnë gjithsej 987 auditime të plota nga 1207 të programuara dhe 1170 auditime tematike nga 614 të programuara, si dhe 220 mbikëqyrje e investigime nga 140 të programuara. Këto të dhëna tregojnë se, pavarësisht faktit që në përbërje të MF është krijuar Drejtoria e Inspektimit Financiar, përsëri nga strukturat e auditimit vijohet të shpenzohet shumë energji dhe kohë, duke u fokusuar më tepër si njësi dhe autoritete të inspektimit sesa në misione vlerësuese të vlerësimeve të brendshme, përmes auditimeve tërësore të bazuara në materialitetin dhe shkallën e rrisqeve të vlerësuara paraprakisht për sistemet.

Gjithashtu, në strukturat e auditimit të *organeve të qeverisjes vendore* pasqyra e realizimit të planit të auditimeve tregon të njëjtën dukuri të përgjithshme, drejtë auditimeve tematike dhe mosrealizim të planit të auditimeve të plota. Të dhëna më konkrete paraqiten në tabelën e mëposhtme:

(Në nivel qeverisje vendore, viti 2010)

Auditime sipas llojit	Të	Të realizuara	Përqindja	e
-----------------------	----	---------------	-----------	---

	planifikuar		realizimit
Auditime të Plota	131	108	82 %
Auditime Tematike	100	95	95%
Auditime të Mbikëqyrjes	29	39	134 %
Gjithsej:	260	242	93%

6. *Shuma e zbulimeve* nga auditimi publik gjithsej për vitin 2010 arrin në 3,375 milionë lekë dhe *treguesi i gjetjeve për një auditues mesatar vjetor* arrin në 8,386 mijë lekë/auditues.

Nga dëmi gjithsej i zbuluar 2,783 milionë lekë janë evazion fiskal, 112 milionë lekë janë mungesa dhe dëmtime dhe 480 milionë lekë shkelje të disiplinës financiare. Shuma e dëmit për të cilin nuk është përcaktuar përgjegjësia është 387 mijë lekë.

Nga njësitë e auditimit të brendshëm, në 4175 raste për 181,900 persona, janë rekomanduar:

- masa zhdëmtimi në vlerën 3,375 milionë lekë,
- masa organizative dhe disiplinore në 3308 raste, nga të cilat 122 largime nga puna;
- masa administrative 285 raste për 457 persona, me vlerë 33,840 mijë lekë.
- Gjithashtu, janë bërë kallëzime penale në 28 raste për 23 persona; padi gjyqësore për 11 persona në vlerën 62 milionë lekë.

Në mënyrë të përmbledhur, kontributi i çdo grupi raportues në zbulimet e sistemit jepen nga të dhënat e paraqitura në këtë tabelë:

Institucionet	Zbulimet gjithsej (mijë lekë)	Pesha specifike e grupit	Numri audituesve fakt	Pesha specifike e grupit	Zbulime për 1 auditues (mijë lekë)
Organet Qendrore	2,849,918	84 %	106	26%	26,886
Strukturat e Vartësisë	465,311	13.8%	186	46%	2,502
Institucionet Pavarura	0	0 %	29	7%	-
Pushteti Vendor	59,952	2.2 %	85	21.1%	705
Gjithsej:	3,375,181	100%	402	100%	8,386

Nga analiza e këtyre treguesve rezulton se, në *institucionet qendrore*, zbulimet mesatare për një auditues gjatë vitit janë më të lartat përkatësisht 26,886 mijë lekë/për një auditues; në subjektet e *varësisë së ministrive të linjës* respektivisht 2,502 mijë lekë/për një auditues dhe në *institucionet vendore* vetëm 705 mijë lekë/për një auditues.

6.1 Rekomandimet e dhëna dhe zbatimi nga strukturat e auditimit.

Nga të dhënat e raportuara për të gjithë sektorin publik rezulton se nga 7986 masa të propozuara, janë pranuar nga entitetet publike 7891 masa, ose 98.8% e rekomandimeve. Më problematike në pranimin e rekomandimeve të auditimit paraqiten subjektet e MM (pranuar 156 nga 214 rekomandime të lëshuara) dhe INSTAT (pranuar 9 nga 45 rekomandime gjithsej). Nga rekomandimet dhe masat e dhëna, peshën më të madhe e zënë masat e zhdëmtimit dhe më pas rekomandimet për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, masat disiplinore, gjobat, kallëzimet penale dhe paditë gjyqësore.

Gjithashtu, nga kontrollet e kryera është konstatuar se njësitë e auditimit të brendshëm nuk kanë kryer verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna,

veprim që vjen në kundërshtim me kreun V, pika 1 të Urdhrit të Kryeministrit nr. 70, datë 18.4.2006 “Për masat në zbatim të rekomandimeve të KLSH, auditimit të brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në institucionet në varësi të Kryeministrit dhe Ministrive”

6.2 Nga mbikëqyrja e planit strategjik dhe matricës së “Planit të veprimit për vitin 2010” të NJQHAB, të miratuar nga Ministri i Financave, rezultoi se, nuk ka objektiva konkrete për ecurinë e procesit e trajnimit dhe çertifikimit të audituesve, të cilat lidhen me studimin e nevojave të këtij sistemi për auditues të çertifikuar, me vazhdimësinë dhe shtrirjen në kohë të sezoneve, me numrin e audituesve që duhet t’i nënshtrohen trajnimit çdo vit me qëllim plotësimin e nevojave dhe njëkohësisht harmonizimin e këtyre kërkesave me tregun real të këtij shërbimi (punësimit) në sektorin publik.

KLSH, ka vërejtur se në fund të vitit 2011, numri i audituesve që i janë nënshtuar procesit të trajnim-çertifikimit dhe kanë fituar titullin ka arritur në 1208 gjithsej. Ky numër është rreth 2.3 herë më i madh se numri i përgjithshëm i stafit të audituesve të brendshëm në strukturat e sektorin publik të raportuar nga MF.

Në urdhrin e Ministrit të Financave nr. 57, datë 29.07.2010, është përcaktuar se, të drejtën për të filluar sezonin e kualifikimit 2010-2011 e kanë kandidatët që kanë mbaruar studimet universitare dhe kanë përvojë pune në auditim ose fusha të tjera të lidhur me të (referencë ligji nr. 9720, datë 23.4.2007, i ndryshuar).

Sipas këtij përcaktimi të drejtën për t’u çertifikuar e kanë kandidatët që plotësojnë kriteret për t’u punësuar në auditim, pra të kenë një eksperiencë pune më të madhe se 5 vjet. Nga shqyrtimi i dokumenteve të kandidatëve të pranuar në sezonin e shpallur, vërehet se nga *280 kandidatë gjithsej, 60 prej tyre punojnë si auditues dhe 220 kandidatë janë të fushave të tjera të sektorit*

shtetëror dhe privat. Madje, 78 kandidatë kanë nga 1-3 vjet vjetërsi pune, nga të cilët 14 auditues nuk përmbushin as kriterin e punësimit në këtë fushë.

Në këto kushte përcaktimi i saktë i nevojave, sezoneve, kritereve, numrit optimal të kandidatëve për çdo sezon, dhe sidomos punës për përditësimin e njohurive në Planin Strategjik dhe në Programin Vjetor të NjQHAB bëhet i domosdoshëm dhe imediat, me qëllim nxjerrjen në pah të efikasitetit dhe vlerave të procesit të çertifikimit në funksionin dhe shërbimin e auditimit të brendshëm të krijuar në shkallë vendi.

B. Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Në kuadrin e reformës të ndërrmarë tashmë nga MF për instalimin e një sistemi të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik, KLSH e konsideron një prioritet dhënien e kontributit për zhvillimin dhe progresin e kësaj reforme. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2011 në bashkëpunim me MF është kryer trajnim për stafin e audituesve të KLSH, me synim ngritjen e kapaciteteve audituese.

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2011, MF ka hartuar një sërë aktesh rregullative për implementimin e koncepteve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. E parë në këtë këndvështrim, kjo reformë është në hapat e para dhe në proces konsolidimi të mëtejshëm.

Në fokus të veprimtarisë audituese të KLSH gjatë vitit 2012, do të jetë vlerësimi i ecurisë së reformës si dhe vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë publike. Gjithashtu, do të vazhdojë bashkëpunimi me Njësitë Qëndrore të Harmonizimit, konkretisht:

- a)** Për menaxhimin financiar dhe kontrollin; dhe
- b)** Për auditimin e brendshëm, duke bashkërenduar përpjekjet me synim ngritjen, konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të modelit të kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP). Në funksion të ndërrmarjes së veprimeve efektive, gjatë vitit 2012 objekt i punës të auditorëve të KLSH do të jetë:

- Vlerësimi dhe monitorimi i veprimtarisë së Njësive Qëndrore të Harmonizimit në MF (AB dhe MFK), si përgjegjësit kryesorë të procesit të implementimit të sistemit të KBPF^{-së}, gjithashtu, monitorimi i zbatimit të Planit 5-vjeçar të implementimit të koncepteve të MFK^{-së} në sektorin publik.

- Ushtrimi i kontrollit në njësitë publike për zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin”, manualit të MFK, si dhe të gjithë kuadrit rregullativ të MFK, me synim vlerësimin e e funksionimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në sektorin publik; identifikimin e aspekteve, dobësive dhe mangësive në këtë drejtim; si dhe dhënien e rekomandimeve për ngritjen e sistemeve efektive.

XI.1 Kontrollat e programuara për vitin 2012

Për hartimin e programit të veprimtarisë të KLSH për vitin 2012, departamentet e kontrollit, si dhe departamentet e drejtoritë e aktivitetit mbështetës, gjatë muajit dhjetor 2011 - janar 2012, përcaktuan masat dhe organizuan punën për përgatitjen, paraqitjen dhe shqyrtimin e projektprogrameve të vitit 2012.

Për hartimin e projektprogrameve të veprimtarisë kontrolluese, janë grumbulluar, seleksionuar dhe studjuar një sërë të dhënash të grumbulluara për çdo subjekt kontrolli për disa vite radhazi, përfshirë vitin 2011, më konkretisht; lloji dhe volumi i veprimtarisë së secilit subjekt objekt kontrolli, periudha e mëparshme e kontrolluar, rezultatet e kontrollit, cilësia dhe shkalla e zbatimit të detyrave të rekomanduara, arësyet e kontrollit duke konsideruar materialitetin dhe riskun. Gjithashtu, lidhur me zhvillimin e strategjisë së planifikimit të kontrollit, janë shfrytëzuar dhe aplikuar gjerësisht njohuritë e përfutuara dhe përvoja e NAO të Britanisë së Madhe. Më konkretisht, janë hartuar dhe përpunuar tre mjete të planifikimit strategjik dhe janë përdorur e shfrytëzuar formularët standard, në të cilët sipas një sistemi vlerësimi me pikë për çdo kriter përzgjedhjeje nga 0-5, nga tërësia e kontrolleve të parashtruar, janë përzgjedhur kontrollet për vitin 2012.

Referuar llojeve të kontrollit, krahas atyre të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, vëmendja është fokusuar në konsolidimin e auditimeve financiare dhe në shtrirjen e përmirësimit cilësor të auditimeve të performancës, si auditime të përdorimit ekonomik të burimeve në aktivitetet administrative, të eficiencës së përdorimit të burimeve njerëzore, financiare e të tjera dhe të aktivitetit të performancës lidhur me përmbushjen e objektivave të subjektit të audituar. Madje, aspekti i matjes së performancës së institucioneve që kontrollohen, mund dhe duhet të shndërrohet në dobinë kryesore të punës të KLSH, krahas parandalimit të abuzimeve dhe korrupsionit.

Pas shqyrtimit në nivel Departamenti Kontrolli, të të dhënave përfshirë vlerësimet për çdo subjekt apo tematikë kontrolli, të pasqyruara në formularët e sipërpërmendur, u realizua shqyrtimi i hollësishëm dhe seleksionues i tyre në takime të veçanta me Kryetarin e KLSH^{së} dhe në takimin përmbyllës në rang drejtorësh. Në këtë takim u konkludua dhe u vendos përgatitja e “Programit të veprimtarisë së KLSH për vitin 2012”, duke reflektuar në të ndryshimet e propozuara.

Në këtë program, trajtohen objektivat prioritare të institucionit, detyrimet kushtetuese dhe ligjore për raportimin në Kuvend, planifikimi strategjik i veprimtarisë kryesore (kontrolluese), duke vijuar me menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe veprimtarinë mbështetëse.

Për vitin 2012 janë *parashikuar të ushtrohen gjithsej 153 kontrole*, ku në mënyrë të përmbledhur, fushat më kryesore të ushtrimit të kontrollit konsistojnë në:

1. Zbatimin e buxhetit të shtetit në 36 institucione shtetërore në nivel qëndror, nga të cilat 10 auditime financiare dhe 2 auditime pilot-çertifikim të llogarive vjetore. Në këto institucione, përparësi do t'i jepet kontrollit të përdorimit të fondeve publike të vëna në dispozicion nga buxheti dhe zbatimit të ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike.

2. Zbatimin e buxhetit vendor (përfshirë grumbullimin e taksave vendore dhe përdorimin e fondeve të vëna në dispozicion) në 37 bashki, nga të cilët 6 auditime financiare; 2 këshilla qarqesh; 3 prefektura dhe 11 komuna.

3. Vlerësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në 16 subjekte në nivel qendror dhe pothuajse në të gjithë subjektet në nivel vendor që kanë detyrimin për të kryer këtë auditim.

4. Kontrollin e zbatimit të investimeve dhe projekteve me financime të huaja në 12 projekte që i përkasin fushës së infrastrukturës, si ndërtimin e rrugëve; në fushën e energjetikës, ujësjellës kanalizime dhe të shëndetësisë nga të cilët 1 auditim performance.

5. Kontrollin e zbatimit të legjislacionit tatimor dhe doganor, në 16 subjekte tatimore dhe doganore, kryesisht lidhur me detajimin dhe grumbullimin e të ardhurave fiskale, nga të cilët 2 auditime performance. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet kontrollit të caktimit të detyrimeve fiskale dhe rivlerësimit të tyre gjatë vitit, si dhe masave të marra për arkëtimin e borxhit tatimor dhe doganor, si dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja.

6. Kontrollin e veprimtarisë ekonomiko-financiare në 13 shoqëri anonime, në drejtim të menaxhimit dhe përdorimit të fondeve publike, nga të cilët 2 auditime performance.

7. Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, sidomos realizimin e fondeve për investime të programuara, në 7 subjekte, nga këto 1 auditim performance.

8. Kontrollin për administrimin dhe rregjistrimin e pronës publike në 6 subjekte të kësaj fushe (ZVRPP).

Gjatë kontrollit të zbatimit të legjislacionit, objekt kontrolli do të jenë edhe; zbatimi i legjislacionit në fushën e urbanistikës, dhënia e objekteve me qira dhe vjelja e qirasë, zbatimi i detyrimeve të ndërsjellta në fushën e konçensioneve, dhënia e licencave të ndryshme, zbatimi i detyrimeve të ndërsjellta në fushën e konçensioneve etj.

XI.2 Objektivat e vitit 2012.

Programi i veprimtarisë i KLSH për vitin që sapo kemi hyrë synon tejkalimin e mangësive të vërejuara gjatë vitit 2011 dhe fuqizimin e mëtejshëm të rezultateve dhe arritjeve të derisotme të institucionit. Më konkretisht, institucioni gjatë vitit 2012 do të përqëndrohet në:



1. Thellimin e realizimit të misionit të tij kushtetues në parandalimin e korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike.

2. Përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, duke kthyer vëmendjen tek auditimi i

performancës dhe auditimi i çertifikimit të pasqyrave financiare, krahas rritjes së efijencës së auditimit financiar.

3. Organizimin dhe sigurimin e kontrolleve me cilësi të lartë dhe efektivitet në përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit, fondeve të huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe ato të kapitalit të BE^{së} të alokuar për Shqipërinë, si dhe kryerja e tyre me objektivet dhe profesionalizëm.

Hapja e institucionit ndaj praktikave më të mira ndërkombëtare të auditimit të jashtëm, të përditësuara në çdo kongres të fundit të INTOSAI dhe respektimi i orientimeve të MSA të Shqipërisë me Bashkimin Evropian është detyrë dhe sfidë për institucionin. Kjo bëhet akoma dhe më e rëndësishme për fatet e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të vendit, sidomos në ditët tona të përjetimit të krizës në Eurozonë, kur disiplina buxhetore dhe financiare e administrimit publik është bërë përparësi absolute për përballimin e pasojave të kësaj krize.

4. Realizimin e plotë të sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore që luftojnë korrupsionin, si me Departamentin AntiKorrupsion pranë Kryeministrit, me Njësinë Qëndrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrit të Financave dhe, në veçanti me organet e Prokurorisë, duke ruajtur pavarësinë e KLSH si organi më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar.

5. Komunikimin dhe ndërveprimin më aktiv me Kuvendin, Qeverinë dhe partnerët e tjerë institucionalë, sidomos intensifikimin e konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2013-2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues. Brënda gjysmës së dytë të këtij viti do të përgatisim Planin Afatmesëm Strategjik të Zhvillimit të institucionit për vitet 2013-2015.

6. Programimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditimit të financave publike, si dhe me organizata profesionale të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë.

7. Intensifikimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të auditimit si INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të kontrollit të BE^{së}, si SIGMA dhe Gjykata Europiane e Audituesve, me institucionet homologe të vendeve të BE dhe të rajonit, dhe në veçanti me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës.

8. Zhvillimin e burimeve njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga institucionet ndërkombëtare të auditimit dhe në përputhje me sfidat integruese të vendit. Në këtë kontekst, do të përshtaten më mirë cilësitë profesionale dhe aftësitë e secilit punonjës, me strukturën organike të institucionit, duke bashkuar strukturat ekzistuese apo krijuar struktura të reja. Do të ketë rritje cilësore dhe të numrit të kontrollorëve të trajnuar brënda dhe jashtë institucionit, mbi bazën e listës së nevojave reale të stafit për ngritjen profesionale dhe të kërkesave të shtruara për institucionet supreme të

kontrollit në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara të datës 22 dhjetor 2011 për rritjen e efijencës së SAI dhe të kërkesave në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit të Shqipërisë me BE.

9. Ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në teknologjinë e informacionit. Qeverisja elektronike po fiton gjithnjë e më shumë terren në administrimin e pasurisë publike dhe ofrimin e shërbimeve publike në Shqipëri dhe është e kuptueshme që përdorimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit të shoqërohet edhe me forma të reja të krimit ekonomik. Kjo është edhe një nga sfidat më të rëndësishme të KLSH në një periudhë afatshkurtër.

10. Përmirësimin e transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse të interesuara për bashkëpunim. Vend të veçantë do të zërë partneriteti i KLSH me shoqërinë civile të angazhuar në luftën për parandalimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit.

Në mbyllje, dua t'ju garantoj se do të punojmë për një institucion të lartë auditimi që siguron një komunitet të angazhuar që ka interes ta mbajë qeverisjen qendrore dhe vendore përgjegjëse. Për këtë do të fuqizojmë rolin e pazëvendësueshëm kushtetues të KLSH si institucioni kryesor ekonomiko-financiar, për ekonominë dhe shoqërinë tonë, me detyrë kontrollin e mirëadministrimit të pronës publike dhe shëndoshjen e financave publike, duke i shërbyer me devotshmëri Kuvendit dhe duke rritur pjesëmarrjen e opinionit publik në realizimin e Buxhetit të Shtetit.

Vërejtjet, mendimet dhe propozimet që mund të parashtroni në diskutimet tuaja, do të plotësojnë më së miri drejtimit dhe objektivat e punës sonë, si dhe do të shërbejnë për rritjen e përgjegjshmërisë të punonjësve të institucionit, me synimin e vetëm ngritjen cilësore të veprimtarisë kontrolluese të institucionit dhe përmbushjen e detyrave dhe objektivave të programuara për vitin 2012.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT*



*Ky raport u përcoll në Kuvendin e Shqipërisë me shkresën nr.50/1 datë 02.03.2012—

RAPORTIM I KRYETARIT BUJAR LESKAJ NË KOMISIONIN E EKONOMISË DHE FINANCAVE “PËR VEPRIMTARINË E KLSH PËR VITIN 2011”

Të nderuar deputetë të Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

Duke ju falenderuar për mbështetjen që i keni dhënë institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2011, të shprehur qartë në Rezolutën e Kuvendit datë 2 qershor 2011, më lejoni t’Ju paraqes një Raport të shkurtër për veprimtarinë e KLSH për vitin 2011. Ky



raport përqëndrohet në përgjigjen e institucionit ndaj rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, në performancën e tij vjetore, duke përfshirë problematikën e konstatuar dhe në objektivat e vitit në vazhdim 2012.

I. Marrëdhëniet me Kuvendin

1. Në Rezolutën e Kuvendit datë 2 qershor 2011 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2010”, ju keni kërkuar përdorimin më gjerësisht të metodologjisë bashkëkohore të kontrollit, mbështetur në standardet ndërkombëtare të INTOSAI dhe praktikat më të mira të vëndeve të tjera. Eksperiencia e fituar nga KLSH nga zbatimi gjatë viteve 2007-2008 i Projektit të Binjakëzimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Britanisë së Madhe dhe me Gjykatën e Auditimit të Hollandës ka prodhuar materiale udhëzuese të vlefshme dhe dy manuale, një i auditimit financiar dhe një i auditimit të performancës, por që janë përdorur dhe referuar pak nga audituesit tanë gjatë auditimeve të vitit 2011.

Megjithatë, krahas materialeve udhëzuese dhe manualeve, KLSH në drejtim të zhvillimit të metodologjisë ka mundur të realizojë:



a) Rishikimin e udhëzimeve dhe standardeve ndërkombëtare të kontrollit të miratuara nga INTOSAI, ndonëse ende nuk ka përfunduar përditësimin e tyre; dhe

b) Rishikimin dhe përmirësimin e draft/dokumentit për auditimin e çertifikimit të pasqyrave financiare dhe hartimin e formularëve standard për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për institucionet

buxhetore, i cili është shpërndarë për vlerësim.

KLSH me vështirësi po orientohet drejt auditimeve sipas praktikave bashkëkohore, ndërkohë që është kërkesë e kohës shtimi i ritmit dhe përmirësimi cilësor i kryerjes së këtyre auditimeve, veçanërisht auditimeve të performancës, duke patur parasysh që në vitin 2011 u realizua vetëm një i tillë.

Edhe pse institucioni ka përpunuar dhe përgatitur udhëzime dhe metodika për ushtrimin e kontrolleve, bazuar në rekomandimet dhe udhëzuesit zbatues të standardeve të auditimit të hartuar nga INTOSAI, njohja, përditësimi dhe zbatimi i tyre, si element thelbësor i teknikës profesionale (edhe pse ka qenë një kërkesë e stafit drejtues të KLSH^{së}) nuk është plotësuar gjatë vitit të kaluar.

Për këtë vit ne kemi përcaktuar objektivat për metodologjinë, të cilat përmbliohen në përditësimin e standardeve të auditimit dhe të formularëve standard, si dhe në kontrollin dhe sigurimin e cilësisë gjatë auditimit.

2. Në Rezolutë, ju keni kërkuar zhvillimin e burimeve njerëzore, me synim rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, veçanërisht të atij kontrollues. KLSH në Planin e Zhvillimit Strategjik 2009-2012 dhe në programin e veprimtarisë të vitit 2011 kishte përcaktuar drejtimet dhe aktivitetet.

Programi është njëra anë dhe ka rëndësinë e tij, por kryesorja dhe më e vështira është ndjekja e zbatimit të aktiviteteve të programuara, shkalla dhe cilësia e zbatimit të tyre, të cilat kanë lënë për të dëshiruar. Aplikimi i produkteve të përfuara nga Projekti i Binjakëzimit i viteve 2008-2009 dhe trajnimi e kualifikimi i punonjësve të cilët nuk kanë marrë pjesë të drejtpërdrejtë në këtë projekt është konsideruar prioritar. Megjithatë, në praktikë në vitin 2011 ka munguar asistencë konkrete e huaj dhe treguesi i trajnimit dhe kualifikimit të personelit prej 2.1 ditë trajnim në vit për punonjës është shumë i ulët. Kryerja me cilësi e auditimeve financiare dhe të performancës kërkon domosdoshmërisht rritjen e kapaciteteve të stafit. Politikat e përfuturit të stafit cilësor gjatë vitit të kaluar kanë qenë të mangëta. Në KLSH nuk janë bërë rekrutime me shpallje, me procedura konkurrimi, por kanë qenë të punësuar 22 punonjës me kontrata të përkohshme pune pa afat ose me afat deri në 31.12.2011. Të gjithë këta punonjës, më datën 28 dhjetor 2011, iu nënshtruan një testimi të aftësive profesionale, për të vlerësuar përshtatshmërinë ose jo të tyre për të vijuar marrëdhëniet e punës me KLSH. Testimi rezultoi në vlerësime të dobëta për 15 prej tyre. Ky fakt flet qartë se rekrutimi jo mbi baza transparence dhe konkurrence prodhon staf cilësisht të dobët, për pasojë dëmton në tërësi punën e institucionit, pasi duke qenë natyra e punës audituese, punë në ekip, mangësitë e këtij stafi rrezikojnë të kompromentojnë edhe cilësinë e punës së stafit ekzistues. Duke filluar nga 1 Janari 2012, procedurat për plotësimin e vendeve të lira kanë filluar të shpallen rregullisht dhe rekrutimi të realizohet nëpërmjet konkurrimit me anë të testimit të njohurive dhe përzgjedhjes mbi kritere objektive (Për më shumë shih faqen 55 të Raportit Vjetor 2011).

Duke konsideruar një lidhje të forte mes shtimit të kapaciteteve dhe rritjes së vëllimit të trajnimeve të stafit, në shkurt 2012 kemi nxjerrë një urdhër të brendshëm ku përcaktojmë një limit të poshtëm prej 10 ditësh trajnimi në vit për punonjës të KLSH dhe 25 ditësh trajnimi për punonjësit e rinj. Mirëpo, po

hasim shumë vështirësi në gjetjen e trajnuesve të përshtatshëm dhe thithjen e ekspertizës jashtë institucionit, ngaqë mungon fondi për pagesat e ekspertëve të jashtëm për vitin 2012. Minimumi nevojiten 10 milionë lekë.

Ndërkohë, edhe pse e kufizuar, për vitin 2011 duhet nënvizuar pjesëmarrja e punonjësve të KLSH për shkëmbimin e përvojave dhe përfitim të njohurive në trajnimet e zhvilluar nga ITAP⁴, nga Agjencia e Prokurimit Publik, nga institucione si përfaqësia e BB në Tiranë, nga organizmat ndërkombëtarë të kontrollit në programet e trajnimit në distancë (IDI, INTOSAI) dhe nga institucionet homologe. Eksperienca e përftuar nga këta punonjës të kufizuar të trajnuar mund të shfrytëzohet dhe këta punonjës të kthehen në trajnerë për pjesën e gjerë të stafit të KLSH që nuk ka marrë kualifikim, gjatë këtij viti dhe në vitet në vijim.

3. Ju keni kërkuar ritjen e cilësisë në kontrollin e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, fondeve të projekteve të financuara nga BE dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare. KLSH ka punuar për njohjen dhe përditësimin në vijimësi të kontrollorëve me dispozitat ligjore e nënligjore, si kusht i domosdoshëm për njohjen dhe vlerësimin e veprimtarisë së subjekteve të audituara, argumentimin e zbulimeve, nxjerrjen e konkluzioneve, përgjegjësisë dhe rekomandimeve përkatëse. Krahas sigurimit të legjislacionit nëpërmjet fletoreve zyrtare, shfrytëzimit të internetit dhe sistemit kompjuterik të institucionit, institucioni ka bërë përditësim të paketës me dispozitat ligjore e nënligjore më kryesore. Megjithatë, njohja e audituesve me të rejtat e dispozitave ligjore e nënligjore më kryesore është e pakët dhe lë shumë për të dëshiruar.

Kontrolli i përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit është detyrim kushtetues për KLSH dhe nga 152 subjekte të kontrolluara gjatë vitit të kaluar, auditimi për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2010 u krye në 94 subjekte, si ministri dhe institucione qëndrore, njësi të pushtetit vendor, agjenci apo projekte që

operojnë me fonde buxhetore. Institucioni kontrolloi në këto auditime realizimin e fondeve buxhetore sipas politikave të programeve, shkallën e realizimit të produkteve dhe kostove përkatëse dhe dha opinionet e tij mbi raportet e monitorimit të ministrive të kontrolluara dhe të Ministrisë së Financave.

Gjatë vitit 2011 janë kontrolluar 9 projekte me fonde të huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare si Banka Botërore, Banka Evropiane e Investimeve, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Gjermane (KfW) etj., në fusha të ndryshme si infrastrukturën rrugore, në energjitikë, në arsim dhe shëndetësi dhe në sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Në kontrollet e ushtruar, përgjithësisht është konstatuar se konsumohet një kohë e gjatë për procesin e negociatave, për hartimin e nënshkrimit të marrëveshjeve dhe bërjen efektive të tyre, duke sjellë jo vetëm pasoja në rritjen e kostos së projekteve, por edhe mangësi në plotësimin e objektivave.

Rritja e efektivitetit të investimeve me financime të huaja nga KLSH është trajtuar e lidhur ngushtë me plotësimin në sasi, cilësi dhe afat të objektivave dhe të komponentëve të projektit. Ndonëse, gjatë ushtrimit të kontrolleve institucioni ka konstatuar edhe dëme ekonomike, të evidentuara kryesisht në fushën e pagave, shpërblimeve dhe prokurimeve në vlerën rreth 64.7 milionë lekë, si në Projektin “Ndërtimi i rrugës Lushnjë-Fier, vlera e dëmit 28.8 milionë lekë” dhe “Menaxhimi i burimeve ujore, 24.7 milionë lekë”; ato nuk janë parë si qëllim në vetvete.

Kohët e fundit, kapitali dhe fondet e huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare, po kontrollohen dhe në një këndvështrim tjetër, në atë mbi vlerësimin e parimeve të përdorura për kontabilitetin dhe çmuarjet e bëra nga menaxhimi, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare, ku sipas situatës konkrete përgatiten dhe dërgohen për zbatim rekomandimet përkatëse.

Në kontekstin e kërkesës së Kuvendit për rritjen e cilësisë së kontrollit, bëj me dije se veprimtaria audituese e KLSH^{-së} për vitin 2011 është bazuar në planifikimin strategjik të kontrolleve të përcaktuara për atë vit, produkt i ndërthurjes së përvojës shumëvjeçare të KLSH^{-së} në fushën e planifikimit, me materialet e trajnimit dhe përvojën e mirë të Zyrës Kombëtare të Auditimit (NAO) të Britanisë së Madhe. Ndonëse kontrollet si numër janë realizuar dhe tejkaluar, në strukturë ato nuk janë realizuar sipas programit të veprimtarisë të miratuar në fillim të vitit. Krahas kësaj mangësie, shqetësim përbën cilësia e zhvillimit dhe përgatitjes së materialeve të auditimeve financiare e të performancës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në manualet e këtyre dy auditimeve, sidomos të atij të performancës. Sfida për rritjen e cilësisë së auditimeve na ka shtyrë që në shkurt të vitit 2012 të krijojmë Departamentin e Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Kontrollit të Brendshëm.

4. Në Rezolutë, ju keni kërkuar zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe intensifikimin e trajnimit të punonjësve. Megjithë masat e marra, kryesisht në blerjen e pajisjeve kompjuterike, gjatë vitit 2011 KLSH nuk ka njohur progres, si rezultat i zhvillimit me hope dhe jo harmonik të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit. Ambienti në të cilin zhvillohet kjo teknologji informacioni, për mungesë totale të hapësirave të punës, ndrydh dhe deformon edhe ato investime që janë kryer vite më pare. Pasja e një rrjeti kompjuterik të amortizuar fizikisht dhe moralisht (i para 10 vitesh) dhe pa parametrat e standardet e përcaktuara nga AKSHI përbëjnë një pengesë të pakompensueshme. **Mungesa e një godine të re për KLSH na detyron që dhe investimi në sistemin e teknologjisë së informacionit të mos jetë i duhuri.** Kjo çështje është një kërkesë vazhdueshme e ekipeve të SIGMA^{-s}, e cila që nga viti 2007 e ka evidentuar në raportet e saj të vlerësimit që adreson për ekonominë, qeverinë dhe institucionet shqiptare. Kështu, në raportin e saj të vitit 2008, thuhet se "...KLSH është vendosur në ndërtesën e administratës

së Kuvendit, por i duhet të lëvizë në një vendndodhje të re. Që nga fillimi i vitit 2007...po pritet për një vendim të Këshillit të Ministrave në cilën ndërtesë do të vendoset...Kjo vonesë në zhvendosje ka pasoja negative në zhvillimin e teknologjisë së informacionit brënda KLSH”. Në raportin e SIGMA për vitin 2011 sërish cilësohet se “...KLSH ende vuan nga ambiente pune të papërshtatshme, të cilat, ndër problemet e tjera, pengojnë investimin e domosdoshëm në infrastrukturën e IT”. Në takimin e datës 19 janar 2012 me Kryetarin e KLSH, Kryeministri Berisha premtoi t’i jepte një zgjidhje sa më të shpejtë dhe të përshtatshme sistemimit të institucionit me ambiente zyrash që mund të hapin rrugë për investimet dhe përmirësimet e nevojshme në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit.

Në tërësi, rezulton se zhvillimi i burimeve njerëzore në KLSH në fushën e IT gjatë vitit 2011 lë mjaft për të dëshiruar. Sasia e trajnimeve për stafin e IT ka qenë e pakët, dhe ato pak trajnime që janë organizuar nga institucionet homologe dhe ato të përfituara nga suporti i dhënë nga qeveria në kontekstin e e-gov nuk janë shfrytëzuar si dhe sa duhet. KLSH ka programuar trajnime të posaçme për të fituar e zhvilluar këto aftësi, siç janë trajnimet për njohjen me teknologjinë e informacionit, programin IDEA, si dhe programet “Financa 5”, “Alpha” dhe “Oracle”, por këto programe nuk u realizuan gjatë vitit 2011. Ne patjetër do t’i realizojmë këtë vit.

5. Ju keni kërkuar harmonizimin e veprimtarisë audituese të kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm dhe rritjen e rolit mbikëqyrës ndaj strukturave të auditimit të brendshëm. Krahas Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, KLSH ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi dhe me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MF^{ve}, Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MB^{me}, kohët e fundit me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik etj. Megjithëse këto marrëdhënie janë vendosur formalisht, shkëmbimi i informacionit mes palëve nuk ka njohur vijimësi dhe rreziku i mbivendosjes në

kontrolle ngelet sërish të lartë. KLSH vlerëson shumë pozitivisht punën e këtyre njësive profesionale dhe shpreson që në të ardhmen e afërt bashkëpunimi me të jetë konkret, në të mirë të rritjes së efikasitetit të auditimit të brendshëm.

Përsa i përket punës me auditimin e brendshëm, gjatë vitit analizues KLSH ka ushtruar:

- Mbikqyrjen e funksionimit të auditimit të brendshëm në 17 subjekte në nivel qendror si: ministri, universitete shtetërore, drejtori të Përgjithshme, institute etj.,
- Vlerësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm në 7 institucione qendrore,
- Mbikqyrjen e organizimit dhe funksionimit të njësive të auditimit në qeverisjen vendore, në 18 bashki, një komunë dhe një ndërmarrje; si dhe
- Mbikqyrjen e funksionimit të auditimit të brendshëm në 14 ndërmarrje dhe shoqëri tregtare (me kapital shtetëror).

Procesi i vlerësimeve dhe mbikqyrjeve, arrijtjet dhe dobësitë apo shkeljet ligjore të vërejtura, janë pasqyruar në Raportet Përfundimtare të Kontrollit, të cilat u janë përcjellë së bashku me rekomandimet përmirësuese përkatëse subjekteve të audituara.

6. Në Rezolutë, ju keni kërkuar konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit.

Marrëdhëniet me Kuvendin burojnë nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i KLSH^{së}. Këto marrëdhënie nga njëri vit në tjetrin janë fuqizuar dhe konsoliduar më tej. Kuvendi me Komisionet e tij, në veçanti Komisioni i Ekonomisë dhe Financës, në vijimësi ka mbështetur dhe inkurajuar veprimtarinë e institucionit. Në këtë këndvështrim, përmendim kontaktet apo shkëmbimin e opinionëve për

kontrollet më të rëndësishme dhe rezolutat e viteve të fundit për veprimtarinë e KLSH.

Institucioni është përpjekur për të përmbushur në kohë detyrimet kushtetuese, si nëpërmjet informimit dhe raportimit në vijimësi për rezultatet e kontrolleve, ashtu dhe për përgatitjen dhe dërgimin në kohë në Kuvend të raporteve të parashikuara në Kushtetutë dhe në Ligjin Organik të tij, të buletinit 3-mujor për rezultatet e kontrolleve të ushtruara për periudhën respektive dhe të një numri materialesh të ndryshëm, me interes në fushën e veprimtarisë audituese.

Bashkëpunimi i KLSH me Këshillin e Ministrave dhe institucionet e tjera qendrore ka qenë i rregullt dhe gjithëvjeter gjatë 2011-ës, por përmasa e tij për thellimin e luftës dhe për parandalimin e korrupsionit nuk ka qenë e zhvilluar në nivel të pritshmërive të publikut.

Institucioni ka dhënë kontribut real në diskutimin dhe përgatitjen e projekt-akteve të ndryshme ligjore, si ai për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, për prokurimin publik, për menaxhimin financiar dhe kontrollin, inspektimin financiar publik, etj.

Lidhur me përmirësimin e Ligjit Organik të KLSH, drafti i përgatitur në konsultim me ekspertët e Gjykatës së Auditimit të Holandës dhe NAO të Britanisë së Madhe nuk është paraqitur në Kuvend, për arsye subjektive. Amendimet që institucioni ka përgatitur janë bërë në përputhje me përcaktimet në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe drafti u është shpërndarë për konsultim institucioneve ndërkombëtare të kontrollit dhe të Evropës, përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të BE dhe SIGMA. Në këto muaj të parë të 2012-ës kemi intensifikuar punën për plotësimin përfundimtar të draftit. Fushat kryesore të përmirësimit të Ligjit organik të KLSH janë rregullimi në mënyrë përfundimtare i pavarësisë së institucionit, konceptimi modern i të drejtave dhe detyrave të KLSH, rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të tij, rritja e kapaciteteve administrative, saktësimi i së drejtës së KLSH të

auditojë fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë, deri tek përdoruesi i fundit dhe saktësimi i së drejtës të çertifikojë llogaritë financiare. Mendojmë që brenda muajit prill 2012 ta paraqesim në Kuvend për shqyrtim.

7. Në Rezolutë ju keni kërkuar rritjen e bashkëpunimit me organet e drejtësisë për shlyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.

Me keqardhje konstatoj se marrëdhëniet e bashkëpunimit dypalësh me organet e prokurorisë gjatë vitit 2011 kanë munguar. Ato kanë ekzistuar formale në ndjekjen dhe plotësimin e angazhimeve të përcaktuara në Memorandumin e Bashkëpunimit për ngritjen e njësive të përbashkëta të hetimit rajonal, të nënshkruar në kuadër të Programit të USAID dhe Departamentit të Drejtësisë të SHBA, Pragu i Mijëvjecarit II^{të}, më datë 6 maj 2009, nga 6 (gjashtë) institucione të vendit, si Prokuroria e Përgjithshme, MB, MF, SHISH, KLSH dhe ILKDP.

Aktiviteti kontrollues i KLSH^{së} në vitin 2011, ka evidentuar si fusha me rrezikshmëri më të lartë për shfaqjen e krimit ekonomik dhe korrupsionit: investimet publike, përfshirë prokurimet dhe zbatimin e projekteve me fonde publike; konçesionet dhe administrimin e investimeve me financime të huaja; mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore; rregullimin e territorit; rregjistrimin e pronës, etj. Këtë e dëshmon fakti se ato pak kallëzime që KLSH ka depozituar vitet e fundit në Prokurori janë bërë për zbulime të shkeljeve me pasojë dëm ekonomik pikërisht në këto fusha dhe kryesisht për konsumim të veprave penale si “Shpërdorimi i detyrës”, “Shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera e ankande publike”, “Vepra penale në fushën e tatimeve” dhe “Falsifikimi i dokumentave”. Gjatë vitit 2011 janë bërë gjithsejt 6 kallëzime penale për 13 persona, për një vlerë tërësore dëmi prej 367 milionë e 657 mijë lekësh. Pak, shumë pak për një institucion si KLSH. Numri i kallëzimeve, që ka arritur maksimumin e vet në vitet 2005-2006, ka ardhur në rënie duke përfunduar në vitet 2010 -2011 në një rënie drastike në nivel

minimal. Ky është një numër shumë i vogël kallëzimesh, ndërkohë që niveli i zbulimeve të KLSH në terma financiarë nuk ka pësuar një rënie të ngjashme. Kjo tregon se përpjekjet e KLSH nuk kanë qenë të mjaftueshme në drejtim të dhënies rrugë për hetime të mëtejshme nga organet e Prokurorisë, për zbulimet e kontrollit që shoqërohen me efekte të mëdha financiare të fondeve dhe pasurisë publike. Shkëmbimet e ndërsjella mes KLSH dhe organeve të Prokurorisë kanë qenë të vakëta dhe të kufizuara vetëm në komunikime formale në kufijtë e kërkesave minimale të ligjit. Ka patur gjatë vitit 2011 një përgjumjeje të KLSH në drejtim të ndërveprimit me organet e prokurorisë. Në fund të vitit 2011, u bë një studim për nivelin sasior të kallëzimeve penale që KLSH ka depozituar në organet e prokurorisë për periudhën 2000–2011(Shihni për më shumë fq. 47 të Raportit Vjetor të KLSH dhe grafikun në fq. 47). Ky studim tregoi se ka një rënie të cilësisë së ndërveprimit mes institucioneve dhe shkaqet për rënien e këtij niveli të ndërveprimit, nga ana jonë duhen kërkuar fillimisht tek mungesa e vullnetit dhe mangësitë në performancën e KLSH, por edhe një indiferencë nga ana e organeve të Prokurorisë, e cila ka konsideruar vetëm 10% të rasteve të sjella nga KLSH gjatë viteve 2000-2011. Situata po ndryshon nga ana jonë gjatë këtij viti. Vetëm në këto tre muaj të parë në Prokurori janë kryer 5 kallzime penalë per shpërdorim detyre për 26 persona në Porti Detar Vlorë Sh.a., në ALUIZNI qendror dhe ALUIZNI Durrës, në komunën Petrelë dhe në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Në drejtim të auditimit të brendshëm të vetë institucionit, është shumë e rëndësishme që, duke qenë KLSH institucioni që kontrollon të gjithë administratën publike, duke vlerësuar edhe përgjegjshmërinë dhe transparencën e saj, duhet së pari që këto vlera dhe detyrime ligjore ky institucion t'i kërkojë tek vetja. Në rrethanat kur Kuvendi që nga viti 2001 nuk ka realizuar kontrollin e llogarive të institucionit, jemi përpjekur ta mbushim në një farë mënyre këtë boshllëk, duke paraqitur rezultatet e auditimit të brendshëm të institucionit në raportin vjetor që ju kemi dërguar. Sipas ligjit

organik të KLSH, neni 3 përcaktohet se llogaritë vjetore të KLSH përgatiten në përputhje me Ligjin për Buxhetin dhe kontrollohen nga një organizëm i pavarur, i caktuar nga Kuvendi dhe që raporton tek ai. Me shkresën nr. 208 datë 02.02.2012 i kemi kërkuar Kryesisë së Kuvendit të realizohet detyrimi ligjor për auditimin sa më parë të llogarive të KLSH për periudhën 2002-2011. Auditimin tonë nga jashtë e kanë kërkuar dhe këshilluar edhe ekspertët e SIGMA-s, në vlerësimet e tyre të përvitshme dhe në atë të ardhur gjatë këtyre ditëve të marsit 2012. Personalisht do ta vlerësoja së tepërmi angazhimin tuaj si deputetë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave për të ndihmuar në auditimin e KLSH-së.

Të nderuar deputetë,

Ky ka qenë reagimi i institucionit ndaj rekomandimeve që ju keni dhënë në qershor të vitit të kaluar. E quajta parësore raportimin për realizimin e këtyre rekomandimeve, jo vetëm në respekt të opinioneve tuaja të shprehura në këtë Rezolutë, por për lidhjen organike që institucioni që drejtoj duhet të ketë me Kuvendin në tërësi dhe me ju si Komision në veçanti.

II. Performanca e KLSH

Më lejoni në vijim t'ju informoj për performancën vjetore të institucionit dhe realizimin e objektivave të Planit të tij Strategjik të Zhvillimit 2009-2012 për vitin raportues 2011. Më konkretisht:

a) KLSH është përpjekur të zhvillojë dhe praktikojë një metodologji bashkëkohore, bazuar në standardet ndërkombëtare për kontrollin dhe praktikën e mira audituese të vendeve të BE, të asimiluara nga institucioni. Për këtë, ka përgatitur dhe nxjerrë në Intranet për përdorim nga punonjësit mjaft materiale, përfshirë standardet e kontrollit, rregullat bazë dhe procedurat për kryerjen e kontrolleve nga strukturat respektive në KLSH, manualët e auditimit, materiali udhëzues për sigurimin e cilësisë së kontrollit etj.

Mirëpo, ndonëse KLSH ka punuar dhe është përpjekur të zbatojë Rregulloren e tij të Brendshme, Standardet e veta të Kontrollit, Metodikat, Manualet e Auditimit Financiar e të Performancës dhe Kodin Etik, nuk ia ka arritur qëllimit për implementimin e tyre dhe të standardeve të përditësuara të INTOSAI, në përputhje me përcaktimet e parashtruara në këto akte. Audituesit në jo pak raste janë mjaftuar me dokumentacionet e ofruara nga subjektet e kontrolluara dhe ka munguar vullneti ose aftësia profesionale për implementimin e materialeve të sipërcituar, në zbulim të mashtrimit financiar dhe të korrupsionit;

b) Institucioni gjatë vitit 2011 ka pasur ecuri pozitive të veprimtarisë kontrolluese, si rrjedhojë e përcaktimit të kërkesave për kontrollin e cilësisë, përfshirë zbatimin me rigorozitet të rregullave procedurale për vlerësimin e sistemit të sigurimit të cilësisë dhe ndjekjes së zbatimit të tij, duke përdorur vlerësimin objektiv të 10% të dosjeve të kontrollit të përfunduara;

c) Sikurse kam përmendur më lart, gjatë periudhës ushtrimore janë realizuar dhe tejkalar detyrat e përcaktuara për veprimtarinë kontrolluese, përkatësisht nga 150 kontrole gjithsej të programuara janë realizuar 152 kontrole.

d) Në auditimet financiare të realizuara, përfshirë çertifikimin e pasqyrave financiare (ndonëse nga 15 të programuara, janë kryer vetëm 10 prej tyre), veprimtaria audituese e kontrollorit është mbështetur deri diku në manualin e auditimit financiar, përfshirë vlerësimin dhe përcaktimin e materialitetit dhe të riskut.

e) Në auditimet e performancës, rezultatet kanë qenë shumë të dobëta. Nga 5 auditime të tilla të programuara është realizuar vetëm një auditim dhe një tjetër është në proces. Shumë pak për një vit, gjë që tregon se ka munguar vëmendja e duhur nga institucioni për këtë lloj auditimi.

f) Veprimtaria për kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe evidentimin e hapësirave apo mospërputhjeve eventuale që mund të ekzistojnë, është shoqëruar me rritje të cilësisë së përgatitjes të propozimeve për ndryshime dhe përmirësime të dispozitave ligjore. Më konkretisht, gjatë vitit 2011 janë përgatitur dhe dërguar në organet respektive 45 propozime për ndryshime dhe përmirësime ligjore, nga të cilat 22 prej tyre janë zbatuar, ndërkohë që 13 propozime të tjera janë në proces zbatimi.

g) Dobia e rezultateve të kontrollit (impakti i kontrollit), rezulton në shumën totale 7,027 milionë lekë (ose rreth 70 milionë dollarë) dhe përfaqëson vlerën totale të zbulimeve të dëmit ekonomik të konstatuar, evidentuar dhe të raportuar në përfundim të kontrolleve të kryer gjatë vitit 2011.

Më konkretisht, sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar dëmet ekonomike, rezulton,

		<i>Në milionë/lekë</i>
A.1	Në shitjen dhe dhënien me qira të pasurisë shtetërore	352.2
A.2	Në prokurimet publike	210.3
A.3	Në sektorin doganor	184.0
A.4	Në fushën e shpërblimeve	149.3
A.5	Në urbanistikë	87.6
A.6	Në sektorin e tatimeve dhe taksave	49.0
A.7	Në sistemin e pagave	36.6
A.8	Në shpenzimet operative	25.0
A.9	Në fusha dhe sektorë të tjerë	5,933.0

Institucioni ka rekomanduar shpërblimin e këtij dëmi ekonomik në masën njëqind për qind në arkën e Shtetit, si dhe ka rekomanduar dhe masa korigjuese administrative e disiplinore, ndonëse në tërësi ato duhet të ishin më të forta (Për më shumë, shihni tabelat në fq. 65-67 të Raportit Vjetor 2011 të KLSH).

Nga vlera e dëmit prej mbi 7 miliardë lekë, peshën dërmuese me rreth 83.4% e zenë dëmet e evidentuara në dy shoqëri anonime, përkatësisht Albpetrol sh.a. Fier në vlerën 3,936,800 mijë lekë (shkaktuar nga moslikujtimi i detyrimeve prej 3,578,690 mijë lekë të rrjedhura nga furnizimi me naftë bruto, gaz natyror dhe hollues deri më datë 31.12.2010 nga kompania ARMO sh.a (ARMO Oil) dhe 358,110 mijë lekë nga moslikujtimi në afat i faturave të shitjes së naftës po nga kjo kompani) dhe Operatori i Sistemit të Trasmetimit të Energjisë Tiranë në vlerën 1,924,209 mijë lekë (moslikujdim i shërbimit të kryer për transmetimin e energjisë elektrike për periudhën nga privatizimi i OSSH deri më 15.12.2010), gjithsej 5,861,009 mijë lekë (Për më shumë, shihni fq. 65 e në vijim të Raportit Vjetor 2011 të KLSH).

Deri tani niveli i arkëtimit të shumës së dëmit total është shumë i ulët, vetëm 9.5 përqind i saj, ose 667 milionë lekë. Në këtë nivel të ulët realizimi ka ndikuar puna e pamjaftueshme e kryer nga strukturat përgjegjëse në KLSH për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të tyre, si dhe përgjegjshmëria e pakët e stafit drejtues apo bordeve të subjekteve të kontrolluara ku janë adresuar rekomandimet për shpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar.

h) Raporti ndërmjet vlerës së dëmeve ekonomike të konstatuara dhe evidentuara gjatë vitit kalendarik 2011, si dhe të kërkuar për shpërblimin e dëmit në shumën 7,027 milionë lekë dhe vlerës të raportuar me situacionin përfundimtar të shpenzimeve të KLSH^{-së} për këtë vit në shumën 253 milionë lekë tregon për shkallën e efektivitetit të veprimtarisë kontrolluese të KLSH^{-së}; dhe konkretisht, për çdo lek të investuar në KLSH gjatë vitit 2011, janë kërkuar për t'ju kthyer arkës së Shtetit 27.76 lekë.

Tregues tjetër i efektivitetit të veprimtarisë kontrolluese të KLSH^{-së} është vlera e shkeljeve financiare me pasojë dëm ekonomik të zbuluar mesatarisht në vitin 2011 nga një i punësuar në KLSH, përkatësisht 45 milionë lekë/për punonjës (7,027 milionë lekë:156 punonjës në organikë), nga 1.6 milionë lekë

të harxhuar mesatarisht gjatë vitit 2011 për çdo punonjës në organikë (253 milionë lekë : 156 punonjës në organikë).

Keta dy tregues dhe analiza të tjera (si p.sh nevoja për auditimin e IT, të rritjes së auditimeve të performances, etj.) do t'i paraqesim tek Ju, kur të kerkojme shtimin e numrit të personelit kontrollor në KLSH.

i) Krahas konsideratave të shprehura nga mjaft drejtues të subjekteve objekt kontrolli dhe specialistë të fushës së financës e të auditimit, për dobinë e kontrolleve të ushtruar dhe cilësinë e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, konkludojmë se niveli i zbatimit të masave të rekomanduara nga ana e KLSH gjatë vitit 2011 paraqitet relativisht mirë.

Në drejtim të rritjes së nivelit të zbatimit të masave përmirësuese të rekomanduara nga KLSH, ka ndikuar ndjeshëm Urdhëri i Kryeministrit nr. 70, datë 18.4.2006 "Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ e Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit e të Ministrave". Qëllimi kryesor i këtij Urdhëri është rritja e shkallës së zbatimit të ligjit. Sikurse thuhet shprehimisht në Pikën 1 të tij: "Të gjitha institucionet qëndrore, në vartësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshi dhe ndërmarrjet me kapital shtetëror a organizatat jofitimprurëse të subvencionuara nga shteti, që i nënshtrohen auditimit sipas legjislacionit në fuqi, që të marrin masat sipas afateve të përcaktuara në ligj e në këtë urdhër për zbatimin e rekomandimeve, të propozimeve, masave disiplinore dhe sugjerimeve që përcaktohen në raportet e :

- Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përputhje me nenet 2, 7, 15, 16 dhe 17 të ligjit organik të tij".

Niveli i zbatimit të Urdhërit është gjithashtu tregues për mënyrën e reagimit të institucioneve të kontrolluara ndaj rekomandimeve dhe masave të propozuara. Më konkretisht:

j.1. Masat organizative janë realizuar në masën 69% (në këtë nivel realizimi përfshihen dhe masat e realizuara pjesërisht, gjithsej 15). Nga 1605 masa të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar plotësisht 1093 prej tyre, pjesërisht 15, në proces 184 dhe nuk janë zbatuar 278 masa, ndërkohë që 35 nuk janë verifikuar nga KLSH.

Në krahasim me një vit më parë, ndonëse numri i masave të rekomanduara është rritur me 80 rekomandime (1605-1525), niveli i realizimit të tyre ka pësuar rënie. Kështu, nga 82.3% niveli i realizimit të rezultuar në vitin 2010, në vitin analizues 2011 ky nivel ka rezultuar në masën 69%, pra me një diferencë në ulje prej 13.3 pikë përqindje. (Për më shumë, shihni fq. 65 të Raportit Vjetor 2011 të KLSH).

Ndër institucionet që kanë nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë: MTKRS me 4 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 8 të rekomanduara, Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit me 8 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 14, MBUMK me 3 masa organizative të pazbatuara nga 11, MF me 2 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 4, dhe QSU “Nënë Tereza” Tiranë me 2 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 11 të rekomanduara (Për më shumë, shihni fq. 77 e në vijim dhe Tabelën në fq. 78 të Raportit Vjetor 2011 të KLSH).

j.2 Masat për shpërblimin e dëmit ekonomik janë tejet të pakta

Nga vlera e përgjithshme e dëmit ekonomik prej 7,027 milionë lekë rekomanduar për shpërblimin e dëmit të evidentuar, deri në fund të vitit 2011 janë nxjerrë urdhërat përkatës për shpërblimin e dëmit dhe janë në proces arkëtimi rreth 667 milionë lekë, ose në masën 9.5% të vlerës gjithsej të rekomanduar për shpërblim dëmi.

Sikurse e përmendëm dhe më lart, treguesi shumë i ulët i arkëtimit të shpërblimit të dëmit dëshmon për një përqëndrim të pakët të vëmendjes dhe punës së KLSH në këtë drejtim. Peshën kryesore në mosarkëtimin e vlerës

së demit ekonomik të shkaktuar e zenë Albpetrol sh.a me një dëm të konstatuar në vlerën 3,937 milionë lekë dhe OST Energji Tiranë me 1,924 milionë lekë, në total 5,861 milionë lekë, gjë që dëshmon për vështirësitë që ndeshin këto dy shoqëri në arkëtimin e dëmit efektiv.

Nga krahasimi i vlerave absolute të raportuara për shpërblimin e dëmit në vitin 2010 përkatësisht 787 milionë lekë, kundrejt 667 milionë lekë në vitin 2011, rezulton se në vitin 2011 janë dëmshpërblyer 120 milionë lekë më pak (Për më shumë, shihni fq. 78 e në vijim dhe Tabelat në fq. 78-79 të Raportit Vjetor 2011 të KLSH).

j.3 Masat administrative dhe disiplinore

Bazuar në përcaktimet në Ligjin Organik të KLSH i ndryshuar, ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, në “Kodin e punës”, ligjin për prokurimin publik, për urbanistikën, për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, për kontabilitetin etj., për parregullsitë dhe shkeljet e ndryshme të konstatuara me apo pa dëm ekonomik, KLSH, u ka rekomanduar subjekteve të kontrolluar dhe organeve respektive të emërtesës, shqyrtimin dhe marrjen e masave administrative dhe disiplinore ndaj punonjësve shkaktarë përgjegjës.

Nga 720 masa të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar 536 prej tyre, ose në masën 74.4%. Duhet theksuar që masat e rekomanduara nga KLSH për vitin 2011 janë në tërësi dytësore dhe jo parandaluese ndaj shkeljeve të ardhshme.

Në krahasim me një vit më parë, numri i masave të rekomanduara është ulur me 127 masa rekomanduese, gjithashtu niveli i realizimit ka pësuar rënie. Kështu, nga 80.8% niveli i realizimit të rezultuar në vitin 2010, në vitin analizues 2011 ky nivel ka rezultuar në masën 74.4%, pra me një diferencë në ulje prej 6.4 pikë përqindje.

Ndër masat administrative, nga 206 të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar 140 prej tyre ose në masën 67.9%, ndërkohë që rezultojnë të pazbatuara 66 masa të rekomanduara.

Ndër masat disiplinore, nga 514 të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar 396 prej tyre ose në masën rreth 77%, ndërkohë që janë pa përgjigje (të pazbatuara) 118 masa të rekomanduara.

Institucionet që kanë nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë MTKRS me 4 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 13 të rekomanduara, Fondi Shqiptar i Zhvillimit 0 të zbatuara nga 17 të rekomanduara, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan 0 nga 10, Dega e Doganës Qafë Thanë 0 nga 10, Dega e Doganës Durrës 0 nga 9 etj. (Për më shumë, shihni fq. 79 e në vijim dhe Tabelat në fq. 79-80 të Raportit Vjetor 2011 të KLSH).

Për vitin 2011, numri i masave të rekomanduara nuk i përgjigjet nivelit të konstatimeve dhe shkallës së përgjegjësisë të punonjësve shkaktarë përgjegjës. Më konkretisht, **janë shumë pak masat për largimin nga puna të personave shkaktarë përgjegjës të dëmeve të konstatuara.** Konstatimet dhe masat e

propozuara nga KLSH duhet të jenë të efektshme dhe të ndihen në publik. Duhet të heqim dorë nga zbulimi i vjedhjeve hipotetike, që s'ekzistojnë, për faktin se këto "zbulime" i shërbejnë mbulimit të korrupsionit të vërtetë. Një libër gri për nëpunësit abuzues do ta dorëzojmë çdo vit pranë Departamentit të Administratës Publike, institucioneve qendrore dhe më gjerë.

j.4 Propozimet për ndryshime apo përmirësime ligjore

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese në vitin 2011, *KLSH ka përgatitur dhe dërguar në strukturat respektive 45 propozime për ndryshim apo përmirësim të dispozitave ligjore në fuqi.* Nga totali i propozimeve të rekomanduara, janë zbatuar plotësisht 22 prej tyre, 13 janë në proces zbatimi, 9 rezultojnë të pazbatuara, kurse 1 propozim nuk është verifikuar.

Institucionet që rezultojnë me nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë: MTKRS me 3 rekomandime të pazbatuara dhe Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit me 2, ndërkohë që MF, DPRMSH, DPT dhe

KESH Sh.a. rezultojnë me nga 1 rekomandim të pazbatuar (Për më shumë, shihni fq. 80 e në vijim dhe Tabelën në fq. 81 të Raportit Vjetor 2011 të KLSH).;

k) Shpenzimet buxhetore të KLSH^{ssë} për vitin 2011 janë kryer në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, duke respektuar me rigorozitet kuotat e planifikuara të zërave të buxhetit, përfshirë pakësimet e bëra me ligj, respektivisht në shpenzimet operative 3 milionë lekë dhe në investime 7 milionë lekë, gjithsej 10 milionë lekë. Bëjmë me dije se institucioni vitin e kaluar kishte 155 punonjës dhe shpenzoi 253 milionë lekë (Për më shumë, shihni fq. 28 e në vijim dhe Tabelën në fq. 28 të Raportit Vjetor 2011 të KLSH);

l) Marrëdhëniet e bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë të kontrollit, si me INTOSAI, EUROSAI, Gjykatën e Llogarive të BE dhe me institucionet homologe të kontrollit, ndonëse kanë pasur vijimësi, nuk janë shfrytëzuar siç duhet dhe nuk kanë qenë shumë dobiprurëse për institucionin. Duhet theksuar se pozicioni i institucionit në këto marrëdhënie ka qenë statik, pritës, pa ndërmarrë vetë nisma konkrete;

m) Marrëdhëniet me Institucionin e Presidentit, Kryeministrinë, ministritë dhe institucionet qendrore, kanë qenë institucionale dhe të fokusuara në zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore në fushën e administrimit të vlerave materiale dhe monetare.

Kontaktet me organet e drejtësisë, ndonëse kanë pasur vijimësi, nuk kanë qenë frutdhënëse, sidomos me organin e prokurorisë. Marrëveshja e lidhur ndërmjet Kryetarit të KLSH dhe Prokurorit të Përgjithshëm në 6 maj 2005, nuk ka kënaqur pritshmëritë dhe nuk ka arritur në nivelin e kërkuar nga të gjithë aktorët, grupet e interesit dhe publiku i gjerë.

n) Në fushën e komunikimit me median, grupet e interesit dhe publikun e gjerë, KLSH megjithëse në vijimësi ka dhënë informacione të vlefshme e të

sakta, kryesisht për rezultatet e veprimtarisë kontrolluese, ka ende rrugë përpara për të bërë, për të siguruar përgjegjshmërinë dhe transparencën e duhur. Media e shkruar nga fillimi i muajit janar 2011 deri në fund të muajit dhjetor 2011 ka prodhuar gjithsej në faqet e saj 280 artikuj, editoriale si dhe komente analitike, nga të cilat vetëm 37 prej tyre ishin nga mesi i muajit Nëntor deri në fund të Dhjetorit, çka përkon me procesin e zgjedhjes së Kryetarit të Ri. Mediat audiovizive gjatë vitit 2011 kanë transmetuar 100 sekuenca filmike, edicione informative, apo kronika të ndryshme televizive për KLSH.

Ndërkohë që për periudhën 11 janar-19 mars 2012 vetëm artikuj, editorialë dhe komente analitike në median e shkruar janë rreth 120, ndërsa kronika televizive mbi 40.

III. Objektivat e vitit në vijim

Programi i veprimtarisë i KLSH për këtë vit synon tejkalimin e mangësive të vërejtura gjatë vitit 2011 dhe fuqizimin e mëtejshëm të rezultateve dhe arritjeve të derisotme të institucionit. Këtij qëllimi i shërben dhe hartimi e ndjekja e zbatimit të programit të objektivave dhe aktiviteteve brënda 100 ditëve, nga data 03 Janar deri në 15 Prill 2012, një pjesë e mirë e të cilave në momentin kur raportojmë është konkretizuar në përputhje me programin.

Më konkretisht, puna ka nisur intensive dhe do të përqëndrohet në vijimësi në:

1. Thellimin e realizimit të misionit kushtetues të KLSH në parandalimin e korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike. Për këtë, krahas punës për zbatimin e standardeve të perditesuara INTOSAI, kemi lidhur në muajin shkurt marrëveshje bashkëpunimi me ILDKP dhe kemi marrë kontaktet e para me organizatat me aktive të shoqërisë civile kundër korrupsionit, për të koordinuar punën me to. Nga ana tjetër, po përpiqemi për bashkëpunim konkret me Prokurorinë e përgjithshme, me Drejtorinë Antikorrupsion pranë Kryeministrisë, me Avokaturën e Shtetit dhe me të gjitha

institucionet e tjera shtetërore që luftojnë korrupsionin. Keto dite do të nenshkruajmë një marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës, për të shkëmbyer eksperiencën me vlerë në parandalimin e konfliktit të interesit dhe abuzimet me tenderat shtetërore.

2. Përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, duke kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës dhe auditimi i çertifikimit të pasqyrave financiare, krahas rritjes së efikasitetit të auditimit financiar. Kryerja me cilësi e auditimeve të performancës kërkon rritjen e kualifikimeve profesionale të stafit dhe për këtë vit. Sikurse e përmendëm në fillim, po hasim shumë vështirësi në gjetjen e trajnuesve të përshtatshëm dhe thithjen e ekspertizës jashtë institucionit, ngaqë munçon fondi për pagesat e ekspertëve të jashtëm për vitin 2012. Kur diskutohej buxheti i vitit 2012 në muajt tetor-nëntor 2011, KLSH nuk u paraqit në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe nuk kërkoi që ky fond minimalisht të ishte sa vitet e kaluara. Kjo mungesë po ndikon negativisht në punën tonë të këtij viti. Shpresojmë që duke e shpjeguar më gjerë këtë në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, të mund të gjejmë dashamirësinë tuaj dhe suportin e qeverisë për çeljen e këtij fondi.

3. Organizimin dhe sigurimin e kontrolleve me cilësi të lartë dhe efektivitet në përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit, fondeve të huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe ato të kapitalit të BE^{-së} të alokuar për Shqipërinë, si dhe kryerja e tyre me objektivitet dhe profesionalizëm. Hapja e institucionit ndaj praktikave më të mira ndërkombëtare të auditimit të jashtëm, të përditësuara në çdo kongres të fundit të INTOSAI dhe respektimi i orientimeve të MSA të Shqipërisë me Bashkimin Evropian është detyrë dhe sfida për institucionin. Kjo bëhet akoma dhe më e rëndësishme për fatet e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të vendit, sidomos në ditët tona të përjetimit të krizës në Eurozonë, kur disiplina buxhetore dhe financiare e administrimit publik është bërë përparësi absolute për përballimin e pasojave të kësaj krize.

KLSH, si strukturë e auditimit të jashtëm në sektorin publik ka një rol të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit dhe forcimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet e kontrollit. Për vitin 2012, gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese që në fazën e programimit të kontrollit, KLSH ka parashikuar të përfshijë në programin e kontrollit një drejtim të veçantë kontrolli *“Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit”*, i detajuar në nënpika, në drejtim të vlerësimit të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë këtij viti, në kuadër të bashkëpunimit me Njësinë Qendrore të Harmonizimit në Ministrinë e Financave, do të ndërmerim një cikël trajnimesh të kontrollorëve në përgjithësi dhe në veçanti, të audituesve që do të kryejnë kontrole dhe specializohen për këtë fushë auditimi.

Është kërkesë e re e kohës dhe e zhvillimeve në fushën e menaxhimit financiar publik që KLSH të përfshijë si objekt të punës së tij vlerësimin e veprimtarisë së MF për zbatimin e letër politikave 2010-2014 për kontrollin e brendshëm financiar publik. Në këtë drejtim, kemi vendosur si prioritet trajnimin e kontrollorëve në këtë fushë, duke u asistuar dhe financuar edhe nga organizmat ndërkombëtare.

4. Komunikimin dhe ndërveprimin më aktiv me Kuvendin, Qeverinë dhe partnerët e tjerë institucionalë, sidomos intensifikimin e konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2013-2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues. Brenda gjysmës së dytë të këtij viti do të përgatisim Planin Afatmesëm Strategjik të Zhvillimit të institucionit për vitet 2013-2015, për të cilin i kemi kërkuar asistencë teknike SIGMA-s.

5. Programimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditimit të financave publike, si dhe me organizata profesionale të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë. Këto ditë

nënshkruajmë marrëveshjen e bashkëpunimit me Fakultetin Ekonomik të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe jemi në bisedime për bashkëpunim konkret me institucione profesionale si IEKA, etj.

6. Intensifikimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të auditimit si INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të kontrollit të BE^{-së}, si SIGMA dhe Gjykata Evropiane e Audituesve, me institucionet homologe të vendeve të BE dhe të rajonit, dhe në veçanti me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës. Sfida jonë për vitet në vijim do të jetë partneriteti me Delegacionin e BE në Tiranë (edhe pse për këtë vit nuk arrijmë dot të përfitojmë programet IPA, për shkak të mungesës së aplikimeve tona gjatë vitit 2011), me Gjykatën Evropiane të Audituesve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të KE në Bruksel. Do të synojmë të marrim pjesë në programet e kontrollit të Gjykatës Evropiane të Audituesve për vendet që aspirojnë për në BE dhe që përfitojnë nga programet e asistencës së BE^{-së}, përfshirë vendin tonë. Për thellimin e dijeve në auditimin e performancës, do të vazhdojmë partneritetin me institucione homologe që na kanë ndihmuar në të kaluarën, si Zyra Kombëtare e Auditimit e Britanisë së Madhe apo Gjykata Hollandeze e Auditimit, por njëkohësisht duke kërkuar partneritet edhe nga institucioni homolog gjerman, suedez apo i vendeve të tjera të fuqishme të EUROSAI. Sikurse e thotë me mprehtësi z. Terence Nombembe, kryetar i Bordit Drejtues të INTOSAI-t dhe Auditor i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut, *“Ne do ta forcojmë pavarësinë tonë me një armë që askush s’do guxonte të na e merrte: diturinë mbi auditimin, që na pajis me ide ose mendime të pavarura dhe analizë”*.

Ne si KLSH jemi futur në procesin vullnetar të rishikimit mes kolegëve (peer review) në komunitetin e drejtuesve të SAI-ve evropiane në EUROSAI dhe presim asistencë nga Komiteti përkatës i EUROSAI.

Rëndësi të veçantë po i kushtojmë marrëdhënieve të bashkëpunimit me SIGMA, në mënyrë që të asistohemi nga kjo organizatë për të siguruar trajnimet aq shumë të nevojshme për stafin e KLSH që këtë vit. U kemi

dërguar kërkesat tona konkrete për asistencë teknike dhe jemi në pritje të reagimit të tyre. Kemi ftuar për bashkëpunim Zyrën e Bankes Botërore në Shqipëri dhe kemi marrë interesimin e saj për të hulumtuar mundësitë e një programi të gjere asistence nepermjet nje granti nga ana e Bankes. Po ashtu, kemi marrë një përgjigje të parë pozitive edhe prej SAI-t suedez për mundësi projekti partneriteti me të.

Ne do t'i kushtojmë gjatë këtij viti e më tej rëndësinë e duhur bashkëpunimit me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, me të cilin nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi në shkurt 2012. Kjo marrëveshje parashikon vizita të ndërsjellta dhe trajnime, ku KLSH mund të përfitojë nga kontributi cilësor që kjo Zyrë e Kosovës ka marrë nga drejtimi i saj prej një autoriteti të njohur të komunitetit ndërkombëtar të auditimit të jashtëm publik. Të dyja institucionet e kontrollit të lartë kanë vendosur të unifikojnë terminologjinë e auditimit në gjuhën shqipe.

Jemi të vendosur të ecim drejt përmirësimit të standardeve tona të auditimit me moton e INTOSAI “*Experientia mutual omnibus prodest*” (Eksperiencia e përbashkët i shërben të gjithëve).

7. Zhvillimin e burimeve njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga institucionet ndërkombëtare të auditimit dhe në përputhje me sfidat integruese të vendit. Në këtë kontekst, do të përshtaten më mirë cilësitë profesionale dhe aftësitë e secilit punonjës, me strukturën organike të institucionit, duke bashkuar strukturat ekzistuese apo krijuar struktura të reja. Do të ketë rritje cilësore dhe të numrit të kontrollorëve të trajnuar brënda dhe jashtë institucionit, mbi bazën e listës së nevojave reale të stafit për ngritjen profesionale dhe të kërkesave të shtruara për institucionet supreme të kontrollit në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara të datës 22 dhjetor 2011 për rritjen e efijencës së SAI dhe të kërkesave në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit të Shqipërisë me BE. Sipas Rezolutës së OKB-së, “*Vendet anëtare*

të Kombeve të Bashkuara theksojnë vlerësimin e tyre për punën e INTOSAI për promovimin e një efijence, përgjegjshmërie, efektiviteti dhe transparence më të madhe në marrjen e duhur dhe përdorimin e burimeve publike në përfitim të qytetarëve. Rezoluta po ashtu shpreh vlerësim për Deklaratat e Meksikos dhe të Limës dhe i nxit vendet anëtare që të aplikojnë, në përputhje me strukturat e tyre institucionale kombëtare, parimet e vendosura në këto deklarata”.

8. Ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në teknologjinë e informacionit. Qeverisja elektronike po fiton gjithnjë e më shumë terren në administrimin e pasurisë publike dhe ofrimin e shërbimeve publike në Shqipëri dhe është e kuptueshme që përdorimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit të shoqërohet edhe me forma të reja të krimit ekonomik. Kjo është edhe një nga sfidat më të rëndësishme të KLSH në një periudhë afatshkurtër.

9. Përmirësimin e transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse të interesuara për bashkëpunim. Vend të veçantë do të zërë partneriteti i KLSH me shoqërinë civile të angazhuar në luftën për parandalimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit.

Për t'i dhënë një impuls, përmbajtje dhe formë krejtësisht të re këtyre marrëdhënieve, brënda progamit të 100 ditëve kemi miratuar *një udhëzues të veçantë për mënyrën e administrimit të kërkesë/ankesave të publikut*, që nga momenti i mbërritjes së tyre dhe deri në dhënien e zgjidhjeve të mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe burimeve njerëzore që disponon KLSH.

Për këtë vit, ndër objektivat kryesorë të KLSH në marrëdhënien me publikun renditet rritja e impaktit në komunikim, njoftime tërësisht transparente, shpërndarja më e gjerë e raporteve të veprimtarisë kontrolluese, si dhe forcimi

i kontakteve me të gjithë aktorët dhe faktorët mediatike të vendit tonë, si analistë të njohur, OJF të angazhuara në luftën kundër korrupsionit, etj. Synimi është përcjellja sa më e shpejtë dhe me vërtetësi e të gjithë veprimtarisë kontrolluese të KLSH tek publiku i gjerë, duke shërbyer si një mjet efikas denoncimi dhe parandalimi të korrupsionit

Në mbyllje, dua t'ju garantoj se do të punojmë për një institucion të lartë auditimi që siguron një komunitet të angazhuar që ka interes ta mbajë qeverisjen qendrore dhe vendore përgjegjëse. Për këtë do të fuqizojmë rolin e pazëvendësueshëm kushtetues të KLSH si institucioni kryesor ekonomiko-financiar, për ekonominë dhe shoqërinë tonë, me detyrë kontrollin e mirëadministrimit të pronës publike dhe shëndoshjen e financave publike, duke i shërbyer me devotshmëri Kuvendit dhe duke rritur pjesëmarrjen e opinionit publik në kontrollin e realizimit të Buxhetit të Shtetit.

Vërejtjet, mendimet dhe propozimet që mund të parashtroji në diskutimet tuaja, do të plotësojnë më së miri drejtimit dhe objektivat e punës sonë.

Ju faleminderit!

Bujar LESKAJ

Tiranë, më 20 Mars 2012

Mbledhja e Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit, mbajtur më datën 20 mars 2012

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i raportit vjetor të Kontrollit të Lartë të Shteti për vitin 2011.

Marrin pjesë:

Edmond Spaho, Selami Xhepa, Gokë Uldedaj, Albana Vokshi, Sybi Hida, Sherefedin Shehu, Luan Skuqi, Florion Mima, Albert Çaçi, Arben Ahmetaj, Gjovalin Kadelli, Ilir Bejtja, Ervin Koçi, Mimi Kodheli, Flamur Noka, Erion Braçe, Arben Malaj, Ledina Alolli dhe Besnik Dushaj.

Të ftuar:

Bujar Leskaj – kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Robert Gjini – drejtor i përgjithshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Elvana Tivari – drejtoreshë e Drejtorisë Juridike në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Lulieta Nano – kryespecialiste në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Edmond Spaho – Zoti Leskaj, falemnderit për ekspozenë e plotë dhe orientuese për debatin që do të zhvillojnë deputetët në lidhje me aktivitetin e institucionit tuaj gjatë vitit të shkuar dhe detyrat që keni për vitin në vazhdim.

Fjalën e ka zoti Mima, si relator.

Florion Mima

Mirëserdhët, zoti Leskaj!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kontrolli i Lartë i Shtetit vjen sot përpara Komisionit të Ekonomisë dhe të Financës së Kuvendit të Shqipërisë me një raport të plotë, dinjitoz, të saktë dhe realist rreth

aktivitetit të tij për vitin e kaluar, i cili ngërthen në vetvete qindra dhe mijëra veprimtari, aksione, reforma, organizime, ristrukturime, programe, operacione,



metodika, metodologji dhe plane, të cilat në përfundim i japin garancinë këtij komisioni se kjo trupë e ngritur nga Kuvendi për t'u siguruar për eficiencën e efikasitetin e përdorimit të fondeve publike më në fund është vënë në shina të drejta. Drejtimi i ri, specifikisht kreu i tij, është kthyer shumë shpejt në strumbullarin e të gjitha reformave transformuese të këtij institucioni, të cilat do ta sjellin atë më në fund në linjë me praktikën më të mirë europiane dhe botërore. Theksoj se raporti për herë të parë përmban tone autokritike, jo thjesht për faktin se ka ndodhur një rotacion në drejtimin e lartë të institucionit, por më shumë nga nevoja për reformimin rrënjësor të punës. Kjo gjë kishte kohë që ishte bërë prioritare. Pa njohur të metat dhe mangësitë e gjendjes ku ndodhesh, kurrë nuk mund të piketosh drejt dhe saktë në lartësitë ku kërkon të arrish dhe të përdorësh mjetet e metodat që do të bëjnë të mundur reformimin. Raporti vëren me realizëm se vetëm 9.5 për qind e rekomandimeve të KLSH-së për zhdëmtimin e dëmit të krijuar janë marrë parasysh nga entet dhe institucionet e audituara. Po ashtu, raporti konfirmon po me realizëm se bashkëpunimi me organet e prokurorisë për mangësi të dyanshme është konkretizuar në vetëm 6 raste.

Auditimi i performancës ka qenë formal dhe cilësia e tij ka lënë shumë për të dëshiruar. Strukturat e brendshme të KLSH-së kanë vepruar të pakoordinuara me njëra-tjetrën, si dhe nuk kanë shfrytëzuar avantazhet e teknologjisë së informacionit, siç është rasti i programit "IDEA", i cili përdoret gjerësisht nga trupat homologe.

Për vitin 2012 KLSH-ja ka një plan të qartë për riorganizimin rrënjësor të punës, sidomos për sa i përket auditimit të performancës dhe fuqizimit të auditimit financiar. Do të vihen në jetë marrëveshje të rëndësishme për shkëmbin e eksperiencës, mbështetje dhe trajnime nga SIGMA.

Do të finalizohet marrëveshja me Ministrinë e Financave, me njësinë e harmonizimit të auditit të brendshëm, për të sinergjizuar punën me audituesit e brendshëm të subjekteve të kontrolluara dhe për të shmangur dublimet në

kontrolle. Institucioni do të hapet edhe më shumë në të ardhmen ndaj medias, ndaj botës akademike dhe ndaj shoqërisë civile.

Shumë shpejt ky institucion do të shndërrohet në një institucion publik modern të auditimit të jashtëm, INTOSAI, i cili funksionon në përputhje me standardet e përditësuara të fushës.

Në përfundim, ftoj të gjithë kolegët e nderuar të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të miratojmë raportin e rezolutën që e pason atë, të garantojmë zotin Leskaj se do të ketë gjithmonë një dorë të hapur në këtë komision dhe një dorë të shtrirë për ndihmë e bashkëpunim reciprok.

Ju falemnderit!

Edmond Spaho – Falemnderit, zoti Mima!

Pyetje?

Fjalën e ka zoti Braçe.

Erion Braçe – Zoti Leskaj, kam disa pyetje që lidhen me problematikën që ju keni paraqitur, por edhe me objektivat që ju prezantuat këtu për vitin e ardhshëm.

Pyetja e parë: ju u kujdesët shumë për të thënë që dëmi i zbuluar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit përgjatë vitit 2011 është i ulët. Mbase për shkak se media i ka kushtuar shumë vëmendje pikërisht këtij fakti, u kujdesët shumë për të thënë se dëmi...

Edmond Spaho – Ai është realist. Pra, paraqet realitetin.

Erion Braçe – A do të më lejoni të bëj pyetjen, apo jo?!

Edmond Spaho – Po ju ndihmoj me terminologjinë.

Erion Braçe – Pra, u kujdesët shumë të thoni që, duke përjashtuar (po ju citoj ju tani) dëmin e ardhur nga dy kompanitë publike “Albpetrol” dhe “OST”, pjesa tjetër e dëmit është e vogël.

Bujar Leskaj – Epitetin “e vogël” nuk e kam përdorur asnjëherë.

Erion Braçe – Kur të zbardhet, do të jetë akoma më e qartë. Unë dua të di, për shkak se kam parë disa raporte të tjera ematike të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2011 se pse nuk janë përfshirë në këtë raportim voluminoz kontrolli i kryer në fushën e koncesioneve në Ministrinë e Ekonomisë, kontrolli i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve? Unë arrita deri të faqja 250 e ca. Më tutje ishte e tmerrshme ta lexoja.

Bujar Leskaj – Pse ishte e tmerrshme?

Erion Braçe – Për shkak të dëmit, zoti Leskaj.

Pse nuk është përfshirë kontrolli i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Legalizimeve?

E dyta, në referencë të asaj që ju thoni në faqen 65, shikoj me shqetësim se vlera prej 3,5 miliardë lekësh, që është dëmi i shkaktuar në Albpetrol në marrëdhënie me kompaninë “ARMO”, raportohet për të dytin vit radhazi. Tani, dua t’ju pyes ju se cili është shkak që bëhet kaq i vështirë arkëtimi i kësaj shume, kur bëhet fjalë për dy kompani? Njëra prej tyre është ende shtetërore, kurse në tjetrën shteti ka mbajtur një pjesë të aksioneve. E njëjta pyetje është edhe për OST-në. Me sa duket po krijohet një zinxhir borxhesh midis kompanive që operojnë në sektorin energjetik, gjë për të cilën kemi folur këtu në komision, por edhe në seancë plenare. Cili është problemi që ka lindur midis OST-së dhe kompanisë private “CEZ”, ku shteti ka përsëri një pjesë të aksioneve, për borxhin e krijuar nga dita e privatizimit e këtej, jo më herët? Pse bëhet e vështirë për t’u arkëtuar kjo shumë?

Së treti, duke parë më vëmendje objektivat që ju keni përcaktuar për të ardhmen (mund ta merrni edhe si sugjerim, por unë po e shtroj si pyetje), pse nuk është përfshirë në objektivat për vitin tjetër kontrolli i zbatimit të disa kontratave të privatizimit ose koncesionare, të miratuara me ligj të Kuvendit dhe që vitin tjetër kanë afate të rëndësishme për realizimin e tyre? E kam fjalën për kontratën për privatizimin e CEZ-it, e miratuar me ligjin e Kuvendit.

Shqetësimi im lidhet me investimet që duheshin kryer dhe me përmirësimin e cilësisë së shërbimit që është e parashikuar në kontratë, e miratuar me ligj të Kuvendit, moszbatimi i secilës sjell një dëm të lartë ekonomik.

Së dyti, për kompaninë “ARMO”, gjithashtu kjo kontratë, është e miratuar me ligj të Kuvendit. Në kufijtë e raportimit të zbatimit të kësaj kontrate, moszbatimi i saj sjell përsëri dëm ekonomik.

Së treti, kontrata e licencimit të operatorit të katërt celular, edhe kjo e dhënë me ligj të Kuvendit, madje me detyrime të përcaktuara në ligj për marrëdhënien brenda kësaj kompanie, por edhe për detyrimet që ka pasur.

Falemnderit!

Edmond Spaho – Fjalën e ka zoti Uldedaj.

Gjokë Uldedaj – Falemnderit, zoti kryetar i KLSH-së!

E vlerësoj realist raportin e KLSH-së. Dua të adresoj tri pyetje.

E parë, si e vlerësoni ju faktin që nga njëra anë ka rënie të shpërblimit të dëmeve, nga 2007-2011, referuar faqes 78, por nga ana tjetër ka një rritje të masave administrative, si dhe të një konstante të masave disiplinore?

Pyetja e dytë lidhet me faktin se ka një rënie të zbatimit të masave organizative të rekomanduara, çfarë do të thotë kjo për ju, si drejtues i ri i këtij institucioni? Si parashikoni të jenë këta tregues për vitin 2012?

Së treti, referuar faqes 90, ka një mosrealizim të auditimeve si për sa i përket sektorit publik, ashtu edhe qeverisjes vendore, përkatësisht 84.7 për qind apo 82 për qind, kjo ka ardhur për mungesë kapacitetesh, apo ka diçka tjetër?

Falemnderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka një mosrealizim të auditimeve të plota, qoftë në sektorin publik, qoftë në sektorin e qeverisjes vendore, përkatësisht 84.7 për qind dhe 82 për qind. Pyetja është kjo: këto mosrealizime kanë ardhur për mungesë kapacitetesh, apo ka diçka tjetër?

Edmond Spaho – Zoti kryetar, edhe unë kam disa pyetje.

Pyetja e parë ka të bëjë me prokurimet publike, e paraqitur e detajuar në faqen 71. Numri i konkurrentëve, mesatarisht, për çdo tender ka qenë tre. Pra, ka qenë numri minimal për t'u zhvilluar një procedurë prokurimi.



Në opinionin e institucionit tuaj, si e gjykoni konkurrencën në prokurimet publike gjatë vitit 2011?

Nga kontrollet që keni bërë, nga 689 procedura prokurimi, në 497 prej tyre janë konstatuar shkelje. Pra, 75 për qind të prokurimeve publike kanë pasur shkelje gjatë zhvillimit të tyre. Si e gjykoni këtë shifër kaq të lartë? Gjatë viteve 2010-2011 janë zhvilluar tenderët më të larë të zhvilluar nga buxheti i shtetit. Për shembull, Rruga e Arbërit, vlera e saj ka qenë rreth 2 miliardë lekë dhe është fituar tenderi, pothuajse, me këtë vlerë, pra nuk ka pasur ulje. Po kështu edhe rruga Librazhd-Qafshutë ka pasur vlerën 1.9 miliardë. Me po kaq është fituar tenderi, pra përsëri nuk ka pasur asnjë ulje. A keni gjetur shkelje gjatë kontrollit në këto prokurime, nëse i keni kontrolluar?

Pyetja tjetër lidhet me shoqërinë “Albpetrol”, e cila ka qenë objekt i kontrollit tuaj dhe sot është në proces privatizimi. Në opinionin tuaj, si e e gjykoni performancën e kësaj kompanie? A është vepruar nga menaxhimi dhe nga qeveria në mënyrën e duhur për të marrë vlerën maksimale gjatë procesit të privatizimit? Sidomos për sa i përket edhe dy pikave kryesore, pra si janë menaxhuar burimet njerëzore dhe a keni gjetur dëme financiare gjatë menaxhimit dhe administrimit të marrëveshjeve hidrokarbure me shoqëritë e huaja?

Pyetja e fundit, në objektin tuaj ju keni për të kontrolluar të gjitha shoqëritë publike, ku shteti shqiptar ka mbi 50 për qind të aksioneve. A nuk duhet të bëhen ndryshime ligjore që të kontrollojnë këto shoqëri, siç është CEZ-i dhe ARMO, për shkak se ato sot janë të pakontrolluara? Nga sa vihet re, ato janë keqadministruar.

Albert Çaçi – Zoti kryetar, ju thatë se prokuroria ka marrë në konsideratë vetëm 10 për qind të denoncimeve që ka bërë KLSH-ja. Ju gjykoni se kjo vjen për paaftësi të prokurorisë, apo materialet e paraqitura nga ana juaj nuk kanë qenë në nivelin e duhur?

E dyta, në qoftë se për masat e prokurorisë ka një përqindje, dua të di se sa për qind e masave që ju keni propozuar nëpër ministri janë marrë në konsideratë. Nëse ju thoni që për prokurorinë është 10 për qind, për ministrinë nuk e kam të qartë sa është kjo masë. Në fakt, ka një problem me masat jo penale për prokurorinë. Domethënë, në të gjitha daljet në media që bën KLSH-ja, jep shkelje shumë të rënda e me vlera jashtëzakonisht të larta, por gjithçka përfundon këtu. Nuk kemi parë që në gjithë këto shkelje në këto nivele të ketë shkarkim të një drejtori drejtorie apo edhe në nivele më të larta. Ju diku aty përmendni një gjë që unë do ta vlerësoja, pra që ju po tentoni të propozoni masa në nivelin më të lartë. Dua të di nëse ju keni kompetencë të propozoni shkarkimin e një ministri. Pra, a ka ndodhur në praktikën e KLSH-së që kryetari i saj të propozojë shkarkimin e një ministri?

Falemnderit!

Arben Malaj – Kam tri pyetje.

Duke vlerësuar vizionin e kryetarit të ri të KLSH-së, i cili do të fokusohet më shumë tek auditimi i performancës, sesa të kontrolli i lëvizjes së mallrave të vlerave monetare (mbase në një kohë të dytë do të na i sqarojë pak më gjatë), pyetja ime lidhet me auditimin e performancës. Unë pashë që ju keni parashikuar për vitin 2012 disa institucione, si Drejtoria e Rrugëve apo dikastere të tjera. A jeni duke marrë modele se si do të rritet kontributi juaj në

mirëmenaxhimin e financave publike, në rastin konkret, përsosja e metodologjive të përzgjedhjeve të investimeve publike që edhe ju të jeni të sensibilizuar në kohë e jo pasi të ndodhin gjërat?

E dyta, a do t'ia vliente më mirë që të harxhonim para për një parlament të ri apo të plotësonim detyrimet për ndërtesat universitare për arsimin apo për shëndetësinë? Si përsoset metodologjia për të përputhur investimet afatgjata, sepse jemi në realitetin kur i fillojmë projektet, por i zvarrisim pa fund?

Pyetja tjetër lidhet me copëzimin elektoral të investimeve publike. Pra, për një kontroll metodologjik, i bazuar në një analizë në rastet, por që del me propozime konkrete. Një nga kontributet shtesë që ju duhet të sillni në komision janë ato që lidhen me përmirësimin e kuadrit ligjor apo institucional për mënyrën se si menaxhohet buxheti.

E treta, për të cilën kemi pasur edhe një debat këtu, të cilën mund ta merrni edhe si një kërkesë zyrtare, lidhet me auditimin e performancës për projektet e huaja. Ju e keni theksuar këtë gjë te detyrat tuaja në faqen 94, por unë do të isha pak më konkret, me një fokus të veçantë te koordinimi, bashkëpunimi apo te mangësitë e këtij të fundit në marrëdhëniet mes qeverisë shqiptare e projekteve të huaja në fushën e pronës, e cila mbetet një nga pikat më të dobëta dhe që krijon probleme zinxhir, qoftë ekonomike, sociale apo politike, për shkak të korrupsionit.

Edmond Spaho – Pyetje të tjera?

Nuk ka.

Fjalën e ka zoti Leskaj.

Bujar Leskaj – Unë do të jap një pjesë të përgjigjeve. Më pas do të vazhdojnë bashkëpunëtorët e mi, në rast se do të kemi nevojë të zgjerohemi apo atje ku unë do ta gjykoj që duhet të përgjigjet ndonjëri prej tyre.

Po i marr me radhë pyetjet, duke nisur me ato të zotit Braçe.

Ju u kujdesët shumë për të theksuar se dëmi i zbuluar është i ulët etj.,?

Për të qenë i sigurtë me ju, në raportin që ju kam dorëzuar, mund ta lexoni vetë se çfarë kam shprehur. Në fjalën që mbajta këtu theksova: “Deri tani, niveli i arkëtimit të shumës së dëmit total është shumë i ulët, vetëm 9.5 për qind i saj, ose 6.67 milionë lekë. Në këtë nivel të ulët realizimi ka ndikuar puna e pamjaftueshme e kryer nga strukturat përgjegjëse në KLSH për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të tyre, si dhe përgjegjshmëria e pakët e stafit drejtues apo bordeve të subjekteve të kontrolluara, ku janë adresuar rekomandimet për shpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar.”. Kjo është e vetmja fjali ku unë kam përdorur epitetin “e ulët”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk kam thënë se dëmi i zbuluar është i ulët. Nuk jam shprehur asnjëherë kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, i shqetësuar. Po do t’u përgjigjem, sepse jam i detyruar. Në punën time, si kryetar i KLSH-së, po përpiqem të vendos një raport të drejtë, transparent, të sigurtë dhe të ndërgjegjshëm me mediat. E fillova duke i ftuar dhe ata kanë asistuar në mbledhjet e departamenteve. U kemi shpërndarë materiale të ndryshme. Kanë qenë në mbledhjen e përgjithshme të institucionit. Kam qenë i hapur në takime të ndryshme që kam zhvilluar në zyrën e kryetarit të KLSH-së. E vlerësoj së tepërmi. Jo më kot i përmenda edhe të dhënat. Nga natyra nuk jam njeri shumë mediatik. Ajo është edhe me të dhënë, është vetë tipi i njeriut. Unë e vlerësoj shumë, sepse më shërbejnë në këtë pozicion për performancën e institucionit. Jam i shqetësuar për faktin se disa herë, madje edhe gazetarë shumë të zotë (për mua të gjithë gazetarët janë të zotë dhe të përkushtuar), kur e kanë kapur këtë fenomen, duhet ta përcaktonin më mirë dhe të thoshin se në këtë dëm, po themi 7 miliardë lekë, 83.4 për qind e këtij dëmi u takojnë këtyre dy operatorëve dhe që nga ky dëm janë arkëtuar 9.5 për qind në total. Kjo nuk ka asnjë gjë të keqe. Kjo ishte për bashkëpunëtorët e mi gazetarë, apo opinionit, të cilët i vlerësoj shumë. Unë nuk kisha si shqetësim

lehtësimin e qeverisë. Unë nuk bëj avokaturën e qeverisë. Unë bëj kontrollin e saj. Unë zbatoj Kushtetutën. Qeveria është avokate e vetes. Flasin punët. Të flasin deputetët e saj.

Ju pyetët se pse nuk ishin përfshirë kontrollet e kryera në METE për koncesionet, në Drejtorinë e Rrugëve apo në Drejtorinë e Legalizimeve.

Këto kontrolle janë në proces evadimi. Ato janë evaduar pas 23 dhjetorit, kohë kur unë kam filluar detyrën. Këtu nuk ka ndonjë sekret. Unë e kam vlerësuar dhe e vlerësoj punën e paraardhësit tim, zotit Çeku, ashtu sikurse vlerësoj edhe punën e zotit Çela, e zotit Kërçuku dhe të të ndjerit Karamuço. Ne shumë shpejt do të organizojmë një veprimtari në kujtim të zotit Karamuço, i cili ka qenë drejtues i KLSH-së.

Duhet të pranojmë faktin se muajt e fundit puna në KLSH ishte zbehur shumë. Çfarë ndodhi?! Kur kam shkuar në institucion, jam ndeshur me një numër shumë të madh praktikash të paevaluara. Drejtori i Përgjithshëm dhe drejtoresha e Drejtorisë Juridike, një nga kontrolloret më me përvojë, mund ta konfirmojnë këtë fakt. Në muajt shtator, tetor dhe nëntor nuk kishte vazhduar praktika normale e punës. Këtë mbyllje praktikash, që është nisur në kohën e zotit Çeku (kontrollet ishin në fazën e projektraporteve, disa ishin firmosur, kurse disa jo), normalisht do ta vazhdoja unë. Mendoj, jo për mburrje se jam nga Vlora, por punën e evadimit të praktikave të prapambetura e kam kryer me sukses.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk jam nga Kuçi, por nga qyteti. Të folurën e kam si lab.

Edmond Spaho – Ju edhe procedimin e parë penal me Vlorën e nisët.

Bujar Leskaj – Ju falemnderit që e sollët në vëmendje!

Unë, para se të jem kryetar i KLSH-së, jam qytetar shqiptar. Ju falënderoj ju për besimin që më dhatë! Nuk ka preferenca për mua, qoftë për ata që denoncoj, qoftë për ata që do të propozojmë për shkarkime. Singërisht, e kam theksuar edhe në takimet e ndryshme të punës që po bëj me stafin dhe jam i

ndërgjegjshëm se puna nuk fillon nga zeroja. Ky është defekti që kemi ne shqiptarët. Duke vlerësuar përvojën dhe punën më të mirë të paraardhësit tim dhe të paraardhësve të tjerë, unë përpiqem që të mirat t'i çoj më tej. Unë ju thashë ju që të shihni grafikun. Te pyetja për prokurorinë do të jap një sqarim më të qartë se si ka qenë ecuria e grafikut. Mund të bëj një shpjegim të tij, meqenëse e kam pak qejf matematikën.

Ju pyetët se përse nuk ishte përfshirë në raportin e bërë herën e dytë për Albpetrolin shkaku i arkëtimit të vështirë të kësaj shume. Pa dyshim që shkaku i arkëtimit të vështirë të kësaj shumë, për mendimin tim personal, është keqadministrimi dhe keqmenaxhimi nga drejtuesit aktualë të Albpetrolit. Në momentin kur kontrollorët, audituesit që drejtohen nga unë, do të shkojnë për kontroll në Albpetrol, ju do të njiheni me masat. Nuk dua të paragjykoj. Ata mund të hasin vështirësi të ndryshme. Ju do të njiheni me masat që do të marr e do të propozoj si kryetar i KLSH-së, në rast se do të ketë keqadministrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në prezantimin e parë këtu te ju si kandidat i nominuar, paraqita 9 pikat e platformës, të cilat i kisha përgatitur me mundim dhe vetë. Për fatin tim të mirë e të keq, të gjitha ikonat e uebit të KLSH-së ishin mbyllur muajin kur unë isha kandidat dhe materialet i gjeta vetë. Unë, jo pa kuptim, ju citova në fund një fjali nga dekalogu moral i Mithat Frashërit, jo nga dekalogu politik: “Në punë kije për lavdi të jesh shërbëstar!”. Ishte pika e 10-të.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mit'hat Frashëri te dekalogu i tij thotë: “Kur merr një detyrë ki disiplinë e durim”. Shqiptarin deri tani e ka prishur mungesa e disiplinës dhe zjarri i padurimit. Unë kam marrë një detyrë të lartë, për realizimin e së cilës do të kem durim dhe disiplinë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Burimet njerëzore në KLSH, kryekontrollorët, kontrollorët e thjeshtë, drejtuesit e lartë, të paktën që nga 23 dhjetori kur unë kam marrë detyrën, po punojnë

me kapacitet të plotë. Miliona euro qarkullojnë në çdo fushë të vendit, madje edhe atje ku kontrollojmë ne, nëpër dogana e tatime, dhe për këtë ne po punojmë fort dhe me përkushtim. Gjatë këtyre 7 vjetve, që do të jem unë në krye të KLSH-së, do ta drejtoj këtë institucion në bazë të Kushtetutës.

(Diskutime pa mikrofon.)

Shqetësimin tuaj do ta kemi në fokus të punës sonë dhe do të reflektojmë në lidhje me të. E njëjta gjë është edhe për kontrollin te Drejtoria e Legalizimeve, i cili po vazhdon ende, ndërsa në Drejtorinë e Durrësit dhe atë qendrore, përveç dëmit të evidentuar prej 364 mijë eurosh dhe 818 milionë lekësh te ALUIZNI qendror apo i Durrësit, ne kemi kallëzuar në prokurori 16 persona. Po vazhdon kontrolli te ALUIZNI në Vlorë dhe, në varësi të këtij kontrolli, në një kohë të dytë do t'i kthehemi edhe ALUIZNI-t qendror. Unë kërkoj prej jush ndihmë që, masat dhe rekomandimet e propozuara nga KLSH, drejtuesit e lartë të këtyre institucioneve t'i zbatojnë.

Për sa i përket kontrollit të zbatimit të disa kontratave të privatizimit, dua të them se këtë gjë do ta shqyrtojmë dhe do t'ju kthej përgjigje. Ndoshta këto janë planifikuar edhe në planin e punës që kemi hartuar për 2012-n, por, edhe nëse nuk i kemi planifikuar, shumë shpejt do t'i vendosim në planet tona.

KLSH-ja vërtet vjen raporton këtu te ju, por edhe ju, edhe ne, të gjithë duhet të jemi të vëmendshëm për të pasur si moto që, krahas zbatimit të detyrave që shtron ligji, ne të përdorim në mënyrë ekonomike burimet tona me eficiencë dhe me efektivitet. Ne kemi nevojë për shtimin e numrit të kontrollorëve në KLSH, megjithatë po përpiqemi të përmirësojmë cilësinë në këto momente. Në lidhje me këtë kemi hapur edhe një konkurs për pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm”, sepse, krahas drejtorit aktual që kemi, të cilin unë e falënderoj për punën e bërë në vite, më duhet edhe një drejtor tjetër i profilit juridik.

Zoti Uldedaj thotë se ka rënie të shpërblimit të dëmit, por edhe të masave administrative. Përgjithësisht, këto vihen në mënyrë lineare, pra në vijë të drejtë dhe unë jam përpjekur të jap një pasqyrim të saktë të gjendjes në

institucion për vitin 2010-2011, pa e rënduar paraardhësin tim, por është e vërtetë që ka pasur edhe zbehje të punës sonë. Megjithatë, kjo rënie vjen edhe si rrjedhojë e mungesës së përgjegjshmërisë nga drejtuesit e pushteteve vendore dhe qendrore. KLSH-ja gëzon mbështetjen e plotë të Kryeministrit për ato institucione dhe agjenci që janë nën drejtimin e tij. Për fatin tonë të mirë, urdhri i Kryeministrit i vitit 2006 i ngarkon këta drejtues me përgjegjësi, urdhër të cilin duhet ta zbatojnë në gjithë. Në të kundërt masat i merr Kryeministri, ne veç propozojmë e rekomandojmë.

Në lidhje me pyetjen për mosrealizimin e auditimeve të auditit të brendshëm, një përgjigje më të saktë mund ta japë specialisti, por unë po them vetëm se bëhet fjalë për kontrollet që ne kemi ushtruar.

Si e gjykoni konkurrencën në këto prokurime? Megjithëse numri i pjesëmarrësve në tender mund të jetë minimal, nëse është e mundur, procedura e prokurimit zhvillohet, por unë nuk mund të jap gjykim në bllok për të gjitha prokurimet, sepse do të ishte megalomani nga ana ime. Unë mund të flas për to rast pas rasti; kur kemi konstatuar shkelje, i kemi evidentuar ato dhe kemi propozuar masa edhe te institucionet përgjegjëse, por edhe te Agjencia e Prokurimeve Publike. Është kjo e fundit pastaj që i ekzekuton vendimet. Në të gjitha rastet kur konstatojmë se prokurimet kanë shkelje, nuk kemi hezitur.

Ju më pyesni për privatizimin, por ne nuk jemi marrë ende me këtë proces, nuk kemi audituar në këtë drejtim.

(Diskutime pa mikrofon.)

Në lidhje me Albpetrolin, përderisa ne kemi nxjerrë një dëm të konsiderueshëm financiar, do të thotë se performanca ka qenë e dobët. Edhe menaxhimi i burimeve njerëzore ka qenë i dobët. Për të qenë i sigurtë, dua të them se kësaj praktike, që është e vjetër, pra e firmosur nga kryetari i mëparshëm, nuk i jam kthyer ta shqyrtoj, pasi nuk kam pasur kohë. Në momentin e parë që do të kem kohë do të merrem me të, por edhe me shqyrtimin e praktikave të tjera, të cilat unë i konsideroj të rëndësishme.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nëse është e vërtetë kjo që thoni ju, ata do të mbajnë përgjegjësi, por këtë gjë ne do ta shohim gjatë auditimit të radhës. Megjithatë, këtu unë dua të citoj një shprehje, që po e përshtat edhe për deputetët dhe audituesit: “Nuk është e rëndësishme ajo çka mendon një auditues apo një deputet, e rëndësishme është çka ata provojnë”. Në rast se ne këto gjëra do t’i provojmë gjatë auditimit të radhës, sigurisht që do të merremi edhe me to. Ju mund të lexoni edhe sot te gazeta “Panorama” një lajm, ku bëhet fjalë që për keqmenaxhim. Ne i kemi propozuar këshillit mbikëqyrës shkarkimin e gjithë drejtorisë së një sh.a-je shumë të fuqishme. Të njëjtën gjë mund të bëjmë edhe për atë që thoni ju, në këtë rast se ne do të vërtetojmë shkeljet. Objektiviteti dhe paanshmëria janë dy parimet kryesore të KLSH-së.

A nuk duhen kontrolluar edhe shoqëritë, ku shteti ka më pak se 50%? Ne mund ta realizojmë, por, për këtë gjë, ju si deputetë duhet të ndryshoni Kushtetutën, pasi neni 163, germa “c”, thotë: “KLSH-ja kontrollon veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesës ose të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti”. Ky nen na pengon t’i kontrollojmë këto shoqëri. Ndryshimet që do të sjellim për ligjin tonë do të jenë edhe për këtë linjë, por këtë herë ne nuk do të sjellim ndryshime në Kushtetutë. Në rast se ju, si Kuvend, do të vendosni për ndryshime të tjera, ne do të jemi të gatshëm t’i sjellim edhe ato.

Në lidhje me pyetjen e zotit Çaçit, për sa u përket raporteve tona me prokurorinë, dua të them se prokuroria gjatë viteve 2000-2011 ka vazhduar me akuzën në gjyq vetëm për 10% të çështjeve. Ky është fakt dhe e vërteta nuk mund të fshihet. Unë e kam theksuar edhe punën e dobët të institucionit tonë, por kjo tregon punën e dobët dhe një nënvlerësim nga ana e prokurorisë. Nëse do të kalojmë te faqja 47 e raportit, ku ne japim rezultatet statistikore, do të shihni se kallëzimet më të larta janë bërë gjatë viteve të para të marrjes së

detyrës nga kryetarët e KLSH-së, numri i të cilave më pas ulet. Unë dua t'ju siguroj për diçka: do të jem sistematik dhe korrekt nga dita e parë deri në ditën e fundit të punës.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ne, përveç kallëzimeve në prokurori, gjithmonë kemi propozuar masa administrative, organizative dhe rekomandime për pushim nga puna, të cilat në raport janë të plota. Natyrisht, duhet të ishim më të rreptë në këtë drejtim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shqetësimi juaj është i drejtë, por ne do t'i përgjigjemi me punë konkrete në të gjitha drejtimet. Problemi qëndron këtu: institucionet supreme të kontrollit në botë i bëjnë raportet si auditues të jashtëm dhe ua lënë në dorë menaxherëve marrjen e masave. Ndonjëherë standardet më të larta të auditimit nuk rekomandojnë masa. Kurse për vetë traditën që është në Shqipëri, por, mbi të gjitha, për atë që publiku pret nga ne, të luftohet korrupsioni, për një periudhë të gjatë kohe vazhdojmë në këtë rrugë, që krahas zhvillimit të auditeve tona profesionale, propozojmë masa të ashpra.

Në lidhje me pyetjen, a keni kompetencë të propozoni shkarkimin e ministrit, t'ju them të vërtetën me këtë qeveri kjo gjë nuk më ka vajtur në mendje, por do ta studioj, do ta shikoj dhe do të kem kohë të marr vendime. Në rast se audituesve tanë, në projekt-raportet që më sjellin, përpara se raporti të marrë formën përfundimtare, do t'u rezultojnë që drejtues të lartë, përfshirë edhe këtë kategori, kanë bërë shkelje dhe duhen rekomanduar për t'i shkarkuar, patjetër që t'ia propozoj Kryeministrit këtë gjë, por deri sot kjo gjë nuk ka rezultuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E rëndësishme është që KLSH-ja të orientohet drejt kontrolleve me profesionalizëm. Është për të ardhur keq që ne realizojmë 150 audite në vit dhe mezi kryejmë një audit performance. Ne gradualisht duhet ta orientojmë

institucionin drejt këtyre auditeve, pa hequr dorë nga auditimi financiar. Ne duhet të edukojmë drejtuesit me ndjenjën e zbatimit të ligjit.

Në lidhje me pyetjet e deputetit Malaj, për auditimin e performacës, a jeni duke marrë modele të tjera dhe si do të rritet modeli juaj, ne, si KLSH, te auditet e performancës jemi dobët. Këtë vit do të përpiqemi të bëjmë një hop, me këto resurse që kemi. Nga një audit performance kemi parashikuar 6 të tilla. Por, unë përfitoj nga rasti të sjell në vëmendjen tuaj që ne si institucion, dhe përgjithësisht institucionet supreme të kontrollit në botë, kemi nevojë për ekspertizë jashtë institucionit. Këtë e theksojnë edhe standardet ndërkombëtare, për problematika të caktuara. Ne nuk kemi ardhur në Komisionin e Ekonomisë në tetor dhe nëntor të 2011-ës, sepse buxhetin për të marrë ekspertë të jashtëm e kemi zero. Në këtë drejtim ne përsëri kemi një bllokim si institucion, sepse për auditet e performancës, për të rritur cilësinë, patjetër që duhet të merren ekspertë të jashtëm. Për shembull, në programimet që kemi bërë për këtë vit, kemi parashikuar një audit performance, të cilin do të zhvillojmë në harkun kohor të 4 muajve për sa u përket të gjitha problemeve të akcizës dhe mendojmë se do të japim një kontribut. Janë përzgjedhur dy-tre kontrollorë me përvojë dhe po përpiqemi të thithim edhe mendimin e huaj dhe po përpiqemi ta realizojmë këtë për ndryshimet e shpeshta, për vlerën, përcaktimet dhe ndikimin në ekonominë e vendit.

Kemi një auditim performance tjetër, të cilin jemi duke e ushtruar në këto momente tek ATSH-ja, duke vlerësuar të gjithë kontributin dhe punën e kësaj agjencie.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me kushtet e reja. Domethënë, kushtet e reja të demokracisë në Shqipëri, media, OJF-të dhe agjencitë private të shtuara na bëjnë që ne të përgatisim një studim. Natyrisht, në fund të çdo audit performance nxirren rekomandimet jo më tepër për marrjen e masave administrative, se sa për përmirësimin e

gjendjes. Besoj se këtu do të jemi të suksesshëm. Auditimi i performancës është një proces, që kërkon punë nga të gjithë ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndoshta nuk e keni dëgjuar me vëmendje, KLSH-ja që nga 2009-ta deri në 2011-ën, mendohet edhe 2012-ta, nuk ka asnjë projekt të tillë dhe nuk ka përfituar nga asnjë program.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pikërisht, në 2009-ën përvoja e mirë që u fitua në 2006-2007-të me Anglinë dhe me Holandën u ndërpre dhe nuk ka vazhduar më. Tani kemi vendosur kontakte me INTOSAI-in dhe me auditin suedez dhe gjerman. Ne po kërkojmë edhe procese të drejtpërdrejta. Besoj se edhe këtë vit do të dimë të kapim projekte.

Kaq kisha në lidhje me pyetjet, në qoftë se keni të tjera jam gati t'u përgjigjem. Po përfitoj nga rasti t'ju garantoj një gjë: unë po përpiqem dhe jam i bindur që edhe në pjesën pozitive të stafit që kam gjetur, pjesën e përkushtuar dhe të ndershme, do të arrijmë që t'i forcojmë tri cilësitë më të rëndësishme të audituesit: pavarësinë, integritetin dhe punën profesionale me standarde të larta. Ne këto tri drejtime bazë, të një audituesi modern të sotëm, unë, me cilësinë e kryetarit të KLSH-së, drejtuesit e lartë dhe i gjithë ekipi po punojmë t'i realizojmë.

Ju falemnderit!

Edmond Spaho – Falemnderit, zoti Leskaj!

Kush dëshiron të shprehet?

Sherefedin Shehu – Së pari, dua të falënderoj kryetarin për prezantimin që bëri!

Bujar Leskaj – A mund t'ju jap një informacion për Albpetrolin?

Robert Gjini – Detyrimi që i përkiste vitit 2007-ë, këtë mund t'jua konfirmoj, ishte 2 miliardë e 260 milionë lekë. Është bërë një detyrim i ARMO-s me

degën e njësisë së tatimpaguesve të mëdhenj dhe është lidhur një aktmarrëveshje kompensimi. Ky detyrim që ne po japim, për furnizimin e ARMO-s, i përket periudhës nga 2008-ta deri në fund të 2010-ës. Për këtë ne kemi bashkëpunuar edhe me METE-n, e cila ka dërguar kontrolluesit e saj. Ky detyrim nuk po arkëtohet, sepse vetë Albpetroli nuk po e hedh në gjyq kompaninë ARMO-n me një argumentim absurd: ne nuk kemi fonde për sigurimin e padisë.

Për sa i përket detyrimit të OST-së ka një marrëveshje nga Ministria e Financave për shuarjen e detyrimeve ndërmjet OST-së dhe konsumatorëve që janë në ministri dhe institucione të tjera. Kjo marrëveshje e OST-së mbyllet nëpërmjet një projektvendimi që ka përgatitur Ministria e Financave.

Edmond Spaho – Zoti Shehu.

Sherefedin Shehu – Përveç prezantimit të rezultateve të punës, shikojmë edhe një vullnet për ndryshime cilësore në punën e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por ajo që më bën më shumë përshtypje është fakti që kryetari i ri ka kapur me shumë të drejtë çështjen e auditimit të brendshëm të institucionit, problem që është diskutuar vazhdimisht në komision, por do ta çoj pak më tej këtë, duke thënë që auditimi i brendshëm duhet të jetë çështje e Kuvendit në raport me institucionet parlamentare. Sepse ndoshta vërtet Kontrolli i Lartë i Shtetit ka motive për të pasur inspektorë të auditit të brendshëm, por institucionet e tjera me 10-20 veta, por nuk ka kuptim të ketë nëpunës auditit të brendshëm, pasi nuk mund të auditojnë vetveten, sepse në shumicën e tyre këta janë titullarë institucionesh që firmosin vetë për gjithçka. Kështu që do të vlerësoja rikonsiderimin dhe daljen me një propozim, pasi ky është një problem për të gjitha të ashtuquajturat trupa parlamentare, pra autoritetet e ndryshme që kemi ne, por të paktën juve keni aplikuar një standard në institucion që duhet ta pranojnë e ta zbatojnë edhe të tjerët, sepse ky shërbim mungon dhe ka qenë pikë debati me Ministrinë e Financave

përse rekomandohej marrja me kontratë e shërbimit të auditit për institucione të tilla.

Për të vazhduar më tej, vlerësoj shumë edhe aspektet e punës për sigurimin e cilësisë në vlerësimin e punës, por sidomos të auditimit të bazuar në performancë. Pavarësisht nga referencat që bëtë, unë mendoj që, në radhë të parë, mund të kemi një audit performance vetëm nëse kemi një buxhet të zbatuar në performancë. Në qoftë se në buxhetin e shtetit mungon sistemi i indikatorëve, atëherë edhe auditit nuk mund të jetë i bazuar në këtë sistem. Faktikisht ne e kemi, por jo të konsoliduar në atë nivel. Pra, zbatimi ka filluar.

Kështu që unë mendoj që bashkëpunimi midis të dyja palëve do ta shtyjë më tej këtë proces dhe të mos ta mendojmë si një gjë që do ta realizojmë në 1 vit ose 5 vjet, sepse edhe shtetet e zhvilluara e bëjnë me pjesë, siç keni filluar ju dhe ju inkurajoj në këto modele, tek auditet e pjesëshme që përmendët ju, sepse ato do t'ju japin një rezultat, i cili do të përdoret si model për ta vazhduar më tej këtë proces.

Ju thatë që do të ndëshkoni nëpunësit etj., por unë mendoj se duhet të filloni të hiqni dorë nga kjo frymë e rolit ndëshkues të institucionit, sepse, siç e thatë edhe ju me të drejtë, keni borxh që t'i jepni Kuvendit një raport dhe Kuvendi, në qoftë se i intereson dhe ka përgjegjësinë, ta përdorë këtë kontribut tuajin për të përmirësuar pastaj punën, sepse ju nuk mund të jeni xhandari...

Ndoshta ky mentalitet ekziston, por duhet të hiqet, sepse ende sot kur shkon Kontrolli i Lartë i Shtetit për kontroll, krijohet njëfarë presioni te nëpunësit atje, sepse u ka shkuar kontrolli, kjo është bërë e zakonshme. Është mirë që gjërat të shkojnë në vendin e tyre.

Tashmë kemi një sistem inspektimi dhe shkeljet nuk mund të presin kur të shkoni ju. Ju duhet të jeni të ndërgjegjshëm që nuk keni një shkallë mbulimi të institucioneve publike, ndoshta është një problem tjetër, por po shfrytëzoj rastin të them që duhet të konsideroni edhe rritjen e shkallës së mbulimit me audite të të gjitha njësive të qeverisjes vendore dhe asaj qendrore.

Ndoshta ligji aktual ka konceptin e mbikëqyrësit për juve, ndërsa unë mendoj që nuk është i arsyeshëm dhe i kohës. Ju duhet të konsideroheni partnerë dhe të plotësoni njëri-tjetrin, sepse ju vetë përmendët rastet e mbivendosjes që ekzistojnë në punën e të dyja shtresëzimeve të auditit. Pra, po t'i shikoni ata si partnerë, mendoj se ka hapësira për ta përmirësuar punën.

Po kështu, në raport pashë që i keni dedikuar një pjesë të kohës edhe kontrollit të projekteve të huaja. Ashtu siç folëm për auditin në përgjithësi të bazuar në performancë, edhe në këtë rast unë mendoj se do të ishte e mira të kishim disa tregues performance. Për shembull, cila është norma e disbursimit e financimeve të huaja, cila është kostoja e angazhimit që shpreh më qartë e më drejtpërdrejt efektet e vonesave, që i keni përmendur në procesin e negociatave ose nëse ka standarde në afate ose neglizhencë në proces? Ju të jepni rekomandimet, që natyrisht janë të vlefshme në kuptimin e mbylljes së hapësirave për ndodhjen e fenomeneve negative.

Njëkohësisht, dua të bashkëngjis një koment timin lidhur me debatin që u bë për dëmet që keni. Ju e keni sqaruar shumë mirë masën e dëmit, sepse të jemi të bindur ne po flasim shumë gjëra dhe ju prezantuat shumë gjëra, por mediat sot dhe shtypi nesër do të flasë vetëm për 6-miliardëshin e dëmit...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Kjo është eksperiencë dhe ju e dini më mirë se unë, sepse unë jam më i ri në punët e politikës...

Lajmi i mirë është që po përforcohet institucioni ose që institucioni ka ambicie për të përmirësuar menaxhimin financiar publik. Edhe milionat, në qoftë se ato miliona ose miliarda janë reale, por, në rastin konkret, unë e kam thënë edhe në paraqitjen e parë këtu që nuk duhet raportuar si zbulim i Kontrollit të Lartë të Shtetit, sepse është një detyrim në bilancin e kompanisë e në marrëdhëniet debitorë-kreditorë midis dy kompanive, pra nuk është bërë ndonjë zbulim atje. Fakti që këto marrëdhënie nuk mbyllen, duhet parë më tej. Duhet të mendoni

që një kompani nesër mund të falimentojë dhe ky detyrim nuk do të paguhet asnjëherë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Kjo është një gjë krejt normale, që mund të ndodhë në këtë sistem ekonomik, por kryesore është që nuk duhet parë në aspektin e dëmit, sepse pavarësisht nga përmasa, ai ka rrjedhur nga marrëdhëniet normale të biznesit.

Së fundi, për sa i përket krijimit të kapaciteteve, e vlerësoj si një aspekt shumë të rëndësishëm, që zoti Malaj e përmendi, programin “*Twining*” si zgjidhjen më të mirë. Duhet të gjeni shpejt një partner dhe të merrni asistencë për këtë punë, por, me sa kam dijeni, Bashkimi European më prioritet për ju ka miratimin e ligjit të ri se sa “*Twining-un*” ose do të duhen zgjidhur që të dyja, miratimin e ligjit të ri që do të na afronte më shumë me standardet e Bashkimit European, për të cilën do të na duhet bashkëpunimi i kolegëve tanë, të cilët kanë frikë se kur të vijë puna, do të tërhiqen nga mbështetja e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Megjithatë, e mirëpresim bashkëpunimin për të miratuar ligjin, por njëkohësisht në qoftë se keni program serioz dhe konkret trajnimi, unë do të lloj brenda këtij komisioni që të shtojmë edhe disa para nga qeveria në qoftë se mendoni se keni aspekte kritike që ju shërbejnë për trajnim.

Falemnderit!

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Mimi Kodheli – Unë besoj që në shpjegimin tuaj dyorësh ose ndoshta më shumë, për të cilin ju falënderoj, ishit për mua të paktën mjaftueshëm i qartë në atë çka keni bërë dhe në objektivat që institucioni që drejtoni ka për të ardhmen. Sigurisht, ndaj të njëjtin opinion me



kolegun Malaj lidhur me menaxhimin që ju mund t'i bëni si institucion kontrollit mbi performancën. Është shumë e rëndësishme që në stadin ku gjendet zhvillimi ekonomik i Shqipërisë, ne të shikojmë jo vetëm si i harxhojmë paratë, por edhe në çfarë efieciënce, sepse vetëm kështu ne mund të kalojmë në një hap cilësor. Sigurisht, menaxhimi i performancës, kontakti që ju do të keni nëse performohet mirë dhe nëse paratë e taksapaguesve shqiptarë shpenzohen me efieciencë ose jo, është një problem shumë i madh sot jo vetëm për ekonominë shqiptare, por edhe për ekonomitë më të zhvilluara se e jona.

E thënë kaq thjesht, duket sikur rruga për ta bërë këtë është e lehtë, por në fakt nuk është e tillë dhe mendimi që u dha këtu që ju mund të shikoni mundësitë e bashkëpunimit me institucionet e tjera prestigjioze është shumë i rëndësishëm, sepse është shumë e rëndësishme që në këtë stad të të gjithë veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit të kemi një hap cilësor lidhur me këtë gjë. E them këtë, sepse, nëse i hedhim një vështrim tabelës përmbledhëse të dëmit ekonomik, që e keni bashkëngjitur në fund të raportimit, 7 miliardë lekë është një shifër impresionuese për dëm ekonomik.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sigurisht, aty ka edhe probleme, disa nga të cilat i përmendi Sherefedini, por 7 miliardë lekë janë gjithmonë 7 miliardë lekë dëm ekonomik, për të cilat ka edhe sqarime respektive dhe probleme të mbartura. Prandaj ne jemi këtu dhe ju vini e raportoni.

Madje, unë do t'ju lutesha të vinit të raportoni qoftë ju personalisht, qoftë nëpërmjet informacioneve, nëse keni nevojë të asistoheni nga Komisioni i Ekonomisë dhe sigurisht hedh poshtë paragjykimin dhe frikën që Sherefedini ka, lidhur me atë sa ne do të jemi bashkëpunues në bërjen e një ligji të ri, i cili do të përfronte edhe më tej kornizën ligjore, që rregullon institucionin tuaj me atë të Bashkimit Europian, dhe në procese të rëndësishme që do t'i shikojmë në vijim.

E rëndësishme është që ne të biem dakord për një gjë. Kjo mund të jetë fare mirë pjesë e draftrezolutës, që Kontrolli i Lartë i Shtetit të mos shikohet më si një zëvendësues i prokurorisë, si një institucion që heton, por në avangardë të problematikës së performancës që ka shpenzimi i parasë publike, sepse është shumë e rëndësishme që ne jo vetëm të jemi në rregull me nenin aq dhe pikën kaq të ligjit, që është pa dyshim më e rëndësishmja, por pa dyshim, siç foli edhe Sherefedini, që ju të vini këtu në mënyrë profesionale për të na treguar cilat janë normat e disbursimit ose të tjera *ratio*, të cilat, të paktën në një komision të tillë prestigjioz, mendoj se do të vlerësoheshin si pozitive.

Edhe një herë, ju falënderoj dhe shpresoj që të mos kalojë 1 vit përpara sesa ne të shihemi sërish për të diskutuar gjërat që diskutuam sot.

Edmond Spaho – Po, zoti Leskaj.

Bujar Leskaj – Dëshiroj t’ju falënderoj të gjithëve për kontributet dhe sugjerimet që dhatë, veçanërisht nënkryetaren e komisionit, zonjën Kodheli, pasi jam shumë dakord me idetë që ajo dhe deputetët e tjerë theksuan.

Në lidhje me diskutimin e zotit Shehu, dëshiroj të theksoj dy çështje, që mendoj se janë kryesore në drejtimin e KLSH-së në këto vite.

Unë jam shumë i vetëdijshëm dhe bashkohem tërësisht me ju në faktin që auditin e brendshëm duhet ta konsiderojmë si partner. Madje edhe në filozofinë time të punës, që ditën e parë, në orientimet e punës që janë dhënë dhe në një marrëveshje bashkëpunimi që ne kemi përgatitur, iu drejtuam drejtuesit të auditit të brendshëm, ministrit të Financave, ku gjetëm pozitivitet dhe do të vazhdojmë në këtë linjë, do ta konsiderojmë partner, madje serioz dhe tërësisht të besueshëm. Mendoj se togfjalëshi “tërësisht i besueshëm” përmbledh gjithçka.

Ne jemi të ndërgjegjshëm, sepse shkalla e mbulimit për vetë burimet që kemi në dispozicion, për mbulimin e kontrollit të institucioneve, pavarësisht se është në masën mbi 50 për qind, hyn në institucionet supreme moderne të kontrollit,

që ka shumë për t'u progresuar, por asnjëherë nuk arrihet një mbulim perfekt. Në këtë drejtim, partneriteti me auditin e brendshëm do të jetë shumë pozitiv. Për sa i përket çështjes së dytë, ku ju me të drejtë sugjeruat që ne duhet të heqim dorë nga fryma ndëshkuese, edhe për një periudhë kohore duhet të vazhdojmë në këto dy linja, që në pamje të parë duket sikur kundërshtojnë njëra-tjetrën, por për mua janë komplementare. Ne do të ndërtojmë një institucion suprem modern të auditit, ku vëmendja do të drejtohet tek auditin e performancës, pa e hequr nga auditin financiar, por që t'u përgjigjemi nevojave të vendit, asaj pritshmërie të publikut, ne duhet të vazhdojmë t'i forcojmë masat tona e propozimet tona, të jemi konkretë e drastikë. Mund ta arrijmë dhe do të fillojmë gradualisht. Unë besoj dhe shpresoj shumë të ndihma dhe përvoja e ju të gjithëve. E them këtë me sinqeritetin më të madh dhe do ta them edhe në çdo situatë tjetër politike, ku ju mund të ndodheni, që anëtarët e Komisionit të Ekonomisë janë të gjithë të vlerësuar, sepse në këndvështrimin tim janë të gjithë profesionistë të zotë. Ne mund të arrijmë në praktika të caktuara dhe do të fillojmë ta praktikojmë këtë gjë, që ne dorëzojmë auditin që kemi kryer dhe pastaj është menaxheri ose drejtuesi i institucionit qendror, i ministrisë ose i agjencisë qendrore që merr masat. Ne po përpiqemi të ecim në të njëjtin ritëm edhe me ato orientime që shefi i kësaj maxhorance, Kryeministri i Shqipërisë, ka dhënë në strategjinë e luftës kundër korrupsionit për periudhën 2008-2013 dhe në veçanti në urdhrin e tij të vitit 2006.

Ne tregohemi të kujdesshëm, sepse këto masa janë rekomandime që ne i bëjmë edhe kur kemi moszbatime të tyre. Personalisht tregohem shumë miqësor me aktorët. Këto janë rekomandime për të përmirësuar punën në mirëadministrimin e punës, të pronës publike, të shëndoshjes së financave publike, të luftës dhe të parandalimit të korrupsionit. Me kohë ne do të orientojemi drejt këtyre.

Së fundi, e mirëpres së tepërmi mbështetjen që zonja Kodheli theksoi dhe ndihmën për ligjin. Ne do ta sjellim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ato janë punët e komisionit, ku unë nuk ndërhyj.

Unë ju falënderoj paraprakisht për rezolutën që ju do të miratoni dhe jam i bindur që atje do të dimë të nxjerrim detyra, si agjentë të mirë të Kuvendit dhe të Komisionit të Ekonomisë!

Edmond Spaho

Më lejoni edhe mua të falënderoj zotin Leskaj për prezantimin e plotë që bëri në Komisionin e Ekonomisë!

Dëshiroj të evidentoj dëshirën e tij dhe të kolegëve, me të cilët bashkëpunon, për të ndryshuar, dëshirë që e



theksuat edhe ju në diskutimet tuaja dhe që fillon nga rritja e numrit të kontrolleve, nga përmirësimi i cilësisë, fokusimi tek auditimi i performancës, nevoja për të rritur bashkëpunimin me institucione të tjera, sidomos me ato të cilat janë të specializuara në fushën e kontrollit, si prokuroria, ose nevoja për të përmirësuar kapacitetet e brendshme të vetë institucionit, të cilin e ka filluar me testimin e punonjësve, me konkurset që po organizon etj., por do të theksoja si një kërkesë imediate miratimin sa më shpejt të jetë e mundur të ligjit, pasi ndryshimi fillon nëpërmjet bazës ligjore dhe kemi gjithë këtë kohë që kemi folur për ligjin e ri të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe kemi akumuluar eksperiencë dhe, sikurse e thatë edhe ju, ndryshimi nuk fillon nga sot. Ne njohim edhe meritat e të gjithë drejtuesve të tjerë të këtij institucioni, por është e domosdoshme që e gjithë kjo eksperiencë të reflektohet në bazën ligjore që ju lejon juve së bashku me Kushtetutën të zhvilloheni më tej si institucion dhe të ruani pavarësinë, që është shqetësimi ynë kryesor, domethënë forcimin dhe ruajtjen e pavarësisë së institucionit.

Së dyti, lidhur me raportet që ne kemi krijuar dhe do të krijojmë edhe në të ardhmen me institucionin tuaj, sigurisht ndryshimi i kohës evidenton problematikë të re dhe nevoja të reja, prandaj, në njëfarë mënyre jam dakord me mendimin që shprehu zoti Shehu, që duhet të shikojmë vendosjen e praktikave të reja. A është koha sot që ne të kalojmë vetëm në ekspozim problemesh? Ndoshta mund të jetë herët, pasi gjërat nuk vijnë të prera me thikë njëherazi, por së paku duhet të fillojmë të përfitojmë edhe nga eksperiencia e institucioneve të Bashkimit European për mënyrën sesi komunikojnë institucionet e kontrollit me ekzekutivin dhe parlamentin. Do të ishte e mira që këto të fillojmë t'i aplikojmë, pasi edhe orientimi ynë është drejt Bashkimit European.

Sigurisht është shqetësim çështja që ngritet për buxhetin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në fakt, ne si komision jemi përpjekur që çdo vit të plotësojmë nevojat e kontrollit, madje edhe kërkesat specifike që keni pasur. Ndoshta fakti që u ndërruan drejtuesit, u la jashtë vëmendjes gjatë hartimit të projektbuxhetit të vitit 2012, por gjatë këtij viti, nëse do të ketë rishikime, ne jemi të gatshëm të ulemi e të diskutojmë se çfarë mund të plotësojmë, por gjithmonë ju inkurajoj që në periudhën e diskutimit të buxhetit për vitin pasardhës të na kontaktoni dhe të na ekspozoni nevojat që keni, pasi ne në asnjë rast, kolegët tuaj janë aty dhe mund t'ju thonë, nuk kemi lejuar mosplotësimin e nevojave për të ushtruar aktivitetin tuaj.

Po kështu, çështjen e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit e kemi ekspozuar tashmë te drejtuesit e Kuvendit dhe shpresojmë t'i japin zgjidhje, jo për ta kapërcyer këtë periudhë, por për të vendosur një standard gjithmonë mbi bazën e një procedure të caktuar mbi të cilën do të duhet të zhvillohet auditimi i vetë institucionit, madje Kuvendi duhet të parashikojë edhe fondet përkatëse.

Besoj se të gjitha elementet e tjera që u trajtuan në diskutimet e kolegëve do të jenë edhe thelbi i projektrezolutës, për të cilën ngarkojmë zotin Mima ta hartojë për ta çuar më pas në seancë plenare.

Edhe një herë, ju falënderoj dhe ju uroj suksese në vazhdim!

Mbledhja mbyllet.

Sekretar

Përgjegjësja e sektorit të komisioneve parlamentare

Igli Cara

Euzheni Pengjili

Diskutim i deputetes Mesila Doda*, mbajtur në seancën plenare të Kuvendit datë 26 prill 2012

Të nderuara zonja deputete,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Sot do të diskutojmë për punën e institucionit të pavarur, i cili ka në kompetencën e tij kontrollin e veprimtarisë shtetërore. Ky është një raport real, objektiv, një raport që nënvizon të meta, detyrat, por dhe objektivat e punës së ardhshme të këtij institucioni. Kjo është një punë e konsiderueshme, por siç pohohet nga vetë raporti, është ende e pamjaftueshme.



Në raport pohohet se gjatë vitit 2011 KLSH-ja ka propozuar ndryshime ose përmirësime ligjore në dispozitat ligjore në fuqi, si dhe ka kryer kallëzim penal pranë organeve të prokurorisë për 6 raste dhe 13 persona, shifra këto sipas raportit të pamjaftueshme përballë sfidës për thellimin e luftës kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij.

Të nderuar zotërinj deputetë,

Unë besoj se ky është diskutimi institucional që ne duhet të bëjmë kur trajtojmë këtë fenomen bashkëshoqërues të njerëzimit i cili përveçse ushqen një mënyrë mjerane të të menduarit, vërtetohet si një faktor që frenon zhvillimin ekonomik, që ul të ardhurat e një shteti dhe frenon investimet e huaja. Nëse do të tentojmë të flasim thjesht për të bërë politikë, duke hedhur thashetheme dhe tymnaja, duke thënë fakte kokëposhtë ose gjysma të vërtetash, më pas t'i kthejmë në pikë për skuadrën tonë politike, atëherë i kemi bërë shërbimin më të mirë korrupsionit, pasi do të vazhdojë të fshihet në fasadën e veprave që të gjithë e konsumojnë dhe të gjithë bëjnë sikur e denoncojnë. Unë nuk besoj se kjo është mënyra e sjelljes që shtetarët ose

parlamentarët duhet të aplikojnë. KLSH-ja pohon se ka dërguar raste në prokurori, megjithëse do të duhej të ishte bërë një punë më e madhe thonë nga ana e tyre. Unë sot ju rikujtoj se kjo maxhorancë ka dërguar pranë organeve të prokurorisë 380 raste të zyrtarëve të saj për vepra korruptive.

Nga ana e organit të akuzës reagimi vazhdon të mbetet ende në nivele inekzistente dhe kjo mbetet një nga problematikat e pazgjidhura të sistemit tonë, pasi thuajse çdo vepër kriminale në fund përfundon në prokurorë që mbyllin ose dështojnë çështjet në duart e gjykatësve që bëjnë sikur nuk shohin dhe nuk dëgjojnë dhe që tentojnë gjetjen e mekanizmave për të çliruar nga akuza vetë rastet e denoncuara prej nesh. Drejtësia mbetet ende kamerdarja e shpëtimit të krimit. Reformimi i saj është beteja jonë me korrupsionin, beteje që duhet ta bëjmë për të shpëtuar strategjikisht atë shtyllë të sistemit që nuk është prekur ende nga asnjë reformë dhe që sot e shohim të gjithë tek bërtet me pavarësi dhe çliron krimin në emër të kësaj pavarësie.

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Kjo maxhorancë ka ndërmarrë aksione reale, ka krijuar një bazë ligjore të plotë, ka krijuar një rrjet institucionesh, që kanë në fokus të punës së tyre betejën për korrupsionin dhe, mbi të gjitha, u ka dhënë këtyre institucioneve pavarësinë për të vepruar, kurajën për të denoncuar çdo rast abuzimi parregullsie shpërdorimi ose korruptimi. Rezultatet e kësaj mënyre të re të konceptuari shihen në shtimin e të ardhurave, në rritjen e investimeve të huaja, në rritjen e investimeve publike, në rritjen e rrogave dhe pensioneve. Dua t'ju kujtoj se vetëm vjet shuma e investimeve të huaja ka qenë 1,1 miliardë euro dhe ky është një tregues i asaj pune të madhe, të palodhur që bëhet për rritjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit. Shqipëria është vendi që ka 100% prokurime publike. Kjo shifër e madhe e arritur ka sjellë si rezultat një kursim prej 25% deri në 30% të fondeve të paracaktuara dhe ky është një rezultat tjetër i asaj pune që bëhet për të eliminuar këtë plagë të shoqërisë. Do të doja të merrja një rast që ka të bëjë me administratën tatimore. Ajo tashmë

kryen detyrat e saj funksionale mbi sistemet informatizuar për menaxhimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore. Ndryshimet e legjislationit tatimor dhe modernizimi i administrimit të tatimeve ka shkuar përkrah përafrimit me vendet e tjera të BE-së. Tashmë është ngritur dhe funksionon qendra e shërbimit të tatimpaguesve për tatimpaguesit e mëdhenj dhe ato të rajonit të Tiranës. Për tatimpaguesit në këtë qendër, përveç sporteleve të shërbimit, mundësohet falas deklarimi elektronik i detyrimeve tatimore. Duhet theksuar se në kuadër të qeverisjes transparente dhe luftës kundër korrupsionit është eliminuar krejtësisht kontakti i subjekteve tatimpaguese me punonjësit e administratës tatimore, pasi tashmë tatimpaguesit deklarojnë *on-line* detyrimet e tyre tatimore dhe këtu përfshihen formulari i deklarimit të pagesës së TVSH-së, i deklarimit dhe pagesës së tatimit, deklarimi i librave të blerjes dhe shitjes së TVSH-së, kontributet e sigurimeve shoqërore. Këto pra janë ato paketa reformuese që bëjnë të mundur uljen e korrupsionit në administratën shtetërore dhe rritjen e të ardhurave në buxhet.

Këto reforma kanë sjellë trefishimin e buxhetit, kanë sjellë rreth 9400 kilometra rrugë kombëtare të shtruara, sollën një reformë të plotë në sistemin e pagave dhe pensioneve. Kjo është mënyra se si ne luftojmë korrupsionin me shifra reale, plotësojmë kuadrin ligjor, rrisim transparencën, fuqizojmë institucionet përgjegjëse për luftën e korrupsionit.

Të nderuara, zonja dhe zotërinj deputetë,

Një nga prioritetet e BE-së është lufta kundër korrupsionit. Një nga prioritetet e përcaktuara prej tyre është heqja e imunitetit për deputetët, si dhe për gjyqtarët, por tashmë thuajse nuk flitet më për këtë nga ana jonë, nga ana e deputetëve. Kemi vendosur të gjithë bashkë që t'i japim jetë kësaj reforme të madhe, ka të bëjë me lënien e imunitetit tonë të të gjithë deputetëve dhe sigurisht edhe përkufizimin e imunitetit të gjyqtarëve. Kjo është një nga punët që ne mund të bëjmë për të ndihmuar në këtë luftë të madhe që kemi të gjithë si shtet kundër korrupsionit.

Do të doja dhe një herë të përgëzoja KLSH-në për objektivitetin në shkrimin e raportit, por sigurisht dhe për ato detyra që vënë për të ardhmen në fuqizimin e rolit të këtij institucioni. Na duhet ta përkrahim të gjithë në punën e tij që duhet të bëjë për forcimin e shtetit ligjor.

Faleminderit!

* Mesila Doda Deputete e PD, anëtare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat,
Nënkyetare e Komisionit për Integrimin Europian të Kuvendit.

Diskutim i deputetes Arta Dade*, mbajtur në seancen plenare të Kuvendit datë 26 prill 2012



Raporti i KLSH-së, paraqitja vjetore e këtij institucioni në Kuvend, përveç informacionit periodik, përbën rutinë për punën e këtij institucioni dhe është për të ardhur keq që kjo përfundon me miratimin e një rezolute, e këtu përmbillet edhe marrëdhënia e këtij institucioni të rëndësishëm me Kuvendin, i cili zgjedh kreun e tij.

Po t'i referohemi raportit, në të thuhet se marrëdhëniet e KLSH-së me Kuvendin kanë ardhur duke u fuqizuar e konsoliduar më tej, madje informacionet periodike kanë shërbyer edhe për të vlerësuar punën e kryer nga ekzekutivi. Por po t'i referohemi raportit të progresit për 2011-n, kërkohet përmirësimi i mëtejshëm, për sa i përket raportimit në Parlament dhe efikasitetit në ndjekjen e problematikës nga Kuvendi të raporteve të KLSH-së. Nëse ky institucion do të funksiononte sipas modeleve e kërkesave të BE-së, pa dyshim që nuk do të kishim vetëm 6 kallëzime penale për 13 persona, për një vlerë dëmi prej 6507 mijë lekë, kjo nuk përkon me realitetin dhe me treguesit e korrupsionit të kësaj maxhorance të evidentuara në të gjitha raportet e organizmave prestigjiozë, që e cilësojnë Shqipërinë vendin më të korruptuar krahasuar dhe me fqinjët tanë. Europa është e prerë, e vendosur në rastet e korrupsionit, madje të dyshuar.

Presidenti i Gjermanisë dha dorëheqjen, sikurse bëri dhe ish-Kryeministri i Irlandës. Ish-ministri i Mbrojtjes u arrestua në vendin që lëngon nga kriza në Greqi. Ish-Kryeministri kroat u denoncua nga vetë partia e tij, e shembujt vazhdojnë si leksion për Shqipërinë që do të integrohet në Europën që, përveç zgjerimit, punon edhe për thellimin e integritetit, siç është rasti me Hungarinë.

Në këtë raport pothuajse ka entuziazëm, por urdhri nr.70, i datës 18.04.2006 i Kryeministrit për masat në zbatim të kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit dhe të ministrave konsiderohet si tepër i vlefshëm dhe i dobishëm për vlerësimin e punës së KLSH-së. Në fakt, duhet përmendur edhe telefoni që instaloi Kryeministri për komunikim me publikun, që, me gjasë, ky i fundit të denonconte direkt korrupsionin te Kryeministri. Po, a e di KLSH-ja se Kryeministri i këtij urdhri është personi më i korruptuar i Qeverisë dhe i të gjitha qeverive në këto 20 vjet?

Si e adresoi Kryeministri dhe urdhri i tij korrupsionin e paprecedentë në Rrugën e Kombit, (që e konstatoi pikërisht KLSH-ja) duke sulmuar opozitën dhe duke nënshtuar gjyqësorin, duke promovuar ministrin si imazh për Qeverinë e tij dhe duke përdorur korrupsionin në sektorin publik si përvojë për korrupsionin elektoral? Po korrupsioni me pasojë krimin shtetëror në Gërdec, a nuk u gatua në zyrën e Kryeministrit me akte ligjore dhe nënligjore dhe u krye nën hundën e shtetëror në Gërdec, a nuk u gatua në zyrën e Kryeministrit me akte ligjore e nënligjore dhe u krye nën hundën e ministrave të Mbrojtjes, Mjedisit, Çështjeve Sociale, Financave?

Pse Kryeministri vazhdon të ketë pjesëtarë të kabinetit ministra të përfshirë direkt apo indirekt në tragjedinë e Gërdecit? Këtë pyetje nuk e bëj vetëm unë, por e gjej në dokumentet periodike që vlerësojnë ecurinë e proceseve integruese. Ka progres të limituar në fushën e politikës antikorrupsion, e cila është përparësi kyçe e opinionit të KE-së. Zbatimi i veprimeve specifike mbetet përgjithësisht joefektiv dhe rezultatet janë të pamjaftueshme. Korrupsioni mbizotëron në shumë sektorë dhe vazhdon të jetë në veçanti problem serioz. Kështu thuhet në raportin e KE-së për vitin 2011. Flitet diku në raport për informimin e publikut rreth mënyrës se si shpenzohen paratë publike nga institucionet publike. Publiku më mirë se kushdo tjetër e di se Qeveria e grabit çdo orë, çdo ditë prej çmimit të bukës së përditshme,

energjisë, ujit, karburanteve, shërbimeve, spitaleve, shkollave deri te shitblerja e vendeve të punës në arsim dhe shëndetësi dhe shitblerja e diplomave në universitetet private.

Grabitja e fondeve të rrugëve që bëhen e ribëhen dhe gjysma e fondeve shkon në xhepat e tenderuesve *online*. Pronarët e ligjshëm e prekin korrupsionin në çdo hap të përpjekjeve të tyre legjitime për pronën si e drejtë e patjetërsueshme e njeriut. Aferat korruptive në sektorët strategjikë, koncesionet e paligjshme, monopolet dhe klientelizmi e kanë rrënuar ekonominë e vendit. FMN-ja së fundmi paralajmëroi praninë e krizës ekonomike në Shqipëri, përkundër mburrjeve të Berishës se ai po çon vendin nga fitorja në fitore, duke lënë pas vendet e Europës, veç Gjermanisë.

Korrupsioni që lulëzon, (që KLSH-ja nuk e sheh dhe s'ka si ta shohë, sepse është pjesë e kësaj maxhorance) rrezikon demokracinë dhe është bërë pengesë serioze për zhvillimin ekonomik, politik, social e kulturor të vendit, kështu thuhet në një nga raportet e fundit për Shqipërinë dhe që vjen mbas atij të Transparency International, para dy vjetësh, kur Shqipëria vetëm brenda një viti ra në klasifikim me 10 vende. Dje dëgjuam ministren e Integritit të thoshte me entuziazëm se 12 pikat e opinionit të KE-së nuk mund të plotësohen të gjitha deri në periudhën që jepen vlerësimet në progresraport. Më pas ndoqëm përfaqësuesin e Komisionit European që ripërsëriti pa entuziazëm se komisioni kërkon që Shqipëria t'i përmbushë të 12 pikat dhe se detyrat për ne janë bërë të qarta.

Edhe zonja ministre, ashtu si Kryeministri i saj, e di mirë që as ka e as do të ketë në periudhën e mbetur të kësaj maxhorance ndonjë gjë për t'u shënuar në luftën kundër korrupsionit, sepse kjo Qeveri nuk mund të luftojë vetveten, sepse kjo Qeveri e ngriti korrupsionin në sistem, sepse kjo maxhorancë është vetë korrupsioni. Sali Berishës i ka ngordhur kali i betejës së luftës kundër korrupsionit të Nanos. Ky donte t'i merrte pushtetin këtij të fundit dhe e ka varur në oborrin e çifligut të vet, por tani Nano rezulton amator në çështje të

korruptionit, krahasuar me mjeshtrin e madh që luan me miliona euro, duke e shndërruar vendin në parajsën e të korruptuarve dhe të lulëzimit të krimit të organizuar, madje me lidhje rajonale edhe më gjerë.

Korrupsioni moral, si prelud i korruptionit financiar, nuk është i panjohur për këtë kryeministër. Mashtrimi shkon dorë më dorë me korrupsionin, i dominuar nga psikoza se vendi është çifligu i tij dhe ai bën çdo gjë me pasuritë kombëtare, me pronën publike, me bregdetin dhe detin me Parlamentin dhe Presidentin, me prokurorin dhe gjykatësin, me ushtrinë dhe policinë. A nuk vrau në 21 janar të pafajshëm, që u kishte privuar të drejtën e jetës dinjitoze, të drejtën e punës dhe të jetesës, të cilën ua njeh Kushtetuta? A nuk gënjeu për ngjarjen, siç kishte bërë edhe për Gërdecin? A nuk pengoi hetimin si edhe në raste të tjera?

Ka momente realizmi në raport, kur pranohet se KLSH-ja ka shumë punë për të bërë për kontributin në rezultate të prekshme në luftën kundër korruptionit, në bashkëpunim me agjencitë e institucionet që ligji i ngarkon me detyrën e luftës kundër korruptionit. Agjencitë, institucionet, ligjet dhe strategjitë janë ato që janë ngritur dhe hartuar ndër vite me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë. Problemi është se ligjet nuk zbatohen për të korruptuarit në majën e kupolës së korruptionit, sepse mungon vullneti politik dhe lufta kundër korruptionit është thjesht retorikë boshe. Pikërisht këtë shënojnë partnerët tanë euroatlantikë edhe kur Shqipëria vizitohet prej tyre, por edhe kur Kryeministri u zë derën për të tundur pozat që merr, kur i tërheq pas vetes për t'i përqafuar, zakon ky nga udhëheqësit e tij shpirtërorë, ku kthehet e rikthehet sa herë nuk i dalin hesapet.

Unë mbështes kërkesat dhe nevojat e KLSH-së për infrastrukturë moderne dhe investime në fushën e teknologjisë së informacionit, kërkesa që vihen edhe nga “Sigma”, agjenci e KE-së, sepse mendoj që nesër ky institucion do të drejtohet nga opozita dhe duhet të kryejë detyrën konform ligjeve me metoda bashkëkohore. Këtë e di edhe Kryeministri, të cilit ka kohë që i ka

perënduar ylli i pushtetit, por duhet bërë kujdes, se në ikje bëhet edhe më i rrezikshëm.

Falemnderit!

* Arta Dade Deputete e PS, anëtare e Komisionit parlamentar për Politikën e Jashtme të Kuvendit.

Diskutim i deputetit Sherefedin Shehu*, mbajtur në seancen plenare të Kuvendit datë 26 prill 2012

Të nderuar kolegë deputetë,



Po vazhdon sulmi ndaj institucioneve në forma nga më të ndryshmet, ashtu siç po dëgjojmë sot, se të gjitha aspektet e qeverisjes, që nga privatizimet, menaxhimi financiar dhe ai i sistemit gjyqësor, i administrimit të pronave, por edhe i administrimit politik të vendit po i atribuohen KLSH-së. Të nderuar kolegë socialistë, këto lloje diskutimesh më detyrojnë t'ju kujtoj dy gjëra

kryesore! Së pari, se ka ikur koha kur KLSH-ja ishte xhandar. Ky është një institucion i rëndësishëm parlamentar dhe detyra e tij nuk është detyra e xhandarit, të ruajë, vëzhgojë e sinjalizojë në çdo kohë se çfarë ndodh në Shqipëri, por njëkohësisht dua t'ju kujtoj se KLSH-ja nuk është as prokurori. Dikur institucionet e shtetit përdorëshin si kërbaç për të goditur të tjerët. Ky institucion jep të dhëna për prokurorinë, mund të ngrejë edhe padi, por kemi një institucion tjetër, i cili nuk na funksionon ne, prokuroria, ndaj mos derdhni vrer për institucionet.

Të nderuar kolegë, standardet e reja të BE-së dhe ato të funksionimit të KLSH-së kërkojnë dhe e bëjnë atë një garant për Parlamentin, se si po shpenzohen paratë publike! Ky është misioni i KLSH-së, që nëpërmjet raportit të të paraqitur prej tij në Kuvend, ne duhet të shohim se si po funksionojnë sistemet në Shqipëri, nëse këto sisteme mundësojnë shpenzimin me eficiencë dhe efektivitet të parave publike, por, që ky institucion ta kryejë këtë mision duhet të ketë një bazë ligjore dhe institucione funksionale. Pra, një institucion i vetëm nuk mund të bëjë çudira në Shqipëri. Ndaj, ët mos presim dhe shpresojmë se kemi një xhandar që mban shkopin të ngritur për të goditur të

tjerët, por të shohim nëse ky institucion ka kuadrin e nevojshëm për të funksionuar mirë. Të shohim nëse vetë sistemi ynë ka një bazë ligjore dhe kuadër institucional që garanton funksionim normal të shtetit dhe funksionimin e mirë të parave publike.

Të nderuar kolegë, që të realizohen këto kërkohet vullnet politik, sepse një vullnet politik për të përmirësuar qeverisjen dhe për ta bërë Shqipërinë pjesë të BE-së mund të garantojë një sistem të standardeve të BE-së. Qytetarët shqiptarë po e shohin këtë vullnet të materializuar këto 6 vjetët e fundit, sepse është krijuar një kuadër ligjor, që përditësohet dhe afrohet me atë të BE-së. dëshmia më e qartë është përmirësimi i këtij sistemi gjatë kësaj periudhe dhe plotësimi i angazhimeve që Shqipëria mori përsipër në kuadrin e MSA-së. Po kështu, ne kemi edhe vlerësime të institucioneve të ndryshme sa i përket luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuara. Këto natyrisht e kanë bazën në funksionim e institucioneve shqiptare dhe në mirëqeverisjen e këtij vendi në këto 7 vjetët e fundit.

Të nderuar kolegë, asgjë nuk bëhet me frymën e shenjtë. Në qoftë se gjërat do të lihen në duart e individëve, atëherë do të ketë premise edhe për abuzime. E vetmja garanci që heq mundësinë e vendimeve subjektive janë sistemet. Çfarë ka ndodhur në Shqipëri këto vjetët e fundit? Le të shohim vetëm sistemet kompjuterike, të cilat jo vetëm nuk ekzistojnë, por dukeshin edhe sit ë pamundura, ndonëse jo drejtpërdrejt lidhen me veprimtarinë e KLSH-së, por sistemet në radhë të parë krijojnë vesim dhe mbyllin shtigjet për vjedhje dhe abuzime.

Le t'i shohim ato një nga një, sepse këtu po mohohet gjithçka. Sistemi elektronik i kartave të identitetit, zhurmë e përvitshme, debate politike dhe sot cili është rezultati? Shqytarët lëvizin të lirë në BE. Nuk ka abuzime nëpër zyra, nuk ka vonesa për qytetarët. Kemi sistemin e tatimeve dhe doganave. Në sistemin doganor dhe tatimor bëhen deklarime e paguhen edhe tatime *online* dhe e gjithë puna bazohet në analizat që bën sistemi, në analizat e riskut dhe

këto aspekte tashmë janë vendosur dhe sistemet do të përmirësohen edhe në vazhdimësi. Po kështu, kemi edhe sistemi e kontrollit elektronik të kufijve, të cilët po bëjnë të mundur të rritet reputacioni i Shqipërisë dhe besimi i BE-së dhe partnerëve tanë; më të kemi atë që është më i rëndësishëm dhe rezultat i vullnetit politik të kësaj qeverie: sistemi elektronik i prokurimeve. KLSH-ja vërtet mund t'i certifikojë këto arritje, por efekti i vërtetë ka ardhur nga instalimi i një sistemi të besueshëm, ku garantohet konkurrenca, i një sistemi i cili garanton funksionimin e rregullave të tregut, i një sistemi që ka garantuar 30% uljen e kostos së projekteve që bëhen në Shqipëri. Pra, kursimi ka ardhur nga krijimi i sistemeve. Por kemi sisteme të tjera, kemi sistemin elektronik në arsim për pranimin e studentëve, që ka qenë fusha më e madhe e korrupsionit, korrupsion për të hyrë dhe në universitet, gjëja më e shëmtuar për një vend që aspironte për të hyrë në BE. Por tashmë nuk dëgjojmë as zhurma, as akuza, përveç atyre akuzave që bëhen nga opozita me keqdashje.

Por ka dhe sisteme të tjera në proces, prandaj qytetarët duhet të kenë besim te kjo qeveri, sepse po krijohet sistemi elektronik i koncesioneve. Po kështu, po përmirësohet sistemi elektronik i sigurimeve shoqërore dhe do të krijohet sistemi elektronik i sigurimeve shëndetësore. Prandaj mendoj se Kontrolli i Lartë i Shtetit tashmë është një institucion i cili duhet të na japë garanci për këto aspekte. Po kështu janë vendosur rregulla për sa i përket investimeve publike. Tashmë ato shpërndahen me borde dhe jo nga ministra të veçantë. Dhe më së fundi, dua t'ju them se kemi një vullnet të shprehur qoftë nga drejtuesi, qoftë dhe nga institucioni i ri. Kemi një sërë marrëveshesh në proces me institucionet për luftën kundër krimit ekonomik. Prandaj ju lutem t'i ndihmojmë këto institucione për të funksionuar normalisht për të krijuar bazën e nevojshme ligjore!

Falemnderit!

* Sherefedin Shehu Deputet i PD, anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit.

Diskutim i deputetes Klodiana Spahiu*, mbajtur në seancen plenare të Kuvendit datë 26 prill 2012

Të nderuar kolegë,

Tashmë nuk ka pikë dyshimi nga askush që sistemi ynë shëndetësor është kryekëput i dështuar dhe thellësisht i korruptuar. Korrupsioni është shkaku kryesor i dështimit të tij. Jo për herë të parë këtij përfundimi i është bashkuar dhe institucioni i KLSH-së, por vetëm për majën e ajsbergut. Në analizën e punës së këtij institucioni për vitin 2011 midis të tjerash thuhet se në Ministrinë e Shëndetësisë, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” shumica e tenderave janë kryer pa shpallje, vetëm me negociim dhe se kjo qendër ka shkelur disa parime të disiplinës financiare me vlerë prej 148 milionë lekësh. Gjithashtu, thuhet tekstualisht se kjo ministri është kapur në flagrancë për shkelje të kryera në dëm të shtetit për të cilat KLSH-ja kërkon shlyerjen në masën 100%. Por kjo është vetëm maja e ajsbergut e shpërdorimeve që ndodhin përditë në këtë sektor kaq shumë të dëshiruar dhe të munguar nga e gjithë popullata.

E nisa diskutimin tim me gjetjet e KLSH-së që gjetjet tona të mos konsiderohen si alibi politike, por si fakte reale të grumbulluara me kujdes nga njerëz të përkushtuar në përpjekje serioze për t'i dhënë fund kësaj gjendjeje alarmante në sistemin tonë shëndetësor.

Shpeshherë nga kjo foltore jemi munduar të kundërshtojmë me forcën e logjikës shkeljet dhe korrupsionin në mënyrën e tenderimit të ilaçeve duke përmendur emra konkretë abuzuesish, por nga kjo maxhorancë nuk ka pasur asnjë lloj reflektimi, përkundrazi, me teorinë e zhvatjes, se po vjen fundi, jeni bërë më të egër për të zhytur duart kudo, së fundi edhe në mbetjet spitalore. Problematika e trajtimit të mbetjeve spitalore është alarmante. Po jua them këtë jo vetëm si mjeke-deputete, por edhe si qytetare e zakonshme e këtij vendi se është një skenë e denjë vetëm për filma horror apo dhe për pamjen e ndonjë vendi pas ndonjë lufte të përgjakshme. Nga raportimet shkresore të një

pjesë të mirë të spitaleve, mbetjet spitalore digjen në kushte primitive, ndërsa nuk mungojnë rastet kur ato hidhen ku të munden, duke mos marrë parasysh efektet negative në komunitet.

Gjendja paraqitet tejet alarmante në spitalin e Bulqizës ku mbetjet spitalore hidhen në të njëjtin kazan ku hidhen edhe mbetjet urbane. Kjo bën që fëmijët e qytetit të luajnë me këto mbetje, si: shiringa, bisturi ose tuba plastikë. Por historia nuk mbaron këtu, pasi me mbetjet nga materniteti, ku bëjnë pjesë dhe indet e trupit të njeriut, përfshirë edhe placentat, merren qentë endacakë duke i shpërndarë ato nëpër rrugët e qytetit dhe duke u bërë kështu burim infeksioni për të gjithë banorët. E ngjashme është gjendja në shumë rrethe të tjera, madje dhe në Fier ku pretendohet se ka edhe një hidroklab ose inçenerator të fuqishëm, ku sipas kontrollit të KLSH-së djegia bëhet në natyrë. Sipas studimeve mbetjet spitalore zënë vetëm 0,17% të mbetjeve në përgjithësi dhe ka që në tetor të vitit 2010 që është miratuar në Këshillin e Ministrave rregullorja për administrimin e mbetjeve të cilat do të eliminoheshin përmes sterilizimit me presion dhe avull. Kanë kaluar 18 muaj dhe ja ku jemi.

Por gjuha shkon gjithmonë ku dhemb dhëmbi, atje ku bie çdo ditë kambana, te mungesa e theksuar e ilaçeve nëpër spitale, që tashmë është kthyer në refren të ditës për çdo të sëmur që përplaset nëpër dyert e spitaleve. Shkaqet dihen, janë thënë dhe stërthënë, por nuk është bërë asnjë përpjekje për përmirësim, vetëm fjalë e slogane boshe për veshët e pacienteve që të gjithë inatin e shfryjnë te personeli shëndetësor. Mungesa e protokolleve të diagnozës dhe mjekimit për të cilat ka 10 vjet që flitet dhe ende nuk janë realizuar, krijon mundësi për abuzim pafund në lidhje me skemat e mjekimit që duhet të ishin standarde e në bazë të tyre të bëhej edhe kostoja e diagnozës.

Sot në spitale mungojnë medikamentet bazë, më të rëndësishmet dhe çuditërisht mund të gjesh preparate që janë luks edhe për spitalet perëndimore. Sipas kontrolleve të ndryshme të KLSH-së është vënë re se në

QSUT ose furnizohet shumë dhe ka stoqe, ose nuk furnizohet fare duke shkaktuar mungesa të theksuara medikamentet më të nevojshme. Në këto raste autoritetet “detyrohen” të kryejnë blerje me prokurim të drejtpërdrejtë duke shpenzuar më tepër para sesa ishin parashikuar në fillim. Në QSUT aktualisht mungojnë 200 lloj ilaçesh për të cilat janë duke u zhvilluar tenderat. Edhe pse faza e parë e furnizimit me ilaçe përfundoi në janar të këtij viti, sërish në pjesën më të madhe të pavijoneve ilaçet mungojnë duke i detyruar pacientët t’i blejnë vetë.

Sipas të dhënave të bëra publike në Agjencinë e Prokurimeve Publike tenderat për kimioterapinë dhe ilaçet e onkohematologjisë janë zhvilluar, por 60% e ilaçeve do të dorëzohen në nëntor. Deri atëherë rrofshin agjencitë funerale që janë bërë si kërpudha rreth spitaleve! Në këtë vend për çudi sarkazma arrin deri në përfitimin nga funerali.

Gjithashtu, janë hasur shumë raste kur ilaçet janë marrë nga subjekte të njëjta duke ulur kështu konkurrencën në treg, si dhe duke rritur përqendrimin e fondeve në depot e caktuara dhe më saktë në njerëz pranë pushtetit. Shembuj ka plot, por do të përmend këtu vetëm rastin e një antibiotiku shurup që u fut në listën e barnave spitalore, edhe pse shurupet përdoren rrallë nëpër spitale terciare. Pra, është një nonsens dhe përveç kësaj është blerë në një sasi të madhe prej 4500 flakonësh, që sot janë në depot e QSUT-së dhe kanë një vlerë prej rreth 9 milionë lekësh, për të mos folur më pas për barnat onkologjike ku 2/3 e buxhetit për to i zënë firma farmaceutike të privileguara të cilat nuk kanë ekskluzivitet importi për asnjë prej tyre, por kanë ekskluzivitet për të fituar tendera. Këto sigurisht jo me emra konkretë, i kanë pohuar në tetor të vitit 2011 vetë drejtues të ministrisë të cilët pranojnë që te onkologjiku, dhe jo vetëm ka shkelje, dhe parregullsi dhe dëmi material për këto abuzime me barnat kap shifrën me rreth 1 milion euro. Gjithashtu, abuzimet dhe shkeljet nuk kufizohen vetëm në medikamente, por përfshijnë dhe dhënien me qira të objekteve spitalore, tenderave për pastrimin, blerjen e aparaturave mjekësore,

punësimin mbi organikën e lejuar për arsye përfitimi dhe elektorale. Sipas të dhënave të fundit në QSUT mbahen rreth 290 infermierë mbi organikë me kontratë të përkohshme 2 ose 3 mujore, të cilët janë të terrorizuar për vendin e punës dhe nuk guxojnë të pipëtojnë edhe pse rrogën e marsit nuk e kanë marrë ende. Të irrituar ngrenë zërin me njëri tjetrin, revoltohen, por sapo dëgjojnë që do të ketë reformë rrënjësore në numrin e personelit, shfryhen dhe harrojnë dhe rrogën e papaguar nga institucioni.

E njëjtë është situata dhe në administratë, me një organikë tullumbace që paguhet me taksat e qytetarëve dhe të ardhura dytësore. Shkurtimisht po ju përmbledh dhe një herë vendet kryesore të korrupsionit në tenderin e medikamenteve: 8,5 milionë euro vetëm një kompani, korrupsion në tenderat e Bankës Botërore ende pa shpjegim, korrupsion masiv me tendera aparaturash që janë të tepërta dhe për më keq shumica nuk vihen në punë për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, korrupsion me tendera pa fund për rikonstruksion ose rregullime që nuk mbarojnë kurrë dhe që janë të padukshme, korrupsion galopant në shërbimin e dializës të blerë me preferencë për spitale private mbi kostot reale. Por përballë këtij realiteti dëgjojen kudo sarkazmat e radhës dhe një e tillë që dhe ajo në mbledhjen e Kryeministrit me Task Forcën për shëndetësinë. Unë nuk e di se si janë ndier ata doktorë dhe profesorë të mbledhur në atë tryezë, por injorim më të madh për këdo që i ka dëgjuar nuk ka. Shqipëria na renditet e treta, për sa i përket aksesit në shërbimin shëndetësor. Më lehtë se të gjitha vendet e tjera qytetarët shqiptarë po frekuentojnë më lirshëm sistemin e tyre shëndetësor.

Ka përgjysmim të korrupsionit dhe mitmarrjes duke filluar që nga roja e spitalit. Por si mund të talleh me inteligjencën e qytetarëve deri në këtë shkallë? Si mund të guxosh të përmendësh shërbime të tilla si kardiokirurgji, hemodinamikë pediatrike, transplant veshkash kur vetëm për këtë të fundit u bënë me qindra e mijëra euro investime me aparatura dhe burime njerëzore dhe puna është bllokuar prej kohësh dhe gjithçka është drejtuar te spitalet

private. Po bëni gjithçka ç'është e mundur për ta shkatërruar një herë e mirë sektorin shtetëror.

Së fundi, po i vardiseni dhe asaj pjese që e keni lënë pa privatizuar në Spitalin Ushtarak. O burra në Zall Herr, atje e kanë vendin mjekët ushtarakë, të tjerët të dalin në pension, të nxitohen të lirojnë vendet se është planifikuar gjithçka! Nuk e di se sa orë do të duhen për korrupsionin gjoja të përgjysmuar në sektorin e shëndetësisë, për aksesin e shkëlqyer të qytetarëve në shërbimet shëndetësore. Më parakalojnë në mendje të sëmurët kronikë, diabetikët, kardiakët, paraplegjikët, të verbrit, të sëmurët e dializës, ata të onkologjikut, talasemikët dhe për secilin grup ndiej keqardhje për fatin që patën të sëmuren në këtë vend. Ky realitet duhet të ndryshojë dhe për këtë ne jemi të vendosur të punojmë ndershmërisht, për t'i dhënë fund një herë e mirë kësaj katrahure. Shërbimi shëndetësor është e drejtë e çdo qytetari.

Politika jonë bazohet në parimin: "Secili sipas mundësive dhe shteti për të gjithë, jo secili për vete e Zoti për të gjithë"! Modeli aktual ka dështuar dhe kalbet mbi tokë nga korrupsioni kapilar. Në këtë sistem më tepër se gjysma e pagesave bëhen nga xhepi i qytetarëve. Tarifat për të pasiguarit u rritën katër herë, po kështu dhe TVSH-ja. Jemi të bindur se politikat aktuale garantojnë vetëm rrënimin e shëndetësisë. Shëndetësia sot nuk parandalon, nuk kuron, nuk rehabiliton dhe nuk shpëton. Vetë punonjësit e shëndetësisë janë lënë në kushte mjerane, nën tutelën e drejtimit politik dhe nën kanosjen e sigurisë fizike.

Sfida jonë është t'u rikthejmë qytetarëve besimin e humbur të shëndetësia, por dhe personelit shëndetësor t'i rikthejmë dinjitetin e humbur.

Falemnderit!

* Klodiana Spahiu Deputete e PS, Anëtare e Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë të Kuvendit.

Diskutim i deputetit Selami Xhepa*, mbajtur në seancën plenare të Kuvendit datë 26 prill 2012

Të nderuar kolegë,



Së pari, dëshiroj të shpreh vlerësimet e mia pozitive për veprimtarinë e KLSH-së. Raportet e këtij institucioni në monitorimin e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Qeverisë, dhe të institucioneve publike, kanë shërbyer si një instrument shumë i rëndësishëm i kontrollit parlamentar, por, mbi të gjitha, ato kanë nxitur një debat të gjerë publik e mediatik rreth gjykimit të performancës

ekonomike dhe financiare të Qeverisë shqiptare.

Duke qenë se raportet e KLSH-së ndikojnë në mënyrë të fuqishme në formësimin e opinionit publik lidhur me eficiencën e Qeverisë dhe vetë integritetin e saj, rëndësia e cilësisë së këtyre raporteve, e profesionalizmit të tyre, e adoptimit të standardeve më të larta, qoftë të kontrollit financiar dhe të auditimit të performancës, janë elemente thelbësore të paanësisë dhe të objektivitetit të punës së këtij institucioni. A i ka arritur KLSH-ja në fakt standarde të tilla? Gjykuar nga kuadri rregullator mbi të cilën e ka ndërtuar punën e vet ky institucion vihet re se veprimtaria e kontrollorëve mbështetet mbi rregulla dhe standarde të përditësuara gjatë viteve të fundit duke synuar adoptimin e politikave dhe praktikave më të mira dhe të standardeve të Intosajt në auditimin e performancës dhe në auditimin financiar. Po kështu institucioni ka ndërtuar programe të rëndësishme të trajnimit të stafit, ka rritur transparencën publike, duke bërë të njohur dhe mediatizuar të gjithë veprimtarinë e saj të kontrollit. Me pak fjalë dua të them se ka një angazhim

për të përmirësuar gjithnjë e më shumë, cilësinë e kontrollit dhe punën në tërësi të këtij institucioni.

Nga ana tjetër nuk mund të mos nënvizohen disa dobësi dhe mangësi, shpeshherë dhe serioze në veprimtarinë e tij. Jo rrallëherë raportet e botuara kanë pasur një natyrë kryesisht të kobures politike, nuk kanë pasur referenca të plota të sakta ligjore, gjë që është evidentuar dhe në marrëdhëniet e KLSH-së me prokurorinë, ku shumë denoncime të kontrollit janë pezulluar nga prokuroria apo çështjet janë mbyllur nga gjykata. Në disa raste mund të ketë pasur tejkalim kompetencash duke marrë vendime që kanë penalizuar subjektet private, në mënyrë indirekte, duke shfrytëzuar të drejtën e kontrollit veçanërisht në dogana dhe në tatime. Gjëja që vazhdon të më befasojë është raportimi i performancës së organeve të fiskut. Çdo mosrealizim të ardhurash të buxhetit klasifikohet si dëm ekonomik, se iks milionë lekë janë shpërdoruar. Kjo mënyrë raportimi më duket e padrejtë, sepse është vetë Ministria e Financave që harton planin dhe që përgjigjet për realizimin e tij. Në këtë kuptim, kjo mënyrë raportimi mund të bëjë që vetë Ministria e Financave të prognozohet me më shumë rezerva rritjen e të ardhurave, në mënyrë që të shmangë kritikën publike në adresë të këtij institucioni. Por, a nuk do të ishte kjo nënperformancë në planifikim të ardhurash po ashtu një dëm ekonomik, që KLSH-ja nuk mund ta evidentojë kurrë?

Në çdo raport të KLSH-së, një pjesë të rëndësishme zënë abuzimet në zërin e pagave dhe shpërblimeve. A nuk është detyrë e KLSH-së të lëshojë udhëzime më të sakta dhe të koordinojë me Ministrinë e Financave për korrektimin e situatës dhe shmangien e praktikave të tilla, që çështje të tilla të mos rezultojnë të përhershme në këto raporte? Duke qenë se është një institucion që edhe vetë është lehtësisht i prekshëm nga korrupsioni, në rregullat e brendshme të tij dhe mënyrën e organizimit të punës, nuk gjej rregulla të qarta dhe procedura të shkruara për të parandaluar praktikën korruptive edhe vetë brenda këtij institucioni. Me pak fjalë, detyra e KLSH-së është të ndihmojë në

ritjen e eficiencës së përdorimit të fondeve publike, duke parandaluar praktikat e dëmshme në menaxhim dhe jo të zëvendësojë apo të dublojë prokurorinë dhe institucionet e tjera të krimit ekonomik.

Jam besimplotë se kryetari i ri i KLSH-së, zoti Leskaj, do të tregojë të gjithë angazhimin e tij për të reformuar më tej punën e institucionit. Projektligji që ai ka përgatitur dhe do t'i nënshtrohet së shpejti debatit parlamentar do të krijojë mundësinë për të rikonceptuar punën e tij, duke e rimodeluar atë, sipas parimeve më të shëndosha të kontrollit dhe auditimit të performancës në veprimtarinë e institucioneve publike.

Falemnderit!

* Selami Xhepa Deputet i PD, anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit, Doktor i Shkencave Ekonomike.

Diskutim i deputetit Asllan Dogjani*, mbajtur në seancen plenare të Kuvendit datë 26 prill 2012



Duke rilexuar raportin e publikuar nga KLSH-ja dhe duke parë shifrat, dëmet, vjedhjet, abuzimet nga institucionet e shtetit shihet qartë se pushtetarët dhe qeveritarët tanë nuk kanë më as frikë e as turp dhe janë vënë në garë kush e kush të vjedhë më shumë dhe kush të pasurohet më shumë se tjetri, pa dashur të dinë se sot shumë familje janë në mjerim dhe e humbin jetën edhe për një thes

miell. Qytetarët i kanë humbur besimin dhe shpresat për të ardhmen, janë turrur të gjithë dhe po vjedhin pasuritë e shqiptarëve pa pasur frikë nga ligji, pa pasur frikë nga asgjë. Po i vjedhin jo vetëm përmes shkeljes, por edhe nëpërmjet hartimit të ligjeve. Dëmi i përgjithshëm i zbuluar nga KLSH-ja kap shifrën e 7 miliardë lekëve. Po ta krahasosh këtë dëm me çfarë ndodh vërtet në institucionet e shtetit, në Qeveri, pushtetin qendror dhe vendor me paratë e shqiptarëve, kjo shifër është e papërfillshme.

Çdo ditë e më tepër dalin fakte të pakundërshtueshme për një korrupsion masiv në çdo sektor, në administratën dogana, tatime, tendera, arsim, shëndetësi, polici, ushtri e kudo. Vetëm në fushën e dhënies me qira të pasurive shtetërore dëmi kap shifrën e 352 milionë 232 mijë lekë. Dëme ka kudo, në urbanistikë, paga, shpenzime dhe në të gjithë sektorët. Ndërsa korrupsioni ka përfshirë çdo sektor e qelizë të shoqërisë dhe Qeverisë, në raportin e KLSH-së thuhet shumë pak ose aspak për korrupsioni nëpër ministri, në pushtetin vendor dhe dëmin që i është shkaktuar buxhetit të shtetit nga vjedhjet dhe korrupsioni në ndërtimin e rrugëve, në dhënien e koncesioneve, në fushën e prokurimeve publike dhe në të njëjtën kohë, numri i kallëzimeve penale ka ardhur në rënie. Është ushtruar kontroll në Ministrinë e

Mbrojtjes dhe dëmi i shkaktuar, sipas KLSH-së, është 1 milion e 204 mijë lekë. E pabesueshme! Në raport nuk është pasqyruar asnjë përqindje e vogël e korrupsionit. Çdo ditë e më tepër dalin fakte tronditëse për vjedhje dhe shpërdorime në Ministrinë e Mbrojtjes, në Forcat e Armatosura, ndërkohë që jemi edhe vend anëtar i NATO-s.

Ndërkohë, në raport nuk janë evidentuar investimet tërësisht të panevojshme në Ministrinë e Mbrojtjes me buxhet të shtetit në miliona euro dhe ndërkohë këto objekte që janë ndërtuar, sot janë bosh dhe nuk funksionojnë. Pra, janë jashtë nevojave. Në buxhetin e viti 2011 ka qenë prioritet vaksinimi i personelit të FA-së. Pse nuk ka asnjë të dhënë në këtë raport se sa është realizuar ky projekt, sa ka qenë buxheti dhe sa është shpenzuar? Si e shpjegoni ju faktin që ushtarakët e FA-së sot refuzojnë ushqimin e firmave fantazmë të lidhura më Qeverinë për shkak të cilësisë së dobët të ushqimit dhe nuk përmendet në raport se si janë zbatuar procedurat e dhënies së tenderave dhe a ka abuzim, vjedhje, dhe shpërdorim fondesh? Pse Ministria e Mbrojtjes u ka hequr ushtarakëve kuotën e ushqimit në lekë, duke i detyruar ata të hanë ushqim jashtë standardeve? Pse nuk rezultojnë në raport shkeljet e përmendura në media në lidhje me tenderimin e skrapit të komandës së forcave detare, ku vetëm në tre nëndetëse të shitura për skrap rezulton një diferencë 600 tonë, që nuk dihet se ku është dhe firma tenderuese ka hedhur në gjyq Ministrinë e Mbrojtjes për këtë diferencë? Si ç'dëgjuam në media, u zhdukën edhe dy anije. A ka lidhje kjo me influencën e ndonjë politikani apo qeveritari? Firma që mori tenderin e nëndetëseve me kë ka lidhje? Në Vlorë e dinë të gjithë se kush fshihet pas tyre.

Rezulton se në këtë raport nuk përmendet asnjë fjalë në lidhje me kontrollin e ushtruar në fushën e karburanteve, ndërkohë që dihet edhe nga publiku se një pjesë e karburantit është shpenzuar për fushatën elektorale të 8 majit. Pa përmendur shkatërrimin e automjeteve të Ministrisë së Mbrojtjes nga nafta virgin. Pse KLSH-ja nuk ka evidentuar se sa është dëmi ekonomik që i është

shkaktuar Ministrisë së Mbrojtjes nga shkarkimet e padrejta që u janë bërë ushtarakëve dhe civilëve të FA-së, të cilët kanë fituar gjyqet dhe sot për një vend pune paguhen dy persona? A është konstatuar ndonjë shkelje? Si nuk përmendet në raport asnjë fjalë për procesin e privatizimit të qindra objekteve të ushtrisë, që janë shitur dhe po shiten për klientët e Qeverisë në shuma qesharake?

E njëjta situatë në Ministrinë e Brendshme. Edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dëmi i shkaktuar, sipas KLSH-së, është 259 mijë lekë. Edhe kjo një shifër që duket krejt e pabesueshme. Pse nuk thuhet asnjë fjalë në raport në lidhje me procedurat e tenderimit të uniformave të policisë se si është zbatuar tenderi? Nga ana jonë janë denoncuar në vazhdimësi parregullsitë. Sa është dëmi dhe cilët janë përgjegjësit? Nuk po u futem këtu problemeve të dietave dhe shpërblimeve për orët jashtë orarit, për pagesat për vjetërsi e vështirësi shërbimi për punonjësit e policisë, sepse as nuk bëhet fjalë dhe nuk u jepen këto të drejta. Marrin shpërblime e dieta vetëm shefat kryesorë, sepse për policët nuk duan t'ia dinë.

I njëjti problem me zbatimin e vendimeve gjyqësore. Çfarë po ndodh me tenderat? Dëmi i shkaktuar në fushën e prokurimeve publike është 210 milionë 324 mijë lekë. Edhe kjo shifër nuk është asgjë me çfarë ndodh në të vërtetë. Bëj çfarë të duash, futu në tendera edhe pse gjoja janë elektronikë, tenderi është i paracaktuar për ta marrë ai që paguan më shumë te shefi.

Mos o Zot, të merresh me vjedhjet e fondeve nga pushteti vendor në qarkun e Kukësit! Katastrofë. Në shumicën komunave që drejtohen prej 20 vjetësh prej të njëjtëve persona nuk bëhet asgjë për banorët e tyre. Kur shkon në këto zona mungon gjithçka, mungon uji i pijshëm. Banorët kanë ardhur duke u varfëruar më shumë dhe për këtë mendja të shkon që këta pushtetarë ose nuk kanë marrë asnjë lek nga buxheti i shtetit këto 20 vjet, gjë që nuk është e vërtetë, ose këto para kanë përfunduar në xhepat e tyre për t'i përdorur për fushatë elektorale apo për interesat e tyre. Pa u marrë me ndihmën

ekonomike që e përdorin për interesa personale. Dikujt ia japin, edhe pse nuk i takon dhe dikujt nuk ia japin edhe pse i takon. Njerëzit jetojnë në varfëri të plotë. Në këto komuna duhet të shkonte KLSH-ja, të ushtronte kontroll për mënyrën dhe procedurat e dhënies së tenderit të ujësjellësit të Kukësit. 3,5 milionë euro janë dhënë për ndërtimin e këtij ujësjellësi. Afati i përfundimit ka qenë janar 2011. Asgjë nuk është bërë deri sot dhe nuk i dihet se kur do të mbarojë ky ujësjellës, por edhe po mbaroi, përsëri nuk e zgjidh problemin e ujit për qytetarët e Kukësit, pasi ky ujësjellës megjithëse shpenzon 3,5 milionë euro, nuk sjell burime të reja dhe qytetarët e Kukësit do të vazhdojnë të vuajnë për ujin e pijshëm.

Korrupsioni është kudo dhe për çdo gjë duhet të paguash. Për t'u emëruar në një vend pune, për t'u transferuar si mjek, për t'u emëruar si mësues, për të punuar në Rinas, kudo dhe për çdo gjë duhet të paguash. Këtë duhet të kontrollonte KLSH-ja dhe jo të sillte një raport që na tregon se si është organizuar ky institucion dhe departamentet e tij. KLSH-ja sot nuk duhet të vinte me një raport që të tregonte se si funksionon si institucion, por të jepte rekomandime për përgjegjësit e gjendjes.

Faleminderit!

* Asllan Dogjani Deputet i PS, anëtar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare të Kuvendit.

Diskutim i deputetit Gjok Uldedaj*, mbajtur në seancën plenare të Kuvendit datë 26 prill 2012

Të nderuar kolegë deputetë,



Edhe në diskutimin e këtij raporti të KLSH-së ju, kolegë opozitarë, nuk hiqni dorë nga oponenca propagandistike, ju, gjithashtu nuk jepni alternativa dhe rrugëzgjdhje dhe dini vetëm të thoni se çfarë nuk është mirë dhe asgjë më tepër. Ky nuk është roli që duhet të ketë opozita në Parlament. Ne do të dëshironim një opozitë që hedh në treg alternativa që lidhen jo vetëm me përcaktimin

e rolit që duhet të ketë KLSH-ja, por edhe për strategjitë dhe mënyrat e administrimit efikas të financave publike.

Objektivi i Qeverisë “Berisha”: Shqipëria vend i zhvilluar dhe vend i integruar në Europë, kërkon që secili nga ne të japë kontribut, pasi performanca e këtij institucioni nuk është në interes vetëm të kësaj maxhorance, por janë në plan të parë interesat e vendit. Mos të harrojmë se kriza ekonomike ka shërbyer si një pikë e rëndësishme refleksioni, por ne nuk kemi pritur që gjërat të ndryshojnë duke bërë të njëjtat gjëra. Reformat kanë qenë forma më e mirë e profilaksisë antikrizë. Në këtë kuadër ne si ligjvënës duhet të rrisim nivelin e kërkesës së KLSH-së. Mos bëni sikur nuk kuptoni se ekonomia shqiptare me treguesit e arritur shpërbleu politikën e ndjekur të kësaj maxhorance nëpërmjet reformave të realizuara që në një farë mënyre kanë lehtësuar edhe punën e institucioneve të kontrollit ekonomik dhe financiar.

Të nderuar kolegë opozitarë, egoizmi dhe fabrikimi i teorive boshe është këshilltari juaj më i keq. Një fjalë e urtë thotë: “Kur të mbetesh pa argumente,

kundërshto dhe ofendo kundërshtarin.” Këtë po bëni ju çdo ditë, por edhe këtu në Parlament.

Ju duhet të dini se i pritshmi juaj varet nga çfarë ju po ofroni nëpërmjet alternativave tuaja boshe. Tri gjëra po e bëjnë të dështuar lëvizjen tuaj të kohëve të fundit duke u fshehur pas çdo ligji, pas çdo raporti dhe pas çdo iniciative qeveritare: Diversioni, xhelozia dhe integriteti i dobët.

Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit është jo vetëm një pasqyrë realiste e situatës, por merr përsipër edhe angazhime për të ardhmen. Fryma e këtij raporti kërkon mbështetje dhe jo ndërkëmbës, siç e keni bërë traditë ju, të nderuar opozitarë.

Ju e kuptoni, të nderuar kolegë opozitarë, që keni hyrë në një spirale të ngatërruar dhe pa alternativa, në një antagonizëm të thellë me realitetin dhe arritjet ekonomike të vendit. Motoja juaj është të mohoni gjithçka dhe çdo gjë. Shqipëria është në një stad të ri zhvillimi, kemi krijuar një model ekonomik të qëndrueshëm që kërkon ristrukturim të vazhdueshëm, por ne kemi theksuar se Shqipëria është përpara sfidave themelore për të precizuar një koncept dhe një politikë të qartë, për të përmirësuar modelin e rritjes ekonomike dhe faktorët esenciale të saj. Mos i banalizoni gjërat përpara opinionit publik! Duhet të kemi respekt për veten, në radhë të parë, pasi ky raport përqendrohet në përgjigjen e këtij institucioni ndaj rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të datës 2 qershor 2011, duke pasqyruar me realizëm performancën e tij vjetore, duke evidentuar problematikat e konstatuara gjatë vitit 2011, dhe duke përcaktuar saktë objektivat në vazhdim në vitin 2012.

Raporti u jep një përgjigje me profesionalizëm të gjitha pikave të rezolutës që lidhen në marrëdhëniet me Kuvendin. Unë mendoj se performanca e Kontrollit të Lartë të Shtetit ka qenë e lidhur me përpjekjet e vazhdueshme për të zbatuar një metodologji bashkëkohore, bazuar në standardet ndërkombëtare për kontrollin dhe me praktikën më të mira audituese të vendeve të Bashkimit Europian. Sigurisht që në këtë drejtim ka dhe shumë mangësi, të cilat janë

objektivi kryesor i punës së këtij institucioni për vitin 2012. Ne duhet të vlerësojmë faktin se gjatë periudhës ushtrimore janë realizuar 152 kontrolle nga 150 kontrolle gjithsej të programuara, por vlerësimi i rezultateve të kontrollit është i lidhur dhe me vlerën totale të zbulimeve të dëmit ekonomik, konstatuar, evidentuar dhe të raportuara në përfundimet e kontrollit të kryer gjatë vitit 2011.

Një tregues tjetër që është rritur nga viti në vit është edhe mënyra e reagimit të institucioneve kontrolluese ndaj rekomandimeve dhe masave të propozuara. Në këtë kuadër është pozitiv fakti se nga 1605 masa të rekomanduara gjithsej janë zbatuar plotësisht 1093 prej tyre dhe pjesërisht 15, kurse në proces janë 184.

Ne duhet të jemi edhe kritikë kur bëhet fjalë për marrëdhëniet e bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë të kontrollit, siç është INTOSAI, EUROSAI, Gykata e Llogarive e Bashkimit Europian dhe me institucionet homologe të kontrollit, që ndonëse ka pasur rritje në vijimësi, nuk janë shfrytëzuar siç duhet dhe nuk kanë qenë shumë dobiprurëse për institucionin. Unë shpreh bindjen referuar raportit dhe programit të veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2012, se do të kemi një tejkalim të mangësive të vërejtura gjatë vitit 2011, si dhe do të arrihet një fuqizim i mëtejshëm i rezultateve dhe i arritjeve të derisotme të këtij institucioni. Unë do të thosha që vizioni i kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit është në të njëjtën linjë me kërkesat standarde të këtij institucioni. Me shumë rëndësi është fuqizimi i rolit të pazëvendësueshëm kushtetues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucion kryesor ekonomik-financiar, me detyrë kontrollin e miradministrimit të pronës publike dhe shëndoshjen e financave publike.

Për sqarim, zotërinj opozitarë, ju ngatërroni dëmin ekonomik me marrëdhëniet kontraktore midis subjekteve, qofshin këto edhe shtetërore, siç është "Abipetroli". Këto ditë ne kemi marrë draftligjin e ri nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ju ftoj të kontribuoni në këtë drejtim, pasi ligji kërkon 3/5-at

dhe të mos mjaftohemi vetëm me konstatime, por të jemi pjesë kontribuuese edhe në këtë drejtim.

Falemnderit!

* Gjok Uldedaj Deputet i PD, anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financa, anëtar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare të Kuvendit, Doktor i Shkencave Ekonomike.

Diskutim i deputetit Erjon Braçe*, mbajtur në seancen plenare të Kuvendit datë 26 prill 2012



Do të doja t'i drejtohesha Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, por, për fat të keq është larguar, megjithatë fjalën time edhe në emër të grupit natyrisht që do t'ia adresoj zotit Leskaj.

Zoti Leskaj, korrupsioni po shquhet prej disa vitesh si një problem shumë i madh dhe serioz në këtë vend, është kthyer në mënyrë qeverisjeje, është kthyer në një mënyrë pasurimi masiv, të lehtë, por

gjithmonë në mënyrë të paligjshme, është kthyer në mënyrë jetese, anë e kënd këtij vendi dhe pothuajse për pjesën më të madhe të atyre që kanë marrëdhënie me shtetin. Natyrisht dëmi kryesor prej korrupsionit po i bëhet interesit publik. Cenimi i rëndë i interesit publik po na rrënon totalisht si shtet, po na rrënon totalisht si shqiptarë, shtetas të këtij vendi, por njëherësh korrupsioni po kthehet edhe në një shqetësim ndërkombëtar, është prioriteti absolut i 12 kushteve të Bashkimit Europian, përmendur veçanërisht në raportet e fundit.

Do të doja t'i citoja konkluzionet e raporteve të vitit 2010 dhe 2011 të BE-së. Në vitin 2010 përkufizimi është ky: "Korrupsioni mbizotëron në shumë fusha dhe është një problem veçanërisht serioz".

Në raportin e progresit të vitit 2011 formulimi është po ky: "Korrupsioni është i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë problem veçanërisht serioz". Është e njëjta fjali që dëshmon fare qartë mungesën e progresit në luftën kundër korrupsionit dhe rrënjosjen dramatike të këtij fenomeni pothuajse në çdo sektor që administrohet gjerësisht nga Qeveria ose agjencitë e saj.

Zoti Leskaj, ju jeni instrumenti më i rëndësishëm kushtetues për të luftuar korrupsionin, pra KLSH-ja që ju drejtoni. Doja të ndalesha te raporti i paraqitur për të thënë se ai ka ndryshuar në thelb dhe kjo jo për mirë, raporti ka

ndryshuar në formë dhe natyrisht jo për mirë, raporti ka ndryshuar dhe cilësisht në dëm të transparencës, pra të gjetjeve të KLSH-së. Këtë e thashë në Komisionin e Ekonomisë dhe dua ta përsëris edhe këtu. Janë disa raporte të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat tashmë duhet t'i tregohen publikut. Është raporti për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për vitet 2008-2009 që çdo shqiptar duhet ta marrë ta lexojë dhe ta ketë në vëmendjen e tij; është raporti për veprimtarinë e Agjencisë së Legalizimit, të cilin çdo shqiptar duhet ta marrë dhe ta lexojë se çfarë po ndodh; është raporti ose një sërë raportesh për veprimtarinë e ndërmarrjeve ose shoqërive publike, raporte të cilat çdo shqiptar duhet t'i marrë dhe t'i shohë për të kuptuar se si administrohet pasuria e këtij vendi.

Do të ndalesha dhe të një element i veçantë që ka qenë pjesë e raporteve të KLSH-së deri te ky i fundit, raporti mbi grantin konkurrues, një fond i cili gjithnjë e më tepër po merr një karakter të theksuar politik ose si një fond i vënë në dispozicion vetëm të një njeriu, zëvendësministrit të Punëve të Brendshme thjesht dhe vetëm si shpërblim për veprimtaritë e tjera të këtij zotërie.

Zoti Leskaj, në raportin e progresit të BE-së vihet një theks shumë i madh mbi hetimet proaktive administrative, që në bazë të ligjit i ndërmerrni edhe ju, por hetime proaktive për organet ose agjencitë e tjera ligjzbatuese të shtetit, kryesisht për prokurorinë. Unë do të doja që t'ju rekomandoja disa fusha ku fare lehtësisht mund të ushtrohen pikërisht këto hetime proaktive.

Së pari, dhe mbi të gjitha doja të ndalesha në kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë për një sërë kontratash privatizimi të miratuara këtu me ligj të Kuvendit të Shqipërisë, kontrata që kanë miratuar dhe detyrime të posaçme për secilën nga kompanitë përfutuese nga ky proces privatizimi. Mbi të gjitha për kontratën e privatizimit të kompanisë ARMO, e cila mbart pikërisht një investim prej gati 228 milionë euro deri në vitin korrent, vit në të cilin jemi.

Do të doja që ju ta kontrolloni zbatimin e kësaj kontrate. Janë investuar 228 milionë euro, sepse pikërisht në atë kontratë ka edhe penalitete për moszbatimin e kësaj pike të kontratës. Ne nuk kemi privatizuar thjesht dhe vetëm për të shitur, por ne kemi privatizuar për të zhvilluar. Pikërisht për këtë arsye unë do të kërkoja nga ju që të kontrolloni zbatimin e kontratës së privatizimit të kompanisë CEZ. Edhe ajo ka një vlerë të konsiderueshme investimesh deri në këtë vit që jemi, vitin korrent. Janë kryer këto investime apo jo? Është zbatuar kjo pikë e kontratës apo jo?

Ashtu siç do të doja t'ju referoja në një tjetër ligj të Kuvendit, ligjin me anë të të cilit u shit licenca e katërt celulare dhe veçanërisht në një pikë. Ajo licencë u shit Post Telekomit të Kosovës. Post-Telekomi i Kosovës na u tregua si investitori strategjik. Po jua them unë, zoti Leskaj, para se ta verifikoni ju: nuk ka më Post-telekom në Kosovë brenda atij konsorciumi, madje është përzënë me shkelma para afatit të përcaktuar me detyrim ligjor.

Doja të ndalesha në një fushë tjetër, e cila duhet të vihet menjëherë nën kontroll, është ajo e koncesioneve, veçanërisht në energjetikë, ose më saktë në hidroenergjetikë. Zoti kryetar i KLSH-së, ka një problem shumë të madh, vënë re edhe nga raporti i progresit të BE-së, në këtë mes. Nuk ka konkurrencë dhe 99% e procedurave e kontratave jepen vetëm përmes procedurës, propozim i pakërkuar. Ky është konteksti, por konteksti më i madh vjen pikërisht në një pikë shumë të rëndësishme: a janë zbatuar kontratat që kanë nënshkruar Qeveria e Shqipërisë me këta investitorë apo jo? 80% e tyre janë jashtë afateve, madje jashtë afatit të dytë të vendosur nga Qeveria, duke mbajtur peng pasuri kolosale të cilat mund t'i shërbenin jo vetëm sektorit energjetik në Shqipëri, por edhe vendit. Për të folur më pas për naftën.

Ju besoj e keni ndjekur debatin që është bërë dhe këtu në Kuvend. Janë një mori marrëveshjesh hidrokarbure, të cilat kanë në afate të caktuara investime që duhet të kryheshin. Ka ardhur momenti që të kontrollohen, sepse agjencitë e tjera që e kanë pasur këtë detyrim nuk e kanë bërë, prandaj KLSH-ja duhet

të marrë në shqyrtim pikërisht këto marrëveshje hidrokarbure. Këto kontrata janë realizuar apo jo dhe në përfitim të kujt, të interesit publik apo të interesit privat thjesht dhe vetëm këtyre kompanive që po nxjerrin miliona nga pasuria e nëntokës së Shqipërisë. E njëjta gjë ndodh dhe me mineralet.

Kthejuni Bulqizës, sepse e kemi që të gjithë detyrim. Mjafton të shikosh se si i zhvatën deri dhe fëmijët në Bulqizë, se si u ngarkohen deri në 100 kilogramë gurë mbi kurriz, për të kuptuar se ato kontrata koncensionare që janë lidhur duhet të kontrollohen më në fund nga një institucion kushtetues, me qëllim që të marrë fund shfrytëzimi kriminal jo vetë i burimeve natyrore por dhe i njerëzve në Bulqizë, për të ardhur tek ato që duhen kontrolluar dhe që janë monopole, të cilat i ka lëshuar Qeveria me kontrata.

Monopoli i pullave fiskale. Po zbatohet kontrata apo jo? Duhet hetuar pa diskutim monopoli që ministri i Transportit dha për ndërtimin e fibrave optike, në të gjitha akset rrugore pasi ishin ndërtuar, duke dëmtuar rëndë dhe të gjitha akset rrugore anekënd Shqipërisë, vetëm te një kompani. Ashtu siç duhet kontrolluar tashmë edhe kontrata e Qeverisë për të lëshuar monopolin e shërbimit dhe kontrollit të automjeteve.

Zoti Leskaj, fushat që do t'ju rekomandoja për hetime proaktive janë të mëdha, por unë do të ndalem vetëm në dy prej tyre. Në zbatimin e ligjit për legalizimin ka ndodhur një masakër e paparë që vetëm tani po del në publik, një mashtrim total jo vetëm përkundrejt qytetarëve, por edhe përkundrejt arkës së buxhetit të shtetit, një krim i përbindshëm me një dëm ekonomik kolosal. Ju duhet t'i shkoni deri në fund, pavarësisht se ai që është në qendër të këtij krimi është anëtar i byrosë politike të PD-së.

Ashtu siç ligji tjetër për pronësinë e truallit në zonën me përparësi turizmin është kthyer në një mjet abuzimi kriminal në të gjithë vijën bregdetare të vendit. Me çmime mizerabël po shiten sipërfaqe toke që vlejné miliona euro. Do të kemi rastin ta diskutojmë edhe në javët në vijim, por është një krim i

përbindshëm, sepse një sipërfaqe prej 30 dynym po shitet vetëm për 20 mijë lekë metri katror, ku vlen 30 milionë euro, dhe kontrata ka përfunduar.

* Erjon Braçe Deputet i PS, anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financa, të Kuvendit.

Diskutim i deputetit Edmond Spaho*, mbajtur në seancen plenare të Kuvendit datë 26 prill 2012

Të nderuar kolegë deputetë,



Edhe në diskutimin e këtij raporti të KLSH-së ju, kolegë opozitarë, nuk hiqni dorë nga oponenca propagandistike, ju, gjithashtu nuk jepni alternativa dhe rrugëzgjdhje dhe dini vetëm të thoni se çfarë nuk është mirë dhe asgjë më tepër. Ky nuk është roli që duhet të ketë opozita në Parlament. Ne do të dëshironim një opozitë që hedh në treg alternativa që lidhen jo vetëm me përcaktimin e rolit që duhet të ketë KLSH-

ja, por edhe për strategjitë dhe mënyrat e administrimit efikas të financave publike.

Objektivi i Qeverisë “Berisha”: Shqipëria vend i zhvilluar dhe vend i integruar në Europë, kërkon që secili nga ne të japë kontribut, pasi performanca e këtij institucioni nuk është në interes vetëm të kësaj maxhorance, por janë në plan të parë interesat e vendit. Mos të harrojmë se kriza ekonomike ka shërbyer si një pikë e rëndësishme refleksioni, por ne nuk kemi pritur që gjërat të ndryshojnë duke bërë të njëjtat gjëra. Reformat kanë qenë forma më e mirë e profilaksisë antikrizë. Në këtë kuadër ne si ligjvënës duhet të rrisim nivelin e kërkesës së KLSH-së. Mos bëni sikur nuk kuptoni se ekonomia shqiptare me treguesit e arritur shpërbleu politikën e ndjekur të kësaj maxhorance nëpërmjet reformave të realizuara që në një farë mënyre kanë lehtësuar edhe punën e institucioneve të kontrollit ekonomik dhe financiar.

Të nderuar kolegë opozitarë, egoizmi dhe fabrikimi i teorive boshe është këshilltari juaj më i keq. Një fjalë e urtë thotë: “Kur të mbetesh pa argumente,

kundërshto dhe ofendo kundërshtarin.” Këtë po bëni ju çdo ditë, por edhe këtu në Parlament.

Ju duhet të dini se i pritshmi juaj varet nga çfarë ju po ofroni nëpërmjet alternativave tuaja boshe. Tri gjëra po e bëjnë të dështuar lëvizjen tuaj të kohëve të fundit duke u fshehur pas çdo ligji, pas çdo raporti dhe pas çdo iniciative qeveritare: Diversioni, xhelozia dhe integriteti i dobët.

Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit është jo vetëm një pasqyrë realiste e situatës, por merr përsipër edhe angazhime për të ardhmen. Fryma e këtij raporti kërkon mbështetje dhe jo ndërkëmbës, siç e keni bërë traditë ju, të nderuar opozitarë.

Ju e kuptoni, të nderuar kolegë opozitarë, që keni hyrë në një spirale të ngatërruar dhe pa alternativa, në një antagonizëm të thellë me realitetin dhe arritjet ekonomike të vendit. Motoja juaj është të mohoni gjithçka dhe çdo gjë. Shqipëria është në një stad të ri zhvillimi, kemi krijuar një model ekonomik të qëndrueshëm që kërkon ristrukturim të vazhdueshëm, por ne kemi theksuar se Shqipëria është përpara sfidave themelore për të precizuar një koncept dhe një politikë të qartë, për të përmirësuar modelin e rritjes ekonomike dhe faktorët esenciale të saj. Mos i banalizoni gjërat përpara opinionit publik! Duhet të kemi respekt për veten, në radhë të parë, pasi ky raport përqendrohet në përgjigjen e këtij institucioni ndaj rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të datës 2 qershor 2011, duke pasqyruar me realizëm performancën e tij vjetore, duke evidentuar problematikat e konstatuara gjatë vitit 2011, dhe duke përcaktuar saktë objektivat në vazhdim në vitin 2012.

Raporti u jep një përgjigje me profesionalizëm të gjitha pikave të rezolutës që lidhen në marrëdhëniet me Kuvendin. Unë mendoj se performanca e Kontrollit të Lartë të Shtetit ka qenë e lidhur me përpjekjet e vazhdueshme për të zbatuar një metodologji bashkëkohore, bazuar në standardet ndërkombëtare për kontrollin dhe me praktikën më të mira audituese të vendeve të Bashkimit Europian. Sigurisht që në këtë drejtim ka dhe shumë mangësi, të cilat janë

objektivi kryesor i punës së këtij institucioni për vitin 2012. Ne duhet të vlerësojmë faktin se gjatë periudhës ushtrimore janë realizuar 152 kontrolle nga 150 kontrolle gjithsej të programuara, por vlerësimi i rezultateve të kontrollit është i lidhur dhe me vlerën totale të zbulimeve të dëmit ekonomik, konstatuar, evidentuar dhe të raportuara në përfundimet e kontrollit të kryer gjatë vitit 2011.

Një tregues tjetër që është rritur nga viti në vit është edhe mënyra e reagimit të institucioneve kontrolluese ndaj rekomandimeve dhe masave të propozuara. Në këtë kuadër është pozitiv fakti se nga 1605 masa të rekomanduara gjithsej janë zbatuar plotësisht 1093 prej tyre dhe pjesërisht 15, kurse në proces janë 184.

Ne duhet të jemi edhe kritikë kur bëhet fjalë për marrëdhëniet e bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë të kontrollit, siç është INTOSAI, EUROSAI, Gykata e Llogarive e Bashkimit Europian dhe me institucionet homologe të kontrollit, që ndonëse ka pasur rritje në vijimësi, nuk janë shfrytëzuar siç duhet dhe nuk kanë qenë shumë dobiprurëse për institucionin. Unë shpreh bindjen referuar raportit dhe programit të veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2012, se do të kemi një tejkalim të mangësive të vërejtura gjatë vitit 2011, si dhe do të arrihet një fuqizim i mëtejshëm i rezultateve dhe i arritjeve të derisotme të këtij institucioni. Unë do të thosha që vizioni i kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit është në të njëjtën linjë me kërkesat standarde të këtij institucioni. Me shumë rëndësi është fuqizimi i rolit të pazëvendësueshëm kushtetues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucion kryesor ekonomik-financiar, me detyrë kontrollin e miradministrimit të pronës publike dhe shëndoshjen e financave publike.

Për sqarim, zotërinj opozitarë, ju ngatërroni dëmin ekonomik me marrëdhëniet kontraktore midis subjekteve, qofshin këto edhe shtetërore, siç është "Abipetroli". Këto ditë ne kemi marrë draftligjin e ri nga kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ju ftoj të kontribuoni në këtë drejtim, pasi ligji kërkon 3/5-at

dhe të mos mjaftohemi vetëm me konstatime, por të jemi pjesë kontribuuese edhe në këtë drejtim.

Falemnderit!

* Edmond Spaho Deputet i PD, kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financa, të Kuvendit, Doktor i Shkencave Ekonomike.

Votimi i rezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2011”.

Zj. Jozefina Topalli:

Kalojmë te votimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2011”.

Hapet votimin me elektronikë.

Mbyllet votimi.

68 vota pro 52 vota kundër



Kryetarja e Kuvendit **Jozefina TOPALLI (ÇOBA)**

Kuvendi miraton rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së, për vitin 2011”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARE

Jozefina TOPALLI (ÇOBA)

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË
TË SHTETIT PËR VITIN 2011**

Kuvendi i Shqipërisë,

Nisur nga misioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit për ushtrimin e kontrollit në subjektet dhe programet publike, për t'i siguruar Kuvendit, grupeve të interesit dhe publikut të gjerë informacion mbi përdorimin e fondeve buxhetore;

Duke njohur vizionin e këtij institucioni për përdorimin e burimeve me efektivitet, në drejtim të ushtrimit të kontrollit të pavarur, objektiv, të sigurt e të besueshëm;

Mbështetur në detyrimet kushtetuese e ligjore, si dhe në objektivat afatmesëm e ata vjetorë të institucionit;

Konstaton se gjatë vitit 2011 Kontrolli i Lartë i Shtetit:

- Ka realizuar detyrat sasiore e cilësore të planifikuara në drejtim të veprimtarinë kontrolluese.
- Është përpjekur të zbatojë dhe të zhvillojë një metodologji bashkëkohore në kontroll, duke përgatitur, përmirësuar dhe përditësuar udhëzimet dhe metodikat përkatëse.

- Në auditimet financiare, u është dhënë përparësi sektorëve të ekonomisë apo subjekteve që janë vlerësuar me materialitet dhe risk të lartë. Auditimi i performancës duhet të zërë një vend më të gjerë në kontrollet dhe vlerësimet që bën institucioni.
- Ka rekomanduar arkëtimin në Buxhetin e Shtetit të dëmit ekonomik të konstatuar gjatë kontrolleve.
- Ka rritur dobinë e kontrolleve dhe cilësinë e rekomandimeve ndaj personave e subjekteve që kanë kryer shkelje ligjore.
- Ka përmirësuar veprimtarinë për kontrollin e zbatimit të legjislacionit dhe ka rritur cilësinë e propozimeve për ndryshime e përmirësime të dispozitave ligjore.
- Është i nevojshëm përshpejtimi më tej i ritmeve të kualifikimit të punonjësve dhe aplikimit të teknologjisë së informacionit. Kuvendi vlerëson masat që po merr institucioni në lidhje me këtë çështje.
- Ka mbajtur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet e përfshira në fushën e administrimit dhe kontrollit të fondeve publike. Raporte më efektive duhet të krijohen me institucionet e hetimit.
- Ka përdorur fondet buxhetore në përputhje me kuotat e planifikuara sipas zërave të buxhetit.

Kuvendi kërkon që, për vitin 2012, Kontrolli i Lartë i Shtetit të intensifikojë punën në këto drejtime:

- Kryerjen e kontrolleve ndaj përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, si dhe fondeve të projekteve të financuara nga BE-ja e nga institucionet financiare ndërkombëtare me objektivitet, profesionalizëm, cilësi dhe efektivitet të lartë.
- Rritjen e efikasitetit të veprimtarisë audituese, nëpërmjet fuqizimit të auditimit financiar dhe hedhjes së hapave më të shpejtë drejt auditimit të performancës.
- Përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, mbështetur në standardet ndërkombëtare e praktikat më të mira të vendeve të tjera.

- Harmonizimin e veprimtarisë së kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm, si dhe zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Zhvillimin e burimeve njerëzore, duke i dhënë përparësi zgjerimit dhe përmirësimit cilësor të veprimtarisë trajnuese.
- Zhvillimin e teknologjisë së informacionit, duke e sjellë atë në nivelet bashkëkohore, si dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në këtë fushë.
- Konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit.
- Rritjen e bashkëpunimit me organet e drejtësisë për shlyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.
- Rritjen e transparencës ndaj medias dhe shoqërisë civile, si dhe rritjen e bashkëpunimit me botën akademike.

26 prill 2012

seria : botime KLSH- 02/2012

ISBN: 978-9928-159-02-1



Kontrulli i Lartë i Shtetit
Bulevardi " Dëshmorët e Kombit", nr. 3,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: klsh@klsh.org.al